

# **MENAXHIMI I INSTITUCIONEVE ARSIMORE ME MËSIMNXËNIE NË DISTANCË: E-LEARNING**

MSc. Ramadan Beqiri

Dorëzuar

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në  
shkenca ekonomike me profil menaxhim për marrjen e gradës shkencore -  
Doktor

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Kosta Barjaba

Numri i fjalëve: 57 467

Tiranë, tetor 2016

## **DEKLARATA E AUTORËSISË**

Deklaroj se ky studim është punë ime origjinale. Ky punim nuk është prezantuar asnjëherë para ndonjë institucioni tjetër për botim, e as që është botuar në tërësi apo pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

## **ABSTRAKTI**

Të mësuarit nuk e humb për asnjë moment vëmendjen nga asnjë brez i shoqërisë së një shteti. Interesimi për gjërmim të metodologjive të reja për mësimnxënie shtrihet deri në pafundësi. Prandaj, zhvillimi i hovshëm i TIK-ut ka ndikuar që edhe Kosova ta planifikojë themelimin, zhvillimin dhe menaxhimin e të mësuarit elektronik. Kështu, ky studim u jep përgjigje pyetjeve kërkimore: A është të mësuarit në distancë më eficient dhe më produktiv se të mësuarit tradicional dhe cilat janë përparësitë e tij? A është eficient menaxhimi aktual i shkollës në Kosovë dhe cilat janë ndërhyrjet e nevojshme për rritjen e eficiencës?

Kampioni i studimit përfshin 500 veta (nxënës, mësimdhënës, prindër, menaxherë të arsimit dhe njohës të arsimit). Të dhënat janë grumbulluar nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve, ndërsa hulumtimi është realizuar nëpërmjet këtyre metodave: analizë, konkretizim, krahasim, vështrim, kompilim dhe kuazieksperiment.

Nga analiza e të mbledhurave të mendimeve të të intervistuarve përfundojmë: Kosova e ka një kuadër ligjor të pamjaftueshëm për rregullimin e të mësuarit në distancë; Platforma e-learning në shkollat e Kosovës është e pazhvilluar; Politizimi i sistemit arsimor është një pengesë për të mësuarit në distancë. Prandaj, për evitimin e vështirësive në këtë fushë janë përmbledhur një varg rekomandimesh. Sistemi arsimor kosovar ka nevojë: ta plotësojë kuadrin ligjor për ta rritur eficiencën e të mësuarit në distancë, me qëllim përgatitjen e burimeve njerëzore dhe forcimin e kriterëve të punësimit të mësimdhënësve, për forcimin e kriterëve për pranimin e studentëve.

Fjalë kyçe: mësimi elektronik, m-learning, mësimi tradicional, mësimi gjatë gjithë jetës.

## **ABSTRACT**

The learning new things, never loses the importance from any future generation.

The interest for exploring the new methods of studying extends to infinity.

The development of TIK had a big impact so Kosovo would plan to establish, to develop and manage the electronic learning.

This study comes with some real answers of these issues; is the distance learning more efficient and productive than the traditional learning and which are the pros of it.

Is the management of the schools in Kosovo enough efficient and what kind of interventions are necessary to increase the efficiency.

This study includes 500 people ( students, teachers, parents, managers of education and people who know more about the education). The results are collected by answering the questionnaires and the survey has been done by these methods; analysis, concretization, comparison, look, compilation and experiments.

From the analysis of collected opinions of people who were interviewed we can conclude: Kosovo has a Lack of legal framework for the regulation of distance learning.

E-learning platform in Kosovo's schools is undeveloped. The politicization of the education system is a barrier for distance learning.

Therefore, to avoid difficulties in this area there are summarized a series of recommendations. Kosovo education system needs: to complete the legal framework to increase the efficiency of distance learning, in order to prepare human resources and strengthening teacher recruitment criteria, to strengthen the criteria for admission of students.

Keywords: e-learning, m-learning, traditional teaching, lifelong learning.

## **DEDIKIMI**

Këtë punim doktoral ua dedikoj dy prindërve të mi, të cilët nuk jetojnë më; bashkëshortes sime, Mevludes, si dhe tre fëmijëve: Arianitit, Agnesës dhe Granitit.

Ata, përveç përkrahjes morale, kanë qenë edhe shtytës dhe motivues në të arriturat e mia, prandaj në këtë rast uroj që kjo punë imja të shërbejë si motivues i ndërsjellë edhe për ata.

## **FALËNDERIME**

E falënderoj udhëheqësin e këtij disertacioni, i cili më përkrahu gjatë gjithë kohës dhe më qëndroi pranë, ndërsa me sugjerimet dhe udhëzimet e tij profesionale ndikoi që ky punim ta marrë formën përfundimtare.

E falënderoj familjen time të ngushtë dhe të gjerë që pati durim të jetë pranë meje gjatë gjithë këtyre viteve të shkollimit. Për asnjë moment nuk kam vërejtur se u jam mërzitur, edhe pse i kam lënë pa gjumë, i kam shpenzuar, ua kam kufizuar piknikët e pushimet dhe shumë nga dëshirat e tyre nuk ia kam arritur t'ua plotësoj.

## **PËRMBAJTJA E LËNDËS**

### **KAPITULLI I HYRJA**

1.1.	Motivacioni (justifikimi për studimin).....	21
1.2.	Qëllimi i studimit .....	24
1.3.	Pyetjet, hipotezat dhe objektivat kërkimore.....	26
1.4.	Metodologjia .....	30
1.5.	Kufizimet e punimit .....	31
1.6.	Vështirësitë e hulumtimit .....	32
1.7.	Rezultatet e pritshme.....	33
1.8.	Struktura e punimit.....	35

### **KAPITULLI II RISHIKIMI I LITERATURËS**

2.1.	Hyrje.....	38
2.2.	Historia e të mësuarit në distancë .....	41
2.3.	Përhapja e deritanishme e e-mësimit.....	44
2.4.	“E-mësimi në Evropë: Si instruktorët, mësimdhënësit dhe nxënësit e vlerësojnë e-mësimin?” .....	48

*(“E-Learning in Europe: How do trainers, teachers and learners rate e-learning?”)*

<i>Përmbledhje e përgjithshme e hulumtimit “E-mësimi në Evropë...” .....</i>	<i>48</i>
<i>Pyetjet dhe rezultatet.....</i>	<i>50</i>

<i>Zgjedhja e modelit pedagogjik</i> .....	51
2.5. Programet për e-mësim .....	54
<i>WebCT (Web Course Tools</i> .....	56
<i>Claroline</i> .....	57
<i>Moodle</i> .....	57
<i>Mësimi në distancë nëpërmjet tabelës SMART</i> .....	58
2.6. Rëndësia e të nxënit nga distanca .....	59
2.7. E ardhmja e e-mësimit .....	61
2.8. Të nxënit nëpërmjet rrjeteve sociale: sporadik dhe sipërfaqësor .....	63
<i>Teamviewer</i> .....	64
2.9. E-libri.....	66
2.10. E-libraritë .....	68
2.11. Përfundime .....	72

### **KAPITULLI III HISTORIKU (RASTI I KOSOVËS)**

3.1. Zhvillimi historik i idesë së të mësuarit nga distanca .....	73
3.2. Shkollat virtuale .....	80
3.3. Shkollat virtuale - model i ri i të mësuarit në Kosovë .....	83
3.4. Mësonjëtoret e shekullit XXI .....	85
3.5. Historia e arsimit në Kosovë .....	88
3.6. E-mësimi në Kosovë .....	90
3.7. Mësimi tradicional .....	100
3.8. Mësimi gjatë gjithë jetës (Life Long Learning) .....	102



3.9. Si kuptohet në Kosovë mësimi në distancë: e-learning?.....	105
3.10. Epërsitë dhe mangësitë e të mësuarit në distancë .....	105
<i>Epërsitë e të mësuarit në distancë</i> .....	105
<i>Mangësitë e të mësuarit në distancë</i> .....	107
3.11. Mësimi në distancë: luks apo nevojë?.....	108
3.12. Sfidat e udhëheqjes së arsimit me mësimnxënie nga distanca .....	110
3.13. Prioritetet për menaxhimin e institucioneve të arsimit e-learning:	
cilësia apo sasia? .....	112
3.14. Menaxhimi i institucioneve arsimore me mësimnxënie e-learning .....	115
<i>Programet certifikuese për platformën digjitale të të nxënësve</i> .....	117
<i>Programe parauniversitare për mësimnxënie nga distanca (e-learning)</i> .....	118
<i>Programe universitare për mësimnxënie nga distanca e-learning</i> .....	119
<b>3.15. Përkufizimi i mësimit nga distanca sipas</b>	
legjislacionit të Bashkimit Evropian .....	120
3.16. Përkufizimi i mësimit nga distanca sipas legjislacionit kroat .....	120
3.17. Përkufizimi i mësimit nga distanca sipas legjislacionit kosovar.....	121
3.18. Përfundim.....	122

## **KAPITULLI IV      METODOLOGJIA E KËRKIMIT**

4.1. Hyrje.....	124
4.2. Çështjet dhe pyetjet kërkimore.....	125

4.3. Përshkrimi i hulumtimit.....	126
4.4. Dizajnimi i hulumtimit kërkimor .....	127
4.5. Popullata dhe zgjedhja e kampionit .....	127
4.6. Metodatat e përdorura .....	140
4.7. Hartimi i pyetësorëve dhe përmbajtja e tyre .....	142
4.8. Mbledhja e të dhënave përgjatë hulumtimit.....	147
4.9. Gjetja e variablave kyçe të hulumtimit .....	151
4.10. Kontributi i hulumtimit kërkimor .....	152
4.11. Sugjerime për studime në vijim .....	154

## **KAPITULLI V ANALIZA E TË DHËNAVE: MËSUESIT, NXËNËSIT, PRINDËRIT, MENAXHERËT DHE KOMUNITETI**

5.1. Paraqitja e të gjeturave nga terreni.....	156
5.2. Vështrim i rezultateve të mbledhura nga terreni .....	156
5.3. Analiza e besueshmërisë .....	157
5.4. Sa janë të përgatitur mësimdhënësit për zbatimin e platformës së mësimin nga distanca?.....	158
5.5. Shqyrtimi i variablave kyçe në analizën e hulumtimit e-learning.....	160
5.6. Sa janë të përgatitur nxënësit të mësojnë nga distanca? .....	201
5.7. Sa janë të përgatitur prindërit për t'i ndihmuar fëmijët e tyre	

të studiojnë me mësim nga distanca? .....	228
5.8. Sa janë të përgatitur menaxherët e arsimit për zbatimin e platformës së mësimin nga distanca? .....	235
5.9. Ku duhet të ndërhyhet në menaxhimin aktual? .....	236
5.10. Analizë dhe përfundime nga intervistat e menaxherëve të institucioneve arsimore në Kosovë .....	237
5.11. Analizë dhe përfundime nga intervistat e komunitetit (njohës të arsimit) në Kosovë.....	241
5.12. Sa e mbështet infrastruktura shkollore në Kosovë mësimin elektronik, e-mësimin? .....	244
5.13. A është e përgatitur shoqëria kosovare për ta pranuar këtë metodë mësimi? ...	245
5.14. A është mësimi i kombinuar ose i përzier (blended learning) ndryshe nga mësimi në distancë (distance learning)? .....	246
5.15. Çelësi i suksesit në arsim, e-mësimi (e-learning).....	247

## **KAPITULLI VI KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME**

6.1. Diskutime .....	249
6.1.1. <i>Diskutim lidhur me faktorët që ndikojnë në ngritjen e cilësisë në mësimnxënie nëpërmjet e-learning</i> .....	250

6.1.2. <i>Diskutimi i varshmërisë së e-learning nga mosha dhe nga përvoja e mësimdhënësve</i> .....	251
6.1.3. <i>Diskutimi i varshmërisë së variablës e-learning nga variablat tjera të pavarura: përdorimi i PC, qasja në internet, e-mail, komunikimi, interneti për ngritje profesionale, platforma online dhe vlerësimi</i> .....	252
6.1.4. <i>Varshmëria e variablës e-learning nga variablat e pavarura të nxënësve</i> ....	253
6.1.5. <i>Diskutime lidhur me intervistën me menaxherë</i> .....	256
6.1.6. <i>Diskutime lidhur me intervistën me njohës të ars</i> .....	257
6.2. Përfundime .....	259
6.3. Rekomandime .....	263
<b>Burimet dhe Bibliografia</b> .....	272
Ueb literatura .....	282
<b>SHTOJCA</b> .....	288
Pyetësi P1.....	288
Pyetësi P2.....	289
Pyetësi P3.....	294
Intervistë 1.....	295
Intervistë 2.....	297

## **LISTA E ILUSTRIMEVE**

Fig. 1. Sisteme interneti .....	39
Fig. 2. ECDL.....	41
Fig. 3. Korrespondenca nëpërmjet postës .....	42
Fig. 4. Wikipedia në shqip .....	47
Fig. 5. Enciklopedia Encarta .....	47
Fig. 6. Smart tabela .....	59
Fig. 7. Faqja startuese e TeamViewer.....	65
Fig. 8. E-learning.....	74
Fig. 9. Sateliti Telstar 1 .....	77
Fig. 10. Learning cafe .....	86
Fig. 11. Shkolla “pa mure”.....	87
Fig. 12. Faqja startuese e almooc-ut.....	95
Fig. 13. Laboratori virtual i fizikës .....	96
Fig. 14. Linku: nektari.....	96
Fig. 15. ECDL.....	98
Fig. 16. Mësonjëtorja e Korçës, 1887 .....	100

## **LISTA E TABELAVE DHE DIAGRAMEVE**

### *Tabelat*

Tabela 1. Të dhënat për nxënësit pjesëmarrës në hulumtim .....	129
Tabela 2. Tabela e frekuentimit .....	130
Tabela 3. Klasa e nxënësve .....	131
Tabela 4. Përdorimi i PC nga nxënësit.....	131
Tabela 5. Qasja e nxënësve në internet .....	132
Tabela 6. Të dhënat për mësimdhënësit pjesëmarrës në hulumtim .....	133
Tabela 7. Tabela e frekuentimit të mësimdhënësve .....	134
Tabela 8. Moshë e mësimdhënësve.....	134
Tabela 9. Përdorimi i kompjuterit (PC) .....	135
Tabela 10. Përvoja e punës së mësimdhënësve.....	135
Tabela 11. Qasja në internet.....	136
Tabela 12. Të dhënat për prindërit pjesëmarrës në hulumtim.....	137
Tabela 13. Shkollimi i prindërve.....	138
Tabela 14. Moshë e mësimdhënësve.....	138
Tabela 15. Përdorimi i kompjuterit nga prindërit.....	139
Tabela 16. Përvoja e punës së prindërve .....	139
Tabela 17. Përdorimi i kompjuterit për ngritje profesionale.....	139
Tabela 18. Grupet e hulumtuara.....	149
Tabela 19. Besueshmëria e analizës.....	157
Tabela 20. Vendbanimi i mësimdhënësve .....	161
Tabela 21. Prezantimi i të anketuarve në grupmosha të caktuara lidhur me e-learning .....	163

Tabela 22. Lidhja ndërmejt “ <i>e-learning</i> ” dhe “ <i>mosha</i> ” .....	164
Tabela 23. Përvoja e punës së mësimdhënësve.....	166
Tabela 24. Lidhja ndërmejt “ <i>e-learning</i> ” dhe “ <i>përvoja e punës</i> ” .....	167
Tabela 25. Lidhja ndërmejt variablove: “ <i>e-learning</i> ” dhe “ <i>përdorimi i PC</i> ” .....	169
Tabela 26. “Chi-Square Tests “ - “ <i>e-learning</i> ” dhe “ <i>përdorimi i PC</i> ” .....	170
Tabela 27. Qasja e mësimdhënësve në internet .....	171
Tabela 28. Lidhja ndërmejt “ <i>e-learning</i> ” dhe “ <i>qasja në internet</i> ” .....	173
Tabela 29. “ <i>e-learning</i> ” dhe “ <i>përdorimi i e-mail-it</i> ” .....	175
Tabela 30. Lidhja ndërmejt “ <i>e-learning</i> ” dhe “ <i>e-mail</i> ” .....	176
Tabela 31. Komunikimi me nxënës nëpërmjet e-mail-it.....	178
Tabela 32. Lidhja ndërmejt “ <i>e-learning</i> ” dhe “ <i>komunikimi</i> ” .....	179
Tabela 33. “Chi Square” për “ <i>e-learning</i> ” dhe “ <i>komunikimi</i> ” .....	180
Tabela 34. . Lidhja ndërmejt “ <i>e-learning</i> ” dhe “ <i>ngritje_internet</i> ” .....	181
Tabela 35. Lidhja ndërmejt “ <i>e-learning</i> ” dhe “ <i>ngritja_internet</i> ” .....	182
Tabela 36. Lidhmëria e “ <i>platformës online</i> ” dhe “ <i>e-learning</i> ” .....	184
Tabela 37. Lidhja ndërmejt “ <i>e-learning</i> ” dhe “ <i>platforma online</i> ” .....	185
Tabela 38. Vlerësimi (1-5) për përdorimin e platformës online .....	187
Tabela 39. Vlerësimi i platformës nga 1 (nivel i ulët i vlerësimit) deri në 5 (nivel i lartë i vlerësimit).....	188
Tabela 40. Lidhja ndërmejt “ <i>e-learning</i> ” dhe “ <i>vlerësimi</i> ” .....	189
Tabela 41. Përmbajtja e pyetjeve 11, 12, 13 ,14 dhe 15 .....	191
Tabela 42. Vetëvlerësimi për mësimin në distancë.....	192
Tabela 43. Interneti dhe libri .....	193
Tabela 44. Përdorimi në të ardhmen i <i>e-mësimit dhe m-mësimit</i> .....	194

Tabela 45. Përdorimi në të ardhmen i e-mësimit dhe m-mësimit .....	195
Tabela 46. Njohja e teknikave.....	196
Tabela 47. Mjetet teknologjike që përdoren për e-mësim.....	197
Tabela 48. Pjesëmarrja dhe përgjigjet e mësimdhënësve lidhur me e-learning .....	199
Tabela 49. Statistika e variablës: e-learning .....	199
Tabela 50. Vendbanimi i nxënësve .....	203
Tabela 51. Shpërndarja e nxënësve dhe përqindja .....	203
Tabela 52. Shpërndarja e nxënësve nëpër klasa.....	204
Tabela 53. Lidhja ndërmjet variablave “e-learning” dhe “përdorimi i PC_nx” .....	206
Tabela 54. “Chi-Square Tests” - “e-learning” dhe “përdorimi i PC_nx” .....	207
Tabela 55. Qasja e nxënësve në internet .....	209
Tabela 56. Lidhja ndërmjet “e-learning” dhe “qasja në internet_nx” .....	210
Tabela 57. “e-learning” dhe “përdorimi i email_nx” .....	211
Tabela 58. Lidhja ndërmjet “e-learning” dhe “e-mail_nx” .....	213
Tabela 59. Komunikimi i nxënësve me mësimdhënës nëpërmjet e-mail-it .....	214
Tabela 60. Lidhja ndërmjet “e-learning” dhe “komunikimi me e-mail_nx” .....	216
Tabela 61. Përdorimi i internetit për mësim nga distanca.....	217
Tabela 62. Lidhja ndërmjet “e-learning” dhe “mësimi në distancë_nx” .....	219
Tabela 63. Lidhshmëria e “e-learning” dhe “platforma online_nx” .....	221
Tabela 64. Lidhja ndërmjet “e-learning” dhe “platforma online” .....	222
Tabela 65. Vlerësimi i platformës online .....	223
Tabela 66. Vlerësimi (1-5) për përdorimin e platformës online .....	224
Tabela 67. Lidhja ndërmjet “e-learning” dhe “vlerësimi_nx” .....	225
Tabela 68. Vetëvlerësim për mësimin nga distanca.....	227



Tabela 69. Mjetet teknologjike që përdoren për e-mësim.....	228
Tabela 70. Qasja në internet.....	229
Tabela 71. Përdorimi i internetit .....	230
Tabela 72. Komunikimi i fëmijëve .....	231
Tabela 73. Përdorimi i internetit për ngritje profesionale .....	232
Tabela 74. Njohuritë për mësimin në distancë.....	233
Tabela 75. Vlerësimi i platformës nga 1 deri në 5 .....	234
Tabela 76. Vetëvlerësimi i prindërve për njohuritë e mësimin nga distanca .....	234
Tabela 77. Pearson Chi-Square dhe Likelihood Ratio për variablën e varur dhe variablat e pavarura të mësimdhënësve.....	253
Tabela 78. Pearson Chi-Square dhe Likelihood Ratio për variablën e varur dhe variablat e pavarura të nxënësve .....	254

### ***Diagramet***

Diagrami 1. Vendbanimi i mësimdhënësve të intervistuar .....	162
Diagrami 2. Moshë e mësimdhënësve të intervistuar .....	165
Diagrami 3. Përvoja e punës së mësimdhënësve .....	168
Diagrami 4. Përdorimi i kompjuterit nga mësimdhënësit .....	171
Diagrami 5. Qasja në internet.....	174
Diagrami 6. Përdorimi i postës elektronike nga mësimdhënësit.....	177
Diagrami 7. Komunikimi me nxënës nëpërmjet e-mail-it .....	180
Diagrami 8. Përdorimi i internetit për ngritje profesionale.....	183
Diagrami 9. Platforma online .....	186

Diagrami 10. Vlerësimi i platformës nga 1 deri në 5.....	190
Diagrami 11. Vetëvlerësimi për mësimin në distancë .....	192
Diagrami 12. Interneti do t'i zëvendësojë librat.....	193
Diagrami 13. Përdorimi në të ardhmen i e-mësimit dhe m-mësimit.....	194
Diagrami 14. e-mësimi dhe m-mësimi do të zëvendësojnë mësimin tradicional .....	195
Diagrami 15. Njohja e teknikave .....	196
Diagrami 16. Mjetet teknologjike që përdoren për e-mësim .....	198
Diagrami 17. Vendbanimi i nxënësve.....	204
Diagrami 18. Përdorimi i PC nga nxënësit.....	208
Diagrami 19. Qasja e nxënësve në internet.....	211
Diagrami 20. Përdorimi i postës elektronike nga nxënësit .....	213
Diagrami 21. Komunikimi me nxënës nëpërmjet e-mail-it .....	216
Diagrami 22. Përdorimi i internetit për mësim nga distanca .....	220
Diagrami 23. Platforma online .....	223
Diagrami 24. Vlerësimi i platformës online nga 1 deri 5.....	226
Diagrami 25. Përqindja e mjeteve teknologjike.....	228
Diagrami 26. Qasja në internet .....	229
Diagrami 27. Përdorimi i internetit .....	230
Diagrami 28. Përdorimi i internetit për komunikim ndërmjet fëmijëve .....	231
Diagrami 29. Përdorimi i internetit për ngritje profesionale.....	232
Diagrami 30. Njohuritë për mësimin në distancë.....	233
Diagrami 31. Vlerësimi i platformës nga 1 deri në 5.....	234

## **LISTA E SHKURTIMEVE DHE FJALORI**

TIK - Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

PSH - Posta Shqiptare

PTT - Posta, Telefoni dhe Telegrafi i Kosovës

PTK - Postë-Telekomi i Kosovës

CAL - computer assisted learning

CBI - computer based instruction

CD - compact disk

ROM - read only memory

e-mësimi - mësimi elektronik

m-mësimi - mësimi mobil

BE - Bashkimi Evropian

ETV - European Training Village

IAP - Institucioni Arsimor Privat

IAL - Institucioni i Arsimit të Lartë

DKA - Drejtoria Komunale e Arsimit

LMS - Learning Management System

ECDL - European Computer Driver Licence

DLS - Distance learning system

SHPK - Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara

Wi-fi - rrjeti pa kablo

AKA - Agjencia e Kosovës për Akreditim

MASHT - Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë

BEP - Basic Education Program

IP - Instituti Pedagogjik

AKK - Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve

SAAP - Sektori për Arsim dhe Aftësim Profesional

DAAP - Divizioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional

AAAP dhe ARR - Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rriturit

IP - Instituti Pedagogjik,

SAAP - Sektori për Arsim dhe Aftësim Profesional

AKK - Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK)

## KAPITULLI I    HYRJA

### 1.1.Motivacioni (justifikimi për studimin)

Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ka ndikuar që procesi i arsimimit në shkollat e Kosovës ta ndjekë me përkushtim progresin që është bërë e që po bëhet në të mësuarit në vendet e zhvilluara. Sipas (Gerbault J 2002:12), TIK-ët përkufizohen si: *“bashkësia e teknologjive më të avancuara që përdoren për të komunikuar, shkëmbyer, trajtuar dhe modifikuar informacionin në mënyrë sinkronike apo asinkronike”*.

Mësimi në shkollat tona ka nisur shumë më herët sesa thuhet në datat historike të të mësuarit. Në fillim, mësimi në trojet tona shqiptare zhvillohej nëpër oda (dhoma të veçanta për pritje). Aty bartej dija, tradita, kultura, trimëria, besnikëria dhe bujaria. Më vonë filluan të zhvillohen mësimet nëpër shkolla, derisa në vitet e ‘90-ta të shekullit të kaluar u ndesh me një vështirësi e paparë, ngaqë nga regjimi i egër i asaj kohe mëtohej zhbërja e shkollës shqipe. Në vitet e pasluftës, në Kosovë po aplikohen të gjitha të arriturat e metodave më të fundit në fushën e arsimit, me ç’gjë rritet nevoja e të mësuarit edhe nëpërmjet teknologjive më të reja nga distanca.

Të mësuarit nga distanca i ka fillet e saj të para tash e mbi 100 vjet. Aso kohe mësimi nga distanca nisi nëpërmjet postës, pastaj nëpërmjet radiotelevizioneve nga të cilat shpërndahej dija nga mësuesit e profileve të ndryshme. Por, edhe kjo metodë u zëvendësua me shpejtësi të madhe falë zhvillimit të hovshëm të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK).

Bartjen e informatave nga një vend në tjetrin në distancë të madhe e mundësoi interneti. Falë kësaj, ne edhe sot në Kosovë mund ta zhvillojmë mësimin nga distanca. Shpesh ndodh që për arsye nga më të ndryshmet, studiuesi nuk arrin dot deri te mësimdhënësi, aty ku është burimi i informacionit. Për shkak të pamundësive të ndryshme, ai mbetet pa nxënie të diturisë kritike për formimin e tij profesional. Ndjekja e mësimëve në shkollë

do t'i mundësojë nxënësit mirëqenie, ngritje profesionale, duke e çuar në studime më të thella shkencore.

Ngritja e vetëdijes për të nxënë në çdo kohë dhe nga çdo vend në të kaluarën do të quhej një arritje me “shkop magjik”. Ndërsa kur e përmendim shkopin, mendja mund të na shkojë te “shkopi i bardhë” (Rotim, 2014:31), kur nëpërmjet kësaj forme të të nxëni mundësohet mësimi dhe komunitetit me shikim të dobësuar. Një numër pesimistësh kanë mbetur të shtangur përballë metodës së të nxënit nga distanca nëpërmjet teknologjive të reja. Ata madje shkojnë aq larg, duke pretenduar se kjo nuk mund të ketë sukses, ngase, gjithnjë sipas tyre, kjo metodë do të përmbysë gjithçka të mirë që kishte sistemi ynë arsimor. Në anën tjetër, mësimnxënia në distancë nënkuptohet vetëm si një ndihmesë që u ofrohet të gjitha komuniteteve. Shumë studentë e kanë përfunduar ciklin e shkollimit e nuk kanë gjetur ende punë, apo për shkak të zhvillimeve të ndryshme rrezikohen të humbin vendet e tyre të punës. Andaj shtrohet pyetja: Si do të gjejnë kohë që t'i rifillojnë studimet për t'u aftësuar në degë e drejtime të ndryshme? Po ata që janë larg një institucioni arsimor, i cili kërkon burime të mëdha financiare për të studiuar jashtë vendit, si do t'ia dalin? Po individët që nuk mund të lëvizin lirshëm për shkaqe të ndryshme, të mbeten pa u aftësuar?

Sigurisht që pesimizmi është motiv për të suksesshmit, duke i ofruar kësaj shoqërie pa dallim modele të reja të cilat do të jenë ndihmesë për mësimnxënie, çfarë ata e kanë ëndërruar me dekada. Kjo na bën edhe më të fuqishëm, meqë çdo ditë na kaplojnë portalet e ndryshme me oferta të jashtëzakonshme për mësimnxënie nga distanca-distance learning, i bazuar në e-mësim (e-learning) dhe tani së fundmi edhe m-mësim (m-learning). Por, shumica e portaleve të tilla nuk janë në gjuhën shqipe, që do të thotë se nuk janë punuar nga ne dhe për ne. Shkollat e këtilla janë emërtuar si: shkolla pa mure, shkolla virtuale, apo shkolla për këdo.

Motoja e përgjithshme e mësimimit në distancë është: kudo që je, kurdo që ke kohë dhe sa herë që ke nevojë për mësim. Në anën tjetër, realizimi i kësaj ëndrre është bërë realitet. Shkolla të shumta në SHBA, tashmë gati 50 % të të nxënit e bëjnë nga distanca. Në këtë rrugëtim shkojnë edhe shkollat tjera të shumë vendeve të BE-së.

Cilët janë faktorët e implementimit të të mësuarit nga distanca?

- **Nxënësit** janë faktorët që do ta përhapin këtë mënyrë të të nxënimit, pa dyshim ndër më kryesorët. Ata duhet të motivohen, të mbështeten, të inkurajohen dhe të shpërblehen në çdo situatë.
- **Mësimdhënësit** e kanë barrën kryesore për mënyrat e përhapjes së dijes, ngase ata mund edhe të dështojnë në këtë rrugëtim, i cili do të jetë i kushtueshëm për një shoqëri të tërë.
- **Institucionet qeverisëse**, e posaçërisht Ministria e Arsimit (MASHT) duhet të luajë rol të rëndësishëm në këtë fushë.
- **Infrastruktura** do të çojë në ngritjen e cilësisë në arsim. Pa dyshim se infrastruktura duhet të jetë në nivelin e pranueshëm dhe e përballueshme nga nxënësit.
- **Komuniteti** është faktor kyç që ndihmon në realizimin e të mësuarit nga distanca, ku ekspertë të fushave të ndryshme, si sociologë, filozofë, analistë, psikologë e pedagogë e shumë të tjerë ndihmojnë në implementimin e të mësuarit nga distanca.
- **Prindërit** janë më meritorët për nga rëndësia. Ata do ta vuanin dënimin për fëmijën e tyre në rast të një dështimi me rastin e reformave në arsim. Ata në fund duhet ta japin edhe pëlqimin e tyre, pa të cilin nuk do të fillonte kthesa e të mësuarit nga distanca.

Pesha dhe rëndësia e hulumtimit që ka të bëjë me të nxënimit nëpërmjet teknologjive të reja me e-mësim (e-learning) ka vënë pah një varg objektivash për një përmbyllje sa më të thukët të punës, e cila do t'i nxjerrë edhe përfundimet e rekomandimet drejtuar aktorëve përgjegjës të shoqërisë kosovare. Rregullimi i anës ligjore, e cila sjell deri te licencimi dhe akreditimi i institucioneve publike, private apo edhe publiko-private për reforma të thella në arsim, të cilat do të jenë edhe selektuese për të gjithë ata që nuk arrijnë do të jenë në trend me zhvillimet e hovshme të IT-së. Në veçanti kërkohet mirëmenaxhimi i këtyre institucioneve, ngase dështimi i tyre është përdhosje e suksesit të pritshëm për ngritje të cilësisë së arsimit. Kjo na dërgon te një varg kërkesash për Kosovën, si:

- Nevoja e përmirësimit të menaxhimit për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit nga distanca - e-learning;

- Rritja e cilësisë së mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit nga distanca - e-learning;
- Studimi dhe vlerësimi i faktorëve që ndikojnë në ngritje të zhvillimit të cilësisë së arsimit;
- Identifikimi i fushave që bëjnë të mundur rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në institucionet arsimore kosovare;
- Përcaktimi i efekteve të aplikimit të këtij modeli në praktikën konkrete të zhvillimit të mëtutjeshëm të arsimit ekzistues;
- Studimi dhe vlerësimi i faktorëve që ndikojnë në ngritjen e zhvillimit të cilësisë së arsimit.

## 1.2.Qëllimi i studimit

Qëllimi i këtij punimi doktoral është hulumtimi në terren, në institucionet arsimore dhe me protagonistët e sistemit arsimor dhe të procesit të mësimdhënies e mësimnxënies, mundësive, përparësive, pengesave dhe sfidave për implementimin e të nxënës nga distanca, zbulimi i sinergjisë ndërmjet të mësuarit tradicional dhe të mësuarit në distancë, si dhe analiza krahasimore ndërmjet këtyre dy metodave të të mësuarit e të të nxënës si një rrugë për të arritur sukses më të mirë në arsimimin e brezave të rinj.

Duke u nisur nga premisa se të nxënës arrihet nëpërmjet komunikimit, punimi synon të zbulojë se cili komunikim është më i përshtatshëm: komunikimi tradicional, komunikimi nga distanca, apo kombinimi i kombinuar?

Dëshmia se edhe sistemi arsimor në Kosovë, si pjesë e kësaj shoqërie të një “familjeje” të madhe duhet të jetë i barabartë dhe i barasvlershëm, krijon kërkesën e të nxënës nga distanca si pjesë e të mësuarit sipas fjalës së fundit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK). Kuadrot tona arsimore duhet të jenë më të përgatitura profesionalisht, në të njëjtin nivel me vendet e rajonit, sidomos me vendet e BE-së.



Shoqëria kosovare duhet ta shikojë të ardhmen, pa e harruar të kaluarën, dhe ta bëjë të pamundurën për të bërë reforma të thella në arsim, në mënyrë që kuadrot e reja të gjërmojnë dije dhe të korrin suksese me gjeneratat e reja, për të nxjerrë të rinj profesionistë të kërkueshëm në tregun evropian dhe botëror.

Nevoja e madhe që Kosova e ka në rrafshin evropian dhe ndërkombëtar është një sfidë e këtij studimi, që të ofrohet një mundësi e re për gjetjen e mënyrave të lehta dhe, para së gjithash, pak të kushtueshme, për studim të fushave nga më të ndryshmet që organizohen edhe nga vendet më të skajshme të globit.

Misioni i një mësimdhënësi të suksesshëm është që nxënësi i tij ta tejkalojë atë. Për përmbushjen e këtij misioni, mësimdhënësi duhet të jetë gjithnjë në krye të detyrës, ngaqë prania e tij pranë nxënësit është rezultat i suksesit të tij. Në saje të metodave të reja të të nxënimit në distancë nëpërmjet e-mësimit (e-learning), mësimdhënësi në përgjithësi mund të jetë në çdo kohë pranë nxënësit të tij. Prania e përhershme e tij në botën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit është virtuale. Pra, mësimdhënësi nëpërmjet kësaj metode do të quhet mësues virtual. Edhe shkolla që nxënësi ndjek nga distanca, por edhe klasa në të cilën ai ndjek leksionet bashkë me nxënësit tjerë të larguar ndërmjet vete me mijëra e mijëra kilometra janë virtuale. Sigurisht se institucioni arsimor, qoftë ai publik apo privat, është plotësisht i vetëdijshëm se kjo metodë është sfidë që nuk kapërcehet lehtë.

Kostoja e lartë e investimeve në pajisje, në përgatitje profesionale të vazhdueshme për mësimdhënësit virtual, mirëmbajtja e tyre nga inxhinierët e IT-së dhe mbrojtja e siguria nga sulmet kibernetike janë faktorë të mosguximit për investime në këtë fushë.

Ndërkaq këto investime e ulin koston e shpenzimeve të atyre që, në anën tjetër, mësojnë nga këto shkolla.

Prandaj, paraqitet nevoja dhe domosdoshmëria që edhe në Kosovë të mendohet dhe të veprohet sa më parë që të jetë e mundur që mësimet nga distanca ta fillojnë funksionin e mirëfilltë, bazuar në e-mësim (e-learning) dhe m-mësim (m-learning). Meqë ndryshimet

e mëdha në pajisje TIK ndikojnë në humbjen e hapit të atyre që ngecën në vend, është e rëndësishme vendimmarrja shtetërore për përkrahje të institucioneve të veta publike, apo edhe publiko-private, për implementimin sa më të shpejtë të të nxënimit nëpërmjet këtyre metodave të reja (Dauti, 2008). Shoqëria ballafaqohet me disa lloje të vendimeve, ndër të cilat mund të veçohen: cilat të mira dhe shërbime t'i prodhojë, si të prodhojë dhe kush i merr të mirat dhe shërbimet.

Nga këto kontekste buron edhe nevoja e këtij hulumtimi për t'i vënë në pah të pabërat dhe të paimplementueshmet në këtë fushë, e cila do ta bënte shoqërinë kosovare të ngrihej në disa shkallë në renditjen e universiteteve botërore sa i përket cilësisë në arsim. Ka vite të tëra që është vërejtur nevoja e madhe për një studim të tillë, prandaj dhe është punuar me përkushtim të veçantë gjatë këtyre viteve të studimit.

Aplikimi i të mësuarit nga distanca nëpërmjet e-mësimit do të ndikojë edhe në punësimin e moshave të reja. Ata duhet të jenë të përgatitur profesionalisht për ta zbatuar këtë platformë të re të të nxënimit. Për këtë duhet pasur parasysh edhe në planifikimin e punonjësve. Planifikimi i punonjësve është procesi nëpërmjet të cilit menaxherët sigurohen se organizata e ka numrin dhe llojin e duhur të punonjësve në pozicionet e duhura, në kohën e duhur (Robbins, 2012).

### **1.3. Pyetjet, hipotezat dhe objektivat kërkimore**

Problem më vete, si për çdo lëndë që fillon hulumtimin, pa dyshim se është që të dijë se si ta fillojë mirë punën e vet (Quivy, 2000:37). Shpesh hulumtuesi bie në të ashtuquajturit rrahë koncentrikë, nga të cilët nuk del dot, duke mos ditur se e ka gjetur rrugën e duhur për hulumtimin e tij, apo thjesht ecën në një rrugë pa krye. Ndaj edhe nisja e punës së këtij hulumtimi daton para disa vitesh, ku në fillim ishte e vështirë gjetja e materialit për t'u mbështetur, si dhe udhëheqësi i temës, me të cilën rrugëtuam për disa vjet me radhë.

Pesha dhe rëndësia që ka ky hulumtim, e që ka të bëjë me të nxënit nëpërmjet teknologjive të reja me e-mësim (e-learning), ka vënë në pah një varg objektivash për një përmbyllje sa më të thukët të punës, e cila do t'i nxjerrë edhe përfundimet dhe rekomandimet drejtuar aktorëve përgjegjës të shoqërisë kosovare. Rregullimi i anës ligjore, e cila sjell deri te licencimi dhe akreditimi i institucioneve publike, private apo edhe publiko-private për reforma të thella në arsim, të cilat do të jenë edhe selektuese për të gjithë ata që nuk arrijnë, do të jenë në trend me zhvillimet e hovshme të IT-së. Në veçanti kërkohet mirëmenaxhimi i këtyre institucioneve, ngase dështimi i tyre është përdhosje e suksesit të pritshëm për ngritje të cilësisë së arsimit. Kjo na dërgon te një varg kërkesash për Kosovën, si:

- Nevoja e përmirësimit të menaxhimit për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit nga distanca - e-learning;
- Rritja e cilësisë së mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit nga distanca - e-learning;
- Studimi dhe vlerësimi i faktorëve që ndikojnë në ngritje të zhvillimit të cilësisë së arsimit;
- Identifikimi i fushave që bëjnë të mundur rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në institucionet arsimore kosovare;
- Përcaktimi i efekteve të aplikimit të këtij modeli në praktikën konkrete të zhvillimit të mëtutjeshëm të arsimit ekzistues;
- Studimi dhe vlerësimi i faktorëve që ndikojnë në ngritjen e zhvillimit të cilësisë së arsimit.

Të nxënit në distancë (e-learning) është një mënyrë e fuqishme dhe populiste e dhënies së arsimit dhe formimit profesional të vazhdueshëm, veçanërisht kur ai mbështetet në teknologji të reja të informimit dhe komunikimit (TIK).

Pyetja kryesore kërkimore mbi të cilën është ngritur ky punim doktoral synon të nxjerrë në pah se cila metodologji është më e suksesshme gjatë të nxënit, mësimi në distancë apo ai tradicional. Gjithashtu, pyetja kërkimore synon zbulimin e përparësive të të nxënit nga distanca. Të nxënit nga distanca nëpërmjet e-mësimit dhe m-mësimit i ka edhe pengesat dhe vështirësitë e veta. Ato gërshetohen dhe e sfidojnë njëra-tjetrën edhe në aspektin e qëndrimit neutral dhe profesional, që d.m.th. e plotësojnë njëra-tjetrën.

Pyetjet kryesore kërkimore mbi të cilat është ngritur ky punim doktoral synojnë të nxjerrin në pah se cila metodë mund të bëhet praktikisht më e suksesshme gjatë të nxënit në kontekstin e sistemit arsimor të Kosovës: mësimi në distancë apo mësimi tradicional, si edhe të zbulojnë përparësitë, pengesat dhe sfidat e të të nxënit nga distanca. Pyetjet kërkimore për këtë hulumtim janë:

Pyetja e parë kërkimore: *Sa mund të bëhet praktikisht në kontekstin kosovar të mësuarit në distancë një metodë më produktive dhe më efiçiente sesa të mësuarit tradicional?*

Pyetja e dytë kërkimore: *Cilat mund të jenë ndërhyrjet e nevojshme në sistemin arsimor në Kosovë për të nxitur e mbështetur të mësuarit në distancë?*

Të mësuarit tradicional e ka përvojën e vet të gjatë të të nxënit. Gjatë kohës janë bërë përpjekje për të bërë reforma dhe integritime të ndryshme të huazuara nga vendet e rajonit, duke i marrë si “kallëp-modele”, e të cilat më vonë shpesh janë braktisur si të dështuara. Menaxhimi aktual që po e udhëheq arsimin në Kosovë nuk është tërësisht adekuat, andaj duhet të bëhen reforma rrënjësore, për të cilat është shkruar në vijim të këtij hulumtimi.

Shekulli XXI është cilësuar si “shekulli i dijes”, prandaj zhvillimi i hovshëm që i ka përfshirë teknologjitë e reja të informimit dhe komunikimit e ka pasuruar procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Këto zhvillime i kanë aktivizuar tejmas ekspertët e arsimit dhe njohësit tjerë të kësaj fushe që të jenë në gjendje gatishmërie për t’u përballur me këtë sfidë. Nëse e shohim nga këndi historik, Kosova i ka zhvilluar ndaras prej Shqipërisë dhe trojeve të tjera jashtë kufijve natyralë proceset edukativo-arsimore. Tani mëtojnë një planprogram unik arsimor, të mbështetur në Sistemin e Bolonjës. Sistemi aktual i menaxhimit e vështirëson ekuivalentimin e diplomave, përfshirë edhe të nxënit nga distanca që realizohet si e-mësim (e-learning) dhe m-mësim (m-learning).

Metodologjia mësimore tradicionale dhe metodologjia mësimore në distancë janë të lidhura me njëra-tjetrën, e të cilat me sukses e ndihmojnë efikasitetin e njëra-tjetrës. Thjesht, këto nuk cilësohen si konkurrenca të njëra-tjetrës, por si plotësim i pajustificueshëm ndër vete.

Se implementohen metodat e reja në arsimin kosovar, a e kanë integritetin e plotë menaxherët institucionalë për përballje me këto ndryshime dhe sa kemi të dhëna nga terreni për përfshirjen e mësimdhënësve dhe të nxënësve në këtë drejtim, këto janë sfidat që kërkojnë angazhim dhe përkushtim.

Të dy hipotezat e studimit mbështeten mbi verifikimin në praktikë të përgjigjeve të të dy pyetjeve kërkimore.

***Hipoteza e parë: Të mësuarit në distancë është më eficient, më produktiv dhe më parësor sesa të mësuarit tradicional, edhe në kontekstin e sistemit arsimor në Kosovë.***

***Hipoteza e dytë: Aplikimi i metodës së të mësuarit në distancë kërkon si parakusht ndryshimin e menaxhimit të sistemit arsimor dhe shkollave në Kosovë.***

#### 1.4. Metodologjia

Me metodologji nënkuptojmë zgjedhjen e metodave dhe procedurave që përbëjnë thelbin e këtij projekti kërkimor (Jakupi, 2005).

Gjatë punimit të këtij disertacioni, kujdes i është kushtuar plotësisht të veçorive themelore të metodave: objektivitetit, besueshmërisë, precizitetit, sistemimit dhe tërësisë.

Gjatë këtij hulumtimi janë përdorur disa metoda:

**Metoda e analizës:** Nëpërmjet kësaj metode është bërë zbërthimi i mendimeve të nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve për pikëpamjet e tyre rreth të mësuarit tradicional dhe atij në distancë, nëpërmjet teknologjive të reja, si: e-learning dhe m-learning. Po ashtu, këtu janë inkorporuar edhe metoda e analizës së teknologjisë (meqë hulumtimi ka të bëjë pikërisht me shkencën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit-TIK), si dhe metoda e analizës kualitative (cilësore). Zbërthimi i konkluzioneve të kampionëve ka të bëjë me analiza cilësore, prandaj kjo metodë ndihmon shumë në përgjigjen e pyetjes kërkimore që ka të bëjë me eficiencën e të nxënësve tradicional dhe atij nga distanca, nëpërmjet e-learning.

**Metoda e konkretizimit:** Hulumtimi ka të bëjë me të mësuarit, i cili konkretizohet në mësim tradicional dhe mësim nga distanca. Të mësuarit është kuptim i përgjithshëm që nënkupton mësimin tradicional, ndërsa kur të mësuarit e konkretizojmë ia shtojmë prepozicionet: nga distanca nëpërmjet teknologjive të reja, e-learning apo m-learning.

**Metoda e krahasimit:** Gjatë hulumtimit kërkohet të arrihen konkluzione, të cilat synojmë të jenë të sakta. Meqë kërkohet ta nxjerrim një paralele ndërmjet mësimin tradicional dhe atij në distancë, që realizohet nëpërmjet TIK-ëve, metoda e krahasimit ndihmon shumë në nxjerrjen e konkluzioneve përfundimtare.

**Metoda e vështrimit:** Për nxjerrjen e përfundimeve se cili model i të mësuarit është më eficient: të mësuarit tradicional, apo të mësuarit nga distanca nëpërmjet e-learning, janë përdorur pyetësorët dhe intervistat. Prandaj, nëpërmjet kësaj metode janë zbatuar teknikat e anketimit dhe intervistave. Pasi janë mbledhur pyetësorët dhe intervistat, puna ka vazhduar me paraqitjen e rezultateve tabelare.

**Metoda e kompilimit:** Për të qenë punimi sa më i kompletuar, gjatë punës kërkimore-shkencore është rishikuar edhe literatura e mëhershme e hulumtimeve të kësaj fushe nga vendet evropiane, vendeve në zhvillim, si dhe shteteve të rajonit. Përvojat e tyre, rezultatet dhe teknikat e marra në këtë hulumtim janë cituar në bazë të kritereve të parapara nga UET.

**Metoda kuazi-eksperimentale:** Fillimit të këtij hulumtimi i ka paraprirë ideja e krahasimit të të nxënit me metodologji të reja. Për të marrë guximin e thellimit të studimeve të nivelit të tretë, gjatë hulumtimit në studimet master janë bërë kërkime shkencore për të marrë konkluzione për të nxënit në mënyrë tradicionale dhe të nxënit me metoda të avancuara nga teknologjitë e reja, nëpërmjet e-learning. Kjo metodë (kuazi-eksperimentale) është aplikuar edhe gjatë këtij hulumtimi.

Paraqitja e rezultateve do të prezantohet në disa forma: tabela, grafikë, të shprehura në formë numerike dhe me përqindje (%).

### **1.5. Kufizimet e hulumtimit**

Ky hulumtim ka kufizime për sa i përket mungesës së literaturës dhe kërkimeve shkencore në Kosovë, të cilat lidhen edhe me mungesën e analizës statistikore sasiore për ndikimin e të nxënit nga distanca nëpërmjet teknologjive të reja në mënyrë elektronike, e-learning. Gjatë hulumtimit po ashtu është vërejtur se mungon literaturë në gjuhën shqipe, e cila

merret me studime të thelluara për t'i motivuar nxënësit për t'i ndjekur mësimet nga distanca nëpërmjet mësimet elektronik e-learning. Gjithashtu, një hulumtim i publikuar nga hulumtuesi i këtij disertacioni: *Doubt of the parents towards the children of excessive use of the internet* (Beqiri, 2016), paraqet shqetësimet e prindërve dhe fëmijëve për mungesë të portale edukative që i udhëzojnë fëmijët si të mbrohen nga abuzimet e ndryshme në internet.

Në Kosovë, kjo platformë është në fazën e fillimit të implementimit. Që të arrihet pavarësi e plotë e të nxënit nga distanca veprojnë shumë faktorë, të cilët janë të vështirë për t'u plotësuar, si infrastruktura, kuadrot arsimore të papërgatitura për këtë metodë të të nxënit, pranimi i rrezikut për dështim nga prindërit, përgatitja e nxënësve, kostoja e lartë për mësonjëtoare dhe kuadrot tjera profesionale etj.

### **1.6. Vështirësitë e hulumtimit**

Gjatë këtij hulumtimi paraqiten një varg vështirësish, të cilat ndikuan drejtpërdrejt në kohëzgjatjen e përfundimit të këtij hulumtimi.

Ishte e vështirë të identifikoheshin shkollat të cilat do të zgjidheshin për hulumtim. Në shumë shkolla mungojnë kabinetet e TIK-ëve. Kjo e vështirëson zhvillimin e hulumtimit për të parë se sa nxënësit mund t'i mësojnë leksionet e tyre nga distanca. Drejtimet e gjimnazeve nuk janë adekuate për këtë lloj të të nxënit. Mësimdhënësit, edhe pse e kanë ndjekur një numër të madh trajnimesh, ende nuk janë përgatitur profesionalisht për këtë platformë të të nxënit, andaj gjatë hulumtimit paraqesin vështirësi në vete. Edhe zgjedhja e nxënësve të cilët do të merrnin pjesë për këtë hulumtim ishte mjaft e vështirë.



Gjithashtu, edhe vonesa e konfirmimit për pjesëmarrje në intervistë të menaxherëve institucionalë nga fusha e arsimit paraqet vështirësi për pjesëmarrje gjithëpërfshirëse.

Edhe pse sistemi e rendit arsimin si prioritet të parë, aplikimi i metodave të vjetruara në shkolla i mban ato larg përmbushjes së standardeve e metodologjive të reja. Ato paraqesin vështirësi për implementimin e një inovacioni të llojit të mëimit nga distanca: e-mësimi (e-learning) dhe m-mësimi (m-mësimi).

Neglizhenca e punonjësve arsimorë në qeverisjen lokale dhe qendrore për të dhënë përgjigje në pyetjet e intervistës e vështirësoi mjaft shumë mbledhjen e numrit të mjaftueshëm të intervistave për këtë hulumtim. Zgjedhja e mësimdhënësve të interesuar për mësimnxënie nga distanca nëpërmjet e-learning, mënyra e kontaktimit me ta dhe kthimi i opinionit të tyre në pyetjet e pyetësorëve paraqet po ashtu vështirësi në grumbullimin e të dhënave për hulumtim.

Përpilimi i pyetësorëve ishte vështirë të përshtatet me kërkesat e hipotezave të shtruara dhe lidhjen e tyre për të dhënë përgjigje në pyetjet e shtruara kërkimore. Ky hulumtim është ndër të parët e këtij lloji që e kemi hasur gjatë kohës së rishikimit të literaturës në Kosovë. Edhe literatura në gjuhën shqipe është e kufizuar, prandaj hulumtimi për trojet shqiptare realizohet me vështirësi.

### **1.7. Rezultatet e pritshme**

Nga hulumtimi shkencor konfirmohet se cili është raporti ndërmjet të mësuarit nga distanca dhe atij tradicional. E ndihmojnë apo janë në kundërshtim me njëra-tjetrën këto dy metoda? Cilat janë epërsitë e të mësuarit nga distanca nëpërmjet e-mëimit (e-learning)? Ku duhet të ndërhyhet që të ulen disavantazhet e të mësuarit tradicional?

Po ashtu, pritshmëria nga hulumtimi ishte edhe përgatitja e kuadrit arsimor për të organizuar mësim nga distanca e-learning: mësim plotësues, mësim për të rritur (mësim gjatë gjithë jetës), mësim të kombinuar tradicional: e-mësim, mësim të pavarur nga ai tradicional.

Ndërsa nga nxënësit pritet që të merret raporti përfundimtar nëse ata janë të përgatitur ta marrin përsipër të mësuarit në distancë nëpërmjet e-mësimit (e-learning), sa do të jenë në gjendje të mbajnë motivimin për mësim, se do ta përjetojnë ndjenjën e të mosqenët në klasë tradicionale dhe të qenët në klasë virtuale. Sa janë të lodhur nga metodat e stërvjetuara të mësimit tradicional, apo e kanë më të lehtë t'i marrin leksionet nga mësuesit e tyre tradicionalë.

Aktorë të tjerë me rëndësi, të cilët ndikojnë në pritshmëritë e këtij hulumtimi, janë edhe menaxherët (udhëheqësit) e institucioneve arsimore, si drejtorët e shkollave tradicionale, drejtorët komunalë dhe qendrorë të arsimit, si dhe ata që e drejtojnë mësimin nga distanca.

Prindërit dhe komuniteti, të cilët janë faktorë shumë i rëndësishëm për ngritjen e cilësisë së arsimit, do ta japin vlerësimin nëpërmjet përgjigjeve të tyre.

Duke marrë parasysh se edhe në të kaluarën shoqëria kosovare i ka pritur pozitivisht reformat në arsim, mund të themi se pritshmëria për ta zbatuar këtë metodë të të nxënit do të jetë pozitive. Këtë pohim e mbështes në bazë të rezultateve të mira që janë arritur me realizimin e suksesshëm të kësaj metode në SHBA, Evropë, si dhe në disa vende të Ballkanit Perëndimor, si edhe të disa organizatave kosovare që kanë filluar të bëjnë kombinime në këtë drejtim.

Kjo platformë është treguar shumë e suksesshme në vendet e zhvilluara, para së gjithash në SHBA. Sipas vlerësimeve të ekspertëve të inovacioneve në arsim, pritet që deri në vitin 2020, rreth 50% e materialit që do të mësohet nga të gjithë nxënësit do të jetë nëpërmjet platformës së të nxënës nga distanca, e-learning.

Ky studim do t'i evidentojë avantazhet e të mësuarit nga distanca dhe masat që duhen marrë për jetësimin e tyre.

Të gjitha këto do të nxirren gjatë shtjellimit të rezultateve nga hulumtimi i bërë nëpërmjet pyetësorëve dhe intervistave.

### **1.8. Struktura e punimit**

Punimi “Menaxhimi i institucioneve arsimore me mësimnxënie në distancë: e-learning” përbëhet nga gjashtë kapituj.

#### **Kapitulli i parë: Hyrja**

Në fillim është paraqitur motivacioni i hulumtimit. Është përshkruar zhvillimi i hovshëm i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, nevoja që kemi si shoqëri kosovare të jemi aktorë të të nxënës nëpërmjet metodave të reja të të nxënës. Faktorët e implementimit të të mësuarit nga distanca janë: nxënës, mësues, komuniteti dhe prindërit. Janë formuluar pyetjet, hipotezat dhe objektivat kërkimore

Në këtë kapitull është paraqitur edhe pritshmëria e rezultateve të cilat jo domosdoshmërisht duhet të jenë identike me gjetjet në terren. Si çdo punim tjetër, edhe

ky që e keni tani në duart tuaja i ka pasur vështirësitë dhe kufizimet e veta. Gjatë punës së vazhdueshme, ato janë kaluar dhe hulumtimi e ka marrë formën e tij të prerë.

### **Kapitulli i dytë: Rishikimi i literaturës**

Në kapitullin e dytë përfshihet rishikimi i literaturës. Një përmbledhje e të mësuarit nga distanca arsyetohet me hulumtimin e CEDEFOP-it. Mësimi gjatë gjithë jetës jep platforma evropiane, ECDL. Numërohen disa programe për e-learning, rëndësia dhe e ardhmja e kësaj platforme, rrjetet sociale, e-libri dhe e-libraritë.

### **Kapitulli i tretë: Historiku (Rasti i Kosovës)**

Ky kapitull e përshkruan përmbajtjen që kanë mësimi tradicional dhe mësimi elektronik, e-mësimi. Disa platforma që janë të njohura për e-learning. Historiku i të nxënit tradicioanl në Kosovë, legjislatura dhe përgatitja e menaxhmentit aktual. Themelimi i shkollave virtuale, epërsitë dhe të metat e tyre.

### **Kapitulli i katërt: Metodologjia e kërkimit**

Në këtë kapitull analizohet përmbajtja dhe karakteristikat e popullatës, si dhe zgjedhja e kampionit që e përfaqëson këtë popullatë. Po ashtu janë shtjelluar metodat dhe instrumentat konkretë të përdorur për realizimin e këtij projekti, si: intervistat dhe pyetësorët.

### **Kapitulli i pestë: Analiza e të dhënave (mësuesit, nxënësit, prindërit, menaxherët dhe komuniteti)**

Në këtë kapitull është paraqitur analiza dhe diskutimi mbi gjetjet e të dhënave në terren. Po ashtu, bëhet krahasimi i punës gjatë hulumtimit me punimet tjera të ngjashme duke e dhënë edhe një arsyetim mbi rezultatet e fituara.

### **Kapitulli i gjashtë: Konkluzione dhe rekomandime**

Në kapitullin e fundit janë përmbledhur përfundimet e nxjerra nga hulumtimi i mësimnxënies nga distanca e-learning, si dhe rekomandimet për instancat adekuate të arsimit në Republikën e Kosovës.

## **KAPITULLI II RISHIKIMI I LITERATURËS**

### **2.1. Hyrje**

Të mësuarit nga distanca mund të llogaritet si komunikim ndërmjet njerëzve në kohë dhe vende të ndryshme. Kjo mënyrë e të nxënimit daton që nga koha e fillimit të komunikimit ndërmjet njerëzve. Ata filluan t'i bartin njohuritë e tyre brez pas brezi, madje edhe me fillimin e lëvizjes së tyre nga një vend në vendin tjetër, ku takonin popuj të tjerë me kultura dhe tradita të tjera. Pa dyshim se komunikimi i atyre kohërave ishte i vështirë, i ngadalshëm dhe jo i saktë. Shumë herë ngjante që informata gjatë kohës dhe vendit ku shpërndahej të pësonte ndryshime thelbësore, duke shkaktuar shtrembërimin e plotë të saj, madje duke dalë krejt diçka tjetër. Arsye e këtyre ndryshimeve gjatë transmetimit ishte se informatat barteshin në formë fjalësh të folura.

Shfaqja e shkrim-leximit, bartja e letrave nëpërmjet postës, shpikja e radiotelevizioneve, shfaqja e shtypit, si dhe teatri, e pa dyshim edhe shkollat, ishin një kthesë e madhe në transmetimin e dijes nga autori deri te studiuesi, përkatësisht nga mësimdhënësi deri te nxënësi.

Ndërsa vitet dhe shekujt po kalonin, lehtësira në të nxënimit nga distanca u krijuan nga zhvillimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit: nëpërmjet internetit informatat barten në mënyrë të menjëhershme. Kjo shpikje ndihmoi shumë edhe në zhvillimin e bartjes së dyanshme të informatave.



Fig. 1. Sisteme interneti

Sot funksionojnë universitete dhe kolegje të ndryshme gjithandej shteteve të zhvilluara, të cilat e realizojnë të mësuarit nga distanca, e-learning. Ato, madje e kanë të rregulluar edhe çështjen e njohjes së plotë të diplomave, të cilat lëshohen me rastin e përfundimit të shkollimit përkatës.

Kosova nuk mund të renditet në listën e atyre shteteve që janë duke e implementuar të nxënimit me mësimdhënie nga distanca që mbështetet në e-mësim (e-learning), m-mësim (m-learning), apo të atyre që kanë shkolla virtuale.

Prandaj, mund të themi se ky është momenti i duhur për një nismë në fushën e zbatimit të metodologjive të reja. Aprovimi i tyre do ta ngrinte shkallën e suksesit të të nxënimit, në përgjithësi, dhe të nxënimit nëpërmjet teknologjive të reja, në veçanti.

Kur duhet të fillojmë? Si ta fillojmë shtrirjen e të nxënimit nga distanca? A kemi kuadro të përgatitura për këtë metodë të të nxënimit, e cila do ta ndihmonte mësimin tradicional?

Vargu i pyetjeve në këtë fushë është i pafund. Pyetje të tilla kërkojnë përgjigje me angazhim të sinqertë, me punë të mirëfilltë dhe me përkushtim të lartë.

Vendet e BE-së janë duke e implementuar me sukses këtë metodë, e cila ka rezultuar e suksesshme. Ato institucione që kanë filluar dhe vazhdojnë implementimin e këtyre metodologjive të reja e kanë thyer tabunë se mësimi në distancë (e-learning, m-learning,

mësim gjatë gjithë jetës, si dhe shkollat virtuale) e rrezikon mësimin tradicional. Në fakt, këto metoda të reja të të nxënësve janë ndihmesë e shkollave tradicionale dhe hulumtimet kanë vërtetuar se vetëm e ndihmojnë punën e tyre. Për më tepër, atyre ua rritin reputacionin edhe më shumë. Në bazë të një hulumtimi në veprim: “Ndikimi i të nxënësve nga shtëpia në ngritjen e rezultateve në mësim” (BEP, 2015) me të nxënësve në lëndën fizikë, në [www.fizike.almooc.com](http://www.fizike.almooc.com), është vërtetuar se të nxënësve nëpërmjet platformës elektronike e-mësim ka arritur suksese të kënaqshme. Nxënësve u është dhënë njësi mësimore që ta mësojnë në shtëpi nëpërmjet platformës elektronike dhe ata e kanë kuptuar po aq sa e kanë kuptuar nxënësit e klasave tjera me anë të mësimdhënies tradicionale. Ky hulumtim ka treguar se edhe nxënësit në Republikën e Kosovës, po të kishin shkolla ku mësimi organizohet nga distanca, do të mund t’i mësonin mësimet nëpërmjet platformës: e-learning. Ndërkaq se sa do të mbahej motivimi i nxënësve, si do të kontrollohej pjesëmarrje e tyre në mësimnxënie dhe rezultatet e arritshmërisë, këto çështje nuk janë studiuar në këtë hulumtim. Ky fakt ngjall shpresat se mund të fillohet me implementimin e të mësuarit nga distanca nëpërmjet e-mësimit. Por, për këtë duhet: angazhim dhe përkushtim i tërë spektrit arsimor; pavarësim i plotë politik i sistemit arsimor; plotësim i kushteve dhe kritereve të parapara për këtë platformë; harmonizim i ligjeve për njohje të diplomave të lëshuara nga institucionet e tilla; infrastrukturë adekuate, kuadër arsimor ië akredituar për mësimdhënie nga distanca nëpërmjet platformës e-learning.

Për t’i parë modelet ekzistuese, organizimin dhe rezultatet e suksesit apo të mospjesëmarrjes, i jemi qasur rishikimit të literaturës nga autorë të ndryshëm, e cila përfshin edhe periudha të ndryshme kohore.

Të mësuarit nga distanca tashmë nuk është risi. Risi mund ta llogaritim përdorimin e teknologjive të reja, ngase të nxënësve nga distanca (distance learning) është i vjetër me



shekuj. Një përshkrim shkarazi për fillimin e të mësuarit nga distanca nëpërmjet teknologjive të reja e detajon fillimin dhe përparimin që patën vendet e rajonit dhe më gjerë. Një përmbledhje e të mësuarit nga distanca arsyetohet me hulumtimin e CEDEFOP-it. Në këtë kapitull është elaboruar mësimi i kombinuar (blended learning) dhe ai në distancë, që na dërgojnë deri te shembujt e ndryshëm për e-mësimin në rajon dhe nismat e para të disa kompanive të vogla në rajon e më gjerë, që në esencë e kanë fushën e arsimit. Kjo i ka motivuar edhe disa organizata kosovare, ngase edhe strategjia e arsimit të Kosovës e kishte prioritet avancimin e metodave të reja në fushën e arsimit.

Një faktor lehtësues në këtë drejtim për përgatitjen e mësimdhënësve, studentëve dhe pjesëmarrësve të tjerë, me theks të veçantë: mësimi gjatë gjithë jetës, jep platforma evropiane ECDL (European Computer Driving Licence). Suksesi i arritshmërisë ngrihet atëherë kur këta pjesëmarrës aftësohen t'i përdorin teknologjitë e reja informative (TIK) nëpërmjet platformës evropiane - ECDL, e cila është e pranuar ndërkombëtarisht.



Fig. 2. ECDL

## 2.2. Historia e të mësuarit në distancë

Historia e të mësuarit nga distanca është e vjetër sa edhe vetë njerëzimi. Vështirë është të konstatohet se kur fillon kjo metodë e bartjes së informatave. Ka pasur ndër shekuj

sigurisht mënyra e mënyra për bartjen e informatave nga një vend në tjetrin, por këtu do të bazohemi vetëm në atë pjesën e historisë që kemi ndeshur duke hulumtuar në shfletuesit e internetit. Kjo nuk e kufizon në tërësi historinë e të mësuarit në distancë.

Të mësuarit nga distanca është revolucion i arsimit të një vendi. Të mësuarit nga distanca trajtohet si mësim në të ardhmen dhe mëton të jetë vazhdimësi e të mësuarit tradicional, e nuk ka për synim përmbysjen e klasave fizike dhe praninë e mësuesit në klasë. Mëton të jetë ndihmesë për të arritur suksese më të larta në mësimnxënie, sidomos në vendet në zhvillim. Të mësuarit nga distanca është përcjellje e njohurive të programit mësimor me anë të pajisjeve të TIK-ëve, nëpërmjet internetit. Kjo platformë u ofron kushte plotësisht të barabarta të gjithë vijuesve të saj, pavarësisht se ku gjenden ata.

Korrespondencat ndërmjet pjesëmarrësve në kurset nga distanca fillimisht mbaheshin nëpërmjet postës, pastaj me anë të linjave telefonike, me radiolidhje dyanëshe, e më vonë nëpërmjet teknologjive me telekonferenca (Iml,2016).



Fig. 3. Korrespondenca nëpërmjet postës

Pa dyshim, me përdorimin e internetit, të mësuarit në distancë u bë një përditshmëri e lehtë dhe e shpejtë, përderisa lundrimi nëpër internet për të gjetur se ku janë fillet e të mësuarit nga distanca na ndihmon ta kemi një pasqyrë më të afërt për kohërat e mundimshme për të nxënë nga distanca.

Të mësuarit nga distanca e ka një histori të largët. Si nismëtar të të mësuarit nga distanca gjejmë fundvitet e 1800-tës. (Pitman,1919:4-22, e themeloi pranë kolegjit të tij në Angli,

kurse me korrespondencë të cilat do të ndiqeshin nëpërmjet postës ndërmjet studentëve në Gjermani, Kanada, Austri, Bashkimin Sovjetik, Japoni, Shtete e Bashkuara etj.

William Rainey Harpe, si president i parë i Universitetit të Çikagos, parashikoi që disa studentë të këtij universiteti që janë larg dhe nga zonat rurale mund ta ndjekin me korrespondencë pjesë të studimeve. Ky numër i studentëve rritet dukshëm pas Luftës së Dytë Botërore, kur shumë ushtarë, që e kishin ndërprerë shkollimin për shkak të luftës, do t'i ndiqnin pjesët e mbetura të shkollimit të tyre nga distanca pa shkëputje nga puna (Sherron, 1997).

Në të mësuarit nga distanca nga viti 1850-1960, që konsiderohet si gjenerata e parë që ndoqi të mësuarit nga distanca, komunikimi kryesisht bëhej nëpërmjet teknologjive, si posta, shtypi, radio dhe televizioni. Gjenerata e dytë e të mësuarit nga distanca i përket periudhës së viteve 1960-1985 dhe përfshin përdorimin e audio-kasetave, televizorëve, videokasetave, faksit dhe shtypit.

Walden University, (2016) e themelon Open University në vitin 1970, i cili akreditohet për studime të plota në distancë në shëndetësi, arsim, menaxhim, psikologji etj. Ky universitet në Shtetet e Bashkuara njihet si lider global i studimeve nga distanca, i cili e vazhdon punën e tij edhe sot me studime në distancë në shumë fusha studimi.

Gjenerata e tretë e mësimit në distancë, e cila përfshin periudhën nga vitet 1985-1995, përdori teknologjitë e kompjuterëve dhe rrjeteve kompjuterike.

Aktualisht jemi në gjeneratën e katërt të të mësuarit nga distanca, që fillon nga viti 1995, kur përdoren kombinime të ndryshme të pajisjeve dhe sistemeve të kaluara të të mësuarit nga distanca, ndikuar nga zhvillimi i hovshëm i teknologjive të reja të informatikës dhe kompjuteristikës. Tani studimet në distancë zhvillohen në kohë reale nëpërmjet e-mësimit dhe m-mësimit (e-learning & m-learning), nëpërmjet videokonferencave, korrespondencës

së dyanshme në kohë reale në mënyrë audio-vizuale. Korrespondenca mbahet në relacionet: student-mësimdhënës, student-student etj.

Prandaj, siç mund të gjejmë edhe më gjerësisht nëpër historinë e zhvillimi të të nxënimit nga distanca, konkludojmë se ky lloj i të mësuarit është mjaft kompleks. Zhvillimi i tij është i mundimshëm dhe zgjat shumë. Për shkak të faktorit më të rëndësishëm të të mësuarit, motivimit, shpesh ka ndodhur që pjesëmarrësit e këtyre studimeve ta humbin durimin, dhe si rrjedhojë ka qenë braktisja e shkollave të tilla. Por, ka edhe të tillë që megjithatë e kanë ruajtur motivin duke shkuar deri në fund, për çka edhe janë shpërblyer me vende pune, ngritje pagash, ruajtje apo ndërrim të vendeve të punës, kalim në grada më të larta etj. Kjo mënyrë e studimit sot konsiderohet edhe si mësim gjatë gjithë jetës, për të cilin këshillohen të gjithë, pa dallim. Sot mospërfshirja në mësimin gjatë gjithë jetës do të thotë dorëzim i vendit të punës.

Falë zhvillimit të teknologjive të reja, mësimi nga distanca nëpërmjet e-mësimit apo m-mësimit është mundësuar që lehtë dhe shpejt të arrihet përfundimi i një kursi, i cili ndikon direkt apo indirekt në avancimin profesional.

### **2.3. Përhapja e deritanishme e e-mësimit**

Me futjen në përdorim të lirë të kompjuterëve dhe internetit, mësimi nga distanca sikur merr krahë. Ai tani do të fillojë të zbatohet nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, që do të quhet e-mësimi. Nga fillimi i viteve të '90-ta (Epignosis, 2014), në disa shkolla fillon të nxënimit nëpërmjet internetit, ku numër i madh studentësh regjistrohen menjëherë, sidomos ata të cilët gjeografikisht ishin larg nga objekti real. Gjithashtu, edhe mundësia kohore për t'i marrë mësimet kur të ketë kohë pjesëmarrësi dhe ato t'i lexojë kur të dojë, e po ashtu sa herë të dojë. Viteve të 2000-ta, disa nga bizneset e shohin si

shumë përfituese përdorimin e kësaj platforme. Ato filluan me ofrimin e trajnimeve të ndryshme nga distanca për punëtorët e tyre, kështu që kostoja ishte shumë më e lirë se me të mësuarit tradicional (Epignosis, 2014). Shembuj të e-mësimit në botë ka mjaft shumë. Në këtë studim ne do të përmendim vetëm disa, sa për ta dhënë një pasqyrë të studimeve të tilla, të cilat do të shërbejnë si model për të mësuarit nga distanca në Kosovë.

Literatura bazohet në studime të veçanta, të njohura si studim rasti (case studies).

Në vendet e Bashkimit Evropian hasim shumë portale, të cilat kanë pikësynim mësimin elektronik, e-learning. Ato janë të organizuara në mënyrë profesionale dhe janë efektive, për çka nënkuptohet se janë të financuara nga institucione profesionale dhe në përbërjen e tyre ka staf profesional për të nxënit në përgjithësi. Ky hap është shumë i rëndësishëm, ngase edhe llogaridhënia dhe matja e performancës sigurisht është e pranishme dhe e matshme.

Ndër këto portale përmendim European Schoolnet, (2016) - The gateway to education in Europe. Në këtë portal të e-learning mund të gjenden njësi mësimore nga lëndë të veçanta, të cilat janë edhe në formë të videoincizimeve, projekte të ndryshme me të arriturat e fundit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) që kanë të bëjnë me mësimin interaktiv nëpërmjet internetit si ardhmëri e klasave virtuale. Po ashtu, i rëndësishëm së veçantë është edhe forumi ndërlidhës ndërmjet shkollave të ndryshme nga vende të ndryshme të cilat i shkëmbejnë përvojat e tyre dhe hulumtimet e arritura në shkollat e tyre (Partner finding forum). Nëpërmjet këtyre platformave nuk ka kufizime të regjistrimit të nxënësve, mësimdhënësve apo të komuniteteve, pavarësisht nga cili cep i botës janë. Të gjithë ata që dëshirojnë të mësojnë gjuhë të ndryshme të huaja, mund t'i shkëmbejnë përvojat e tyre, pa kufizime kohore ta përvetësojnë gjuhën e huaj të dëshiruar

për studim. Këto portale vërtet i kanë kapërcyer kufijtë ndërmjet shteteve, rajoneve apo kontinenteve. Madje mund të themi se platformat e tilla kanë ngritur ura dhe kanë rrëzuar mure. Po ashtu, këto portale kanë vendosur vegëzat, të cilat mundësojnë kalimin në portale tjera të cilat janë të të njëjtës domethënie. Me këtë mundësohet “lundrimi” nëpër botë pa lëvizur nga vendi.

Një platformë tjetër digjitale falas për përdoruesit e saj është Wikipedia (2016). Kjo është një faqe interneti me informacione nga fusha të ndryshme. Freskimin e kësaj faqeje mund ta bëjnë edhe personat nga e gjithë bota, duke pasur kujdes që edhe këtu është një kod mirësjelljeje, meqë informatat duhet të jenë të besueshme, profesionale dhe para së gjithash të paanshme. Sidomos kriteri i fundit (paanshmëria) duhet të përfilllet me saktësi, ngase kemi të bëjmë ende me urrejtje ndërmjet njerëzve të kombeve, shteteve, besimeve e përkatësive të tjera të ndryshme. (WikipediaShqip, 2016) është edhe në gjuhën shqipe, ndërsa e ka linkun e vet të posaçëm: [https://sq.wikipedia.org/wiki/Wikipedia\\_shqip](https://sq.wikipedia.org/wiki/Wikipedia_shqip).

Wikipedia në shqip është varianti shqip i Wikipedia-s, enciklopedisë së lirë. Ajo filloi më 12 tetor 2003 dhe sot përmban 53 803 artikuj (5. 8. 2016). Wikipedia në shqip e ka vendin e 75-të në rangun *Meta* sipas listës së Wikipedia-ve dhe vendin e 208-të sipas listës së wiki-ve më të mëdha (WikipediaShqip, 2016).

Wikipedinë sot e udhëheq një organizatë jofitimprurëse *Wikimedia Foundation*, në kuadër të saj janë gati 4 milionë përdorues (në shumë gjuhë të ndryshme të botës), të cilët marrin informata të ndryshme nga vendet prej katër anëve të globit. Kjo ka rëndësi të madhe që informatat të jenë sa më të sakta dhe të qarta, ndërsa studiuesit të kenë besim që të referohen në to.

Slogani i Wikipedisë është “enciklopedi e lirë të cilën mund ta redaktojë secili”. Duke pasur parasysh mërinë dhe zilinë ndërmjet njerëzve të botëkuptimeve të ndryshme dhe të redaktimit të lirë të secilit përdorues, nuk mund të kemi një kënaqësi të të lexuarit në këtë portal. Kemi raste ku shfaqen edhe “shkrime” nga vandalistë, ekstremistë dhe shtrembërues të historive të kombeve të ndryshme.



Fig. 4. Wikipedia në shqip

Enciklopedia e ka një rol të rëndësishëm për botën, andaj ekspertët e fushës së programimit janë kujdesur që të prodhojnë CD dhe DVD me enciklopedi të ndryshme, të cilat kanë kaluar nëpërmjet filtrit redaktorial. Po ashtu, janë lansuar edhe online portalet, të cilat shfaqin të dhëna të sakta nga fusha të caktuara. Pa dyshim se ndër to dallojmë ENCARTA (2016).



Fig. 5. Enciklopedia Encarta

Gjejmë edhe shumë enciklopedi multimediale në disqe të ndryshme, si: Enciklopedi për Universin (Encyklopedia of Space and the Universe), Enciklopedi për shkencën dhe natyrën (Encyklopedia of Nature, Encyklopedia of Science), Enciklopedi për historinë botërore (Enciklopedia History of the World), Atlasin botëror (Google Earth, The Dorling Kindersley World Reference Atlas), Enciklopedinë e anatomisë së njeriut, anatomisë shtazore (The Ultimate Human Body and The Ultimate Skeleton) etj. Secili nga këto materiale e përdor mundësinë multimediale nëpërmjet zërit, filmit, fotografisë, videos, animacioneve etj., të cilat dosido e përqafojnë botën reale të të nxënësit tradicional.

Përderisa autorët e huaj i kanë zhvilluar me sukses enciklopeditë e tyre në gjuhët dhe kulturat e tyre, shqiptarët kanë ngecur në këtë fushë. Është shumë e nevojshme që hapësirat tona shqiptare të mbulohen me material, i cili është i nevojshëm, jo vetëm për ne, por do të ishte shumë atraktiv edhe për studiuesit e huaj. Shqyrtimi i kësaj literature vë në pah nevojën, kërkesën dhe domosdoshmërinë për platforma të tilla në gjuhën dhe kulturën shqiptare. Për shkak të mungesës së literaturës sonë, shpesh gjejmë materiale të shtrembëruara nga të tjerët për kulturën, traditën, zakonet, bujarinë, trimërinë dhe të arriturat tjera të kombit shqiptar. Është e rëndësishme së veçantë shkrimi i historisë nga vetë shqiptarët, sepse vetëm ne e shkruajmë drejt.

#### **2.4. “E-mësimi në Evropë: Si instruktorët, mësimdhënësit dhe nxënësit e vlerësojnë e-mësimin?”**

*(“E-Learning in Europe: How do trainers, teachers and learners rate e-learning?”)*

*Përmbledhje e përgjithshme e hulumtimit “E-mësimi në Evropë...”*



Hulumtimi “E-mësimi në Evropë...” është realizuar në vitin 2005 dhe ka pasur për qëllim të nxjerrë në pah punën në të mësuarit nga distanca nëpërmjet mënyrës elektronike. Ky hulumtim është zhvilluar në faqet (Cedefop, 2016) (European Training Village) në rubrikën Projects & Networks, e-Learning News, në adresën: [http://www.trainingvillage.gr/etv/Projects\\_Networks/Elearning/news.asp](http://www.trainingvillage.gr/etv/Projects_Networks/Elearning/news.asp) (2005). I tërë hulumtimi ka mund të shkarkohet në formatin pdf në:

[http://www.trainingvillage.gr/etv/Projects\\_Networks/ELearning/survey/Report\\_survey\\_Teachers\\_and\\_Learners\\_and\\_e-learning\\_final.pdf](http://www.trainingvillage.gr/etv/Projects_Networks/ELearning/survey/Report_survey_Teachers_and_Learners_and_e-learning_final.pdf) (2005).

Hulumtimi “E-mësimi në Evropë...” i realizuar në korrik të vitit 2005, është sjellë në ETV - European Training Village në web faqen Cedefop: European Centre for the Development of Vocational Training. Ky hulumtim kishte për qëllim të gjejë marrëdhënien e e-mësimit nga perspektiva e bartësve të procesit mësimor: mësuesve, instruktorëve dhe nxënësve. Analiza mbështetej në katër fusha themelore që kishte synim marrjen e përgjigjeve:

- Kush ishin ata që dhanë përgjigje?
- Ç’është e-mësimi nga këndi i mësimdhënësit, instruktorit dhe nxënësit?
- Si vlerësohet e-mësimi nga mësuesit, instruktorët dhe nxënësit?
- Cila është ardhmëria e e-mësimit nga këndvështrimi i mësuesit, instruktorit dhe nxënësit?

Në hulumtim kanë marrë pjesë rreth 600 anketues. Pyetësori ka qenë online dhe përmbante 15 pyetje të ndara në tri grupe dhe një pyetje ishte e hapur. Cedefopi nga viti 1999 ka realizuar një seri prej dymbëdhjetë hulumtimeve për e-mësimin, të cilat mund

të shkarkohen në internet nëpërmjet të faqeve të ETV (për vitin 2000) në adresën:

([http://www2.cedefop.europa.eu/etv/Upload/Exchange\\_views/Surveys/survey\\_5\\_-\\_Economics\\_of\\_eLearning\\_-\\_Dec\\_2000.pdf](http://www2.cedefop.europa.eu/etv/Upload/Exchange_views/Surveys/survey_5_-_Economics_of_eLearning_-_Dec_2000.pdf)), parë më 15. 5. 2016), ose për vitin 2001 në

adresën:

([http://www2.cedefop.europa.eu/etv/Upload/Exchange\\_views/Surveys/survey\\_6\\_-\\_European\\_trade\\_unions\\_and\\_e-learning\\_-\\_Jun\\_2001.pdf](http://www2.cedefop.europa.eu/etv/Upload/Exchange_views/Surveys/survey_6_-_European_trade_unions_and_e-learning_-_Jun_2001.pdf), parë më 22. 4. 2016).

Dizajni i hulumtimit:

- Hulumtimi përbëhet nga pyetësi online i prezantuar nëpërmjet ueb-faqes së ETV, ndërsa në kohën e hulumtimit kishte 56 832 anëtarë, prej tyre 43 891 nga Evropa (77%). Hulumtimi zgjati nga 6. 4. 2005 deri më 4. 5. 2005, të cilin e plotësuan më shumë se 600 persona.

*Pyetjet dhe rezultatet*

Në këtë anketë janë përgjigjur veçanërisht nxënësit (34%) dhe mësimdhënësit/instruktorët (21%). Ndërsa të tjerët ishin pedagogë, tutorë, menaxherë, programues, ueb-dizajnues, si dhe mbështetës të tjerë të fushave të ngushta, apo të ngjashëm, që ndërlidhen me e-mësimin.

Pedagogët, në veçanti, kërkojnë që e-mësimi ekskluzivisht të udhëhiqet nga mësimdhënësit profesionist, të cilët duhet t'i luajnë të gjitha rolet brenda platformës së të nxënësve në e-mësim, për të qenë të suksesshëm së paku sa janë në mësimin tradicional.

Personat e anketuar janë pyetur se cilat teknika përdorin më shumë gjatë e-mësimin, me cilat metoda të mësimin më së shpeshti atakohen, si dhe cilat tema më së shumti shtjellohen në e-mësim. Gjithashtu janë pyetur për përvojën e tyre që kanë në e-mësim, si dhe shkathtësitë e tyre që i kanë në përdorimin e pajisjeve TIK.

Të anketuarit janë përgjigjur se rreth 95 % e përdorin internetin kabllor dhe ueb-faqet për mësim (65%), CD-ROM dhe DVD- ROM-in e përdorin rreth 55% e tyre. Një interesim të madh të anketuarit kanë shprehur në përdorimin e video-konferencave (25%) dhe ueb-konferencave (29%). Në atë kohë (2005) vetëm 7% janë deklaruar se përdorin smart pajisje, ose pajisje mobile (pa tela). Kjo shifër sigurisht se tani ka pësuar rritje të dukshme, në vitin 2016.

### *Zgjedhja e modelit pedagogjik*

E-mësimi kryesisht përdoret si metodë e të mësuarit nga distanca, në vend të metodës “ballë për ballë”. Të anketuarve u është kërkuar që ta zgjedhin modelin pedagogjik të cilin ata e pëlqejnë për e-mësim, si: mësonjëtorja virtuale (10-15% e zgjedhën këtë model pedagogjik), tele-mësimi, mësimi hibrid (*blended learning*) (34%), të mësuarit bashkëpunues (*collaborative learning*) (31 %), vetëmësimi i mbështetur (*supported self-learning*) (20 %).

Në pyetjen se për çka e përdorni e-mësimin, të anketuarit përgjigjen: për mësim të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit TIK (36 %), lidhur me aftësime për punësim (34 %), menaxhim, (22%), zhvillim të softuerëve (16%), për financim me e-mësim (6%), për marketing (8%), ndërsa për opsionin “Tjetër” janë përgjigjur (32%).

Sqarim: Në rastet kur përgjigjet kalojnë përqindjen 100%, kuptohet se një pyetje ka pasur alternativë të shumëfishtë.

Rreth 92% e të anketuarve përgjigjen se e-mësimi për ta është i lehtë dhe i suksesshëm. Ndërsa ka vite që janë duke mësuar nëpërmjet kësaj platforme.

Të anketuarit kishin pyetje edhe për atë se cila është arsyeja që i qasen kësaj metode të të nxënimit. Përgjigjet ishin për fleksibilitet (65%); menaxhim më i lehtë me kohën (55%), inovacion (42%), përmbajtje kualitative (24%), efikasitet (29%).

*Cilët janë faktorët që e bëjnë e-mësimin të suksesshëm?*

Motivimi (47%) është faktori i suksesit të e-mësimit, kualiteti teknik i mbështetjes radhitet faktori i dytë me (29%), zgjatja e mësimit (24%). Faktorë tjerë zgjodhën rreth (3%).

Pyetjes nëse është inovacion e-mësimi, përgjigje pozitive japin mbi 64% të të anketuarve, ndërsa vetëm 5% nuk mendojnë se e-mësimi është inovacion.

Sqarim: Në rastet kur nuk arrihet përqindja prej 100 %, kuptohet se të anketuarit nuk janë përgjigjur në të gjitha pyetjet për ç'gjë nuk janë të obliguar.

*Sa duhet të kenë aftësi specifike mësimdhënësit për e-mësim?*

Nxënësit kërkojnë që ata të jenë në nivel për ta kuptuar e-mësimin, ndryshe do të bëhej i neveritshëm për ta. Pedagogët kërkojnë me ngulm që mësimdhënësit të jenë mjaft të vëmendshëm në rastin e lanimit të njësisë mësimore, ngase metodologjia e të nxënimit nga distanca e-mësimi dallon shumë nga mësimi tradicional, ku mësimdhënësi ka mundësi ta risqarojë dukurinë apo problematikën nëse vëren në fytyrat e nxënësve se nuk e kanë kuptuar. Një gjë e tillë nuk është e mundur nëpërmjet e-mësimit, përveç kur nxënësi i drejtohet mësimdhënësit për bashkëbisedim e sqarim shtesë nëpërmjet e-mailit, forumit, apo video-konferencave, nëse ato organizohen.

*Cila është e ardhmja e e-mësimit: vizioni i mësimdhënësit, instruktorit dhe nxënësit?*

Kjo ishte pyetje e hapur në të cilën të anketuarit mund të shprehen me anë të fjalëve të veta për ardhmërinë e e-mësimit. Përgjigjet e marra janë grupuar në njëmbëdhjetë tipe:

- i) Ardhmëria e e-mësimit është mësim hibrid (i kombinuar), (blended learning) - d.m.th. kombinim i mësimit elektronik dhe atij tradicional, jo vetëm mësim online ose virtual.
- ii) Ardhmëria e e-mësimit përfshin mësimin gjatë gjithë jetës.
- iii) E-mësimi në të ardhmen duhet të devijojë pak nga mësimi elektronik për ta vendosur si ndërmjetësues faktorin pedagogjik, duke anuar nevojën e motivimit të nxënësit.
- iv) Ardhmëria e e-mësimit duhet të jetë e orientuar në kualitet: duhet të vendosen standarde të larta të kualitetit që përfshijnë organizimin më të mirë, proceset e të mësuarit, proceset pedagogjike, trajnime të vazhdueshme dhe shumë më të avancuara për mësimdhënës, materiale më voluminoze online, ambiente më të përshtatshme për nxënës.
- v) Ardhmëria e e-mësimit duhet t'i marrë parasysh seriozisht nevojat dhe kërkesat e nxënësve, si dhe qëllimet që ata i kanë.
- vi) Ardhmëria e e-mësimit duhet të mbështetet në zhvillimin e vazhdueshëm të nevojave dhe kërkesave karshi zhvillimit të hovshëm të TI-së, si (e-mentori, e-aftësimi), ku mësuesi duhet të jetë udhëheqës.
- vii) Ardhmëria e e-mësimit është mësim bashkëpunues (*collaborative learning*). Kjo nënkupton që lidhja mësues-nxënës të jetë e vazhdueshme, si dhe lidhja ndërmjet veglërive të jetë në kohë reale, si komunikimi, audio-video-komunikimi etj.

- viii) Ardhmëria e e-mësimit është m-mësimi (mësim mobil): mësimi kur do dhe ku do. Mësimi nëpërmjet telefonave mobilë, pajisjeve smart (të mençura), internet wifi etj.
- ix) Ardhmëria e e-mësimit duhet ta përcjellë zhvillimin teknologjik.
- x) Ardhmëria e e-mësimit do të sjellë fleksibilitet. Kjo kërkon apriori aftësim të vazhdueshëm të mësimdhënësve dhe domosdoshmërisht aftësi të të mësuarit nga distanca.
- xi) Ardhmëria e e-mësimit duhet të mbështetet në botën akademike duke mundësuar dhënien e diplomave apo certifikatave valide. Kjo duhet të rregullohet me ligj.

## **2.5. Programet për e-mësim**

Të mësuarit në distancë sot e ka kuptimin e mësimit elektronik. Shkurtesa [*e-*] e ka domethënien: *elektronik*. Kështu mësimi elektronik në gjuhën shqipe shkruhet si e-mësim, ndërsa në gjuhën angleze shkruhet e-learning. E-learning (e-mësimi) është një nga sfidat jo të lehta për korrje të sukseseve në fushën e arsimit. Dihet se mësimnxënia është një proces i vazhdueshëm dhe tepër i rëndësishëm për secilin shtet dhe komb. Ardhmëria e një rinie është pikërisht rezultat i të nxënësve. E gërshetimi i mësimit tradicional me e-learning (e-mësimin) do të përmbajë një konglomerat që do të jetë frytdhënës në shkallën e suksesit shqiptar.

Realizimi i e-mësimit (e-learning) bëhet nëpërmjet pajisjeve kompjuterike, të cilat kanë të instaluar programe adekuate, e që në fakt janë softuerë të kompjuterëve. Deri tani kemi hasur në shumë definicione sa u përket këtyre mjeteve për e-learning (e-mësim), e që në anglisht njihen si: courseware tool. Vetë programet e dizajnuara për këtë qëllim quhen eduweaver (Fochler, 2006). Ato janë lansuar në tregun e teknologjisë së

informacionit dhe komunikimit (TIK), ku edhe po gjejnë zbatim jashtëzakonisht të madh.

Meqenëse kërkesat për mësim nga distanca janë të mëdha, atëherë edhe angazhimi i ekipeve profesioniste nga fusha e IT-së i është përkushtuar kësaj fushe.

Deri tani mund të hasim në disa përkufizime të cilat defilojnë në internet sa u përket programeve që kanë të bëjnë me e-mësim. Përmendim disa nga to:

- Realizimi i procesit mësimor me ndihmën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (Edupoint, 2016).
- Të dhëna dhe programe të përdorura në trajnim bazuar në kompjuter (GIZ, 2012)
- Softuer i kompjuterit, i dizajnuar për arsimim (Burimi: Enciklopedia multimediale e digjitalizuar: Encarta).
- Softuer i dizajnuar për qëllime edukimi (Burimi: Ultralingua Net).
- Softuerët për e-learning mund të jenë në CD, ueb-faqe, videoprojekte për instruksione edukative, ose programe për nxënie. Softuerët për e-learning shpesh përdoren edhe për arsimimin e atyre që përdorin kompjuterët, në kurse të ndryshme për gjuhë të huaja, kurse kompjuteri: modulet ECDL, dizajn, ueb-dizajn, faqosje, pikturim, këndim etj. (Burimi: NetLingo Classification)

Për realizimin e të nxënit nga distanca po japim në vijim disa nga programet që janë në dispozicion për nxënie nga distanca nëpërmjet e-learning: **WebCT, Claroline, Moodle, Bazaar, College, eLearner, FirstClass, IntraLearn, LotusLearningSpace, LotusSameTime, Tutor, dotLRN, Fledge, Ilias** etj.

*WebCT (Web Course Tools)*

(WebCT, 2016) është program aplikativ, i cili mundëson mbajtjen e mësimin në distancë e-learnig, atëherë kur mësimdhënësi dhe mësimnxënësi janë fizikisht larg njëri-tjetrit, ose përdoret si plotësim në kurset tradicionale. WebCT përbëhet nga disa vegla të veçanta programimi. Në vijim do të përmendim vetëm disa mundësi të përdorimit të këtij aplikacioni.

WebCT (Web Course Tools) është zhvilluar në University of British Columbia në vitin 1995. Punonjësit e departamentit të informatikës të punësuar në këtë universitet (Murray W. Goldberg etj.) e zhvilluan këtë aplikacion thjesht për nevojat e tyre, pasi vërejtën se mësimdhënësit duhet të kalojnë kohë të gjatë duke dhënë përgjigje, të cilat shpesh ishin të përsëritura për studentët e tyre. Kështu, në vitin 2000 fillon përdorimi i këtij aplikacioni. Nga viti 2005 bashkohen dy kompani udhëheqëse në fushën e e-learning, për ta themeluar (Blackboard, 2016).

Kështu ky aplikacion ofron (Maturski, 2016).

- Vlerësimin e dijës së treguar në teste dhe detyra online
- Mundëson pjesëmarrjen në provim në kohë të ndryshme
- Pasuron kursin klasik me elemente multimediale (zë, foto, linqe etj.)
- Krijon indekse dhe fjalorë me terma krucialë që përdoren në leksione
- Integron ueb-resurset ekzistuese në kurs
- Mundëson komunikimin e vijuesve të kursit ndërmjet veti dhe me mësimdhënësin nëpërmjet forumeve dhe chat-eve.



### *Claroline*

Claroline është një aplikacion tjetër, i cili mundëson të nxënit në distancë nëpërmjet e-learning, i cili zhvillohet në Universitetin belg Catholique de Louvain (UCL) si mbështetës i kampusit virtual, që kishte qëllim parësor lehtësimin e punës së mësimdhënësve në e-learning (Claroline, 2016). Ekipit që po e zhvillonte këtë aplikacion i printe Thomas de Praetere. Claroline është një aplikacion, i cili i plotëson kërkesat e një varg kriterëve. Epërsia e tij është se është program Open Source, që mund të përdoret falas. Aplikacioni është programuar në gjuhën PHP dhe përdor bazën MySQL, që mund të instalohet në Windows, Unix, Linux, FreeBSD, MacOS etj.

### *Moodle*

**Moodle** (*Modular Object-Oriented Dynamic Learning Environment*) është zgjidhje ideale për realizimin e mësimin online nëpërmjet internetit (Moodle, 2016). Aplikacioni është në dispozicion si softuer me kod të hapur (në bazë të Licencës GNU Publike). Në thelb, kjo do të thotë që Moodle është nën mbrojtje autoriale, megjithëse ka disa liri të përdorimit. Është i lejuar që të kopjohet, të përdoret, të bëhen ndryshime në Moodle, me kusht që do t'ua lejoni edhe të tjerëve të kenë qasje falas, pa të drejtë të ndërhyri në licencë, apo çfarëdo lloj ndryshimi tjetër i autorësisë. Moodle është një aplikacion i shpejtë, i tipit Open Source tool. Përdor bazën MySQL dhe PostgreSQL. Mund të instalohet në shumë gjuhë. Është i lehtë për t'u përdorur nga mësimdhënësit dhe nga vijuesit e kursit. Ka gjetur përdorim të gjerë te mësimdhënësit, sidomos për shkak të bazave pedagogjike dhe është shumë i përshtatshëm për kërkesat akademike. Moodle përdoret në shkolla publike dhe private, në universitete, si dhe në korporata, të cilat kanë

program të të nxënësve në distancë, e-learning. Përdoruesit e këtij aplikacioni janë nxënës të shkollave të mesme, studentë të fakulteteve dhe studimeve postdiplomike.

#### *Mësimi në distancë nëpërmjet tabelës SMART*

Mësimi në distancë-distance learning po bëhet çdo ditë e më shumë tërheqës, i lehtë dhe njëkohësisht i domosdoshëm. Përdorimi i këtyre tabelave është fjala e fundit e teknologjisë sa u përket tabelave mbi të cilat kemi traditë të lashtë të shkruarit. Këto i kanë thyer të gjitha ëndrrat e dikurshme se edhe tabela do të bëhet e “mençur” (Education, 2016). Nëpërmjet këtyre tabelave në kohë reale mund t’u përcillet mësimi pjesëmarrësve kudo që ata janë. Janë të thjeshta për përdorim dhe shkathtësia që kërkohet në përdorimin e smart tables konsiderohet e barabartë me shkathtësinë e punës me PowerPoint.

#### *Përparësitë dhe mundësitë*

Teknologjia TouchScreen e shndërron tabelën elektronike, ku projekton projektori në “Touch Screen” dhe hapësirë manovruese. Shkruan direkt në tabelë, direkt në të apo mbi materialin prezantues në Power Point, Word, Excel, apo ndonjë softuer tjetër. Gjatë shpjegimit të shkencave natyrore, si: fizikë, kimi, matematikë e lëndë të tjera paraqitet nevoja që nxënësve me mësim në distancë nëpërmjet pajisjeve të reja, që mbështetin editorin e formulave, t’u shpjegohen formulat, (Skenderi, 2000:170).

Sigurisht se kërkesat e studiuesve të rinj janë të mëdha, po ashtu edhe programet e licencuara dhe të akredituara të institucioneve arsimore, të të gjitha niveleve, janë të shumta, e që kanë për qëllim aftësimin e pjesëmarrësve të tyre në fusha të ndryshme, në përgjithësi, e në ato të TIK-ut, në veçanti, kanë bërë të mundur që të përfshijnë edhe programet: Corel Draw (Aleksic, 2005:19), Front Page (Perry, 2004:417), PowerPoint

(Dika, 2004:179), Teknik i kompjuterëve (hardveri dhe softueri), (Dika, 2003:29), Windows i shpejtë dhe praktik (Warner D., 2000:4), Krijimi i bazave të të dhënave nëpërmjet MS Access (Cox, 1999:168), Serviset e Internetit (Vukiq, 2012:199), Matje dhe njësiti e madhësive (Marjanovic, 2008:22), ushtrime me sisteme numerike (Beqiri, 2010:5), (Dika, 2003:9) etj.

Smart tabela mundëson inkorporimin e materialeve mësimore në smart board. Ajo e bën mësimin më joshës, më atraktiv dhe më të kompletuar. Nëpërmjet lapsit elektronik mund të shkruajmë në tabletë, madje edhe me ngjyra dhe manipulohet mjaft thjesht me të. Gjithë mësimi që shpjegohet nga mësimdhënësi mund të ruhet edhe me zë dhe të dërgohet shpejt deri te nxënësi që nuk ka qenë i pranishëm në atë kohë në klasë.



Fig. 6. Smart tabela

Smart tabela e ka të instaluar softuerin e vet, smart notebook me veglat e saj bazike.

## 2.6. Rëndësia e të nxënit nga distanca

Mësimi nga distanca, i cili po realizohet nëpërmjet platformës e-mësimi (e-learning) e ka rëndësinë e veçantë. Gjithnjë e më shumë po shihet si një metodë hibride (*blended*

*learning*) e të mësuarit tradicional (Staker, 2012:3), meqë po i plotëson boshllëqet e shumta që i kishte në të kaluarën dhe është duke i rritur rezultatet e suksesit të të nxënit. Për mosarritjen e sukseseve ndër vite, faktorë kyçë ishin dhe mbeten kushtet jo të mira për punë kërkimore, kufizimet e natyrës metodologjike etj. (Gojkov, 2007); Pesiq, 2004:58). Ndërsa kur ta analizojmë më në detaje kujt i dedikohet kjo metodë e të mësuarit, atëherë mund të radhitim një varg aktorësh që përfitojnë nga ky organizim. Në rishikim të literaturës, parashihet një rast, i cili falë mësimit në distancë, nëpërmjet video-konferencës në një shkollë fillore në Kroaci, u arrit që të evitohet mbyllja e një shkolle, e ku si rrjedhojë një fëmijë i atij vendbanimi do të mbetej pa u shkolluar për shkak të moshës së tij dhe pamundësisë për udhëtim deri te ndonjë shkollë tjetër. Nxënësit e klasës së pestë i ndoqën mësimet nga distanca nga paralelja e tyre e ndarë në shkollën amë (Zhuro, 2004:2). Por, mësimi në distancë do të ketë edhe raste kur fëmijët apo të rriturit për shkak të vështirësive në lëvizje mund t'u ndihmojë që t'i vijojnë mësimet nga distanca (e-learning). Ndërkaq një rëndësi tjetër e veçantë e implementimit të kësaj metode mësimore do të jetë edhe ulja e kostos së shpenzimeve dhe vijueshmëria kohore që nuk do të shkaktojë shpëputje nga puna. Me gjithë rëndësinë e madhe që e ka kjo metodë e re e të nxënit, shumë analistë dhe profesionistë të fushës së arsimit e shohin nga një kënd tjetër këtë inovacion. Disa madje shkojnë aq larg së komentuari se kjo platformë do t'i mbyllë përfundimisht shkollat reale (tradicionale). Por, kjo nuk mund dhe nuk do të arrihet. E aq më tepër nuk e ka për qëllim një gjë të tillë, ngase asgjë nuk e zëvendëson realen, apo të vërtetën. Të mësuarit nga distanca nëpërmjet teknologjive të reja me e-mësim (e-learning) dhe m-mësim (m-learnig) ka për qëllim ta plotësojë të nxënit tradicional, ta lehtësojë atë dhe ta bëjë më atraktiv e tërheqës për nxënësit e vet. Ndërsa kur kemi parasysh se të nxënit nëpërmjet e-mësimit është i domosdoshëm edhe për vetë

mësimdhënësit dhe të rriturit të tjerë që kanë nevojë për mësim gjatë gjithë jetës, atëherë i eviton të gjitha dilemat se dikush dëshiron të përmbysë diçka që është arritur me shekuj. Zhvillimi i hovshëm i teknologjive të reja (TIK) ka ndikuar direkt në avancimin e metodologjive të reja të të nxënësve. Kështu të mësuarit virtual do të jetë një pjesë e konglomeratit të përbashkët të procesit pambarimisht të lartë të cilësisë së arsimit dhe për asnjë moment nuk duhet të shihet si i ndarë nga kompleksi i të gjitha të arriturave në fushën e arsimit.

Vendet të cilat ende nuk kanë filluar, apo ato që vetëm janë duke numëruar në vend pa bërë asgjë ende konkrete në drejtim të të nxënësve nga distanca, do të duhej që urgjentisht të fillojnë me zbatimin e pilot-projekteve për implementim të e-mësimit (e-learning).

Shtrohet pyetja: Ku jemi ne (si shoqëri shqiptare) dhe si jemi pozicionuar? Shoqëria jonë kosovare nuk mund t'i mbyllë sytë përballë një nevoje kaq të madhe dhe të përditshme për t'i çuar më tej metodologjitë e reja të të nxënësve. Platformat të cilat janë të specializuara në këtë fushë janë numerikisht të shumta, aq sa na bëjnë ne edhe më të vendosur për ta nisur sa më parë të nxënësve në këtë drejtim.

Rëndësia në këtë aspekt sigurisht se është e shumë, për çka kërkohet ngritja e kësaj çështjeje në shoqërinë kosovare për të ndikuar në vendimmarrje qeveritare.

## **2.7. E ardhmja e e-mësimit**

E ardhmja e një vendi lidhet me integrimin e mësimdhënësve. Mësimdhënësi është hulumtues (Stenhouse 1975:30), i cili gjithnjë është në kërkim të asaj që është më e reja, më praktikja dhe më e lehta për nxënës. Performansa e mirë në të nxënësve nga distanca rrit edhe biznesin e një organizate që merret me këtë fushë të të nxënësve (Epignosis 2014).

Duke u mbështetur në këtë, sot e kemi arritur në një nivel të lartë të të nxënit, meqë mësimi tradicional tani ndihmohet, e në disa situata edhe zëvendësohet nga mësimi në distancë, që realizohet nëpërmjet e-mësimit (e-learning) dhe m-mësimit (m-learning).

E ardhmja e e-mësimit mund të përmblihet në disa pika:

- Fleksibiliteti i kohës
- Çmime - vlera konkurruese
- Gjeografikisht i pavarur
- Përqendrimi bie mbi studentin
- Teknologji gjithëpërfshirëse
- Diversitet etnik

Duke u bazuar në të dhënat e vendeve të zhvilluara, madje edhe të disa nga vendeve në zhvillim, mund të kërkojmë që Qeveria e vendit tonë duhet me më shumë përkushtim të formojë ekipe ekspertësh, të cilat do ta zhvillojnë realisht këtë metodologji të re, e cila do ta plotësojë shumë suksesin e studiuësve, duke i bërë ata të jenë të përgatitur në mënyrë profesionale, po aq sa janë të përgatitur kolegët e tyre në vendet e zhvilluara.

Jemi të vetëdijshëm se kjo është njëra nga sfidat shumë të rënda për implementim, ngase varshmëria e saj është e lidhur me shumë faktorë, si:

- politikat qeveritare dhe opozitare,
- përgatitja e mësimdhënësve për të qenë në gatishmëri të plotë në krye të detyrës,
- menaxherët arsimorë ta bëjnë të pamundurën për përkrahje dhe implementimin e kësaj platforme digjitale, e cila vetëm sa e plotëson metodën e kahershme të të nxënit në distancë,
- vetëdijesimi i nxënësve për të qenë sa më azhur në përcjelljen e leksioneve dhe materialeve e detyrave tjera, të cilat ia përcjell mësimdhënësi i tij virtual,

- prindërit t'i mbështetin, t'i përkrahin dhe t'u qëndrojnë gjithnjë afër fëmijëve të tyre që ta realizojnë suksesshëm këtë platformë,
- komuniteti i përbërë nga profesione të ndryshme, si pedagogë, psikologë, sociologë, ekspertë të arsimit dhe të tjerë ta japin kontributin e tyre në evitimin e mangësive, të cilat do të rezultojnë në mospësuksin e nxënësve në arritjen e rezultateve (Hodge, 2006:4).

## **2.8. Të nxënit nëpërmjet rrjeteve sociale: sporadik dhe sipërfaqësor**

A ka qenë më i lehtë dhe më i shpejtë komunikimi i njerëzve ndërmjet tyre kur ata ishin larg fizikisht nga njëri-tjetri?

Kësaj pyetjeje mund t'i përgjigjemi vetëm për aq sa dimë nga ajo që kemi të shkruar. Duke e ditur se njerëzimi gjatë evolucionit të vet, për shkak katastrofave të ndryshme natyrore mund të ketë pësuar humbje të tërë asaj që e ka arritur, kjo hipotezë lë të nënkuptojë dyshimet se në të kaluarën njerëzimi mund të ketë qenë më i zhvilluar shumë më shumë se që është sot. Ndonëse për këtë hulumtimet prore vazhdojnë. Kjo mund të rezultojë si pozitive kur e dimë se çdo ditë e më shumë lexojmë, duke hulumtuar në internet për gjetje të ndryshme, të cilat mund dhe po e ndryshojnë të kaluarën faktike. Shtrembërimet eventuale në historinë e njerëzimit, arritjet në shkencë dhe faktet tjera që dëshmojnë për të arriturat e njerëzimit ndër miliona vite nuk do të mund të ndalen dot, falë zhvillimit të shpejtë të internetit. Tani informatat po barten në çast, që kualifikohen si mësim në distancë-distance learning, nëpërmjet e-mësimit (e-learning), e poashtu edhe nëpërmjet m-mësimit (m-learning). Komunikimi ndërmjet njerëzve tani po bëhet në mënyra të ndryshme falë shtrirjes së gjerë të internetit. Investimet në këtë fushë janë më

se të domosdoshme. Mësimi në distancë po i shkrin kufijtë ndërmjet shteteve të bëra nga njerëz egoistë, që padrejtësisht janë ndërtuar ndërmjet nesh (njerëzimit). Liderë në heqjen e tyre është interneti dhe mësimi nga distanca. Njerëzit e larguar me miliona kilometra po i bën virtualisht në një vend teknologjia e re e informacionit dhe e komunikimit nëpërmjet pajisjeve, të cilat po e realizojnë ëndrrën e njerëzimit se mund ta mësojmë njëri-tjetrin. Krahas zhvillimit të pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK-ëve) - harduerëve, me po aq shpejtësi po zhvillohen edhe programe të ndryshme aplikative, të cilat i përkrahin këto pajisje-softuerët. Gjuha me të cilën komunikojnë pajisjet teknologjike është gjuha programuese, e falë tyre janë lansuar një varg programesh (softuerë) për komunikime. Shumë nga programet e tilla janë edhe falas, ndërsa janë të instaluar në pajisje të reja teknologjike, apo edhe mund të shkarkohen lehtë. Ato mundësojnë përdorim falas për komunikim ndërmjet nesh. Kjo ka bërë që të rritet numri i përdoruesve që blejnë pajisje të reja të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. E kjo rritje ka ndikuar te kompanitë që ta rritin prodhimin e pajisjeve dhe t'i përshtatin ato me kërkesat e konsumatorëve anëmbanë botës (Pink, 2010:16).

Përdorimi i drejtë i programeve, të njohura si rrjete sociale, mundëson që nëpërmjet tyre t'i mësojmë edhe në distancë të madhe personat e ndryshëm. Ndër to, veçojmë:

#### *Teamviewer*

(TeamViewer, 2016), është një program (softuer) mjaft praktik, i cili mundëson komunikimin ndërmjet dy kompjuterëve, duke mundësuar që personi nga ana tjetër të manipulojë nëpërmjet kompjuterit të tij sikur të ishte afër nesh. Në rastet kur ne kemi hasur në ndonjë vështirësi në zgjidhjen e detyrave, problemave, apo manipulime me ndonjë program, atëherë dhënia e mundësisë së ndërhyrjes të personit adekuat nga



kompjuteri i tij, i larguar fizikisht pambarimisht, me të vetmin kusht të kenë qasje në internet, do ta zgjidhë problemin sikur të ishte pranë kompjuterit tjetër. Bazuar në ueb-faqen zyrtare të temaviewer, deri tani janë mbi njëqind milionë përdorues të kyçur anembanë rruzullit tokësor në këtë platformë. Ky rrjet social shkarkohet dhe përdoret falas.




Fig. 7. Faqja startuese e TeamViewer

Po për çka në fakt mund të përdoret TeamViewer?

- TeamViewer mund të përdoret për mbështetje ad hoc të kolegëve kudo që ata ndodhen;
- Administrator në servisimin e kompjuterëve, duke bërë të mundur që të ndërlihet nga ana tjetër;
- Të lidheni me platforma tjera të sistemit operativ
- Të lidheni edhe nëpërmjet smart pajisjeve mobile si android;
- Ta bëni ekranin “share” për të qenë publik edhe me kolegët tjerë, në rastin e punëve ekipore që zhvillohen ndërmjet anëtarëve, të cilët janë të autorizuar të kyçen direkt nga shtëpitë e tyre, që e realizojnë mësimin nga distanca;

- Të lidheni me kompjuterin tuaj në shtëpi, edhe kur ju jeni larg fizikisht, dhe të manipuloni me të, në kontrollimin e postës elektronike, modifikimin e imazheve të ndryshme, dokumenteve apo çfarëdo veprimesh tjera, sikur të ishit ulur pranë tij.
- Të lidheni me kompjuterin e punës dhe të manipuloni me të sikur të jeni në zyrën e juaj dhe nga ju kërkohen informacione dhe instruksione të ndryshme.

Përdorimi i tij është krejt falas dhe e ka një gamë të gjerë të epërsive që mundëson kryerjen e punëve në mënyrë virtuale sikur të ishim pranë kompjuterit në mënyrë reale.

TeamViewer mundëson komunikimin me kolegun tuaj, partnerin, apo me këdo tjetër dhe mund ta bëni edhe me audio dhe video.

TeamViewer po ashtu mundëson edhe mbajtjen, përkatësisht pjesëmarrjen në video-konferencë. Sigurisht se për pjesëmarrje ju nevojitet ta shkruani fjalëkalimin e konferencës, i cili është unik për të gjithë pjesëmarrësit e atij takimi. Atë fjalëkalim e ndan softueri në mënyrë automatike me rastin e krijimit të konferencës.

## 2.9. E-libri

*“Ëndrra e bibliotekës virtuale - del në pah aktualisht jo se premtion një të ardhme kureshtarë e ngacmuese, por sepse premtion një të ardhme që do të jetë jo vetëm si e shkuara, por shumë më e mirë dhe më e shpejtë” (James J. O’Donnerll, Avatars of the World).*

Në kohën e teknologjisë së re të informacionit, leximi po e gjen vendin e vet të merituar. Krahas kërkesave të shumta që e kanë përdoruesit e internetit, ndër to është edhe kërkesa

për e-libër. E-libri është në fakt libër virtual. Libër i digjitalizuar. Falë pajisjeve të reja të mençura (Smart device), gjithnjë e më shumë po rritet numri i lexuesve të librave elektronikë. Hulumtimet e ndryshme japin shifra të rritjes së këtij numri të lexuesve sidomos të moshës së re. Ata shumë më të lehtë po e shohin leximin e një libri virtual se sa leximin e një libri tradicional (fizik).

Ekzistojnë softuer të shumtë, të cilët mundësojnë digjitalizimin e librit, duke e shndërruar atë për pak kohë në e-libër.

Edhe e-libri, sikur të gjitha produktet tjera elektronike, i ka avantazhet dhe disavantazhet e veta.

E-libri rrezikon mbylljen e shtëpive botuese, uljen e fitimeve që kanë pasur shtypshkronjat, uljet e përfitimeve të letër-shitësve, por e-librat e ruajnë prerjen e drurëve, të cilët janë prodhuesit e vetëm dhe gjigantë të oksigjenit.

Librat elektronikë (e-librat) janë të domosdoshëm për e-mësim dhe m-mësim. Mësimi në distancë në të kaluarën është zhvilluar pikërisht nëpërmjet librit fizik, kur autori mësimet e veta i ka bartur deri te nxënësi i tij nëpërmjet librit.

Mësimi i shkencave të natyrës, i gjuhëve të huaja etj., pikërisht janë mësuar nga autorët, të cilët fizikisht nuk kanë qenë pranë nxënësve (studentëve, lexuesve). Por, në kohën e zhvillimit të hovshëm të teknologjisë informative IT-së, është e paimagjinueshme të mos flasim edhe për e-librin.

E-libri gjen zbatim të madh edhe te mësimi gjatë gjithë jetës, te mësimi në distancë (e-learning), si dhe te lexuesi i përditshëm që dëshiron ta marrë informatën shpejt dhe saktë. Digjitalizimi i librit (e-librit) ka hapur rrugë të krijimi të e-bibliotekave (bibliotekave elektronike), apo bibliotekave “pa mure”. Këto janë disa nga emërtimet për bibliotekat e internetit, që në fakt janë biblioteka virtuale, ngase edhe vetë librat që gjenden në

biblotekat e internetit janë virtuale. Kjo e ka vënë në një situatë shumë të mirë lexuesin, i cili me komoditet mund të “hyjë” në bibliotekën e tij, e cila për gjithmonë është e hapur dhe ta shkarkojë librin e tij të preferuar. Për ata të cilët e kanë pasur burim parësor apo edhe dytësor, kjo mënyrë është jashtëzakonisht e dëmshme dhe madje ndoshta edhe e paligjshme. Ndërsa për lexuesin është ndihmesë e madhe dhe kërkesat e tyre janë të mëdha për të pasur numër më të madh të titujve për lexim. Autorët e librave të ndryshëm, si shkencorë, shoqërorë, të arteve e kulturës, apo edhe të gjuhëve të huaja, duhet të ndërrojnë qasje të punimeve të tyre. Ata tani mund të jenë edhe vetë shitës, të cilët ia dorëzojnë lexuesit direkt librin.

E-libri e fuqizon edhe më shumë nevojën e madhe të këtij hulumtimi që bazamentin e vet e ka në të nxënit nga distanca nëpërmjet e-mësimit (e-learning) dhe m-mësimit (m-learning).

## **2.10. E-libraritë**

Botimet e librave kanë histori të vetën mbi shtatë mijëvjeçare. Ato ndër kohëra kanë pësuar ndryshime në botimin e tyre. Zhvillimi i mjeteve teknike ka ndikuar që të ketë përparime në fushën e shtypjes (printimit) të librave. Ndryshimet rrënjësore në fushën e publikimit të librave i ka sjellë pikërisht revolucioni elektronik. Shumë shpejt paraqitet nevoja dhe realizimi i saj për formën elektronike të librit. Digjitalizimi i librit filloi në vitin 1971 me projektin e Gutenbergut (Gutenberg, 2016). Deri më tani mund të shkarkohen mbi 45 000 libra vetëm në këtë projekt. Libraritë elektronike kanë sjellë inovacion në fushën e leximit. Lexuesit e rinj e kanë me vete kudo librarinë elektronike dhe kurdo mund ta lexojnë librin e tyre të preferuar. Libraria elektronike (e-libraria)

funkcionin edhe si librari mobile m-libraria, meqë nëpërmjet pajisjeve mobile, të cilat e përkrahin internetin wifi, mund të lexohet ai libër apo libra të tjerë të disponueshëm në platformën elektronike si e-libra, që gjenden në librarinë elektronike, e-librari. Nxënësi (studenti) edhe gjatë udhëtimit mund ta shfletojë literaturën e ofruar nga programi i zgjedhur për mësim nga distanca - distance learning. Përgatitjen e civateve të ndryshme, referimet tjera profesionale dhe shumë kërkesa tjera të panumërta i ofrohen në xhepin e tij, në të cilin bart smart phon të tipave të ndryshëm. Ndërkaq një smart pajisje mund të ketë shumë e shumë e-libra, madje mund të themi edhe shumë e-librari. Të gjitha në një vend me qasje sipas modelit: kurdo, kudo dhe sa herë të dëshirojë lexuesi mund ta shfletojë literaturën e tij profesionale, apo atë të preferuar.

Libraritë elektronike (e-libraritë) dhe librat elektronikë (e-librat) e kanë një varg përparësish:

- Libraria është e hapur (online) 24/7;
- Gjetje dhe qasje e lehtë;
- Nuk ka nevojë për dërgesë a pagesë;
- Nuk presim për ribotim;
- Lexuesi mund ta lexojë librin elektronik edhe aty ku nuk ka dritë, ngase vetë pajisja smart e ndriçon “faqen e librit”;
- Në ribotimin eventual, lehtë mund të shtohen ndryshimet;
- E-libri nuk mund të dëmtohet fizikisht.

Në kuadër të një librarie elektronike mund të gjenden me mijëra tituj librash. Sigurisht se ato janë të kategorizuara dhe institucioni arsimor me mësimnxënie në distancë e ka numër të mjaftueshëm titujsh profesionale nga fusha e ngushtë e programit që studiohet.

Natyrisht si në çdo epërsi të fushës elektronike, po ashtu edhe në digjitalizimin e librit vërehen edhe efektet anësore. Sepse:

- Leximi për një kohë të gjatë sjell lodhje,
- Shikimi mund të dobësohet, e për një kohë të shkurtër mund të shfaqet edhe shkurtpamësia.

Për evitimin e këtyre efekteve ka filluar të aplikohet e-letra dhe e-leximi. E-letra shfaq pamjen e ekranit që simulon letrën reale, ndërsa e-lexuesit kanë për qëllim që ta përshtatin dritën në mënyrë që të mos ketë reflektim të dritës në syrin e lexuesit, e më shumë të kërkohet drita natyrore për ta parë ekranin, që virtualisht themi e-letrën. Sido që të jetë, qëndrimi i gjatë pranë e-librit shkakton lodhje, e cila kërkon çlodhje duke dalë në natyrë të gjelbër dhe preferohet shikim për një kohë të caktuar në largësi sa më të mëdha. Këtë gjë duhet ta kenë parasysh menaxherët institucionalë, në mënyrë që nëpërmjet ekspertëve të tyre brenda ekipit të dinë dhe t'ia dalin ta mbajnë motivimin e lexuesit në shkallë sa më të lartë, duke i njoftuar ata herë pas here me nevojat për takime fizike ndërmjet njerëzve dhe aktiviteteve tjera. Për këtë mund të thuhet se mjaft efektive po tregohen edhe kafenetë për mësim (learning café). Për këto kafene mund të lexoni brenda këtij punimi, te “Mësonjëtorët e shekullit XXI”.

Nëse u përmbahemi pikave të numëruara më lart për kujdesin që duhet të kemi, atëherë mund të shtojmë se në këtë drejtim duhet të jemi më azhur në e-libra dhe sidomos në e-librari. Ato janë të nevojshme, edhe për faktin se:

- Nuk kanë kufij fizikë (nuk kërkohet që lexuesi fizikisht të hyjë në librari),
- Nuk ka orar pune (lexuesi mund ta marrë kur të dojë librin e tij të preferuar),
- Qasje e pakufizuar (lexues të panumërt mund ta marrin përnjëherë të njëjtin libër),

- Gërmim i lehtë i përmbajtjes (lexuesi mund ta gjejë librin e tij të preferuar nëpërmjet fjalëve kyçe apo togfjalëshave),
- Hapësirë e vogël (libraritë reale kërkojnë hapësirë të madhe fizike, ndërsa e-libraritë zënë fare pak vend),
- Vegëza (linqe) ndërmjet librarive (nga njëra librari mund të kaloni në librarinë tjetër elektronike pa asnjë pengesë dhe në mënyrë të shpejtë),
- Mirëmbajtje e lirë (për mirëmbajtje të e-librit nuk kërkohet investim i madh si për librin klasik).

Libraritë elektronike i kanë akoma mangësitë e tyre, si: çmimi për përgatitje, kufizimet për autorësi, kërkesat për teknologji dhe softuer janë të kushtueshme, rrezatimi për sy etj. Institucioni arsimor me mësimnxënie nga distanca - distance learning, i bazuar në e-mësim apo m-mësim, duhet ta ketë të publikuar edhe kodin e vet për informim të lexuesit. Njoftimi për efektet anësore që mund t'i ketë studimi nga distanca është më se i domosdoshëm. Ky model mësimi në shikim të parë mund të jetë krejt i pranueshëm për secilin, por me kalimin e kohës ai mund të jetë shumë kufizues, për ç'gjë i ka edhe rreziqet e veta. Menaxherët e mirë dinë t'i informojnë me kohë studiuesit dhe t'i mbajnë ata brenda institucionit të vet, duke ua mundësuar aplikimin e mësimit gjatë gjithë jetës, që është garantuesi i vetëm për momentin për qëndrueshmëri afatgjate të akëcilit prej nesh në trend me kohën dhe kërkesat që janë gjithnjë e më të mëdha në fushën e dijës.

## 2.11. Përfundime

E rishikuar literaturën që e patëm në dispozicion, nëpërmjet së cilës e bëmë një lundrim në kohë. Mësimi nga distanca është një term i vjetër. Ai kalon edhe datat e cekura në historiatin e të nxënit nga distanca. Lajmet edhe në të kaluarën përhapeshin nga distanca. Edhe pse me mjete primitive, ato e kanë pasur efektin e vet, e po ashtu edhe shpejtësinë që i kalon edhe përmasat e shpejtësisë së internetit në shumë momente. Përhapja e informatave nëpërmjet zjarrit arrin shpejtësinë e përhapjes me shpejtësi drite. Po ashtu, informatat janë bartur edhe me shpejtësi zëri, e më vonë edhe me letra nëpërmjet lajmëtarëve, postës, telegrafit, pllakave të gramafonit, kasetave me shirita, CD-ve, e tani edhe nëpërmjet flash-memorieve. Shembuj të shumtë flasin për mësimin nga distanca, të bazuar në e-learning dhe m-learning. Një pasqyrë të vlerësimit të e-mësimit që e japin instruktorët evropianë, mësimdhënësit dhe nxënësit, e paraqet hulumtimi CEDEFOP. Një varg programesh janë aktive për mësimnxënie nga distanca. Ato nuk dihet me saktësi se sa janë të sigurta dhe të qëndrueshme në treg. Karshi tyre disa inxhinierë shqiptarë të TIK-ut përpiqen që të shfaqin platforma të ngjashme për këtë metodologji të të nxënit. Koha është para nesh, ndërsa puna është kushti parësor që të arrihen rezultatet në këtë lëmi.



## KAPITULLI III HISTORIKU (RASTI I KOSOVËS)

### 3.1. Zhvillimi historik i idesë së të mësuarit nga distanca

Togfjalëshi “të mësuarit nga distanca” sot nënkupton të mësuarit elektronik, që gjithnjë e më shumë po merr forma të ndryshme të shprehjes, si: “të mësuarit online” apo “mësimi virtual” (Epignosis, 2014). Megjithatë, në bazë të shtrirjes në vendet e caktuara, mund të themi se diku përdoret më shumë, e diku nuk ka arritur dot të aplikohet fare. Por, edhe përkundër kësaj gjendjeje, mund të themi se është në fjalorin e përditshmërisë si diçka e re dhe domethënëse.

Para më shumë se 100 vjetëve, në SHBA, fillon të përdoret shprehja “Home study”, që në përkthim të lirë e ka kuptimin “Mësim nga shtëpia”. Në gjermanisht, ky emërtim përdoret me termin “fern”, (Fernunterricht, Fernstudium, Fernschule). Shprehja “Fernstudium” e ka kuptimin e të mësuarit me korrespondencë, që po ashtu lidhet edhe me të gjitha llojet e të mësuarit nëpërmjet radio-televizioneve, gazetave, pllakave të gramafonit, si dhe kompjuterit. Disa vende të tjera, këtë mënyrë të të nxënies e përdorin me anë të parashtresës “tele”, që nga greqishtja “téle” - distancë, largësi. Në literaturën tonë mund ta hasim si teledidaktikë, ndërsa në SHBA përdoret shprehja “teleteaching”.

Ishte viti 1939, kur Margarita Fitzsimons, një vajzë e re 17-vjeçare, nga Irlanda, e cila dëshironte ta ndiqte një kurs më specifik për stenografi (Burns, 2011:1). Shkolla e saj organizonte kurse vetëm në gatim dhe qepje, që për të ishin të padëshirueshme. Ajo arrin të regjistrohet në një kurs për stenografi me korrespondencë, me seli në Londër. Për disa muaj vetëm studioi, e pastaj iu nënshtrua provimit. Ajo ishte me qindra kilometra larg Londrës, ndërsa po priste rezultatet për ta realizuar ëndrrën e saj në këtë profesion.

Margarita e kaloi provimin në fushën e stenografisë, duke u pajisur me diplomë, e cila ia mundësoi edhe punësimin. Ky shembull mund të trajtohet edhe si pikënisje e studimeve, të cilat mund të kryhen edhe nga distanca - distance learning, e jo vetëm me mësimin “ballë për ballë” (face2face). Ndërkaq, zhvillimi i hovshëm i teknologjive të reja po i rrishte shpresat për realizim të ëndrrave edhe të të rinjve të tjerë, të cilët në pamundësi që të shkonin në ato vende ku ishte shkolla e tyre e preferuar mund ta mbaronin programin e tyre të preferuar.

Shfaqja e internetit shkaktoi revolucion të paparë në shumë fusha. Ndër to, edhe në mësimnxënie nga distanca nëpërmjet e-learning. Kompjuteri u rendit si “medium i të gjitha medimeve” (Rodek, 1986:11), i cili mund t’i bartë të dhënat në mënyrë audio-vizuale, t’i plotësojë ato duke shtuar apo larguar pjesë të ndryshme të të dhënave nga mësimi. Ai po ashtu mund të komunikojë në mënyrë të dyanshme nëpërmjet postës elektronike dhe video-konferencave.




Fig. 8. E-learning

Prandaj mund të përfundojmë se mësimi nga distanca është zhvilluar: nëpërmjet mësimin me korrespondencë, me postë, telemësimin (me anë të radio dhe televizionit, e-mësimin

(Torres, 2010:5), nëpërmjet internetit (bartja e të dhënave në mënyrë sinkrone dhe asinkrone), si dhe m-mësimi (mësimi me mjete mobile nëpërmjet smart phoneve).

Sipas R. M. Delling, shpërndarjen e informatave e hasim qysh në përshkrimin e bartjes së informacioneve me anë të “afisheve”, me të cilat dijetarët, besimtarët dhe mendimtarët e ndryshëm u drejtoheshin popujve të tyre në Kinën e vjetër, Egjipt, Greqi dhe Romë (Iml, 2016).

Është e rëndësishme të përmendet se në korrik 1728, në gazetën e atëhershme (elearningIndustry, 2016), “The Boston Gazette”, Caleb Philips (DistanceLearning, 2016), e bën një shpallje në të cilën ofronte mësim nga stenografia edhe nga distanca. Në shpallje sqaronte se cilido person, kudo qoftë ai, mund të merrte leksione me anë të postës, për t’u aftësuar në mënyrë efikase dhe absolutisht njëjtë sikur ai të ishte në Boston. Kursi kishte të bënte me aftësimin për mënyrën e të shkruarit të shpejtë gjatë ligjërimit të kujt do qoftë.

Mësimi me korrespondencë në mënyrë të organizuar filloi më 1856, në shkollën e Berlinit për gjuhë të huaja, të cilën e themeluan Charles Toussaint (francez) dhe Gustav Langenscheidt (gjerman), (Iversity, 2016).

Në vitin 1858 i filloi studimet Universiteti i Londrës me mësim nga distanca (distance learning) (elearningIndustry, 2016).

Nga viti 1891, Thomas J. Forster (Forster, 2016), filloi të shkruajë artikuj për gazetatat lokale në Pennsylvani (SHBA) për sigurinë në punë, i nxitur nga fatkeqësitë e përjetuara në miniera.

Në Suedi Hans Hermods (Hermods, 2016), në vitin 1890, filloi në mënyrë sistematike t'i dërgojë udhëzime për zgjidhjen e problemeve të ndryshme të detyrave një ish-nxënësi të tij, i cili e kishte ndërruar vendbanimin.

Në Angli, që nga viti 1880 aplikohet “edukimi nëpërmjet postës” (Education by Post).

Në Australi, organet udhëheqëse të arsimit në Victori e pranojnë një letër nga një prind, në të cilën shkruante se shkollën më të afërt e kishte tetë milje (rreth 13 km) dhe si pasojë e kësaj nuk mund t'i shkollonte fëmijët e tij. Me këtë rast, gjashtë studentë në mënyrë vullnetare nisin të shkëmbejnë letra me ata fëmijë për t'i mësuar ata. Ky rast shënon fillimin e të mësuarit me korrespondencë në Australi.

Në vitin 1946 themelohet Universiteti i Afrikës Jugore për mësim nga distanca (*University of South Africa*). Në Britaninë e Madhe, qendra më e madhe edukative e të mësuarit nga distanca themelohet në vitin 1969, e emërtuar Universiteti i Hapur (Open University). Në Gjermani, në Hagen, themelohet Universiteti për mësim nga distanca në vitin 1974, i njohur si FernUniversität.

Kujdesi ndaj fëmijëve për shkollim gjithëpërfshirës në Angli fillon ligjërisht të mbrohet që nga viti 1870. Me këtë ligj, shkollimi i fëmijëve bëhet obligues (Parliament, 2016). Që nga ajo kohë fillojnë metodat e ndryshme të organizimit të mësimnxënies.

Shpërndarja e pamfleteve, e gazetave dhe e broshurave të ndryshme në vende dhe kohë të ndryshme nxit interesimin për mësim edhe në vendet tjera që në shekullin XVIII, kur fillon gjithëpërfshirja e mësimit edhe për të rritur. Që atëherë pretendohej të çrrënjosej analfabetizmi, por mjerisht edhe sot (shek. XXI) ende përballemi me këtë fenomen.

Gjatë viteve të pesëdhjeta të shekullit XX paraqiten video-konferencat dhe telekonferencat (Video Conferencing dhe Telekonferencing). Në korrik të vitit 1962 lansohet sateliti i parë amerikan në orbitë, Telstar 1. Ai e kishte një orbitë të vogël, për çka kërkonte antena të mëdha për qasje, ndërsa komunikimi nuk ishte konstant. Sot performojnë satelitë të shumtë në një lartësi 22 300 mile (rreth 35 888 km) mbi ekuator, të cilët mundësojnë video-konferenca të vazhdueshme në kohë reale.



Fig. 9. Sateliti Telstar 1

Historinë e televizionit shqiptar e fillon TVSH më 29. 4. 1960 (WikipediaShqip, 2016). Asokohe shfaqej program vetëm dy orë në ditë. Pastaj, më vonë, edhe ky medium filloi të gjallërohej, duke futur në skemën e vet programe edhe emisione edukativo-arsimore.

Transmetimi i parë për shqiptarët e mbetur jashtë Shqipërisë, në ish-Jugosllavi, në gjuhën shqipe realizohet më 26 nëntor 1966 nga Televizioni i Beogradit (Zajmi, 2011). Ndërkaq Televizioni i Prishtinës (TVP) themelohet dhe e fillon transmetimin me 26 nëntor 1975. Ky televizion suprimohet më 5 korrik 1990 nga policia serbe për shkaqe politike dhe për mosdëgjueshmëri për ndryshim të skemave programe të lejueshme për pushtetin e asaj kohe.

Nëpërmjet satelitëve në vitet e '90-ta, Kosova i mbijetoi "territ informativ" nga mbyllja totale e të gjitha medimeve nga regjimi i asaj kohe. Televizioni shqiptar (TVSH) dhe radiotelevizionet tjera të pavarura ndërkombëtare, nëpërmjet satelitëve bartnin te popullata shqiptare informata të rëndësishme për t'ia mundësuar mbijetesën.

Teknologjia e përhapjes së informatave zhvillohet nga dita në ditë. Sot televizionet kosovare e bëjnë përhapjen e programeve të veta nëpërmjet sistemit kabllor, me satelite, antena të zakonshme, me internet, kanale You-Tub, nëpërmjet platformave IPTV etj.

Nevoja për bartjen e informatave nga njëri vend në tjetrin ishte dhe mbetet domosdoshmëri e kohës. Së bashku me njerëzimin lindën edhe lajmëtarët. Ata në fillim i shpërndanin lajmet (informatat) nëpërmjet zërit, e pastaj edhe nëpërmjet zjarreve. Duke pasur parasysh shpejtësinë e përhapjes së zërit (Beqiri, 2007) dhe shpejtësinë e përhapjes së dritës (Beqiri, 2007), themi se lajmëtari e bartte informatën në kohë reale.

Lajmëtari ka qenë i mbrojtur, madje kjo dëshmohet edhe në Kanunin e Lekë Dukagjinit: "Lajmësi nuk vritet, pavarësisht nga lajmi që e sjell" (Gjeçovi, 1933).

Zhvillimit të hovshëm të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit i ka mbijetuar veprimtaria postare. Madje ky zhvillim i TIK-ut nuk ia ka dalë dot ta zëvendësojë plotësisht shërbimin postar.

Ofrimi i shërbimeve postare në Kosovë daton që nga viti 1950 (PTK, 2016), kur edhe u themelua Posta, Telefoni dhe Telegrafi i Kosovës (PTT), e cila më vonë ka operuar në sistemin e Postës dhe Telekomit të Kosovës (PTK).

Teknologjia kompjuterike mundësoi paraqitjen e të mësuarit interaktiv. Interaktiviteti mundëson komunikimin e dyanshëm, me ç'rast studiuesit (bashkëbiseduesit) mund t'i

shkëmbejnë informatat e tyre dyanshëm. Të mësuarit interaktiv në distancë mundësohet nëpërmjet softuerëve të veçantë, të cilët shfaqen që në vitin 1960. Të mësuarit e këtij lloji njihet si “mësim nëpërmjet kompjuteri”, ose “kompjuteri ndihmon të mësuarit” (angl. computer assisted learning, CAL); “në kompjuter është themeluar të mësuarit” (ang. computer based instruction, CBI). Zhvillimi i CD-ROM-it (Compact Disk Read Only Memory) e lehtësoi mjaft shumë bartjen e shënimeve nga një kompjuter në tjetrin, duke mundësuar përparimin e mësimin nga distanca. Një hap tjetër gjigant revolucionar e bën lansimi i ueb-portaleve (www: world wide web), në të cilat mund të gjejmë mësim në formë teksti, video e pyetësorë të ndryshëm, duke shkuar deri te komunikimi i menjëhershëm ndërmjet bashkëbiseduesve. Këto portale kanë bërë të mundur që të formohen “klasa virtuale”, në të cilat mësimdhënësi e bën komunikimin me nxënësit në mënyrë të sinkronizuar (nëpërmjet chat-it, video-konferencave) dhe në mënyrë të asinkronizuar (nëpërmjet e-mailave apo forumeve).

E-mësimi paraqitet në vitin 1994, kur nëpërmjet internetit shfaqet mësimi elektronik. Tani në kohë reale kemi bartjen e zërit dhe videos nga mësimdhënësi deri te nxënësi. Kjo teknologji avancohet, kështu që në vitin 2000 rritet shpejtësia e bartjes së informatave deri në 100 kbit/sekondë, duke vendosur standarde të reja të paraqitjes reale të audiovizualitetit ndërmjet bashkëbiseduesve.

E-mësimi ka ndikuar në rritjen e efikasitetit të të nxënit, uljen e kostos së shpenzimeve për udhëtim deri tek institucioni arsimor, korrelacion më i lartë ndërmjet studiuësve, komoditet më të lartë etj.

Krahas e-mësimin është realizuar edhe m-mësimi (m-learning). M-mësimi “kurdo dhe kudo” realizohet nëpërmjet pajisjeve mobile ku nxënësi (studenti) ka mundësi ta marrë

informatën në pajisjet e veta mobile nëpërmjet smart-pajisjeve (pajisje të mençura elektronike). Sot janë në përdorim smart phonet, smart table etj., të cilët e shoqërojnë studiuesin kudo që ai gjendet.

### **3.2. Shkollat virtuale**

Shkollat virtuale janë organizata arsimore, të cilat mësimin dhe kurset i mbajnë nëpërmjet internetit ose me ndihmën e ueb-faqeve, që është një vazhdimësi e natyrshme e përdorimit të teknologjisë dhe mësimin në distancë (distance learning), nëpërmjet platformës elektronike të të nxënit: e-mësimi (e-learning). Rritja e shpejtësisë së internetit dhe shtrirja e tij në masë të gjerë në vende të shumta të botës, përsosja e aplikacioneve për video-konferenca dhe zhvillimi i softuerëve për nxënie nga distanca kanë ndikuar dukshëm në formimin e shkollave virtuale. Fëmijët, studentët dhe të tjerët mund ta regjistrojnë një shkollë virtuale, pavarësisht largësisë së shkollës ku është, pavarësisht kohës lokale dhe pengesat tjera, si dallimet ndërmjet racave apo besimeve. Po ashtu, zhvillimi i hovshëm i teknologjisë mobile (smart phone, wifi, tablet) ka ndikuar edhe më shumë që të hapen shtigje të reja të të mësuarit nëpër shkolla virtuale.

Shkollat virtuale tashmë janë bërë alternativë e shkollave dhe fakulteteve klasike.

Në të kaluarën jo shumë të largët, ëndërr e shumë të rinjve ka qenë që të studiojnë në ndonjë universitet me renome ndërkombëtare, por këtë nuk ua kanë lejuar shumë faktorë, si: institucioni i tillë arsimor ka qenë në një vend apo shtet tjetër, në të cilën nuk kanë mundur të shkojnë, kostoja e regjistrimit të vitit ka qenë shumë e lartë, gjë që ka qenë e papërbalueshme. Këto pengesa nuk janë më tabu, ngase ato janë thyer me konfigurimin e një koncepti të ri të të nxënit në shkolla virtuale. Ato do të jenë edhe si modernizim i



shkollave tradicionale, për ç'gjë do të kenë edhe rëndësi të madhe historike. Në shkollat virtuale vijuesit e saj komunikojnë ndërmjet tyre nëpërmjet postës elektronike (e-mail, skype, viber, twitter, whatsapp, video-konferencave, si dhe me aplikacione tjera arsimore të dedikuara për mësimnxënie elektronike). Librat janë zëvendësuar me e-libra (e-books). Prezantimet që bëheshin në hamer janë zëvendësuar me programe aplikative, si PowerPoint. Regjistrimi në këto shkolla legale është i lejuar me ligj, të cilat i kanë plotësuar me rastin e akreditimit, ndërsa diplomat njihen nga vendet e treta. Shkolla virtuale tani janë të hapura gjithandej botës, ndërsa numri më i madh i tyre gjendet në SHBA, ndërsa e para është hapur në vitin 1991, në Kaliforni.

Edhe pse popullariteti i këtyre shkollave është në rritje e sipër, shifrat arrijnë përqindje të ulët të përfshirjes së studiuesve në këto lloje të shkollave. Në SHBA mendohet se janë rreth 3% të shkollave virtuale, në Evropë ka rreth 100 shkolla virtuale, e në disa vende janë hapur pikërisht për shkak se disa familje nuk kanë mundur të jenë banorë rezidentë në vendin ku fëmijët e tyre kanë shprehur interesim të studiojnë. Shkollat virtuale gjithashtu janë shumë të përshtatshme edhe për njerëzit me nevoja të veçanta, të cilët nuk mund të lëvizin pa përcjellje, apo për shkak të pengesave tjera.

Po ashtu jemi në dijeni se ka familje që jetojnë në zona të thella, e assesi nuk mund të lëshojnë ato vendbanime, apo edhe më e rënda është situata kur familjet janë të hasmuara e nuk e kanë lirinë e lëvizjes së lirë, prandaj shkollat virtuale janë zgjidhje ideale për to në rrethanat e tilla.

Gjithashtu këto shkolla janë të dobishme edhe për situatat e rënda kur të burgosurit nuk e kanë të drejtën e shkuarjes në një shkollë apo universitet për shkak të vuajtjes së dënimit, prandaj kjo do të jetë një “liri brenda burgut”.

Shkollat virtuale mund të jenë të kombinuara me ato tradicionale, kështu që një pjesë e leksioneve zhvillohet nga distanca, e pjesa përfundimtare e provimit mund të mbahet edhe në objektin fizik të shkollës. Kështu, shkollat virtuale nuk mund të konsiderohen krejt si zëvendësuese të atyre klasike, por si modernizim i tyre dhe integrim arsimor me metodologji të reja, të ndihmuara nga teknologjitë e informacionit dhe komunikimit.

Shkollat virtuale mund të jenë: shkolla me orar të plotë mësimi virtual (full time), me mësim shtues virtuale (supplemental schools), si dhe shkolla të tipit “shkolla në shkollë”.

Te grupi i parë i shkollave, mësimi organizohet plotësisht nga distanca, te grupi i dytë një pjesë e mësimit mbahet në shkolla tradicionale, e pjesa shtesë e mësimit realizohet nga shtëpia, dhe grupi i tretë është kur shkolla brenda saj krijon shkollë virtuale, ku nxënësit do të kyçen me mësimdhënës, të cilët nuk janë në atë shkollë.

Organizimi i mësimit në shkolla virtuale mund të jetë nga shkolla fillore e deri te universitetet, ndërsa varësisht nga pronësia ato mund të jenë shtetërore, private, publiko-private, me donatorë, si organizata joqeveritare të mbështetura me fondacione etj.

Këto shkolla mund të jenë të profileve të ndryshme.

Suksesi i një shkolle virtuale varet ekskluzivisht nga përgatitja e mësimdhënësit, mentorit dhe personelit mbështetës, të cilët azhurnojnë leksionet dhe detyrat tjera që kërkon një shkollë e modernizuar. Shkollat virtuale kanë edhe mentorë, të cilët i ndihmojnë nxënësit në rastet kur ata kanë vështirësi në marrjen e detyrave dhe në kthimin e përgjigjeve, në publikimin e punimeve të tyre, lehtësojnë komunikimin në forume, me fjalë tjera - janë mbrojtës së nxënësve (studentëve). Në kuadër të shkollave virtuale janë edhe IT administratorët dhe menaxherët, të cilët në çdo hap e përcjellin mbarëvajtjen teknike, edukative, ligjore, estetike, pedagogjike dhe profesionale.

Faktori kyç megjithatë është nxënësi (studenti), i cili duhet të jetë vetëkritik, sfidues, i përbajtur, i përpiktë, i rregullt në mësim dhe vetëmotivues. Natyrisht se rrallë mund t'i ketë secili vijues të gjitha këto tipare.

Shkollat virtuale kanë një varg epërsish, si: u mundësojnë nxënësve/studentëve të kenë orar të vetin fleksibil, të marrin pjesë në diskutime, në bashkëzgjdhje të problemave shkencore, bashkëbisedim me bashkëmoshatarë të vendeve gjeografikisht të largëta, të mësojnë bashkë edhe me ata të cilët kanë besime të ndryshme, përkatësi tjetër kombëtare, kosto të lirë studimi, shkëmbim të përvojave dhe të kulturave të ndryshme, “udhëtime” virtuale nëpër botë me bashkëstuduesit e vet, përfshirje të atyre që janë me shëndet të ligë, të cilët hospitalizohen, të privuarit nga e drejta e lëvizjes së lirë, gratë shtatzëna, bashkëshortët me fëmijë të vegjël, fëmijët me defekte tjera, apo ata të cilët kanë qenë të dhunshëm me moshatarët e vet etj.

### **3.3. Shkollat virtuale - model i ri i të mësuarit në Kosovë**

Shkollat tona tradicionale duhet të integrohen apo të plotësohen me modele të reja të të nxënësve. Shifrat e Bashkimit Evropian planifikojnë që deri vitin 2020 të jenë të përfshira me 20% të shkollave virtuale. Në këto kohë krizash ekonomike dhe pamundësi të lëvizjes në vendet e BE-së, Qeveria e Kosovës dhe sidomos Ministria e Arsimit duhet të dalin me plan konkret të mbështetjes së organizatave, të cilat kanë njohuri të mjaftueshme për hapjen e shkollave virtuale. Kosova ka shifër të lartë të rinisë, por ka shifër të ulët të arsimimit. Arsimimi joadekuat e thëllon papunësinë. Shkollat virtuale duhet të

subvencionohen, certifikohen, akreditohen dhe zyrtarizohen në mënyrë që të krijohet gjithëpërfshirja e popullatës në to, madje edhe të jetësohet mësimi gjatë tërë jetës. Me një angazhim të mirëfilltë duhet të mbështeten kuadrot e reja, në mënyrë që të përgatiten mësuesit me përvojë të gjatë në arsim për organizim të mësimin në distancë edhe nëpërmjet shkollave virtuale. Një mësimdhënës i mirë tradicional nuk do të thotë se është edhe mësimdhënës i mirë virtual. Mësimdhënësi virtual duhet të jetë i përgatitur profesionalisht dhe po ashtu të ketë shkathtësi të mira në përdorimin e aplikacioneve të reja arsimore të teknologjive të reja, si dhe të jetë fleksibil në përmbushjen e kërkesave të vijuesve në shkollat virtuale.

Kosovës i mbetet të veprojë fuqishëm në këtë drejtim, ngase ardhmëria e arsimimit të një vendi varet nga mësimi në distancë nëpërmjet shkollave virtuale.

### 3.4. Mësonjëtoret e shekullit XXI

Të mësuarit po përhapet me shpejtësi më të madhe se kurdoherë. Në rrafshin e arsimit gjithëpërfshirës ka shumë tipa të të nxëniet. Mënyra e të mësuarit si deri më tani, kur qëllim përfundimtar ka qenë marrja e një diplome të ciklit (të mesëm, të lartë, apo pasdiplomik) dhe zënia e një vendi të punës, që për epilog kishte punën deri në pensionim, tani i takon vetëm periudhës së kaluar, apo thënë më troç shekullit të kaluar. Tashmë e dimë se fillimshekulli XXI e ka rritur kërkesën për mësimdhënie të vazhdueshme. Për këtë, në të gjitha vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim është përfshirë “Mësimi gjatë gjithë jetës” (UNESCO, 2014). Ka ndodhur kështu për faktin se nuk mund të kemi më vend pune që nuk kërkon aftësim profesional të vazhdueshëm, përveç atij të fituar nga studimet. Zhvillimi i hovshëm i teknologjive të reja, metodat e reja të punës, udhëheqjet e punës në grup dhe ndryshimet globale kanë ndikuar që të rritet kërkesa për mësim gjatë gjithë jetës. E për t’u arritur të gjitha këto, ne sot mund të kemi nevojë për të studiuar në një vend krejt tjetër dhe po ashtu të studiojmë diçka tjetër. Themi kështu për faktin se në vendin ku jeton një studiues mund të mos organizohen studime të drejtimit, të cilin ai e kërkon. Koha tani nuk na premtonte të udhëtojmë, apo edhe të migrojmë në ato vende ku gjenden ato institucione arsimore që përgatitin kuadro për fushën e caktuar. E këtë “mërgim” mund ta bëjmë virtualisht. Ta ndjekim mësimnxënien në distancë - distance learning nëpërmjet e-learning.

Për përmbushjen e këtyre kriterëve kërkohet që shkollat tona të pësojnë reforma të thella. Ato duhet që patjetër të përshtaten me kohën dhe të ofrojnë mjedis të përshtatshëm për fëmijët. Është e kuptueshme se nuk mund ta transformojmë tërë sistemin arsimor në sistem virtual. Sistemi i të mësuarit nga distanca DLS është plotësim i mësimin tradicional,

por fëmijët, para së gjithash, duhet të socializohen me bashkëmoshatarët e vet dhe me këtë paraqitet nevoja e krijimit të shkollave moderne, me mësonjëtoje moderne, të cilat me një emër të përbashkët do të quheshin *Mësonjëtoje të shekullit XXI*.

Mësonjëtojet me standarde evropiane duhet të jenë të ndërtuara dhe përgatitura mirë.

Ato duhet t'i plotësojnë standardet e përcaktuara ndërkombëtare (Rgvision, 2016).

Marc Prensi e përshkruan se si nxënësit më nuk e duan amfiteatrin e madh për ligjëratat dhe në vend të kësaj duan hapësira të cilat "lejojnë ata të takohen, të angazhohen në dialog, duke punuar vetëm ose në grupe në projekte. Ata po ashtu janë të interesuar për të marrë ose siguruar feedback personal për t'i mësuar leksionet, të cilat ua dërgon mësimdhënësi përkatës (Prensky, 2006). Për telefonat mobilë të gjeneratës së re thotë se janë: kompjuterë të fuqishëm, gjithmonë në xhepin tuaj, optimalë për komunikim, e kanë të integruar kamerën, GPS, internetin dhe manipulohet lehtë me ta, për input/output me jashtë. Gjithashtu kërkojnë mjedis bashkëpunues që mbështet të mësuarit dhe të kuptuarit" (Miller, 2011).

Komoditetin e lartë nxënësit e arrijnë edhe në kthinat e veçanta moderne, të njohura si Learning cafe (Students' Union, 2016).



Fig. 10. Learning cafe

Në këto hapësira nxënësit freskohen, argëtohen, mbajnë aktivitete të ndryshme shkollore dhe sidomos kanë kontakt me mësimdhënësit e tyre për të marrë instruksione fillestare

apo edhe përfundimtare për leksionet e tyre. Edhe këtë hapësirë dhe kohën që qëndrojnë në to mund ta shfrytëzojnë për biseda në forume e chat-te me shoqërinë e tyre jashtë shkollës në një vend dhe shtet tjetër (Neto, 2013). Rritja e numrit të studentëve që shfrytëzojnë e-learning kafiteritë e ka inkurajuar universitetin e tyre për t'i shtuar hapësirat në të cilat do të kalojnë studentët duke mësuar gjatë kohës së lirë. Kjo ka për qëllim që të sigurohet zgjidhje për t'i mbuluar zonat e lira përreth objektit, duke ndërtuar kopshte të reja, të cilat ata do t'i shfrytëzojnë për mësim, aktivitete kulturore dhe kohë të lirë të dobishme për shëndetin e tyre. Me këtë rritet motivimi i studentëve që të qëndrojnë sa më gjatë në objektet e tilla, e ku edhe do të aplikohet mësimi tërëditor. Shembujt e tillë duhet të jenë inkurajim për të ndërtuar godina të reja me standarde të reja, të cilat do të mundësojnë të mësuarit efektiv dhe ngritjen e rezultateve në suksesin me mësimnxënie nëpërmjet teknologjive të reja, të cilat janë kudo rreth nesh dhe gjithnjë e më të fuqishme. Njëherësh, kostoja e tyre, përballë efektit që e kanë, do të jetë gjithnjë e më e ulët. Komunikimi është bërë mjaft i lehtë, e shkollat të cilat akoma nuk i kanë nisur këto investime e kanë tani kohën e fundit, ngase mësimi në distancë (e-mësimi) po i kalon të gjithë kufijtë duke ndërtuar “shkolla pa mure” (Pogledaj, 2016).



Fig. 11. Shkolla “pa mure”

### **3.5. Historia e arsimit në Kosovë**

Ëshët tejet vështirë është të vërtetohet me saktësi se kur fillojnë mësimet e para për shqiptarët në trevat e veta (Osmani, 2000). Por, në bazë të disa shkrimeve mund të themi se format e organizimit të mësim-këndimit, siç quhej atëherë edukimi dhe arsimimi, zë fill që në kohën e ilirëve. Megjithatë, përfshirja e shqiptarëve nëpër shkolla në trojet e veta asokohe zhvillohej në gjuhë të huaja. Ato shkolla administroheshin nga okupatori i kohës. Planet dhe programet krejt natyrshëm mund të thuhet se ishin të papëlqyera dhe aspak adekuate për shqiptarët, të cilat u imponoheshin dhunshëm. Askund nuk mund të gjeje histori apo kulturë kombëtare. Mësimet ndërpriteshin shpesh për arsye të ndryshme, e sidomos si pasojë e humbjes së pushtetit okupues, për të rifilluar pastaj nga okupatori i ri, i cili sillte rregulla dhe diktatura të reja. Ndërprerjet e tilla sillnin edhe ngecja të mëdha në të nxënit e asaj kohe. Zhvillimet politike ndikonin shumë në procesin arsimor. Kur theksohet kjo, e kemi të qartë se Kosova ka rënë nën pushtime të shumta, si: turke, bullgare, italiane, e së fundi edhe serbe. Pas Luftës së Dytë Botërore, edhe përkundër luftës për çlirimin e vendit nga okupatori, premtimet ishin që secili komb do t'i gëzonte të drejtat dhe liritë, madje edhe në të drejtën e vetëvendosjes. Por, kjo nuk u jetësua për shqiptarët e Kosovës, pasi padrejtësisht mbetën jashtë trungut kombëtar, pa të drejtë bashkimi me Shqipërinë. Edhe brenda asaj Jugosllavie, shqiptarët ishin të ndarë në tri republika tjera, përveç Kosovës që mbeti krahinë e Serbisë. Pjesa e shqiptarëve të mbetur në ato republika konsiderohej si pakicë, si në: Serbi (Presheva, Medvegja e Bujanoci), Mal të Zi dhe Maqedoni. Sigurisht, arsimimi i asaj kohe, edhe pse trumbetohej se po bëhej në gjuhën amtare, kontrollohej në mënyrën më të egër për t'i bërë të gjitha përpjekjet e ndjelljes së urrejtjes dhe përçarjen deri në vëllavrasje. Mbretëronte frika e jashtëzakonshme nga të gjitha kombet që e përbënin shtetin jugosllav se arsimimi i



shqiptarëve paraqet kërcënim serioz për sovranitetin e Jugosllavisë. Në anën tjetër, shqiptarët e ëndërronin një sistem arsimor të pavarur, në të cilin të gjitha planet dhe programet mësimore do të hartoheshin nga vetë shqiptarët, ashtu siç po e bënin edhe pjesëtarët tjerë shumicë në Jugosllavi. Demonstratat e vitit 1968, kur u kërkua më shumë liri e barazi për shqiptarët e atij shteti, ndikoi që në vitin 1970 të hapet Universiteti i Kosovës (UP, 2016). Kjo është njëra nga periudhat më të ndritshme për arsimin shqip në këto troje. Ky universitet mbikëqyrej nga dashakeqët e shqiptarëve, por megjithatë e vazhdon punën deri në vitin 1989. Në këtë vit Kosovës i suprimohet edhe ajo autonomi e vogël që iu pat dhënë me Kushtetutën në vitin 1974. Arsimi goditet më së rëndi, ngase nga aty buronte gjithçka kombëtare. Filluan ditë të rënda për arsimin shqip, sepse Serbia tashmë e shfaqur sheshazi kërkonte ndërhyrje në plan-programet mësimore. Shqiptarët nuk e pranojnë asesi një nëpërkëmbje të tillë dhe vetorganizohen, duke themeluar shkolla plotësisht të pavarura. Serbia këto shkolla i quante paralele dhe filloi futjen e masave të dhunshme, duke i nxjerrë nxënësit e studentët nga objektet e tyre, të cilat me vetëkontribut i kishin ndërtuar vetë shqiptarët. Prandaj, shqiptarët këtu e bëjnë hapin më të madh gjatë historisë nën pushtimet shekullore. Tani filluan dhe hartuan plan-programet sipas nevojave të kohës. Historia kombëtare dhe kultura shqiptare e hapën kapitullin e ri, për të mos u zbrapsur më asnjëherë. Ky organizim zgjati deri në vitin 1999, kur për shkak të luftës gjithnjë e më të madhe dhe të pabarabartë me Serbinë ndërpritet përkohësisht mësimi në të gjitha nivelet (nga ai fillor e deri në Universitet). Ky vit (1999) shënon ndërprerjen e fundit të mësimin për shqiptarët nga faktori njeri. Menjëherë pas çlirimit të Kosovës, të ndihmuar nga NATO-ja, në qershor të vitit 1999, në Kosovë rifillon mësimi, i cili gjithnjë po bën përpjekje për të sjellë ndryshime dhe të fusë metodologji të reja, duke ndjekur hap pas hapi vendet e zhvilluara, në përgjithësi, e vendet në zhvillim, në veçanti.

Ky hulumtim, që ka të bëjë me mësimnxënien në distancë, që zhvillohet mbi bazën e e-mësimit (e-learning), flet për përkushtimin e futjes së rregullave të reja në të nxënit si pjesë e zhvillimit të plotë të standardeve evropiane në arsim (Osmani, 2010).

### **3.6. E-mësimi në Kosovë**

Në strategjinë e qeverisjes elektronike 2009-2015, të aprovuar në tetor të vitit 2008 (QK, 2016), parashihej edhe zhvillimi i mësimit nëpërmjet e-shkollave në Republikën e Kosovës. Aty kemi zotime të mëdha se si do të fillojë implementimi i e-mësimit si nevojë e kohës për t'i përmbushur standardet e kërkuara për një arsim cilësor të pranueshëm ndërkombëtarisht. Kjo strategji nuk ia ka arritur as për së afërmi të fillojë me implementimin e saj, madje ajo është e tejkaluar për shkak se deri më tani ajo ka mbetur një “fontanë dëshirash”. Kjo strategji parashihte që të bëjë kompjuterizimin e shkollave, të organizonte mësim online, madje të përdorte edhe e-ditarët, e-diplomat, e-mësimin, e-librezat, e-indeksat etj., për të krijuar një sistem modern, ashtu siç e parasheh Evropa dhe bota (QK, 2016).

Të mësuarit nga distanca në Kosovë sigurisht që mund të thuhet se është në stadin e përpjekjeve për ta filluar një gjë të tillë. Le të jemi modestë dhe ta sqarojmë të vërtetën, më shumë flitet se që është arritur në këtë drejtim. Se ku qëndrojnë anomalitë apo defektet në këtë drejtim, sigurisht se do të shpalosen në vijim të këtij studimi dhe madje tek pasi t'i paraqesim rezultatet e pyetësorëve të realizuar me prindër, mësimdhënës, nxënës dhe komunitete. Sistemi arsimor në Republikën e Kosovës është publik dhe privat (jopublik). Shkollat private quhen kolegje dhe ato bëjnë marketing edhe për organizimin e e-mësimit, madje edhe të m-mësimit. Krejt kjo varet sa të zëshëm e kanë marketingun.

### *Ecuria e krijimit të një kursi online*

Pasi të keni arritur deri te koncepti i krijimit të një kursi online për mësim nga distanca nëpërmjet platformës e-learning, me pak mund do ta krijoni një klasë për mësimnxënie nëpërmjet e-mësimit apo edhe m-mësimit (Epignosis, 2014).

Për këtë preferohet:

- të filloni me sistemin LMS (Learning Management System)
- të krijoni një ueb-faqe
- të siguroni një model për e-mësim (shumë kompani ofrojnë modele falas (template), si Google ofron dizajne të ndryshme, por edhe kompani tjera)
- të siguroni veglëri që përkrahin multimediat
- të krijoni leksionet tuaja (i ruani dhe i bartni në ueb-faqen tuaj).

Në këtë mënyrë është arritur që të mundësohet komunikimi me nxënësit nga distanca nëpërmjet formës elektronike të të nxënës, e-mësimi dhe m-mësimi. Për të gjitha paqartësitë, ata drejtohen te mësuesi i tyre nëpërmjet postës elektronike apo mënyrave të tjera që i ofron vetë ueb-faqja.

### *Zgjedhja e ritmit të të nxënës*

Pjesëmarrësit e studimit nga distanca nëpërmjet platformës DLS mund të zgjedhin në mënyrë krejt të pavarur për shpejtësinë me të cilën ata do të mësojnë. Janë të pavarur në listimin e leksioneve dhe atë mund ta bëjnë sa herë të duan dhe madje kur të duan. Në materialet që janë më të lehta për ta, mund t'i kalojnë më shpejt, ndërsa leksionet që i vlerësojnë më të vështira mund t'i përsëritin disa herë. Në këto raste mund të ngrenë

edhe tema diskutimi në forum me bashkëpjesëmarrësit, apo edhe me mësimdhënësin e lëndës përkatëse.

#### *Zgjedhja e vendit për mësim*

Zgjedhja e vendit se ku do të mësojë pjesëmarrësi është plotësisht e lirë. Varësisht nga përzgjedhja e tij, ai mund të mësojë në shtëpi, në punë, në piknik, në udhëtim, e kudo tjetër që i mundësohet qasje në internet dhe ka në dispozicion kompjuter, tablet, smart phone, apo pajisje tjera të përshtatshme për riprodhim të materialit të ofruar nga mësimdhënësi i tij.

#### *Zgjedhja e mënyrës së të mësuarit*

Secili nga studiuesit e ka mënyrën e vet të preferuar për mësim. Dikush e pëlqen mënyrën aktive të të mësuarit, e dikush atë pasive. Ka raste ku studiuesit e pëlqejnë që të mësuarit ta bëjnë ulur, disa të tjerë të shtrirë, dikush tjetër e pëlqen që mësimin ta bëjë duke bashkëbiseduar me të tjerët, e dikush duke qenë krejt i pavarur në zgjidhjen e problemave të ndryshme. Ka të tjerë të cilët preferojnë që të nxënit ta bëjnë nëpërmjet telekonferencave apo video-konferencave, nëpërmjet animacioneve, grafikoneve etj.

Për të gjitha këto dhe shumë mënyra tjera i ka në dispozicion të përhershëm platforma DLS.

#### *Puna praktike me teknologji të ndryshme*

Të nxënit nga distanca është një përzierje, e cila jo vetëm që i mundëson nxënësit të mësojë për lëndët e tij në programin e përzgjedhur, por gjithashtu ky sistem i jep mundësinë që ai të mësojë edhe për përdorimin e teknologjive të ndryshme dhe në veçanti

teknologjive të reja, të cilat thuhet se çdo ditë ndryshojnë. Për mësim nga distanca zakonisht përdoren kompjuterët (PC, laptopët, tabletët etj.), CD player, videorekorderët, smart-pajisjet, si: smartphonet, tochsreenët, smart tabelat, projektorët etj. Për të gjitha këto dhe pajisjet tjera teknologjike, pjesëmarrësit do të fitojnë shkathtësi për përdorim.

### *Mësimi i pavarur*

Studentët të cilët e kanë zgjedhur mënyrën e të nxënies nga distanca, zakonisht janë shumë të motivuar dhe ata pretendojnë që mësimin ta bëjnë të pavarur. Ata e marrin materialin nga mësimdhënësi i tyre nga distanca në mënyrë elektronike, e përpunojnë atë, por gërmojnë edhe në gjetjen e informatave tjera shtesë, të cilat e bëjnë atë edhe më të kompletuar. Gjithashtu, mësimdhënësi shpesh në fund të leksioneve të tij parashtron edhe pyetje kërkimore, të cilat t'i përfundojnë vetë studentët. Po ashtu studentët i kryejnë në mënyrë të pavarur shumë zgjidhje të detyrave nga shkencat e natyrës, por këtë mund ta bëjnë edhe nëpërmjet bashkëpunimit me grupin.

### *Koha për mësim*

Të mësuarit nga distanca (DLS) ofron mundësinë që studenti ta zgjedhë kohën se kur ai do të mësojë. Pra, ai është plotësisht i pavarur nga studentët tjerë, madje edhe nga mësimdhënësi i tij, për ndarjen e kohës për mësim, apo për përpilimin e orarit për studim. Kështu platforma DLS ia ofron atij mundësinë 24/7 (24 orë në ditë gjatë tërë javës) të mësojë sipas dëshirës, kohës apo kushteve tjera që i ka në dispozicionin. Dhe kështu e vazhdon gjithë kohën e studimeve me të drejtë të ndërhyrjes në orarin, të cilin vetë e përpilon, vetë i përmbahet, madje vetë edhe e ndryshon.

### *Komunikimi me profesorë dhe asistentë*

Me anë të teknologjive të reja po lehtësohet gjithnjë e më shumë mënyra e studimit. Këto pajisje bëjnë të mundur komunikim të lehtë me mësimdhënësit, apo me ndihmësin e tij.

Kjo arrihet në mënyrë direkte (online), nëpërmjet ligjëratave direkte, video-konferencave, telekonferencave, forumeve, chat-eve, por edhe nëpërmjet mesazheve në rrjete sociale, si fb, viber, e-mail etj.

Në përgjithësi, studentët kanë dëshirë që të mos bëjnë mësim direkt, por ato t'i mësojnë kur ata ta kenë kohën e preferuar. Megjithatë, edhe kjo është përzgjedhje e tyre, ndërkaq platforma DLS e mundëson një gjë të tillë. Shkolla virtuale e ka të implementuar patjetër këtë mundësi, pa të cilën nuk do të mund të funksiononte mësimi nga distanca, e-learning.

### *Akademia online e të mësuarit nga distanca - Almooc*

Një nga platformat e ofruara për mësim nga distanca nëpërmjet platformës digjitale është almoku (Almooc, 2016). Në kuadër të kësaj platforme, të menduar për gjithëpërfshirjen e nxënësve të shkollave të mesme të ulëta dhe shkollave të mesme të larta sipas sistemit të arsimit, të miratuar nga MASHT i Republikës së Kosovës, deri tani zhvillohen mësim në anglisht (Ang, 2016), matematikë (Mat, 2016), fizikë (Fiz, 2016), kimi (Kimi, 2016), kodim (Kodim, 2016) dhe TIK (Tik, 2016).

Bazuar në portalin e saj, deri tani janë përfshirë rreth 50 000 nxënës (Almooc, 2016). Në bazë të të dhënave shihet se deri tani janë plotësuar 176 365 teste, janë dorëzuar 16 596 projekte, si dhe janë diskutuar 48 556 tema (Almooc, 2016).



Fig. 10. Faqja startuese e almooc-ut (parë më 19. 8. 2016)

Në kuadër të fizikës (Fiz., 2016), deri tani janë të regjistruar mbi 5 500 studentë, leksionet e tyre mund t'i marrin të gjithë ata që janë nxënës të shkollës së mesme të ulët, nga klasa VI deri në klasën IX, si dhe nga klasa X deri në klasën XII në kuadër të shkollës së mesme të lartë, sipas Ligjit për arsim parauniversitar (Ligji nr. 04/L-032), të miratuar nga MASHT i Republikës së Kosovës. Regjistrimi për të gjithë nxënësit është falas, ndërsa brenda kësaj platforme janë ofruar njësi mësimore në bazë të planprogrameve mësimore sipas Ligjit të arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës.

Mësimdhënësit janë të përzgjedhur dhe i përgatitin njësitë e tyre mësimore në bazë të planprogrameve mësimore të miratuara. Literatura që përdoret është po ajo që e përdorin nxënësit në shkollë gjatë mësimit tradicional. Numri i tyre është gjithnjë në rritje. Ata e kanë edhe forumin për bashkëbisedim brenda kësaj platforme. Kuizin pas çdo njësie mësimore dhe mundësinë e dërgimit të pyetjeve drejt mësimdhënësit të asaj lënde. Në

kuadër të lëndës së fizikës është krijuar edhe laborator virtual, në të cilin nxënësi mund ta përcjellë zhvillimin e ushtrimit laboratorik, bie fjala të përcaktimit të dendësisë së trupit, kur dihet masa dhe vëllimi i tij (Fiz., 2016).




Fig. 13. Laboratori virtual i fizikës

Po ashtu, në kuadër të kësaj platforme funksionon edhe nektari (Nektari, 2015), me pyetje të përditshme për nxënësit nga lëndët që organizohet në almooc (Almooc, 2016).




Fig. 14. Linku: nektari



Kësaj platforme si nismë i ka prirë fillimi i mësimimit në anglisht, kur atëbotë ishte vegëza për çasje: (Ang, 2016). Pas suksesit të parë fillon edhe mësimi online në matematikë e kodim, dhe pastaj i shtohet lënda fizikë e kimi. Së fundi, përfshihet edhe lënda TIK.

Këtë platformë nxënësit mund ta përdorin falas sa herë të duan dhe madje kur të duan.

Një qasje e tillë është edhe kriteri i të nxënimit nga distanca nëpërmjet e-mësimimit (e-learning).

Kjo akademi funksionon edhe si e-mësim edhe si m-mësim. Pra, asaj mund t'i qaset nxënësi nga PC, laptopi nëpërmjet internetit kabllor që e përbën e-mësimin, e po ashtu edhe nëpërmjet tabletëve, smartphonëve, mobil-telefonave me internet wifi.

#### *Mësimi ECDL dhe modulet e tij*

Njohja e punës me kompjuter është njëri nga kriteret themelore të të nxënimit nga distanca nëpërmjet e-mësimimit (e-learning). (Learndirect, 2016). Sigurisht se do të duhej të përcaktohej një prag kalueshmërie e nivelit të njohjes së punës me këtë metodologji të re informative. Së pari duhet të theksojmë se me njohuritë bazike të punës me kompjuter duhet domosdoshmërisht të aftësohet mësimdhënësi, i cili në këtë platformë të të nxënimit nëpërmjet e-mësimimit (e-learning) është në rolin e të ashtuquajturit mësimdhënës virtual. Por, në anën tjetër, edhe vijuesi në shkollën virtuale (nxënësi, studenti, i punësuar, i papunësuar) duhet të ketë njohuri bazike në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK). Ka mjaft programe të cilat formojnë gjuhë programuese (Oblinger, 2006), e që janë të mbështetura në parimet dhe rregullat e matematikës, si Java, C++, php etj., me të cilat studentëve u mundësohet të regjistrohen, të marrin leksione, të paraqesin provime, t'u nënshtrohen kuizeve e testeve tjera të ndryshme që i ofron platforma online.

Paketa themelore e njohjes së punës me kompjuter që duhet ta zotërojë mësimdhënësi është ECDL (European Computer Driving Licence), që në përkthim të lirë e ka kuptimin “Patentë-shoferi evropian për përdorim të kompjuterit”.



The screenshot shows a website page for ECDL courses. At the top, there is a breadcrumb trail: Home > Office Computing > ECDL. Below this, there are two main columns. The left column is titled 'Office Computing' and contains a list of links: Microsoft Office Specialist (MOS), Microsoft Office 2013, Microsoft Office 2010, Microsoft Office 2007, ECDL, Keyboard Skills, Browsers & Operating Systems, and Sage. The right column is titled 'ECDL COURSES' and contains a paragraph of text: 'These interactive ECDL (European Computer Driving License) courses can be purchased as a collection ("ECDL Skills Suite" for Office 2007 or 2010) or as separate modules. They are perfect for beginners and will help you to feel comfortable with IT and become more confident using Microsoft applications. In addition to ECDL training, the courses are also a popular choice for desktop IT training in general.' Below this paragraph, there is a note: 'Please note that the courses themselves do not amount to an ECDL qualification, rather they provide the background knowledge for key aspects of the syllabus. The required assessments for ECDL qualifications must be purchased separately from an approved ECDL test centre and additional training may be required for qualifications at Level 2 and above.' At the bottom of the right column, there is a link: 'A full range of courses for Microsoft Office applications are also available from our store.'

Fig. 15. ECDL

Aftësitë kompjuterike, të cilat i merr mësimdhënësi nga paketa ECDL, i mundësojnë që në mënyrë profesionale t’i përcjellë mësimet deri te nxënësi (studenti) nëpërmjet internetit, që është e-mësimi (e-learning).

ECDL është një certifikim progresiv dhe fleksibil për zhvillimin e shkathtësive digjitale të individëve. ECDL është standardi kryesor ndërkombëtar i certifikimit të njohurive kompjuterike. Programet e ECDL-së janë të ndërtuara në mënyrë modulare, me përfaqësi në mbi 150 shtete të botës dhe me mbi 13 milionë kandidatë, ECDL është standardi më i përhapur në botë dhe me rritjen më të shpejtë (Ecdl-Kosova, 2016).

Për mësimnxënie të suksesshme nga vijuesi në shkollën virtuale, ai domosdoshmërisht duhet t’i dijë elementet bazike të ECDL-it. “Misioni ynë dhe misioni i ECDL-së ka të bëjë me ngritjen e nivelit të njohurive themelore kompjuterike dhe të teknologjisë informative” (Kasumi, 2005). Themelore është të jetë i njoftuar me internetin. “Interneti përbëhet nga lidhja e një numri shumë të madh rrjetash të kompjuterëve të shpërndarë

*anekënd botës*” (Skenderi, 2000). Para së gjithash, duhet të jetë në gjendje që ta formatojë tekstin e radhitur (Font, Size, Bold, Italic, Underline), pastaj për krijimin, plotësimin e tabelave, zgjedhjen e formatit të letrës, ruajtjen e tekstit në sirtarin (Folder-in) e dëshiruar, printimin e tekstit etj. Për largimin e rreshtave ndërmjet vete me hapësirë 2 (Celebiq 2012) seklectohet teksti dhe me kombinimin e tasteve CTRL+2, i gjithë teksti i selektuar do të largohet ndërmjet rreshtave me hapësirë dyshe (double). Për punën me programin MS Excel, autori: (Skenderi, 2000) shkruan: *“Microsoft Excel është një program me të cilin mund të bëhet llogaritje automatike e tabelave, analiza statistikore, parashikimi i rezultateve financiare, prezantime, ndërtimi i diagrameve dhe tabelave të ndryshme etj.”* Pra, të mësuarit e punës me MS Excel, veç tjerash, duhet të përfshijë edhe: formatimin e tabelës, të shkruarit e formulave bazike për kalkulime, krijimin e grafikonëve, ruajtjen dhe printimin e një flete të punës (File në Folder-in e caktuar). Prezantimi i një punimi që e përgatit patjetër që duhet të ketë shkathtësi që ta krijojë dhe ta prezantojë. Pastaj, leximi i postës elektronike dhe manipulimi me materialet e dërguara si dhe njohuri bazike në pjesën harduerike të kompjuterit.

Një varg modulesh (të lartcekura) janë pjesë e paketës ECDL, të cilat po ashtu i ndihmojnë vijuesit të përgatiten për të qenë të gatshëm gjatë kohës së ndjekjes së leksioneve dhe detyrave tjera që u ofrohen nëpërmjet platformës elektronike e-mësimi (e-learning).

MASHT-i duhet të vazhdojë me trajnimin e të gjithë mësimdhënësve të arsimit parauniversitar (Dervisholli, 2013), në mënyrë që ata të jenë të gatshëm të përballen me sfidat e reja që vijnë nga teknologjia e re dhe inovacionet tjera.

### 3.7. Mësimi tradicional

Shkollat e para të themeluara përbëheshin nga një grumbull fëmijësh, të cilët thjesht argëtoheshin. Ata mësonin si ta kenë një fëmijëri të lumtur të asaj kohe, argëtoheshin nëpërmjet lojërave dhe detyrave tërheqëse, të cilat ua mësonin mësuesit e tyre. Nëse ky ishte qëllimi i shkollave të para të themeluara, atëherë fare lehtë është të kuptojmë se kush mund të kenë qenë ata fëmijë të lumtur, të cilët bëheshin pjesë e atyre shkollave. Sigurisht që fëmijët e njerëzve të pasur dhe me ndikim të atyre kohërave. Këto janë të dhëna për zanafillën e shkollave të para, mijëra vite më parë.

Pushtuesit në trojet tona shqiptare ishin të rreptë dhe gjithnjë vepronin për persekutimin e kombit, me theks të veçantë moslejimin e hapjes së shkollave. Edhe atëherë kur ato hapeshin, shqiptarët ishin këmbëngulës që të mësonin, edhe pse obligoheshin që mësimin ta bënin në gjuhë të huaja, në vendin e tyre. Kjo ishte “liria”, këto ishin rregullat e pashkruara të një loje të paparë. Sistemi i shkollimit në trojet tona gjithnjë ishte i imponuar. I përgatitur dhe përshtatur me kulturë, histori dhe urrejtje të papërshkrueshme për kombin tonë. Pak më të lehtë do ta kishin shkollat pas Luftës së Dytë Botërore. Klasat ishin dhoma klasike, në të cilat në mur qëndronte e varur një tabelë e zezë, mbi të cilën do të shkruhej me një shkumës me ngjyrë të bardhë.



Fig. 16. Mësonjëtorja e Korçës, 1887

Nxënësit uleshin nëpër rreshta dhe e dëgjonin vetëm atë që fliste mësuesi. Pyetjet e tyre rrallë mund të drejtoheshin, ngase ora ishte e kufizuar dhe pas saj mbyllej gjithçka. Notimi i nxënësve bëhej sipas tekeve të mësimdhënësit dhe ngjasonte në gjykatore. Grupi i madh i nxënësve në klasë nuk lejonte dot që ata të jenë të lirë në zhvillimin e ndonjë debati për çështjen e ngritur. Ndërkaq në shkollat nëpër fshatra, ku numri i nxënësve është ulur dukshëm, në ciklin fillor (deri klasën V) mësimi mund të zhvillohet edhe në klasë të kombinuara. Kjo nënkupton që një mësues t'i mësojë përnjëherë dy klasë, p.sh. klasën e parë dhe të tretën. Një kombinim i egër që bëhej nuk ka se si të nënkuptohet ndryshe veç si një tendencë për mosarritje të suksesit. Fatkeqësisht, edhe sot ekzistojnë klasë të tilla në Kosovë. Klasat e tilla dhe nxënësit në fjalë nuk do të korrin sukses, ndërsa bota e qytetëruar mendon, punon dhe realizon mësimin nga distanca me mbështetje të e-mësimit (e-learning).

Mësonjëtoret e shkollave tradicionale përdorin literaturë të stërvjetruar, ndërsa mësimdhënësit në shumë raste ende japin shënime. Vlerësimi me nota është bëhet në mënyrë klasike, ndërsa për lëvizje të lirë brenda orës mësimore as që mund të paramendohet. Planprogramet mbeten të njëjtat, sikur ato që ishin dekada përpara, ndërsa mësimdhënësit nuk trajnohen për të qenë në hap me kohën. Infrastruktura është e varfër, bibliotekat me tituj të stërvjetruar dhe gjithçka larg standardeve. Nxënësit janë të pajisur në mënyrë vetjake me pajisje më të reja, të cilët e shohin botën e qytetëruar, ndërsa ata nuk mund të kalojnë në të mësuarit me reforma të reja, ngase mësimdhënësit nuk i janë qasur mësimin gjatë tërë jetës. Ata kanë mbetur larg shkathtësive të përdorimit të teknologjive të reja, ndërsa shteti nuk ka plan konkret për të dalë nga kjo gjendje. Është koha e fundit për të filluar integrimin e këtyre shkollave dhe për ta reformuar mësimin tradicional e për t'i dhënë shtytje të fortë e-mësimit dhe mësimin gjatë gjithë jetës.

Viteve të fundit vërehen përmirësime minore në disa shkolla. Mirëpo, ende gjithçka është larg nga përmbushja e standardeve të BE-së dhe Procesit të Bolonjës.

### **3.8. Mësimi gjatë gjithë jetës (Life Long Learning)**

Në të kaluarën jo shumë të largët, me të përfunduar të një cikli arsimor dhe gjetjes së një vendi të punës me kontratë të përhershme, shumëkush konsideronte se e ka përmbyllur të mësuarit për gjithë epokën e punës (deri në pensionim). Për dallim, vetëm mësimdhënësit konsideroheshin se duhet të mësojnë për t'i mësuar nxënësit e tyre. Ishte ky një sistem i cili pastaj kërkonte vetëm përvojë pune dhe pagesë solide që u ofronte punëtorëve, ndërsa këta të fundit punonin për të arritur deri në moshën e pleqërisë dhe për ta gëzuar pensionin e merituar. Por, në atë sistem të ish-Jugosllavisë, pensionimi mund të bëhej edhe me vite të caktuara të përvojës së punës. Një gjë e tillë kaq e ashpër është parë se ishte plotësisht e gabuar, ngase me hapa gjigantë po zgjerohen kufijtë e dijes, ndërsa ata që nuk marrin pjesë në këtë maratonë rrezikohen të mbeten të marginalizuar dhe të mbeten prapa në marrjen e diturive të reja krahas zhvillimeve dhe ndryshimeve në arsim, me çka mund edhe ta pësojnë me vend pune. Një ndër strategjitë e Qeverisë së Kosovës, por jo vetëm të kësaj, është platforma dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës. Por, si mund ta përkufizojmë më thjesht mësimin gjatë gjithë jetës?

Mësimi gjatë gjithë jetës (Memorandum i BE-së për mësim gjatë gjithë jetës) është një proces i cili zgjat tërë jetën e një njeriu (Komisioni Evropian, 2000). Ai që nga moshën e fëmijërisë së hershme, kur i fillon mësimet e para, gjatë gjithë jetës së tij duhet të mësojë. Mësimi i tij natyrisht se e ka intensitetin e vet, e ka ngritjen dhe rënien, por gjithnjë duhet të jetë mbi zero. Kjo do të thotë se aftësimi i tij duhet të jetë permanent. Kjo bëhet për

shkak të zhvillimit të hovshëm të metodologjive të reja në fushën e specializimeve nga më të thjeshtat, varësisht nga profesioni i arritur gjatë shkollimit obligues. Mjetet e punës në organizata të ndryshme ndryshojnë dita-ditës, ka vende pune që ato zëvendësohen nga makina të programuara me softuer adekuat, si dhe me robotë. Aty shkurtimi i vendeve të punës është i pashmangshëm. Lëvizja e lirë, por edhe migrimi i madh që po ndodh, nxjerr në pah fuqi punëtore, që pranojnë të punojnë për paga minimale, apo paraqiten edhe ekspertë të fushave specifike, të cilët janë konkurrentë të pakrahasueshëm me të gjithë ata që ende mendojnë se janë të përhershëm në atë organizatë, apo janë të pazëvendësueshëm. Mësimi gjatë gjithë jetës është aktivitet arsimor, i cili ka për qëllim ngritjen gjithnjë e më të madhe profesionale për të krijuar aftësi dhe përgatitje sa më të lartë në fushën përgatitore.

Të mësuarit gjatë gjithë jetës, në literaturën e ndryshme shqipe, por edhe të gjuhëve tjera mund të gjendet si mësim apo arsimim në vazhdimësi, permanent, i pandërprerë, deri në pleqëri, e kështu me radhë. Është e rëndësishme të kuptohet se kemi të bëjmë me të mësuarit sa të jemi gjallë. Mësimi gjatë tërë jetës përbëhet prej mësimit formal (ai obligativ) dhe joformal (mësimi pas marrjes së diplomës së një cikli, si kurset, trajnimet, specializimet etj). Në kuadër të mësimit gjatë gjithë jetës bën pjesë edhe arsimi për të rritur (Deklaratë për arsim për të rritur - program për të ardhmen, UNESCO, 1997) dhe arsimi profesional.

Meqë për të gjitha këto, siç po shihet, krejt kjo shndërrohet në orë, ditë, javë, muaj e vite, koha ecën, koha është e pakthyeshme. Si të gjendet mundësia e kohës për të gjitha këto obligime në procesin arsimor? Si të menaxhohet me kohën? Sigurisht se përgjigjen do ta gjejmë pikërisht të platforma për të cilën është hulumtuar në këtë punim: studimi nga distanca nëpërmjet e-mësimit (e-learning).

Tani shtrohet një pyetje: Për çka duhet të mësojmë tërë jetën?

E përgjigjet janë të shumta:

- Të mësojmë si të mësojmë,
- Të mësojmë që të aftësohemi për një profesion të ri,
- Të mësojmë si të punojmë,
- Të mësojmë si të gjejmë punë,
- Të mësojmë në ngritje profesionale, pasi ta kemi përfunduar një shkollim të caktuar,
- Të mësojmë si të punojmë më mirë,
- Të mësojmë si të jetojmë,
- Të mësojmë të jetojmë.

Në kohën e zhvillimeve të hovshme të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), pa dyshim se koha është shndërruar në një element shumë të rëndësishëm. Assesi nuk mund të paramendojmë se e kemi përfunduar këtë shkollim dhe tani jemi të përgatitur gjatë gjithë jetës të punojmë. Kjo dinamikë vë në pah ndryshimet që duhet t'i bëjë shoqëria, e sidomos që studentëve t'u mundësohet që një pjesë të kohës së tyre ta kthejnë në punë. Kjo do ta zbuste edhe gjendjen e tyre ekonomike dhe do t'u jepte atyre një pamje reale se arsimimi nuk përfundon asnjëherë.

Në kuadër të kësaj mund të ngrihet edhe një dilemë tjetër: A është e mundur që të punojmë në distancë?

Sigurisht se kjo pyetje mund të jetë për të gjithë ata të cilët do ta bënin një hulumtim në këtë fushë.



Në fund duhet ta kemi parasysh se njeriu është qenia më e rëndësishme e kësaj shoqërie (Globazition, 2016), andaj duhet të çmohet, vlerësohet, ruhet dhe të trajtohet si më e rëndësishmja për ne.

### **3.9. Si kuptohet në Kosovë mësimi në distancë: e-learning?**

Rezultatet e analizës së këtij hulumtimi tregojnë se grupi hulumtues e ka vlerësuar lart ardhmërinë e e-mësimit, i cili është në rritje e sipër, duke cituar se kërkohet përfshirje edhe më e madhe e popullatës, por gjithashtu edhe një vetëdisiplinë më e lartë për ngritjen e vetëdijes për vetëmësim, shkathhtësi më të mëdha në nxënie etj. Të dhënat flasin se e-mësimi nuk shihet më si metodë e kundërt nga mësimi i deritanishëm. Por, shihet gjithnjë e më shumë si plotësim i metodave të të nxënies, të cilat e lehtësojnë mësimnxënien dhe po ashtu e bëjnë edhe më tërheqëse. E-mësimi shihet nga grupet e hulumtimit si një proces fleksibël, i cili po integrohet gjithnjë e më shumë në mësim natyral, e jo si e-mësim, duke marrë kuptimin e “learning” pa “e- kuptim elektronik”. Ky lloj mësimi mund të vlerësohet vetëm si një metodë e re pedagogjike.

### **3.10. Epërsitë dhe mangësitë e të mësuarit në distancë**

#### *Epërsitë e të mësuarit në distancë*

Nëse parashtrahet pyetja se çka ofron mësimi nga distanca karshi mësimit tradicional, apo cila është arsyeja që në vend të studimeve në fakultet të përcaktohem për mësim online, pa dyshim se ka një varg epërsish. Para se t'i numërojmë disa nga këto përparësi, vlen të theksojmë se të mësuarit nga distanca nuk bie ndesh me të mësuarit tradicional,

por e plotësojnë njëri-tjetrin, duke e pasuruar rezultatin përfundimtar të të nxënit, që njëherësh është edhe pikësypnim i një mësimdhënësi.

Të përmendim disa nga epërsitë e shumta që ofron e-mësimi:

- Nuk ka shpenzime për banim dhe shpenzime tjera që kërkohen gjatë studimit tradicional në institucion,
- Mund të zgjidhet fakulteti në të cilin studiohet, pavarësisht se në cilin vend ndodhet studiuesi, pa pasur nevojë në ndërrim vendbanimi,
- E-mësimi mund të ndiqet sipas orarit të cilin e përcakton vetë nxënësi (studenti),
- Edhe atëherë kur nxënësi (studenti) privohet nga mundësia e pjesëmarrjes fizike në ligjërata, në rastet e sëmundjeve apo pengesave tjera të ndryshme, nëpërmjet platformës e-learning me sukses do të jetë i pranishëm gjithnjë për t'i parë dhe dëgjuar leksionet që i obligon institucioni arsimor,
- Nëpërmjet e-learning, vetë studiuesi mund ta përcaktojë kohën e studimit, gjë që i jep një relaks dhe motivim shtesë, pa pasur nevojë që ta humbë kohën e tij të çmuar.

Përveç kësaj, të mësuarit elektronik e-learning ka edhe përparësi tjera në krahasim me mënyrën e të mësuarit tradicional.

- Nëpërmjet e-mësimit realizohet mësimi gjatë gjithë jetës (Lifelong learning),
- Vijuesit e këtij modeli të të nxënit janë të pavarur gjatë mësimit, mbajnë tempin e vet dhe vetë e zgjedhin kohën se kur do të “hyjnë në ligjërata”,
- Për një lëndë, që e ofron institucioni arsimor, ata mund të përzgjedhin vetë njërin nga mësimdhënësit e shumë të asaj lënde,

- Mësimin nga distanca nëpërmjet platformës e-learning mund të zgjidhet të përcillet nga shtëpia, nga vendi i punës, nga pikniku nëpërmjet m-learning (m-mësimi),
- Edhe kur vendbanimi, apo edhe shteti në të cilin jeton studiuesi, nuk e ofron drejtimin e programit që e dëshiron, nëpërmjet e-learning kjo realizohet në kohë reale,
- Mundësohet pjesëmarrja në ligjërata e profesorëve me renome ndërkombëtare, pa pasur nevojë migrimi,
- Përzgjedhja e mënyrës së të mësuarit, aktive apo pasive,
- Edhe mësimdhënësit do të jenë më azhur gjatë gjithë kohës, ngase studentët e tyre parashtrajnë pyetje nga më të ndryshmet, të cilat kërkojnë shkathtësi të veçanta për t'u përgjigjur.

#### *Mangësitë e të mësuarit në distancë*

Me gjithë epërsitë e shumta që ka metoda e të mësuarit nga distanca, pa dyshim se ajo i ka edhe mangësitë e veta. Njëloj sikur që pacienti e përdor një medikament, është i vetëdijshëm se ai i ka edhe efektet anësore, për të cilat duhet të njoftohet paraprakisht, ashtu edhe mësimnxënësi duhet t'i marrë njohuritë bazë për të metat që i ka mësimi në distancë, e-learning.

Platforma e të nxënies nga distanca kërkon shkathtësi të veçanta për ta shfrytëzuar në mënyrë reale tërë atë që e ofron e-mësimi. Në radhë të parë kërkohet që ai të pajiset me mjetet më të avancuara të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si: kompjuter, internet, kamerë digjitale, kufje, printer, skaner etj. Këto pajisje e kanë koston e vet, por gjithashtu kërkojnë edhe njohuri të avancuara në përdorimin e tyre. Mosnjohja e punës

me to, në cilindo stad, e ndërpret ecjen tutje të të nxënit. Gjithashtu faktor shumë i rëndësishëm është edhe disiplina e rreptë që duhet ta vetëmbajë studiuesi gjatë kohës së ndjekjes së leksioneve, e në veçanti kur ato janë online dhe janë organizuar nëpërmjet video-konferencave. Vetëbesimi dhe vetëmotivimi janë faktorë tjerë, të cilët mund ta ulin apo edhe ta ndërpresin përdorimin e kësaj metode të të nxënit. Vetëvlerësimi duhet të jetë njëra nga sfidat të cilat nuk është edhe e lehtë të implementohet sa është vetëdija e lartë e studiuesit që ta përcaktojë kohën e përbushjes së përcjelljes së leksioneve, ushtrimeve dhe debateve tjera të domosdoshme për korrjen e rezultateve gjatë studimit.

### **3.11. Mësimi në distancë: luks apo nevojë?**

Mësimi në distancë ka kohë që aplikohet në forma të ndryshme. Lajmëtarët e parë që kishin për detyrë t'i njoftonin të tjerët kanë përdorur mënyra të ndryshme për ta përhapur informatën. Përhapja e informatave në distancë është bërë edhe nëpërmjet letrave. Edhe pëllumbat kanë qenë shpërndarës të letrave, të cilëve ua kanë lidhur letrën në këmbë dhe ata kanë fluturuar me disa qindra kilometra për të arritur deri te personi, të cilit është dërguar letra. Po kështu, ka raste kur mësimi në distancë është organizuar për disa nxënës apo edhe studentë, të cilët, për shkak të ligjeve kanunore, kanë rënë në hasmëri dhe nga frika e gjakmarrjes janë detyruar të ngujohen. Në ato raste, ata kanë mbetur pa i vijuar fare mësimet tradicionale. E në ato raste, kur ka qenë pak e zhvilluar teknika, ata kanë mundur që mësimet t'i ndjekin kohë pas kohe nëpërmjet ndonjë radioje, e më vonë edhe të televizionit. Por, sot, të mësuarit në distancë është bërë trend i kohës. Disa i ndjekin programet e studimit me mësimnxënie nga distanca vetëm për ta kursyer kohën, të tjerët nga pamundësia e udhëtimit për shkak të shpenzimeve të mëdha, e të tjerët nëse janë me

aftësi të kufizuara në pamje, në ecje apo me ndonjë vështirësi tjetër (Holcombe, 2014). Edhe fëmijët me aftësi të kufizuara mund të ndjekin programe me studim nga distanca - distance learning, nëpërmjet e-mësimit (e-learning) apo m-mësimit (m-learning). Në ato raste kur fëmijët kanë aftësi të veçanta, ata mund të ndjekin programe të përshtatshme për ta edhe nga shtëpia e tyre, apo vendi ku ata jetojnë. Natyrisht se ky studim atyre do t'ua lehtësojë ndjekjen e leksioneve të mësimdhënësit, njësoj sikur të ishin të pranishëm fizikisht në klasë. Kjo nuk do të thotë se ata kërkojnë lehtësira në kalueshmërinë e provimit, por mënyra e marrjes së leksioneve ua lehtëson përgatitjen e programit të zgjedhur të studimit. Kalueshmëria është përcaktuar në bazë ligjore, varësisht si e ka paraparë statuti i kolegjit apo i universitetit.

Pothuajse në secilin shtet, fatkeqësisht, ekziston një numër i fëmijëve të cilët kanë bërë shkelje ligjore, e të cilët për shkak moshës jomadhore, në bazë të ligjit, nuk mund të dënohen, por ata do të vendosen në shtëpi të veçanta të shtetit, ku tërë kohën janë nën përkujdesje shtetërore (Holcombe, 2014). Atyre u ofrohet siguri dhe secili nga ta e ka edhe një person kujdestar, siç mund të quhet - prind zëvendësues apo kujdestar. Ai duhet të kujdeset që edhe fëmijët, të cilët janë nën përkujdesjen e tij, ta ndjekin shkollimin falas brenda asaj shtëpie për kujdes ndaj të miturve. Ka raste kur fëmijët e tillë mund të jenë tepër të zgjuar dhe kërkojnë ndonjë program që aty brenda nuk u ofrohet. Prindi kujdestar duhet që në bashkëpunim me prindin natyral ta plotësojnë kërkesën e fëmijëve të tillë. Në këto raste, një gjë të tillë e ka bërë më të lehtë metoda e të mësuarit nga distanca, nëpërmjet e-mësimit (e-learning) apo m-mësimit (m-learning).

Dhe, nga të gjitha këto, si mund të japim përgjigje: Mësimi në distancë është luks, nevojë, apo gjest human?

Cilado nga këto përgjigje është e saktë. Për të tri rastet kemi shembuj të cilët flasin për arsyen e të studiuarit nga distanca (distance learning) nëpërmjet e-mësimit (e-learning) dhe m-mësimit (m-learning).

Nga të gjitha, arsyeja kryesore është se të mësuarit në distancë është më i përsosur se të gjitha llojet tjera të të nxënimit. Kjo nuk do të thotë se të mësuarit tradicional duhet larguar, ta shpallim të pavlefshëm, apo ta nënvlerësojmë. Mësimi në distancë është vetëm plotësim i mësimit tradicional dhe shpesh autorët e ndryshëm (Epignosis, 2014) e quajnë edhe mësim të kombinuar apo të përzier (blended learning).

### **3.12. Sfidat e udhëheqjes së arsimit me mësimnxënie nga distanca**

Udhëheqja me arsimin është njëra nga sfidat më të mëdha për menaxherët. Ekipet të tëra punojnë dhe vazhdimisht studiojnë për të arritur cilësi në fushën e arsimit. Ardhmëria e një shteti, pikërisht varet nga cilësia në arsim. Kjo nuk paraqet zbulimin e “ujit të nxehtë”. Por, sigurisht se kërkon vëmendje të vazhdueshme për secilin popull, e sidomos për popullin shqiptar, që akoma është larg pikës reale, me të cilën do të vetëkënaqeshim me të arriturat në arsimin dhe edukimin mbarëkombëtar. Në përmbushjen e planit dhe programit arsimor me mësimnxënie nga distanca, që bazohet në mësimin elektronik, i njohur si e-mësim (e-learning), aktorët që përfshihen jemi pikërisht ne. Kur themi ne, fjala është për:

- Nxënësit, të cilët do të pajisen me dituri të reja, çfarë nuk ka mundur as të paramendohet para disa dekadave,

- Mësimdhënësit, të cilët me metodat e reja, nëpërmjet teknologjive që gati çdo ditë pësojnë avancime, arrijnë me lehtësi dhe në kohë reale ta bartin tërë dijen e nevojshme deri te nxënësit e tyre për programet të cilat i realizojnë,
- Komuniteti, që me vëmendje i përcjell të arriturat dhe ngecjet në arsim dhe
- Prindërit, që mbi supet e tyre e kanë barrën më të rëndë në rast mosuksesit të pasardhësve të tyre.

Bazuar në gjendjen reale të popullatës kosovare dhe gjendjes që e ka kaluar shekuj me radhë, sigurisht se nuk mund të flasim për një cilësi krahasuese me vendet e zhvilluara. Po ashtu, koha e pasluftës nuk ka i ka dhënë pavarësi të plotë arsimit kosovar. Natyrisht se për këtë nuk mund të fajësohet askush, por duhet të vetëkritikohemi. Zhvillimet e hovshme të teknologjive të reja kanë bërë që me shpejtësi të shfaqen edhe nevoja për ndërhyrje në metodat e të nxënësve. Për këtë, të mësuarit nga distanca e ka marrë një formë të prerë të saj, e cila i ka thyer kufijtë e vendeve, duke arritur që t'i ndërtojë të ashtuquajturat “shkollat pa mure”. Kjo u ka ndihmuar shumë të gjithë mësimdhënësit që për shkaqe të ndryshme nuk mund të jenë ballë për ballë (face2face) me nxënësit e tyre, përkatësisht studentët, që për shkak të kostove të larta të studimeve në vende të largëta, ka qenë i privuar të studiojë, e prindërit të mos migrojnë për shkak se fëmijët e tyre nuk kanë mundësi shkollimi në vendin ku jetojnë.

Por, Kosova në këtë drejtim është mjaft larg. Ndryshimet rrënjësore janë më se të domosdoshme, edhe pse ato janë të dhimbshme. Janë të dhimbshme, ngase vështirë do të pranohen nga kuadrot arsimore, se ata vështirë do t'ia dalin të integrohen me metodat e reja, të cilat janë detyruese për ne, për shkak të zhvillimeve të hovshme që po bëhen në elektronikë. Këto ndryshime kanë sjellë pajisje të reja, të cilat e ndihmojnë shumë realizimin e mësimnxënies në kohë dhe në vend të ndryshëm. Secili për vete mund të

vendosë, si mësuesi: kur do ta lansojë leksionin e paraparë për nxënësit apo studentët e tij, nxënësi: kur do t'i mësojë leksionet e ofruara nga mësimdhënësi i tij, prindi: kur do t'i kontrollojë notat (arritshmërinë) e fëmijës të tij, komuniteti: e vëzhgon gjithë situatën për t'i dhënë propozimet e reja për ndërhyrje në pikat më të dobëta të mësimnxënies së arritur nëpërmjet teknologjive të reja me e-mësim dhe m-mësim, ndërsa menaxhmenti i institucionit e përcjell realizimin e punës së përditshme të institucionit në ballë të të cilit qëndron.

### **3.13. Prioritetet për menaxhimin e institucioneve të arsimit e-learning: cilësia apo sasia?**

Është një listë e gjatë për përmbushjen e kriterëve për menaxhim të suksesshëm të një institucioni arsimor me mësimnxënie nga distanca - e-learning. Një ekip i përkryer me përkushtim të veçantë dhe tepër i disiplinuar mund t'i përmbushë kriteret e panumërta, të cilat për çdo çast janë sfidë jo e lehtë për vendimmarrje në këtë fushë inovative dhe karizmatike. Asnjëri nga ekipi përbërës nuk mund të jetë më pak përgjegjës për mospërmbushjen e kërkesave të kësaj platforme. Të gjithë duhet të veprojnë në çdo kohë së bashku, si një celulë enigmatike. Pjesëmarrësi (nxënësi, studenti apo dikush tjetër), i cili e ka përzgjedhur institucionin arsimor, kërkon kurdo leksione, detyra, ngre dilema, hap debate, bën komente, shpërhap dilema për një çështje tejet të rëndësishme dhe aty nis “gumëzhima” për dhe kundër. Secili në mënyrën e vet, e ekipi i ekspertëve me vigjilencë duhet t'i përcjellë të gjitha këto “furtuna”, të cilat mund të jenë ciklike dhe aciklike. Përbërja e pjesëmarrësve është heterogjene. Aty mund të ketë pjesëtarë të komuniteteve



të ndryshme, me përkatësi të ndryshme kombëtare e fetare, me orientime të ndryshme dhe të ndryshëm në numër.

Por, cili është qëllimi i një institucioni arsimor aq të vlefshëm për kohën e kompjuterizimit? Të ketë numër të madh pjesëmarrësish (sasi), apo të korrë suksese (cilësi) të larta me ta?

Dilemë që duhet të debatohet. Ato janë të rëndësishme dhe të pandashme. Të gjithë ata që shprehen për njërin apo tjetrën që ka prioritet më të madh, apo më të vogël, ka hequr dorë nga gjysma e suksesit. Edhe (Mattheis, 2012:7) konkludon se sfida është se si të rritet suksesi (cilësia) dhe gjithëpërfshirja (sasia). Me gjithëpërfshirje nuk do të thotë se kemi garanci për cilësi në arsim. Mirëpo, Kosova, si shtet i ri, çdo hap që e ndërmer në cilëndo fushë, në përgjithësi, e në atë të arsimit, në veçanti, përballë vetes e ka sfidën e dyfishtë: cilësinë dhe sasinë. Për arritjen e një syzheu të përbashkët duhet të ketë shpërndarje të profesioneve. Pra, institucionet arsimore nuk guxojnë të jenë me programe të njëjta, por ato të specifikohen varësisht nga kërkesat e tregut. Me këtë nënkuptojmë gjithëpërfshirje të të rinjve në mësim nga distanca, por edhe rritje të cilësisë me kushte dhe pasuri të lartë të programeve në përmbajtjen dhe pasurimin e tyre me shumë më tepër material sesa që kërkojnë studentët. Mbajtja e motivit në nivel të lartë dhe të qëndrueshëm krijon stabilitet afatgjatë të të nxënës nga distanca - distance learning, si nga njëra anë, ashtu edhe nga ana tjetër. Njëri nga matësit më të mirë të stadi të cilësisë së arsimit në një institucion arsimor me mësimnxënie nga distanca (e-learning), është edhe vetëvlerësimi. Suksesi i institucionit arsimor varet edhe nga kriteri i matjes së dijes me rastin e regjistrimit të studentit, gjatë studimeve dhe matja e dijes përfundimtare me rastin e diplomimit. Kritereve që duhet t'u përmbahet institucioni me rastin regjistrimit të studentëve janë të shumta, por janë veçuar: kriteret e pranimit dhe vlerësimit të

studentëve, kriteret e pranimit të studentëve të huaj, procedurat për pranimin e studentëve me anë të transferimit etj. (Epoka, 2016). Regjistrimi i studentëve në institucione arsimore me mësimnxënie në distancë e-learning (Gaebel, 2014:9) mundëson njëkohësisht përfshirje më të madhe të studentëve dhe ofrim kualitativ të kushteve për secilin veç e veç. Në anën tjetër, bashkëpunimi i studentëve ndërmjet tyre është i vazhdueshëm si dhe me mësimdhënësit e tyre kontaktet virtuale janë të pakufizuara.

Te analizat e mbledhura në hulumtime të ndryshme, këtu e veçnam raportin (Olson, 2011:14), sa u përket ndikimeve arsimore nëpërmjet e-learning. Gjetjet tregojnë se studentët e kanë mirëpritur këtë strategji të të nxënimit nga distanca, e cila është e përshtatshme, si në rrafshin lokal, me planprograme adekuate për lokalitetin, e po ashtu ato ndërkombëtare, të cilat e kanë një kërkesë më të madhe të atyre vendeve në të cilat nuk organizohen programe të tilla. Mundësia e natyrshme e klasave me kompjuterë të gjeneratës së re dhe të pajisura me internet të shpejtë dhe download (shkarkim) dhe upload (ngarkim) adekuat, ka bërë që studentët e institucioneve të tilla me programe të pranueshme për ta të vlerësohen me impakt faktor të lartë të arsimimit nga distanca me e-mësim. Analizat e këtyre hulumtimeve, të cilat mbështeten te të mësuarit nga distanca, nxjerrin në pah se studentët janë më të pavarur dhe hulumtimet e tyre, janë më të suksesshëm, duke bërë që ata të jenë pjesëmarrësit e ardhshëm të mësimit gjatë tërë jetës. Sistemi i të mësuarit me platformë të nxënies nga distanca e bën të mësuarit më atraktiv dhe më joshës, ndërsa studentët e mësimdhënësit i mban në shkallë konstante të motivimit. Janë këto metoda inovative, të cilat e zgjojnë trurin në çdo interval të shkurtër kohor për t'i dhënë sinergji për ecje tutje. Të gjithë pjesëmarrësit (të brendshëm dhe të jashtëm) e procesit të të nxënimit nga distanca i bën të jenë shumë më përgjegjës, më të

shkathët dhe më energjikë. Gjithnjë janë në rrugëtim për hulumtime të reja, ngase inovacioni është “ajka” e tërë këtij procesi.

### **3.14. Menaxhimi i institucioneve arsimore me mësimnxënie e-learning**

Të mësuarit nga distanca ka filluar shumë më herët se që mendohet. Por, epitetin e vet gjithëpërfshirës si duket e ka marrë me shfaqjen e teknologjive të reja informative dhe komunikimit. Ndërsa rritja e shpejtësisë së internetit në mënyrë rapide e ka arritur efektin e vet kulmor në mësimnxënie nga distanca (e-learning). Në disa vende, të nxënit nga distanca fillon me mbajtjen e kurseve online nga më të thjeshtat. Fjala vjen, mësim nga distanca mbahet për mësimin e gjuhëve të huaja, si gjuhë angleze (Ang, 2016), gjermane, frënge, italiane etj., por gjithashtu të mësuarit nga distanca arrin edhe në të mësuarit e shkencave të natyrës, si: matematikë (Mat, 2016), fizikë (Fiz, 2016), kimi (Kimi, 2016), kodim (Kimi, 2016), tik (Tik, 2016), e kështu me radhë. Të mësuarit e këtyre lëndëve ndër dekada ishte mësim i lodhshëm dhe i mundimshëm. Pak orë mësimore gjatë javës, pak apo fare mësim shtues e plotësues, bënin që këto lëndë të trajtoheshin si të vështira. Por, me lansimin e portaleve të ndryshme, që pikësynim e kanë arsimimin, këto dhe shumë lëndë të tjera po bëhen më të lehta dhe më të kuptueshme. Përfundimi i kurseve të tilla për mësim nga distanca mund të mbarojë edhe me lëshimin e diplomave, certifikatave e dëshmive tjera të ndryshme. Edhe për këto mënyra të të nxënit nëpërmjet teknologjive të reja të informacionit dhe komunikimit kërkohet menaxhim profesional. Përkrahja e rezervë e inxhinierëve të IT-ëve, mbrojtja nga sulmet kibernetike dhe lansimi i leksioneve të reja janë pjesë e pandashme e punës udhëheqëse të shkollave virtuale. Nëse janë të mjaftueshme vetëm kurset nga distanca për plotësimin e nevojave të të nxënit gjatë gjithë jetës, sigurisht se përgjigja është: Jo.

Të mësuarit nga distanca fillon me kurse që lëshojnë për dëshmi certifikatat, e vazhdojnë deri te studimet doktorale, kur për dëshmi jepen diplomat e doktoraturës. Secili njeri që e regjistron një program të mësimit nga distanca kërkon që të kurorëzohet me një diplomë, e cila duhet të njihet së paku në vendin në të cilin jeton, por arsimimi është një përpjekje gjatë gjithë jetës, të cilën synon ta përfitojë secili njeri që i kalon kufijtë e një diplome (Distancelearning, 2016).

Për funksionalizimin e mirëfilltë të institucioneve arsimore me mësimnxënie në distancë, ato duhet të jenë të kompletuara me staf profesional (mësimdhënës të fushave përkatëse çfarë i ka synim programi arsimor), inxhinierë të IT-ëve të përgatitur dhe të dëshmuar për sukseset e tyre që kanë në mirëmbajtjen e portaleve online për mësim nga distanca, pedagogë e psikologë për mbështetje të studentëve gjatë gjithë kohës së studimeve, si dhe menaxherë të cilët kanë vizion të qartë për përmbushjen e synimit të të nxënimit kualitativ, infrastrukturë të avancuar të përgatitjes së leksioneve, ushtrimeve, pyetësorëve, kuizëve dhe formave tjera të vlerësimit të të nxënimit nëpërmjet e-mësimit.

Institucioni arsimor mund të funksionojë si:

- Mësim shtues për studentët e rregullt,
- Mësim i kombinuar: mësimi tradicional & e-mësim (Epignosis, 2014),
- E-mësim dhe m-mësim i pavarur.

Institucioni arsimor mund të jetë:

- publik (që financohet nga Qeveria, Ministria, Komuna etj.),
- jopublik apo privat (që financohet nga biznesmenë, të cilët bashkojnë mjetet me aksione, sh.p.k., korporata etj., apo
- publiko-privat (bashkëfinancues dhe bashkudhëheqës shtetërorë dhe privatë).

Institucioni arsimor me mësimnxënie nga distanca mund të fillojë punën publike pasi të jetë akredituar nga agjencia e akreditimeve të programeve të tilla të shtetit në të cilin është regjistruar veprimtaria e arsimimit të programit apo programeve të caktuara. Në rastin tonë, akreditimi bëhet nga (AKA, 2016), Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA). Agjencia e Kosovës për Akreditim është pranuar në dy organizata të fuqishme arsimore evropiane, në:

- ENQA (Asociacioni Evropian i Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë) (AKA, 2016), dhe
- (European Quality Assurance Register-EQAR (Regjistri për Sigurimin e Cilësisë Evropiane - RSCE), në vitin 2015 (AKA, 2016).

Institucionet arsimore mund të funksionojnë mbi bazën e ligjit të arsimit në fuqi. Ato programe mbështeten kryesisht në të mësuarit gjatë gjithë jetës. Nivelet e të nxënimit nga distanca mund të rangohen në shkallë:

#### *Programet certifikuese për platformën digjitale të të nxënimit*

Programet certifikuese (LMS, 2016) janë të mësuarit në distancë për specializim të një fushe të caktuar, p.sh. një teknik i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për ta rritur reputacionin e tij profesional ose për t'i dëshmuar aftësitë e tij profesionale në mirëmbajtjen e kompjuterëve duhet që herëpashere të vijojë programe certifikuese për harduerë të rinj nga kompanitë inovative. Një teknik i mjekësisë, si teknik-dentist, për të qenë i përgatitur gjithnjë me produktet e reja dentare duhet të ndjekë programe certifikuese të fushës së ngushtë profesionale. Natyrisht se këto trajnime janë të herëpashershme, por janë me kohëzgjatje të vazhdueshme që kategorizohen në të

mësuarit nga distanca. Këto trajnime kryhen zakonisht nga distanca-distance learning me mësimnxënie e-mësim (e-learning) dhe m-mësim (m-learning). Janë të domosdoshme dhe duhet të menaxhohen mirë nga institucioni arsimor i specifikuar për fusha të tilla të programeve certifikuese.

Në fund, secili kandidat kërkon të pajiset edhe me certifikatë (LMS, 2016), e cila duhet të jetë e pranueshme për kursin të cilin e ka ndjekur. Me rastin e regjistrimit, pjesëmarrësi do të njoftohet me të gjitha rregullat, kushtet dhe përgjegjësitë që i ka gjatë kohës sa merr pjesë në kurs të caktuar. Pasi t'i ketë ndjekur të gjitha, të ketë kaluar nëpër testet dhe kuizet digjitalë që i ofron institucioni, do të bëjë edhe printimin e certifikatës online, e cila dëshmon për përfundimin me sukses të kursit përkatës. Një shembull për këtë është edhe qendra për trajnime profesionale (LMS, 2016).

#### *Programe parauniversitare për mësimnxënie nga distanca (e-learning)*

Varësisht nga kërkesat e tregut duhet të përshtaten edhe programet e institucioneve arsimore që ofrojnë mësim nga distanca-distance learning nëpërmjet e-mësimit (e-learning) dhe m-mësimit (m-learning). Ndërmjet shkollës së mesme (sipas Ligjit të arsimit në Kosovë) dhe fakultetit ekziston edhe një vit mësimi për specializim të fushës së ngushtë, të cilën e ka ndjekur nxënësi gjatë shkollimit të mesëm trevjeçar. Ky është një vit që mund të mbulohet me sukses mësimi nga distanca, varësisht nga drejtimi të cilin e ka ndjekur, por gjithashtu ky vit studimi mund të shërbejë edhe për arsimimin e të rriturve.

Synimet e AAAP dhe ARR janë (Agjencia, 2016):

- të zhvillojnë kualifikime të bazuara në kompetencat dhe rezultatet e të nxënit gjithmonë të lidhur me edukimin dhe me nevojat e tregut të punës,

- të zhvillojë një sistem të arsimit dhe aftësimit profesional, i cili siguron të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe mobilitetit,
- definimi i rolit të mësimdhënësve të orientuar në rezultatet e të mësuarit,
- krijimi i një sistemi të sigurimit të cilësisë.

#### *Programe universitare për mësimnxënie nga distanca e-learning*

Institucionet arsimore me mësimnxënie në distancë, bazuar në e-mësim dhe m-mësim, organizojnë studime të kombinuara apo plotësisht të pavarura edhe në nivelin bachelor. Këtë lloj të studimeve e ka lejuar edhe Ligji për arsimin e lartë të Kosovës (Ligji ALK, 2016). Në bazë të këtij ligji (neni 5 pika 5) lejohet vijimi i mësimit edhe nga distanca.

Sigurisht që Kosova ka nevojë të themelojë kolegje të tilla universitare, mirëpo gjatë hulumtimit tonë për këtë nuk kemi gjetur asnjë institucion arsimor të akredituar për mësimnxënie nga distanca. Kërkesa i është bërë edhe AKA-së, por nuk është gjetur institucion i akredituar për mësimdhënie të plotë nga distanca.

Në vendet tjera organizohen programe të të nxënimit nga distanca në drejtime të ndryshme, por sigurisht edhe në gjuhë të ndryshme.

Teknologjitë e reja informative çdo ditë e më shumë janë të përshtatshme për aplikim të mësimit elektronik (e-mësim) dhe mësim mobil (m-mësim). Shfrytëzimi i tyre, themelimi dhe menaxhimi i institucioneve të tilla arsimore do ta përmbushte misionin për një mësimnxënie më të mirë në arsimin kosovar, në veçanti, e të arsimit mbarëshqiptar, në përgjithësi.

### **3.15. Përkufizimi i mësimit nga distanca sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian**

Bashkimi Evropian e ka rregulluar me ligj të mësuarit nga distanca. Shumica e vendeve të këtij unioni tashmë e aplikojnë mësimin nga distanca nëpërmjet platformës elektronike e-learning. Në vijim do të shpalosim Ligjin për arsimin e Kroacisë dhe të Kosovës, në të cilët parashihen me akte normative mësimdhënia dhe mësimnxënia nga distanca (e-learning).

### **3.16. Përkufizimi i mësimit nga distanca sipas legjislacionit kroat**

Mësimi në distancë - distance learning, i realizueshëm nëpërmjet e-mësimi (e-learning), e në disa vende ka filluar edhe nëpërmjet m-mësimit (m-learning), ka gjetur përkrahje në shumë shtete të reja të ish-Jugosllavisë. Me përkushtim në këtë drejtim është angazhuar edhe Republika e Kroacisë, e cila këtë çështje e ka rregulluar edhe me akte ligjore mbi arsimin e lartë (Ligji Kroat, 2016).

Në kapitullin: Studimet në distancë, neni 40, pika:

- (1) Pjesa e programit të studimeve të akredituara mund të organizohet edhe nëpërmjet studimeve në distancë, nëse janë plotësuar kushtet për studim të programit të miratuar ku studenti mund të studiojë i pavarur, i ndihmuar nga materialet adekuate arsimore për përgatitjen e provimeve përkatëse.
- (2) Para fillimit të studimeve që përfshihet mësimi në distancë, studentëve në fillim u ofrohet në mënyrë të detajuar orari i moduleve arsimore dhe mësimi i pavarur, si dhe mënyra se si ata mund të qasen në materialet arsimore për përgatitjen e provimit.



- (3) Kalueshmëria në provimet e studimeve nga pika 1 e këtij neni rregullohet sipas kriterëve të cilat i nxjerr institucioni i arsimit të lartë me akt të veçantë.
- (4) Licenca për programin e studimit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni dhe ekzekutimi i tij lëshohet në qoftë se rezultatet e parashikuara për të mësuarit mund të fitohen nëpërmjet të mësuarit në distancë, ndërsa procedura dhe licencat rregullohen me rregullore të veçantë.

Republika e Kroacisë është pranuar në BE, andaj edhe të gjitha ligjet i ka harmonizuar me kushtet dhe kriteret e parapara për pranim. Gjithashtu me ligj e ka të përcaktuar edhe “Mësimin gjatë gjithë jetës”.

Shumë institucione të larta arsimore e kanë filluar edhe implementimin e mësimit nga distanca (distance learning). Në këtë hulumtim janë përfshirë edhe disa nga ato programe.

### **3.17. Përkufizimi i mësimit nga distanca sipas legjislacionit kosovar**

Legjislacioni kosovar e ka aprovuar Ligjin për Arsimin e lartë në Republikën e Kosovës në vitin 2011. Qasja në arsimin e lartë është përfshirë në nenin 5, ndërsa pika 5 e këtij neni thotë (Ligji ALK, 2016):

*“Arsimi i lartë mund të vijohet në mënyrë të rregullt, me korrespondencë, **nëpërmjet të mësuarit në distancë** dhe me kombinim të cilësdo prej këtyre mënyrave të studimit, ashtu sikur parashihet në statutin e bartësit që jep kualifikim të arsimit të lartë”.*

Pra, në bazë të ligjit të arsimit të lartë saktësohet që studimet mund të zhvillohen edhe nga distanca, e-learning. Sipas këtij ligji, mësimin nga distanca mund ta zhvillojnë institucionet publike dhe private.

Akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë e bën Agjencia për Akreditim e Kosovës (AKA), pas vlerësimit pozitiv që i bëjnë ekspertët ndërkombëtarë për vlerësim. Gjatë hulumtimit të interesuar tejmase nuk është gjetur një institucion arsimor në Republikën e Kosovës, i cili e aplikon në tërësi këtë platformë të të nxënimit nga distanca, e cila, duke e shfrytëzuar teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), e aplikon platformën e-mësimi apo m-mësimi.

Në pyetjen tonë drejtuar menaxhmentit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) se cilat janë institucionet e akredituara për arsim nga distanca, përgjigjja ka qenë se nuk ka të tilla. Kjo dëshmohet edhe nga faqja zyrtare e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA, 2016).

### **3.18. Përfundim**

Është e pamjaftueshme të aprovohen ligje të cilat e mbështetin të mësuarit nga distanca, e-learning. Qeveria duhet t'i mbështesë pa rezervë ato nisma për themelimin e institucioneve të larta arsimore, të cilat kanë për synim mësimnxënien nga distanca- (distane learning), që realizohen nëpërmjet e-mësimit dhe m-mësimit. Lista e gjatë me universitete shtetërore dhe bartës privatë të arsimit të lartë, të akredituara si kolegje, nuk siguron domosdoshmërisht cilësi në arsimin kosovar. Asnjëra nga to nuk është akredituar për mësimnxënie të pavarur nga distanca nëpërmjet teknologjive të reja, e-mësim dhe m-mësim. Infrastruktura aktuale e arsimit shtetëror nuk i plotëson kushtet për mësimnxënie nga distanca, e as të mësimit të kombinuar. Mësimdhënësit e të dy sektorëve (publik dhe privat) të arsimit të lartë në Kosovë nuk janë integruar as për së afërmi për realizimin e mësimdhënies nga distanca. Teknologjitë e reja të domosdoshme për këtë metodë të të

nxënit po pësojnë ndryshime ditore. Për këtë, strategjia e të mësuarit gjatë gjithë jetës nuk mjafton të jetë vetëm e shkruar dhe aprovuar. Trajnimet e panumërta dhe të llojllojshme kanë qenë projekte, të cilat ia kanë arritur qëllimit të tyre vetëm në përmbushjen e vërtetimit të shpenzimit të buxhetit të paraparë. Në të ardhmen projektet për integrim të mësimdhënësve duhet të jenë krejtësisht ndryshe. Për integrimin e mësimdhënësve, infrastrukturës dhe rritjes së cilësisë në arsimin e Kosovës, medoemos politika duhet të tërhiqet plotësisht nga pragu i institucioneve arsimore. Moshë e mësimdhënësve është një kusht i cili pengon në integrimin e mësimdhënësve për implementim të programit, mësimnxënie nga distanca nëpërmjet e-learning dhe m-learning. Plani strategjik i pavarur krejtësisht nga politika do të nxirrte “pano” të qartë, e cila do të planifikonte për numrin e studentëve të ardhshëm që i nevojitet arsimit të Kosovës. Edhe punësimi i mësimdhënësve të rinj në shkolla do të bëhej pa ndikime politike. Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) duhet të mbështesë edhe ndonjë IAL (publik apo privat) për akreditim së paku të një programi, i cili do të nxirrte menaxherë profesionistë për realizimin e mësimin nga distanca, e-mësimi dhe m-mësimi. Se sa është e rëndësishme mësimnxënia nga distanca e tregon edhe përkushtimi i shteteve anëtare të BE-së që e përkrahin pa rezervë këtë metodë të mësimnxënies. Ndër to veçohet Kroacia, si një shtet i ri dhe anëtar i BE-së, që njëkohësisht ishte pjesë përbërëse e ish-Jugosllavisë, aty ku ishte edhe Kosova. Sa i përket aprovimit të ligjeve për këtë fushë, edhe në Kosovë janë miratuar ligje dhe strategji të cilat e përkrahin mësimin nga distanca dhe mësimin gjatë gjithë jetës. Me urgjencë nevojitet përkrahje e rezervë në këtë drejtim. Ndryshe mësimdhënia dhe mësimnxënia në institucionet e arsimit në Kosovë (në të gjitha nivelet) nuk është as për së afërmi e kënaqshme. Këto qëndrime, gjithnjë e më shumë, po shfaqen edhe nga vetë organet kompetente të shtetit të Kosovës.

## KAPITULLI IV METODOLOGJIA E KËRKIMIT

### 4.1. Hyrje

Metodologjia e aplikuar në këtë hulumtim shkencor është punuar duke u bazuar në metodën e kërkimit parësor (primar) dhe dytësor (sekondar). Kërkimi parësor bazohet në realizimin e punës në terren, në analizën e realizimit të të nxënit në shkollat e Kosovës, në rezultatet e marra nga 3 (tri) llojet e pyetësorëve, të cilët ishin të ndryshëm për mësimdhënës, nxënës dhe prindër, opinionet e marra nëpërmjet intervistave nga menaxherët institucionalë të arsimit dhe njohësit e arsimit. Shpërndarja e pyetësorëve është bërë në shkollat e Prishtinës, siç është përshkruar në vijim të këtij kapitulli, ndërsa menaxherët institucionalë dhe njohësit e arsimit janë kontaktuar sipas modelit “orteku i borës”, për çka gjithashtu më gjerësisht flitet po në këtë kapitull.

Të dhënat dytësore janë grumbulluar dhe analizuar nga rishikimi i gjerë i literaturës, ku një pjesë e saj është përshkruar në kapitullin e dytë të këtij hulumtimi, që ka të bëjë me të nxënit nga distanca nëpërmjet platformës e-learning.

Puna kërkimore e këtij hulumtimi në bazë të rrugëtimit të saj ndahet në dy pjesë:

- Pjesa parapërgatitore dhe analiza e mësimnxënies në institucionet e arsimit në Kosovë, që ka të bëjë me përpilimin dhe analizimin e pyetësorëve dhe intervistave dhe
- Pjesa kërkimore në terren, që ka të bëjë me shpërndarjen dhe marrjen e pyetësorëve dhe intervistave

## 4.2. Çështjet dhe pyetjet kërkimore

Ashtu siç është përshkruar në kapitullin e parë, në seksionin metodologjia, edhe këtu po nënvizojmë se hulumtimi i bërë i paraprin fillimit të të nxënit nga distanca: e-learning, në institucionet e arsimit në Republikën e Kosovës. Puna në terren është fokusuar në plotësimin e veçorive themelore të metodave: objektivitetit, besueshmërisë, precizitetit, sistemimit dhe tërësisë. Në rishikimin e literaturës, me kujdes është analizuar të nxënit nga distanca, i shtjelluar nga autorë të ndryshëm dhe portale të shumta, të cilat e kanë filluar zbatimin e kësaj metodologjie. Të vetëdijshëm se ky lloj hulumtimi është pikë fillestare në trojet shqiptare, të të nxënit nëpërmjet platformës digjitale e-learning, me përkushtim është përdorur metoda e kompilitimit, e cila ka të bëjë me rishikimin e hulumtimeve të bëra më herët, në shtetet e zhvilluara. Vështrimi i atyre hulumtimeve ndihmoi në përpilimin e pyetësorëve, të cilët në bazë të mbledhjes së të dhënave nga kampioni ndikuan pozitivisht në diskutimet, konkluzionet dhe rekomandimet e dala në fund të këtij punimi.

Metodologjia e kërkimit është në përshtatshmëri të plotë me titullin e temës së këtij disertacioni, pyetjeve kërkimore dhe hipotezave të shtruara para fillimit të hulumtimit. Kjo metodologji është përdorur për mbledhjen, analizën, diskutimin, konkluzionet dhe rekomandimet që do të dalin në dy kapitujt në vijim.

Të nxënit nga distanca nëpërmjet teknologjive të reja, që njihet si e-mësim, ka zgjuar kureshtjen tonë për t'i hulumtuar grupet e interesit të kësaj fushe në Kosovë, ndaj janë ngritur dy çështje kërkimore:

Çështja e parë kërkimore:

Të mësuarit në distancë është më eficient, më produktiv dhe më parësor sesa të mësuarit tradicional edhe në kontekstin e sistemit arsimor në Kosovë.

Çështja e dytë kërkimore:

Aplikimi i metodës së të mësuarit në distancë kërkon si parakusht ndryshimin e menaxhimit të sistemit arsimor dhe shkollave në Kosovë.

Me trajtimin e këtyre çështjeve kërkimore janë shtruar dy pyetje kërkimore:

Pyetja e parë kërkimore:

Sa mund të bëhet praktikisht në kontekstin kosovar të të mësuarit në distancë një metodë më produktive dhe më eficiente sesa të mësuarit tradicional?

Pyetja e dytë kërkimore:

Cilat mund të jenë ndërhyrjet e nevojshme në sistemin arsimor në Kosovë për të nxitur e mbështetur të mësuarit në distancë?

#### **4.3. Përshkrimi i hulumtimit**

Ky hulumtim e pati për synim ta gjejë efijencën e të mësuarit nga distanca karshi të mësuarit tradicional, si dhe ndërhyrjet e nevojshme që duhet të bëhen në menaxhmentin e arsimit kosovar për implementimin e kësaj platforme. Hulumtimi po ashtu synon të arrijë deri te konkluzionet se cila platformë e të nxënësve është më e përshtatshme për nxënës të shkollave dhe studentë shqiptarë. Gjatë hulumtimit janë vërejtur pikat e forta dhe të dobëta të pëlqyera nga nxënësit, mësimdhënësit, prindërit dhe menaxherët arsimorë.

Studimit i ka paraprirë zhvillimi i të mësuarit nga distanca nëpërmjet platformës digjitale (Almooc, 2016): në fushën e fizikës, e cila e fillon punën e saj në shtator të vitit 2014. Numri i nxënësve që mësojnë nga kjo platformë deri tani është 6 835 (<http://fizike.almooc.com/v2/>,

parë më 14. 6. 2016). Për ta kompletuar hulumtimin vëmendja është përqendruar, por jo edhe kufizuar, në disa çështje, si në vijim:

- Hartimi dhe zhvillimi i pyetësorëve me mësimdhënës, nxënës dhe prindër,
- Hartimi dhe zhvillimi i intervistës për menaxherë të arsimit dhe njohës të arsimit,
- Zgjedhja e popullatës dhe kampionit për realizimin e pyetësorëve dhe intervistave.

#### **4.4. Dizajnimi i hulumtimit kërkimor**

Hulumtimi në fokus pati gjetjen e epërsive të të nxënësve nga distanca nëpërmjet platformës elektronike: e-learning. Siç u tha edhe më lart, këtij hulumtimi kërkimor i parapriu të mësuarit nëpërmjet platformës: <http://fizike.almooc.com/v2/>. Gjatë diskutimeve dhe debateve të bëra në mënyra të ndryshme, si dhe përgjigjeve të dhëna nga nxënësit në pyetjet e shtruara në këtë platformë rezultoi numri më i madh i nxënësve të jenë nga tri gjimnaze të Prishtinës dhe një shkollë e mesme e ulët, po ashtu e Prishtinës. Gjatë intervistës janë përfshirë nga dy paralele të gjimnazeve dhe një grup i përzgjedhur i nxënësve të shkollës së mesme të nxënësve, sipas formulës së zgjedhjes së kampionit.

#### **4.5. Popullata dhe zgjedhja e kampionit**

Popullata e cila ka ndikuar në zgjedhjen e kampionit të këtij hulumtimi ishin nxënësit e shkollave të mesme të Prishtinës. Gjatë ndjekjes së të nxënësve nga distanca nëpërmjet platformës digjitale: [www.fizike.almooc.com](http://www.fizike.almooc.com), mësimdhënës i së cilës është autori i këtij disertacioni doktoral, numri më i madh i nxënësve që shprehin interesim vjen nga tri gjimnaze të Prishtinës: “Sami Frashëri”, “Ahmet Gashi” dhe “Eqrem Çabej”. Një pjesë e

konsiderueshme e këtyre nxënësve ishin paraprakisht nxënës të SHMU “Xhavit Ahmeti”, po ashtu nga Prishtina.

Në një anketë të zhvilluar me nxënës të regjistruar në platformën: [www.fizikë.almooc.com](http://www.fizikë.almooc.com), 2015, u përgjigjën gjithsej 550 nxënës. Pyetja ishte: *A do t'i vijonit mësimet në një shkollë me mësimnxënie nga distanca nëse ajo është e akredituar?* Nxënësit që dhanë përgjigje ishin kryesisht nga gjimnazet e Prishtinës. Gjithashtu vlen të theksohet se nxënësit e parë që regjistrohen në të nxënit nga distanca në platformën e lartcekur janë nga SHMU “Xhavit Ahmeti”. Hulumtuesi i këtij disertacioni është mësimdhënës i kësaj shkolle, prandaj edhe udhëzimet e para ata i morën direkt gjatë mësimit tradicional. Po ashtu, numri më i madh i këtyre nxënësve pastaj regjistrohen në këto gjimnaze. Kjo ishte edhe arsyeja tjetër e përfshirjes së këtyre nxënësve në këtë hulumtim.

Për zgjedhjen e kampionit përdoret formula, e cila mbështetet në teorinë e nxjerrjes së mostrës (Yumane, 1967), e paraqitur si në vijim:

$$n = \frac{N}{1 + N \cdot e^2}$$

$n$  - numri i elementeve të zgjedhjes,

$N$  - numri i elementeve të popullatës,

$e$  - niveli i rëndësisë, që është 5,55%.

#### *Kampionimi i hulumtimit - nxënësit*

Siç thamë më lart, numri total i nxënësve që shprehin interesimin për të mësuar nga distanca nëpërmjet platformës elektronike e-learning ishte 550, atëherë gjejmë:  $n$  - në rastin tonë numri i kampionëve.



$$n = \frac{N}{1 + N \cdot e^2} = \frac{550}{1 + 550 \cdot (0.0555)^2} = \frac{550}{1 + 550 \cdot 0.00308025} =$$

$$= \frac{550}{1 + 1.6941375} = \frac{550}{2.6941375} = 204$$

Meqenëse niveli i rëndësisë është  $e = 5.55\%$ , atëherë kjo metodë ka besueshmëri të hulumtimit prej 94,45%, që e arsyeton numrin e arritshmërisë së të anketuarve. Nga besueshmëria e metodës së numrit të elementeve të zgjedhjes,  $n=204$  është numër i mjaftueshëm i kampionëve për realizimin e hulumtimit.

Janë mbledhur gjithsej 200 pyetësorë, nga 210 pyetësorë të shpërndarë, i cili pati gjithsej 18 pyetje.

Në bazë të analizës së pyetësorëve rezulton se: 167 nxënësit e intervistuar, apo 83,50 %, jetojnë në Prishtinë, 6% e tyre, përkatësisht 12 jetojnë afër Prishtinës, përderisa në fshat janë deklaruar se jetojnë 17 nxënës, nga 200 të përfshirë, dhe 4 nxënës janë duke jetuar jashtë Prishtinës.

Nxënësit e intervistuar ishin të klasave IX, XI dhe XII. Shpërndarja e tyre nëpër klasë dhe përqindja: klasa IX janë 16 nxënës me 8,25%, klasa XI janë 68 nxënës me 35,05% dhe klasa XII janë 110 nxënës me 56,70%. Nga 200 nxënësit e intervistuar, 180 e përdorin internetin, 19 nxënës kanë thënë se nuk e përdorin internetin, ndërsa 1 nxënës nuk është deklaruar. Nëse kanë qasje në internet janë përgjigjur 196 nxënës nga gjithsej 200 që i kanë plotësuar pyetësorët. Prej tyre, 192 janë deklaruar se kanë qasje në internet, 4 nxënës nuk kanë qasje në internet, ndërsa 4 nxënës nuk janë deklaruar.

**Tabela 1.** Të dhënat për nxënësit pjesëmarrës në hulumtim

Menaxhimi i institucioneve arsimore me mësimnxënie në distancë: e-learning

		Numri pjesëmarrës	Përqindja
Vendbanimi	Prishtinë	167	83,50%
	Afër Prishtinës	12	6,00%
	Në fshat (komuna Prishtinë)	17	8,50%
	Jashtë Prishtinës	4	2,00%
Klasa	IX	16	8,25%
	XI	68	35,05%
	XII	110	56,70%
	Nuk dhanë përgjigje	4	2,00%
Përdorimi i kompjuterit	Po	180	90,45%
	Jo	19	9,55%
	Nuk dhanë përgjigje	1	0,50%
Qasja në internet	Po	192	97,96%
	Jo	4	2,044%
	Nuk dhanë përgjigje	6	3,00%

Burimi: Autori, 2016

Me anë të programit SPSS Statistics versioni 22 është bërë analiza deskriptive e frekuentimit të variablave: vendbanimi, klasa, përdorimi i kompjuterit (PC) dhe qasja në internet e nxënësve të përfshirë në hulumtimin për mësimnxënien nga distanca nëpërmjet formës elektronike, e-learning. Pas analizës së këtyre variablave shfaqen të dhënat tabelare, si në vijim:

**Tabela 2.** Tabela e frekuentimit

		vendbanimi			
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
vendb animi	Prishtinë	167	83,5	83,5	83,5
	Afër Prishtinës	12	6,0	6,0	89,5

Menaxhimi i institucioneve arsimore me mësimnxënie në distancë: e-learning

	Fshat	17	8,5	8,5	98,0
	Jashtë Prishtinës	4	2,0	2,0	100,0
	Total	200	100,0	100,0	

Burimi: Autori, 2016

Në tabelën e mësipërme është paraqitur variabla, *vendbanimi* me këto të dhëna: *frekuentim (Frequency)*, *përqindje (Percent)*, *përqindje valide (Valid Percent)* dhe *përqindje kumulative (Cumulative Percent)*.

**Tabela 3.** Klasa e nxënësve

		Klasa			
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Klasa	Klasa IX	16	8,0	8,0	8,0
	Klasa X	68	34,0	34,0	42,0
	Klasa XII	101	50,5	50,5	92,5
	Nuk ka përgjigje	15	7,5	7,5	100,0
	Total	200	100,0	100,0	

Burimi: Autori, 2016

Në tabelën e mësipërme është paraqitur variabla, *klasa* me këto të dhëna: *frekuentim (Frequency)*, *përqindje (Percent)*, *përqindje valide (Valid Percent)* dhe *përqindje kumulative (Cumulative Percent)*.

**Tabela 4.** Përdorimi i PC nga nxënësit

		përdorimi_i_PC			
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Përdori mi i PC	Po	180	90,0	90,0	90,0
	Jo	19	9,5	9,5	99,5
	Nuk ka përgjigje	1	0,5	0,5	100,0
	Total	200	100,0	100,0	

Burimi: Autori, 2016

Në tabelën e mësipërme është paraqitur variabla, *përdorimi PC* me këto të dhëna: *frekuentim (Frequency)*, *përqindje (Percent)*, *përqindje valide (Valid Percent)* dhe *përqindje kumulative (Cumulative Percent)*.

**Tabela 5.** Qasja e nxënësve në internet

		qasja_internet			
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Qasja në internet	1	190	95.0	95.0	95.0
	2	4	2.0	2.0	97.0
	3	6	3.0	3.0	100.0
	Total	200	100.0	100.0	

Burimi: Autori, 2016

Në tabelën e mësipërme është paraqitur variabla, *qasja në internet* me këto të dhëna: *frekuentim (Frequency)*, *përqindje (Percent)*, *përqindje valide (Valid Percent)* dhe *përqindje kumulative (Cumulative Percent)*.

#### *Kampionimi i hulumtimit - mësimdhënësit*

Në hulumtim janë përfshirë edhe mësimdhënësit. Gjatë një hulumtimi në veprim ishin 120 mësimdhënës të interesuar për zhvillimin e mësimnxënies nga distanca, nga lëndët e shkencave të natyrës dhe TIK, të punësuar nëpër institucionet arsimore të komunës së Prishtinës. Atyre u është përcjellë pyetësi në formë elektronike, nëpërmjet e-mail-it, dhe rrjetit social: Facebook - fb.

Pyetësi, i cili pati gjithsej 18 pyetje, u është dërguar 120 mësimdhënësve. Atij i janë përgjigjur 100 mësimdhënës.

Në bazë të analizës së pyetësorëve rezulton: 50 mësimdhënësit e intervistuar apo 50% jetojnë në Prishtinë. Nga tabela vijuese shihet se janë ndarë 4 grupe të moshës: deri në 35 vjeç, ishin 10 mësimdhënë, nga moshë 36 deri në 45 vjeçe, ishin 34 mësimdhënë, nga 46 deri në 60 vjeçe kanë qenë 48 mësimdhënë dhe mbi moshën 60 vjeçe, 8 mësimdhënë. Me përvojë pune deri në 10 vjet ishin 27 mësimdhënë, nga 11 deri 25 vite përvojë pune, u deklaruan 40 mësimdhënë, nga 26 deri 35 vite përvojë ishin 22 mësimdhënë, ndërsa me përvojë pune mbi 35 vjet ishin 11 mësimdhënë. Sa e përdorin kompjuterin, ata përgjigjen kështu: 86 mësimdhënë e përdorin kompjuterin në shtëpi apo në shkollë, ndërsa 14 mësimdhënë nuk e përdorin. Nga 100 mësimdhënësit e përfshirë në hulumtim, 96% deklarohen se kanë qasje në internet, ndërsa vetëm 4% nuk kanë qasje në internet.

**Tabela 6.** Të dhënat për mësimdhënësit pjesëmarrës në hulumtim

		Numri pjesëmarrës	Përqindja
Vendbanimi	Prishtinë	50	50%
	Afër Prishtinës	25	25%
	Në fshat (komuna Prishtinë)	10	10%
	Jashtë Prishtinës	15	15%
Moshë	Deri 35 vjeç	10	10%
	36 - 45 vjeç	34	34%
	46 - 60 vjeç	48	48%
	Mbi 60 vjeç	8	8%
Përdorimi i kompjuterit	Po	86	86%
	Jo	14	14%
Përvoja e punës	Deri 10 vjet	27	27%
	11 - 25 vjet	40	40%
	26 - 35 vjet	22	22%

## Menaxhimi i institucioneve arsimore me mësimnxënie në distancë: e-learning

	Mbi 35 vjet	11	11%
Qasja në internet	Po	96	96%
	Jo	4	4%

Burimi: Autori, 2016

Me anë të programit SPSS Statistics versioni 22 është bërë analiza deskriptive e frekuentimit të variablave: vendbanimi, moshja, përdorimi i kompjuterit (PC) dhe përvoja e mësimdhënësve të përfshirë në hulumtimin për mësimnxënëien nga distanca nëpërmjet formës elektronike, e-learning. Pas analizës së këtyre variablave shfaqen të dhënat tabelare, si në vijim:

**Tabela 7.** Tabela e frekuentimit të mësimdhënësve

		<b>vendbanimi</b>			
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Prishtinë	50	50,0	50,0	50,0
	Afër Prishtinës	25	25,0	25,0	75,0
	Fshat	10	10,0	10,0	85,0
	Jashtë Prishtinës	15	15,0	15,0	100,0
	Total	100	100,0	100,0	

Burimi: Autori, 2016

Në tabelën e mësipërme është paraqitur variabla, *vendbanimi* me këto të dhëna: *frekuentim (Frequency)*, *përqindje (Percent)*, *përqindje valide (Valid Percent)* dhe *përqindje kumulative (Cumulative Percent)*.

**Tabela 8.** Moshja e mësimdhënësve

		<b>mosha</b>			
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Moshja	deri 35	10	10,0	10,0	10,0
	36 - 45	34	34,0	34,0	44,0
	46 - 60	49	49,0	49,0	93,0

Menaxhimi i institucioneve arsimore me mësimnxënie në distancë: e-learning

	mbi 60	7	7,0	7,0	100,0
	Total	100	100,0	100,0	

Burimi: Autori, 2016

Në tabelën e mësipërme është paraqitur variabla *mosha*, me këto të dhëna: *frekuentim (Frequency)*, *përqindje (Percent)*, *përqindje valide (Valid Percent)* dhe *përqindje kumulative (Cumulative Percent)*.

**Tabela 9.** Përdorimi i kompjuterit (PC)

**perdorimi\_i\_PC**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Përdori mi i PC	Po	86	86,0	86,0	86,0
	Jo	14	14,0	14,0	100,0
	Total	100	100,0	100,0	

Burimi: Autori, 2016

Në tabelën e mësipërme është paraqitur variabla *përdorimi i kompjuterit (PC)*, me këto të dhëna: *frekuentim (Frequency)*, *përqindje (Percent)*, *përqindje valide (Valid Percent)* dhe *përqindje kumulative (Cumulative Percent)*.

**Tabela 10.** Përvoja e punës së mësimdhënësve

**përvoja**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Përvoja	Deri 10 vjet	27	27,0	27,0	27,0
	11 - 25 vjet	40	40,0	40,0	67,0
	26 - 35	22	22,0	22,0	89,0
	Mbi 35 vjet	11	11,0	11,0	100,0
	Total	100	100,0	100,0	

Burimi: Autori, 2016

Në tabelën e mësipërme është paraqitur variabla **përvoja**, me këto të dhëna: *frekuentim (Frequency)*, *përqindje (Percent)*, *përqindje valide (Valid Percent)* dhe *përqindje kumulative (Cumulative Percent)*.

**Tabela 11.** Qasja në internet

		qasja_internet			
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Qasja në intern.	PO	96	96,0	96,0	96,0
	JO	4	4,0	4,0	100,0
	Total	100	100,0	100,0	

Burimi: Autori, 2016

Në tabelën e mësipërme është paraqitur variabla **qasja në internet**, me këto të dhëna: *frekuentim (Frequency)*, *përqindje (Percent)*, *përqindje valide (Valid Percent)* dhe *përqindje kumulative (Cumulative Percent)*.

#### *Kampionimi i hulumtimit-prindërit*

Një hulumtim i bërë në (BEP, 2015), në pyetjen e pestë: Nëse ata (fëmijët tuaj) kërkojnë që t’i mësojnë nga një portal online shkencat e natyrës, a do t’u lejoni që të qëndrojnë më gjatë pranë kompjuterit? Atëherë 85 % e prindërve janë përgjigjur po, 5% jo dhe 10% nuk e di. Në këtë hulumtim janë përfshirë 20 (njëzet prindër) të një klase VIII, në Prishtinë. Nëpërmjet tyre, me metodën: “orteku i borës” (Mathews, 2012) janë kontaktuar 100 (njëqind prindër) për hulumtimin e këtij disertacioni.

Në këtë hulumtim janë përfshirë gjithsej 125 prindër. Janë mbledhur gjithsej 112 pyetësorë, prej tyre 12 ishin të pavlefshëm. Nga kjo përfundojmë se për analizë janë 100 pyetësorë, të cilët do t’i nënshtrohen programit SPSS Statistics versioni 22. Kjo është përshkruar në këtë kapitull, në seksionin: 4.4. - *popullata dhe zgjedhja e kampionit*.



**Tabela 12.** Të dhënat për prindërit pjesëmarrës në hulumtim

		Numri pjesëmarrës	Përqindja
Shkollimi i prindërve	Shkollë e mesme	40	40,00%
	Fakultet	45	45,00%
	Master (magjistër)	10	10,00%
	Doktoraturë	5	5,00%
Mosha e prindërve	Deri 35 vjeç	10	10,00%
	36 - 45 vjeç	38	38,00%
	46 - 60 vjeç	44	44,00%
	Mbi 60 vjeç	8	8,00%
A e përdorin kompjuterin fëmijët tuaj?	Po	97	97,00%
	Jo	3	3,00%
A e përdorni ju kompjuterin për ngritje profesionale?	Jo	10	10,00%
	Rrallë	25	25,00%
	Shpesh	65	65,00%
A komunikojnë fëmijët tuaj me të tjerët?	Po	95	95,00%
	Jo	5	5,00%

Burimi: Autori, 2016

Me anë të programit SPSS Statistics versioni 22, është bërë analiza deskriptive e frekuentimit të variablave: *shkollimi*, *mosha e prindërve*, *përdorimi i kompjuterit (PC)*, *përvoja e punës së prindërve dhe përdorimi i kompjuterit për ngritje profesionale të përfshirë në hulumtimin për mësimnxënien nga distanca nëpërmjet formës elektronike e-learning*. Pas analizës së këtyre variablave shfaqen të dhënat tabelare si në vijim:

**Tabela 13.** Shkollimi i prindërve

**Shkollimi**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Shkolli mi	Shkollë e mesme	40	40,0	40,0	40,0
	Fakultet	45	45,0	45,0	85,0
	Master	10	10,0	10,0	95,0
	Doktoraturë	5	5,0	5,0	100,0
	Total	100	100,0	100,0	

Burimi: Autori, 2016

Në tabelën e mësipërme është paraqitur variabla **shkollimi**, me këto të dhëna: *frekuentim (Frequency)*, *përqindje (Percent)*, *përqindje valide (Valid Percent)* dhe *përqindje kumulative (Cumulative Percent)*.

**Tabela 14.** Moshë e mësimdhënësve

**Moshë**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Moshë	deri 35	10	10,0	10,0	10,0
	36 - 45	38	38,0	38,0	48,0
	46 - 60	44	44,0	44,0	92,0
	mbi 60	8	8,0	8,0	100,0
	Total	100	100,0	100,0	

Burimi: Autori, 2016

Në tabelën e mësipërme është paraqitur variabla **mosha**, me këto të dhëna: *frekuentim (Frequency)*, *përqindje (Percent)*, *përqindje valide (Valid Percent)* dhe *përqindje kumulative (Cumulative Percent)*.

**Tabela 15.** Përdorimi i kompjuterit nga prindërit

**Përdorimi\_i\_PC**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Përdorimi i PC	Po	97	97,0	97,0	97,0
	Jo	3	3,0	3,0	100,0
	Total	100	100,0	100,0	

Burimi: Autori, 2016

Në tabelën e mësipërme është paraqitur variabla **përdorimi i PC**, me këto të dhëna: *frekuentim (Frequency)*, *përqindje (Percent)*, *përqindje valide (Valid Percent)* dhe *përqindje kumulative (Cumulative Percent)*.

**Tabela 16.** Përvoja e punës së prindërve

**Përvoja**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
<b>Përvoja</b>	Deri 10 vjet	27	27,0	27,0	27,0
	11-25 vjet	40	40,0	40,0	67,0
	26-35	22	22,0	22,0	89,0
	Mbi 35 vjet	11	11,0	11,0	100,0
	Total	100	100,0	100,0	

Burimi: Autori, 2016

Në tabelën e mësipërme është paraqitur variabla **përvoja**, me këto të dhëna: *frekuentim (Frequency)*, *përqindje (Percent)*, *përqindje valide (Valid Percent)* dhe *përqindje kumulative (Cumulative Percent)*.

**Tabela 17.** Përdorimi i kompjuterit për ngritje profesionale

**perdorimi\_PC\_per\_ngritje\_profesionale**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	10	10,0	10,0	10,0

Rrallë	25	25,0	25,0	35,0
Shpesh	65	65,0	65,0	100,0
Total	100	100,0	100,0	

Burimi: Autori, 2016

Në tabelën e mësipërme është paraqitur variabla ***përdorimi i PC për ngritje profesionale***, me këto të dhëna: *frekuentim (Frequency)*, *përqindje (Percent)*, *përqindje valide (Valid Percent)* dhe *përqindje kumulative (Cumulative Percent)*.

#### *Kampionimi i hulumtimit-menaxher institucional dhe njohës të arsimit*

Menaxherët institucionalë dhe njohësit e arsimit i kanë shprehur opinionet e tyre lidhur me mësimin në distancë nëpërmjet platformës digjitale e-learning me anë të intervistës. Intervista u është dërguar dorazi, nëpërmjet postës elektronike dhe rrjetit social, Fb. Intervista është drejtuar në 10 (dhjetë) institucione arsimore në Prishtinë. Edhe këtu nëpërmjet metodës “orteku i borës” është arritur shpërndarja e pyetësorit, ku autorit të këtij disertacioni i kthehen gjithsej 100 (njëqind) përgjigje nga intervista.

#### **4.6. Metodatat e përdorura**

Zgjedhja e metodave që përdoren në një hulumtim varet nga hipotezat e ngritura, pyetjet kërkimore dhe tematika e hulumtimit (Mathews, 2010). Bazuar në natyrën e këtij hulumtimi janë përdorur disa metoda:

***Metoda e analizës:*** Nëpërmjet kësaj metode është bërë zbërthimi i mendimeve të nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve për pikëpamjet e tyre rreth të mësuarit tradicional dhe atij në distancë, nëpërmjet teknologjive të reja si: e-learning dhe m-learning. Po ashtu, këtu janë inkorporuar edhe metoda e analizës së teknologjisë (meqë hulumtimi ka të bëjë pikërisht me shkencën e teknologjisë së informacionit dhe

komunikimit - TIK), si dhe metoda e analizës kualitative (cilësore). Zbërthimi i konkluzioneve të kampionëve ka të bëjë me analiza cilësore, prandaj kjo metodë ndihmon shumë në përgjigjen e pyetjes kërkimore që ka të bëjë me eficiencën e të nxënimit tradicional dhe atij nga distanca, nëpërmjet e-learning.

**Metoda e konkretizimit:** Hulumtimi ka të bëjë me të mësuarit, i cili konkretizohet në mësim tradicional dhe me mësim nga distanca. Të mësuarit është kuptim i përgjithshëm, që nënkupton mësimin tradicional, ndërsa kur të mësuarit e konkretizojmë i shtojmë prepozicionet: nga distanca nëpërmjet teknologjive të reja, e-learning apo m-learning.

**Metoda e krahasimit:** Gjatë hulumtimit kërkohet të arrihen konkluzione, të cilat synojmë të jenë të sakta. Meqë kërkohet ta nxjerrim një paralele ndërmjet mësimin tradicional dhe atij në distancë, që realizohet nëpërmjet TIK-ëve, metoda e krahasimit ndihmon shumë në nxjerrjen e konkluzioneve përfundimtare.

**Metoda e vështrimit:** Për nxjerrjen e përfundimeve se cili model i të mësuarit është më eficient - të mësuarit tradicional, apo të mësuarit nga distanca nëpërmjet e-learning, janë përdorur pyetësorët dhe intervistat. Prandaj, nëpërmjet kësaj metode janë zbatuar teknikat e anketimit dhe intervistave. Pasi janë mbledhur pyetësorët dhe intervistat, puna ka vazhduar me paraqitjen e rezultateve tabelare.

**Metoda e kompilimit:** Për të qenë punimi sa më i kompletuar, gjatë punës kërkimore-shkencore është rishikuar edhe literatura e mëhershme e hulumtimeve të kësaj fushe nga vendet evropiane, vendeve në zhvillim, si dhe shteteve të rajonit. Përvojat e tyre, rezultatet dhe teknikat e marra në këtë hulumtim janë cituar në bazë të kritereve të parapara nga UET.

**Metoda kuazieksperimentale:** Fillimit të këtij hulumtimi i ka paraprirë ideja e krahasimit të të nxënimit me metodologji të reja. Për ta marrë guximin e thellimit të studimeve të nivelit

të tretë, gjatë hulumtimit në studimet master janë bërë kërkime shkencore për të marrë konkluzione për të nxënit në mënyrë tradicionale dhe të nxënit me metoda të avancuara nga teknologjitë e reja, nëpërmjet e-learning. Kjo metodë (kuazieksperimentale) është aplikuar edhe gjatë këtij hulumtimi.

**Metoda statistikore:** Paraqitja e rezultateve do të prezantohet në formë: të tabelave, grafikëve, të shprehur në formë numerike dhe me përqindje (%). Paraqitja e rezultateve të tilla është mundësuar me anë të programit SPSS. Pas paraqitjes dhe analizës së rezultateve mund të nxjerrim diskutimet, konkluzionet dhe rekomandimet, të cilat edhe e përmbyllin këtë hulumtim shkencor me tematikë të nxënit nga distanca nëpërmjet teknologjive të reja, me mësim elektronik, e-learning.

Me anë të mbledhjes së rezultateve nëpërmjet instrumenteve të përdorura do të arrihet besueshmëria e hulumtimit. Pjesëmarrësit në këtë hulumtim janë mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit të cilët përgjigjet e tyre për të nxënit elektronik dhe tradicional i dhanë me anë të pyetësorëve, që ishin të ndryshme për secilin grup. Dy grupe tjera i dhanë opinionet e tyre nëpërmjet intervistave. Ata ishin menaxherë institucionalë dhe njohës të arsimit. Kjo në mënyrë më të detajuar është paraqitur në kapitullin vijues.

Këto metoda janë përshkruar edhe në kapitullin e parë të këtij disertacioni në seksionin - Metodologjia.

#### **4.7. Hartimi i pyetësorëve dhe përmbajtja e tyre**

Hapi tjetër ka të bëjë me pyetësorët dhe intervistat. Për të qenë hulumtimi sa më i kompletuar, vëmendje të veçantë i është kushtuar hartimit të pyetësorëve dhe përmbajtjes së tyre. Në hulumtim u përdorën tre lloj pyetësorësh, të cilët iu dedikuan mësimdhënësve,

nxënësve dhe prindërve. Po ashtu, në hulumtim përfshihen edhe disa intervista me menaxherë të arsimit dhe komuniteteve.

Hartimi i pyetësorëve bazohet në rishikimin e literaturës, përvojën e hulumtimeve të mëparshme, analizën e hulumtimeve nga autorë të tjerë, si dhe duke u mbështetur në hulumtimin e përshkruar në kapitullin e parë, rishikimin e literaturës, në seksionin: 2.4. *“E-mësimi në Evropë: Si instruktorët, mësimdhënësit dhe nxënësit e vlerësojnë e-mësimin?”*

Në fillim, pyetësorët iu shpërndanë disa prindërve, nxënësve dhe mësimdhënësve, mbështetur në sugjerimin e literaturës se është një zgjedhje e mençur që në fillim ta bësh një test me një grup prove, pastaj ta realizosh me një grup më të gjerë (Hamelton, 1999). Pas kësaj, ato u korrigjuan, ngase në disa pyetje testi provë rezultoi të ketë pasur disa pyetje, të cilat u konsideruan nga grupi provë si të koklavitura dhe jokonkrete.

U shpërndanë pyetësorët, të cilët ishin të ndarë për mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit. Ndërsa intervistat janë bërë me menaxherë institucionalë dhe komunitete (njohës të arsimit).

Përmbajtja e tyre:

**Pyetësori 1:** Është për mësimdhënësit dhe përmban 18 pyetje. Nga përgjigjet e ofruara nga ky pyetësor synohet të arrihet në konkluzionet për:

- moshën e mësimdhënësve dhe përvojën e tyre,
- Sa e përdorin internetin, postën elektronike, sa shkëmbejnë e-mail me nxënësit e tyre?
- A përdorin ndonjë platformë të të nxënësve nga distanca dhe çfarë është opinioni i tyre për platformat e të nxënësve nga distanca?

- Cilat mjete teknologjike i përdorin dhe si e shohin ardhmërinë e të nxënësve nga distanca, e-learning?

Përmbajtja e plotë e pyetësorit dedikuar mësimdhënësve është paraqitur në fund të këtij hulumtimi, te pjesa Aneksi, e lexueshme si Pyetësori 1.

**Pyetësori 2:** Është për nxënësve dhe përmban 18 pyetje. Qëllimi i këtij pyetësori është marrja e përgjigjeve nga nxënësve për të parë se:

- Si e përdorin internetin nxënësve e moshave të caktuara nga pjesë të ndryshme të Prishtinës?
- A e përdorin internetin vetëm për forume sociale, chat e argëtime, apo e përdorin për të mësuar mësim, të cilat i kanë në planprogramin e tyre mësimor?
- A komunikojnë me mësimdhënësve nëpërmjet postës elektronike?
- Në ç' masë e përdorin internetin për të mësuar nga distanca nëpërmjet e-mësimit (e-learning) apo m-mësimit (m-learning)?
- Sa e ndiejnë veten të përgatitur për të mësuar nga distanca, si e shohin internetin në të ardhmen, si dhe a mendojnë se mësimi në distancë në të ardhmen do ta zëvendësojë mësimin tradicional?
- Në fund do të jenë të lirë ta shprehin opinionin e tyre se sa kanë njohuri për mësimin në distancë.

Përmbajtja e plotë e pyetësorit dedikuar nxënësve është paraqitur në fund të këtij hulumtimi, në pjesën Aneksi, e lexueshme si Pyetësori 2.



**Pyetësi 3:** Është për prindër dhe përmban 16 pyetje. Qëllimi i këtij pyetësi është marrja e përgjigjeve nga prindërit për:

- A u kanë mundësuar fëmijëve të tyre të kenë internet në shtëpi?
- Sa gjatë e përdorin internetin fëmijët e tyre në shtëpi dhe a komunikojnë me bashkëmoshatarët e tyre?
- A kanë njohuri për mësimin në distancë?
- Si e shohin nga këndi i tyre të ardhmen e mësimin në distancë?
- Cilat janë pengesat themelore për mësimin në distancë?
- Si e vlerësojnë mësimin në distancë?

Përmbajtja e plotë e pyetësorit dedikuar prindërve është paraqitur në fund të këtij hulumtimi, në pjesën Aneksi, e lexueshme si Pyetësi 3.

**Intervista 1:** Është për menaxhmentin. Përmbajtja e pyetjeve ishte e hapur, ndërsa u është përcjellë në formë elektronike, kështu që koha për të kthyer përgjigje nuk ka qenë shumë e kufizuar. Intervista e parë përmban gjashtë pyetje, të cilat kanë të bëjnë me përgatitjen e mësimdhënësve për e-mësim, për interesimin e nxënësve që ata kanë vërejtur për e-mësim, si dhe sa janë prindërit të gatshëm për këtë platformë të të nxënit. Kjo intervistë është bërë me disa udhëheqës të arsimit komunal, drejtorë të disa shkollave, si edhe me disa mësimdhënës, të cilët e shohin veten në të ardhmen si udhëheqës institucional, në Ministri të Arsimit (MASHT), në drejtori komunale të arsimit (DKA), apo drejtor shkolle. Përmbajtja e plotë e intervistës dedikuar menaxhmentit të arsimit është paraqitur në fund të këtij hulumtimi, në pjesën Aneksi, e lexueshme si Intervista 1.

**Intervista 2:** Është për komunitetin. Kjo intervistë është bërë me disa personalitete, njohës së problematikave të arsimit, analistë të fushës së arsimit, pedagogë, psikologë, publicistë, studentë etj.

Përmbajtja e plotë e intervistës dedikuar komunitetit (ekspertëve, analistëve dhe njohësve të arsimit) është paraqitur në fund të këtij hulumtimi, në pjesën Aneksi, e lexueshme si Intervista 2.

### ***Aspektet etike të punës në terren***

Kodi etik gjatë hulumtimit është harmonizuar me rregullat dhe ligjet në fuqi që parashihen me rastin e mbledhjes së të dhënave të nevojshme për të arritur deri te diskutimet, konkluzionet dhe rekomandimet të cilat njëherit edhe do të vërtetojnë hipotezat e ngritura apo i hudhin poshtë ato. Meqë bëhet fjalë për një metodologji të re të të nxënit, janë sqaruar edhe më lartë se kampion janë nxënësit, mësimdhënësit dhe menaxherët institucional. Aty ku ishte e nevojshme, është ruajtur privatësia, ndërsa para marrjes së informatave të nevojshme, të gjithë do të informohen për qëllimin e mbledhjes së informatave dhe përdorimin e tyre. Në ato pika ku kërkohet të merret pëlqimi, nënshkruhet edhe *formulari për dhënie pëlqimi*.

### ***Plani i zbatimit të kërkimit***

Zbatimi i këtij hulumtimi është realizuar në disa faza:

*Faza e parë:* Në fazën e parë janë intervistuar menaxherët institucionalë të arsimit dhe njohës të arsimit. Grumbullimi i përgjigjeve të tyre është bërë nga muaji shtator 2015 deri në shkurt 2016. Janë grumbulluar gjithsej 100 (njëqind) intervista. Metoda e mbledhjes

së menaxherëve dhe njohësve të arsimit kanë filluar me një grup të vogël, të cilët e kanë përcjellë formularin e intervistës të kolegët e tyre. Kjo mënyrë e realizimit të hulumtimit njihet si “orteku i borës” (Mattheews, 2010).

*Faza e dytë:* Në fazën e dytë hulumtimi i nënshtrohet mbledhjes së përgjigjeve të prindërve, të cilët e kishin pyetësin e veçantë dhe ata u zgjodhën me metodën “orteku i borës” (Mattheews, 2010). Shpërndarja dhe kthimi i pyetësorëve për prindër është bërë në periudhën kohore nga muaji janar deri në maj të vitit 2016. Gjatë kësaj periudhe janë mbledhur 100 pyetësorë.

*Faza e tretë:* Në fazën e tretë janë përfshirë nxënësit dhe mësimdhënësit, të cilët patën pyetësorë të veçantë. Mënyra e zgjedhjes së kampionimit të mësimdhënësve dhe nxënësve është përshkruar në mënyrë të detajuar në këtë kapitull, në seksionin: 4.4.

*Popullata dhe zgjedhja e kampionit.* Hulumtimi me nxënës dhe mësimdhënës është bërë në fillim të vitit shkollor 2016-2017.

#### **4.8. Mbledhja e të dhënave përgjatë hulumtimit**

Mbledhja e të dhënave në terren, siç u cek, deri tani është realizuar nëpërmjet pyetësorëve dhe intervistave.

E tërë puna në terren është realizuar në mënyrën më demokratike. Nga shkollat, në të cilat është zhvilluar hulumtimi, është kërkuar paraprakisht leja nga drejtorët e shkollës. Me ta është caktuar dita kur do të realizohet hulumtimi. Është bërë kujdes që të mos vështirësohet realizimi i procesit mësimor. Në shpërndarjen, sqarimin, realizimin dhe mbledhjen e pyetësorëve, hulumtuesi ka marrë vetë pjesë. Nxënësit dhe mësimdhënësit

kanë qenë plotësisht të lirë ta plotësojnë pyetësozin, ndërkaq në fillim janë njoftuar me natyrën e hulumtimit. Para fillimit të shpërndarjes së pyetësorëve, u është thënë:

*“Jam duke e kryer një hulumtim lidhur me mësimin nga distanca e-learning. Ju jeni zgjedhur në mënyrë të rastësishme që të jeni pjesë e këtij hulumtimi. Të dhënat tuaja janë konfidencionale dhe përgjigjet për pyetjet në vijim nuk vlerësohen gabimisht apo saktë. Ju thjesht jepeni opinionin tuaj, i cili pa dyshim se do të më ndihmojë për nxjerrjen e konkluzioneve që kanë të bëjnë me mësimin nga distanca. Paraprakisht ju falënderoj!”*

Pastaj ka filluar shpërndarja e pyetësorëve. Kjo metodologji është përsëritur në të gjitha shkollat ku është përfshirë hulumtimi.

Nxënësit kanë qenë të njoftuar se në çdo kohë mund të tërhiqen nga plotësimi i pyetësorit, apo mund të mos japin përgjigje në të gjitha pyetjet e parashtruara në pyetësor. Atyre u është bërë me dije se të dhënat që i japin në pyetësorë janë plotësisht konfidenciale. Ato thjesht përdoren për analizë statistikore të këtij hulumtimi dhe në asnjë moment nuk do të kenë asnjë ndikim tjetër, i cili mund t'i dëmtojë ata në çfarëdo mënyre. Po ashtu, nga ata është kërkuar që të jenë sa më të sinqertë në dhënien e alternativave, pavarësisht ndikimit që mund të kenë në vërtetësinë e hipotezave. Privatësia është parësore dhe ajo do të ruhet në çdo pikëpamje. Për këtë shihet edhe përmbajtja e pyetësorit, meqë në asnjë rast nuk kërkohet zbulimi i identitetit të tyre, si: emër, mbiemër, numër të çfarëdoshëm të ID, telefon, apo ndonjë adresë të përafërt e qëndrimit apo banimit.

Në fund vlen të theksohet se në të gjitha shkollat ku është përfshirë ky hulumtim, përkrahja e drejtorëve dhe e stafit udhëheqës, si dhe e personelit arsimor ka qenë në nivelin më të lartë të mundshëm. Në asnjë moment nuk është bërë asnjë përpjekje për ndërhyrje te nxënësit për ta devijuar opinionin e tyre në plotësimin e pyetësorëve.

Ndërsa është krejt e kuptueshme se mësimdhënësit e përfshirë në hulumtim janë plotësisht të njoftuar me rregulloret dhe etikën e hulumtimit, andaj atyre nuk kemi pasur nevojë t'u japim sqarime të tilla, përveç që edhe ata e kanë pasur në pyetësorë fjalën hyrëse për qëllimin e këtij hulumtimi, si standard i formularëve për intervistë dhe pyetësorë.

Në mënyrë të njëjtë është vepruar edhe me prindërit, menaxherët institucionalë të arsimit dhe njohësit e arsimit.

Në fund janë grumbulluar gjithsej 400 pyetësorë dhe 100 intervista.

**Tabela 18.** Grupet e hulumtuara

Nr.	Grupet e hulumtuara	Të shpërndarë	Të kthyer	Të pavlefshëm	Përqindja e mbledhjes
1.	Mësimdhënës	120	100	12	83,33%
2.	Nxënës	225	200	14	95,23%
3.	Prindër	125	100	12	80,00%
4.	Menaxherë	70	50	14	71,42%
5.	Njohës të arsimit	65	50	9	76,92%

*Burimi: Autori 2016*

### ***Llogaritja e shkallës së përgjigjeve***

Për ta llogaritur shkallën e përgjigjeve, pra sa individë i kthyen pyetësorët e plotësuar, e përdorëm këtë formulë (Skenderi, 2016):

$$\text{Shkalla totale e përgjigjeve} = \frac{\text{Numri i përgjithshëm i përgjigjeve}}{\text{Numri i përgji. i mostrës} - \text{të pavlefshme}}$$

Nëse nxjerrim simbolet për:

*shtp* – Shkalla totale e përgjigjeve

*npp* – Numri i përgjith. i përgjigjeve

*npm* – Numri i përgjith. i mostrës

*p* – të pavlefshme

Tani e nxjerrim këtë formulë:

$$shtp = \frac{npp}{npm - p} \cdot 100\%$$

Llogaritjen e shkallës së përgjigjeve të kthyer do ta bëjmë duke i marrë vlerat numerike nga tabela 18, për:

- Mësimdhënës

$$shtp = \frac{npp}{npm - p} \cdot 100\% = \frac{100}{120 - 12} \cdot 100\% = \frac{100}{108} \cdot 100\% =$$

$$= 0.93 \cdot 100\% = 93\%, \text{ d.m.th. shkalla e përgjigjeve është } 93\%.$$

- Nxënës

$$shtp = \frac{npp}{npm - p} \cdot 100\% = \frac{200}{225 - 14} \cdot 100\% = \frac{200}{211} \cdot 100\% =$$

$$= 0.95 \cdot 100\% = 95\%, \text{ d.m.th. shkalla e përgjigjeve është } 95\%.$$

- Prindër

$$shtp = \frac{npp}{npm - p} \cdot 100\% = \frac{100}{125 - 12} \cdot 100\% = \frac{100}{113} \cdot 100\%$$

$$= 0.85 \cdot 100\% = 85\%, \text{ d.m.th. shkalla e përgjigjeve është } 85\%.$$

- *Menaxherët e arsimit*

$$\text{shtp} = \frac{\text{npp}}{\text{npm} - \text{p}} \cdot 100\% = \frac{50}{70 - 14} \cdot 100\% = \frac{100}{113} \cdot 100\% =$$

$$= 0.89 \cdot 100\% = 89\%, \text{ d.m.th. shkalla e përgjigjeve është } 89\%.$$

- *Njohës të arsimit*

$$\text{shtp} = \frac{\text{npp}}{\text{npm} - \text{p}} \cdot 100\% = \frac{50}{65 - 9} \cdot 100\% = \frac{50}{54} \cdot 100\% =$$

$$= 0.93 \cdot 100\% = 93\% \text{ d.m.th. shkalla e përgjigjeve është } 93\%.$$

#### 4.9. Gjetja e variablave kyçe të hulumtimit

Identifikimi i variablave kyçe të këtij hulumtimi, që ka të bëjë me mësimnxënien në distancë nëpërmjet platformës e-learning, mundëson teatimin e variablës së varur dhe variablave të pavarura, nëpërmjet shprehjes:

$$Y = \beta_0 + \beta_1 X_1 + \beta_2 X_2 + \beta_3 X_3 + \beta_4 X_4 + \beta_5 X_5 + \beta_6 X_6 + \beta_7 X_7 + \beta_8 X_8 + \beta_9 X_9 + \varepsilon_i$$

Y- *e-learning* (e-mësimi karshi mësimit tradicional është variabël e varur).

Variablat e pavarura të identifikuar në këtë hulumtim shkencor janë:

X<sub>1</sub> - *mosha*;

X<sub>2</sub> - *përvoja e punës* (për mësimdhënës dhe prindër), ndërsa për nxënës variabël e pavarur është *klasa*;

$X_3$  - përdorimi i PC (kompjuteri personal);

$X_4$  - qasja në internet;

$X_5$  - e-mail;

$X_6$  - komunikimi,

$X_7$  - interneti për ngritje profesionale,

$X_8$  - platforma online dhe

$X_9$  - vlerësimi

$\beta_0$  - është një konstante (përfaqëson efektivitetin e auditimit të brendshëm) dhe çdo ndryshore e pavarur është zero.

$\beta_1 - \beta_9$  - janë koeficientë

$\epsilon_i$  - gabimi standard (i cili shpreh shmangiet e modelit të vlerësuar nga të dhënat reale).

#### **4.10. Kontributi i hulumtimit kërkimor**

Hulumtimi është bërë në mënyrën më të mirë të mundshme. Kohëzgjatja e punës në terren për mbledhjen e të dhënave për sa u përket aktorëve pjesëmarrës në hulumtim ka ndikuar pozitivisht në gjithëpërfshirje të popullatës, e cila lidhet me të nxënit nga distanca nëpërmjet platformës digjitale, e-learning. Gjatë kohës së hulumtimit është bërë kërkimi i literaturës në gjuhën shqipe në Kosovë për të nxënit në distancë dhe gjetja e ndonjë hulumtimi të thelluar të kësaj fushe, por ajo ka qenë e pakët apo shumë në mungesë.



Kështu, bazuar në përfundimin e këtij hulumtimi, ky disertacion do ta japë kontributin e vet për studiuesit e rinj në shumë dimensione:

- Paraqitja e literaturës së rishikuar ndërkombëtare do të ndihmojë në vazhdimin e punës së hulumtuesve të rinj në këtë fushë,
- Analiza e hulumtimit të të nxënit nga distanca, të rishikuar në kapitullin e dytë, e jep kontributin e radhës së këtij hulumtimi,
- Studimi i kufizuar i kësaj fushe në Kosovë, mësimnxënia nga distanca nëpërmjet platformës e-learning, do ta plotësojë sado pak nevojën e madhe që shpërfaqet në literaturën e ardhshme për studim të mëtutjeshëm, do të jetë një kontribut i radhës së këtij hulumtimi,
- Ky hulumtim do t'i provokojë në mënyrë pozitive studiuesit e rinj që të merren me vazhdimin e hulumtimeve që do të hapin debate dhe diskutime, të cilat do të nxjerrin konkluzione dhe rekomandime në punime e konferenca të ndryshme shkencore, me theks fushën e arsimit,
- Prindërve do t'u ndihmojë që të marrin vendime për mbështetjen e fëmijëve të tyre për t'i thelluar studimet nga distanca nëpërmjet e-mësimit dhe m-mësimit,
- Mësimdhënësve do t'u mundësojë që ta rritin interesimin e tyre për të krijuar ekipe brenda kolektivit për të nisur të nxënit nga distanca për nxënësit e tyre, në fillim si alternativë (mësim shtues), për të vazhduar deri në pavarësimin e plotë të të nxënit nga distanca,
- Nxënësve të cilët janë kureshtarë për secilin inovacion, pa dyshim do t'ua lehtësojë të nxënit, duke u mundësuar atyre që në çdo kohë, sa herë që ata dëshirojnë t'i ndjekin leksionet e tyre nga lëndë të preferuara të shkollës,

- Menaxherëve institucionalë, të cilët e mbulojnë fushën e arsimit, sado pak do t'ua "kthjellin" memorien për t'i nxitur që të bëjnë integrame sa më të shpejta në të gjitha kahet në fushën e e-learning,
- Stafit akademik dhe studentëve të rinj do t'u ndihmojë për të nisur gërmimet e reja në fushën e menaxhimit dhe realizimit të mësimnxënies nga distanca nëpërmjet e-learning.

Sigurisht se ka edhe kontribute të tjera që jep ky hulumtim, që në pjesën e fundit do të paraqiten në formë diskutimesh, konkluzionesh dhe rekomandimesh.

#### **4.11. Sugjerime për studime në vijim**

Sikur që theksuam disa herë deri tani, hulumtimi ka hasur në vështirësi dhe kufizime të ndryshme. Por, studimi i kujdesshëm ka bërë që ta nxjerrë në shesh kontributin e tij për lexuesin, duke i ndihmuar në zgjedhjen e njëjës së vështirësisë në mënyrën e të nxënit. Për një mbarëvajtje më të mirë për të gjithë ata që janë të përkushtuar ta shpërndajnë dijen e tyre te brezat e rinj, sugjerojmë:

- Thellimin e studimeve dhe hulumtimeve shkencore në fushën e arsimit sa i përket të mësuarit nëpërmjet teknologjive të reja elektronike, e-learning,
- Vazhdimin e punimeve shkencore të doktorantëve të rinj, në fusha të ngjashme, për të cilat ka nevojë imediate dhe kërkesë të madhe nga gjeneratat e reja për një mësimdhënie dhe mësimnxënie sa më kualitative (cilësore),
- Prindërit të jenë sa më të kujdesshëm në lejimin apo pengimin e fëmijëve të tyre për punë në kompjuterë dhe internet, duke shprehur edhe dyshimet e veta në

- gjetjen e përparësive dhe mangësive të portaleve të ndryshme elektronike që ofrojnë materiale me tematika të ndryshme. Ato mund të jenë mjaft të dobishme, sikur që edhe mund të jenë edhe mjaft të dëmshme për zhvillimin e drejtë të brezit të ri, meqë rinia shqiptare llogaritet brezi më i shëndoshë në rajon dhe në Evropë,
- Kuadrot arsimore të të gjitha niveleve t'i hartojnë dhe harmonizojnë planprogramet e reja për mësimnxënie nga distanca nëpërmjet e-mësimit dhe m-mësimit,
  - Autorët profesionistë, të cilët merren me përgatitjen e literaturës që ka të bëjë me studimin e mësimnxënies, të përgatitin libra të rinj nga kjo fushë. Literatura në gjuhën shqipe është shumë e varfër, për të mos thënë se ajo mungon,
  - Në këtë hulumtim është shënuar edhe për e-librin (librin elektronik). Leverdia nga publikimi i një libri fizik është e vogël, por tani është më se e nevojshme për lansimin e e-book (e-librit), të cilin studiuesi i ri kërkon ta gjejë me pajisjet e reja të mençura, si p.sh. smart phone,
  - Qeveria dhe politika kosovare, së paku në këtë fushë, t'i lejojnë të punojnët në mënyrë të pavarur dhe profesionale kuadrot adekuate, duke i mbështetur me grante të pakufizuara për sjelljen e përvojave në sistemin arsimor kosovar nga vendet e BE-së,
  - Përpjekje të pareshtura për integrim të infrastrukturës, mësimdhënies dhe mësimnxënies nga distanca, në mënyrë që të themelohen shkolla “pa mure” dhe klasë me ambiente të përshtatshme për një mësimnxënie kualitative, sikur në vendet e zhvilluara.

## **KAPITULLI V ANALIZA E TË DHËNAVE: MËSUESIT, NXËNËSIT, PRINDËRIT MENAXHERËT DHE KOMUNITETI**

### **5.1. Paraqitja e të gjeturave nga terreni**

Hulumtimi është realizuar në formë të pyetësorëve dhe intervistave. Përmbajtja e tyre është bashkëlidhur në fund të këtij punimi. Pasi janë grumbulluar pyetësorët dhe intervistat e sjella nga terreni, fillon faza e analizimit të tyre. Metodologjia e hulumtimit është përshkruar në mënyrë të detajuar në kapitullin IV (katër) të këtij hulumtimi, përkatësisht në kapitullin paraprak. Rezultatet e hulumtimit janë bazament për të bërë analizimin e rëndësisë së mësimnxënies nëpërmjet platformës elektronike e-learning, e cila varet nga shumë faktorë direktë dhe indirektë. Ndikimi i tyre bën që të ndihmojë ose të pengojë fillimin e implementimit të të nxënit nga disatnca me e-learning edhe në institucionet e Kosovës. Rezultatet e paraqitura në pyetësorë dhe intervista kanë qenë plotësisht të lira dhe në plotësi është ruajtur origjinaliteti i tyre, pavarësisht se cili ishte ndikimi i tyre në vërtetimin e hipotezave.

### **5.2. Vështrim i rezultateve të mbledhura nga terreni**

Të dhënat në pyetësorë dhe në intervista të grumbulluar te autori i hulumtimit fillojnë me hapin e parë, vështrimin e rezultateve. Shpërndarja dhe grumbullimi i tyre ishte një punë jo edhe shumë e lehtë. Pas të gjitha atyre vështirësive dhe pengesave tjera të natyrave të ndryshme, u arrit të grumbullohen në total 500 pyetësorë dhe intervista. Shpërndarja dhe

mbledhja e tyre u bë në mënyrë direkte dhe nëpërmjet internetit. Rezultatet kanë synuar të japin përgjigje në pyetjet kërkimore:

Pyetja e parë kërkimore: Sa mund të bëhet praktikisht të mësuarit në distancë në kontekstin kosovar një metodë më produktive dhe më efiçente se të mësuarit tradicional?

Pyetja e dytë kërkimore: Cilat mund të jenë ndërhyrjet e nevojshme në sistemin arsimor në Kosovë për ta nxitur e mbështetur të mësuarit në distancë?

Dhe, në vërtetimin e hipotezave:

Hipoteza e parë: Të mësuarit në distancë është më efiçent, më produktiv dhe më parësor sesa të mësuarit tradicional, edhe në kontekstin e sistemit arsimor në Kosovë.

Hipoteza e dytë:

Aplikimi i metodës së të mësuarit në distancë kërkon si parakusht ndryshimin e menaxhimit të sistemit arsimor dhe shkollave në Kosovë.

Pyetësorët dhe intervistat në fillim kodohen dhe pastaj fillon puna e bartjes së variablave me të dhëna në programin për analiza të të dhënave SPSS Statistics versioni 22 (Skenderi, 2016).

### 5.3. Analiza e besueshmërisë

Për ta realizuar analizën e besueshmërisë përdoret koeficienti Alfa i Cronbach-ut. Kjo vlerë sillet në kufijtë nga  $\alpha=0.60-0.70$  (Myers, 2003). Me anë të programit për nxjerrjen e statistikave, SPSS versioni 22, nxirret koeficienti për variablat e pavarura dhe variablën e varur. Pas vendosjes së vlerave të këtyre variablave, shfaqet tabela (19) si në vijim:

**Tabela 19.** Besueshmëria e analizës

**Reliability Statistics**

Cronbach's Alpha	Cronbach's Alpha Based on Standardized Items	Nr i variablave
.646	.581	10

Burimi: Autori, 2016

Siç vërehet nga tabela (19), vlera e koeficientit të besueshmërisë Cronbach's Alpha,  $\alpha=0.646$ , për të gjitha variablat e pavarura dhe të varura të këtij hulumtimi. Ndërsa, po nga kjo tabelë vërehet se koeficienti i besueshmërisë Cronbach's Alpha bazuar në vlerat standarde është  $\alpha=0.581$ , atëherë përgjigjet e grumbulluara nga pyetëtorët e plotësuar për të gjitha variablat e përdorura janë të besueshme dhe të mjaftueshme për analizën e të dhënave.

#### **5.4. Sa janë të përgatitur mësimdhënësit për zbatimin e platformës së mësimin nga distanca?**

Se arsimi dhe edukimi i një vendi është i rëndësishëm, kjo çështje është e ditur kaherë. Prandaj shumë autorë dhe studiues e kanë pasur e kanë dhe duhet ta kenë prioritet të tyre pikërisht këtë çështje fundamentale të shoqërisë. “Edhe arsimi, si detyrë e shtetit, e luan një rol të rëndësishëm për Smithin, i cili në veprën ‘Pasuria e kombeve’ e zhvillon një diskutim kritik për domethënien shoqërore të edukimit dhe arsimimit” (Helen Winter, 2006:230). Njëri nga shumë faktorët që ndikojnë në përgatitjen e mësimdhënësve për ta zbatuar platformën e mësimin nga distanca është edhe moshja e tyre. “Mësimdhënësit njëzetvjeçarë hulumtojnë opsione të reja përreth vetes, ndërsa dyzetvjeçarët janë në krizën e mesit të moshës dhe gjithnjë e pyesin veten nëse janë duke punuar atë që kanë menduar dhe nëse i kanë arritur qëllimet” (Stoll & Fink, 2000:205).

Përgatitja e mësimdhënësit për të qenë profesionalisht i përgatitur është një proces i vazhdueshëm (Craft, 2000: 47), i cili fillon ditën e parë të punës së tij dhe mbaron ditën e fundit të punës së tij profesionale. Pra, shihet se kjo periudhë kohore është e gjatë, ndërsa ai vazhdimisht e ka obligim që të riaftësohet, të mësojë metodologji të reja, të jetë i pandalshëm në zbatimin e tyre, ashtu që nxënësi i tij gjithmonë të mësojë gjëra të reja nga ai. Pasuria e kombit është arsimit, prandaj shoqëria duhet t'i kushtojë gjithnjë kujdes të veçantë, meqë e ka marrë për sipër të kujdeset për arsimimin e shtetit të vet. (Helen Winter, 2006:232) vazhdon t'i kushtojë rëndësi të veçantë arsimimit, kur ashpër i kritikon nëpunësit dembelë, të paafët dhe të plogëtit e një shoqërie që e shpërfillin këtë kërkesë të ligjshme të shoqërisë.

*“Një mësues privat nuk mund ta shohë kurrë si të leverdishme të japë mësim në një sistem të shkatërruar dhe të vjetër të një shkence të njohur si të dobishme, apo një shkencë që mbahet përgjithësisht si një masë e kotë dhe pedante me sofizma dhe gjëra pa kuptim. Këto sisteme, këto shkencë, nuk mund të mbijetojnë në asnjë vend, përveçse në ato shoqëri të përbëra nga korporatat për arsimimin, zhvillimin dhe të ardhurat e të cilave janë në një masë të madhe të pavarura nga veprimtaritë e tyre”. (Helen Winter, 2006:232)*

Natyrisht se për të gjitha këto, duke marrë para sysh se kushtet në të kaluarën kanë qenë të vështira për të arritur shkëmbimin e përvojave ndërmjet tyre, tani janë lehtësuar dukshëm. Zhvillimi i teknologjive të reja shihet si mënyrë jashtëzakonisht e lehtë për integrimin e mësimdhënësve në jetën edukativo-arsimore, meqë gjithnjë kërkohet formësimi i tij. Kjo edhe më tepër e thellon arsyetimin e nevojës së mësimin gjatë gjithë jetës.

Për ta kuptuar se si qëndron përgatitja e mësimdhënësve për metodën e re të të nxënimit nga distanca nëpërmjet teknologjive të reja, përkatësisht e-mësimin (e-learning), po i sjellim rezultatet e hulumtimit.

Janë intervistuar 100 mësimdhënës nëpërmjet pyetësorit, i cili i kishte gjithsej 18 pyetje.

### **5.5. Shqyrtimi i variablave kyçe në analizën e hulumtimit e-learning**

Në këtë punim variabël i varur është caktuar e-learning, i cili buron nga pyetja: *Çfarë konsideroni të jetë lajmi më i madh i e-mësimit karshi mënyrave tradicionale të të mësuarit?* Për t'i gjetur faktorët të cilët ndikojnë në fillimin e implementimit të mësimnxënies nga distanca nëpërmjet *e-learning* (variabël i varur), janë identifikuar disa variabla (ndryshore) të pavarura, si: *mosha, përvoja e punës, përdorimi i PC, qasja në internet, e-mail, komunikimi, interneti për ngritje profesionale dhe platforma online.*

Paraqitja e statistikave të variablit të varur dhe të variablave të pavarura është bërë në programin SPSS Statistics 22 (Pallant, 2009), me analizën e kryqëzimit të tabelave (Crosstabulation), për t'i shpjeguar marrëdhëniet ndërmjet dy variablave. Testi Chi Scuar i Koeficientit Person gjen nëse ka një lidhje ndërmjet dy variablave cilësore. Rezultati i analizës me metodën “crosstabs” në këtë program paraqitet me anë të një table, e cila e përmban statistikën Chi Scuar dhe vlerën e saj të rëndësisë (domethënies) e cila tregon nëse është vlera më e vogël se 0,05 ( $p < 0,05$ ), për të vërtetuar se ndërmjet dy variablave ekziston një ndryshim sinjifikant.

Për të përcaktuar nëse ekziston një lidhje ose jo statistikore ndërtohen dy hipoteza:

Ho: Nuk ka lidhje ndërmjet variablave në shqyrtim

Ha: Ka lidhje statistikore ndërmjet variablave në shqyrtim

Nëse  $p < 0,05$  (sinifikanca), atëherë hipoteza Ho hidhet poshtë dhe pranohet alternativa (ka lidhje ndërmjet variablave).



Në qoftë se  $p > 0,005$ , atëherë pranohet hipoteza  $H_0$  (nuk ka lidhje ndërmjet variablave).

### PI.1. Vendbanimi i mësimdhënësve

Pyetja e parë do ta identifikojë vendbanimin e mësimdhënësit. Në bazë të analizës së pyetësorëve rezulton se: grupi i parë prej 50 mësimdhënësve të intervistuar apo 50%, jetojnë në Prishtinë, ndërsa në grupin e dytë janë përfshirë mësimdhënësit, të cilët jetojnë jashtë Prishtinës. Prej tyre, 1/4 e tyre, përkatësisht 25, jetojnë afër Prishtinës, përderisa në fshat janë deklaruar se jetojnë 10 mësimdhënës, nga 100 të përfshirë dhe 15 mësimdhënës janë duke jetuar jashtë komunës së Prishtinës.

**Tabela 20.** *Vendbanimi i mësimdhënësve*

**e\_learning \* vendbanimi Crosstabulation**

Count		vendbanimi				Gjithsej
		Prishtinë	Afër Prishtinës	fshat	Jashtë Prishtinës	
<b>e_learning</b>	e-mësimi është inovacion	22	8	3	4	37
	Nuk ofron lajm të veçantë	6	14	4	7	31
	Krijon lidhje të reja: mësues - nxënës	10	0	0	0	10
	qasje të reja	12	3	3	4	22
Gjithsej		50	25	10	15	100

Burimi: Autori, 2016

Nga tabela 20 shihet se opinioni i mësimdhënësve me vendbanim në Prishtinë, lidhur me mësimin e-learning, është si në vijim:

- *e-learning* është inovacion (22 mësimdhënës);
- *e-learning* nuk ofron lajm të veçantë (6 mësimdhënës);
- *e-learning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (10 mësimdhënës) dhe


- *e-learning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (12 mësimdhënës).

Po nga kjo tabelë vërejmë se 10 mësimdhënës, nga 100 të intervistuar nëpërmjet pyetësorit, që me vendbanim janë nga fshatrat e Prishtinës, lidhur me mësimin e-learning shprehen kështu:

- *e-learning* është inovacion (3 mësimdhënës),
- *e-learning* nuk ofron lajm të veçantë (4 mësimdhënës),
- *e-learning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (asnjë mësimdhënës) dhe
- *e-learning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (3 mësimdhënës).

Testi statistikor tregon lidhje kuptimplota ndërmjet variablave, d.m.th. variablat janë të varura dhe lidhja ndërmjet tyre është e justifikueshme.

**Diag. 1.** Vendbanimi i mësimdhënësve të intervistuar



Burimi: Autori, 2016

### ***P1.2. Moshë e mësimdhënësve***

Moshë e mësimdhënësve të intervistuar është prezantuar në tabelën në vijim:

**Tabela 21.** Prezantimi i të anketuarve në grupmosha të caktuara lidhur me e-learning

**Crosstab**

Count

		mosha				Total
		deri 35 vjeç	36-45 vjeç	45-60 vjeç	Mbi 60 vjeç	
<b>e_learning</b>	e-mësimi është inovacion	28	6	2	1	37
	Nuk ofron lajm të veçantë	29	1	0	1	31
	Lidhje të reja: mësues-nxënës	6	0	4	0	10
	qasje të reja	12	7	0	3	22
Total		75	14	6	5	100

Burimi: Autori, 2016

Nga tabela 21 shihet se janë ndarë 4 grupe të moshës: deri në 35 vjeç (75 mësimdhënës), nga mosha 36 deri në 45 vjeçe (14 mësimdhënës), nga 46 deri në 60 vjeçe (6 mësimdhënës) dhe mbi moshën 60 vjeçe (5 mësimdhënës).

Po ashtu nga tabela 21 konkludojmë se mësimdhënësit me moshë deri 35-vjeçare vlerësojnë se:

- *e-learning* është inovacion (28 mësimdhënës),
- *e-elarning* nuk ofron lajm të veçantë (29 mësimdhënës),
- *e-elarning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (6 mësimdhënës) dhe
- *e-elarning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (12 mësimdhënës).

Ndryshe shprehen mësimdhënësit e moshës mbi 60-vjeçare, të cilët njëherësh janë në vitet e fundit të karrierës së tyre. Po nga tabela e njëjtë nxjerrim konkluzionet e tyre:

- *e-learning* është inovacion (1 mësimdhënës),
- *e-elarning* nuk ofron lajm të veçantë (1 mësimdhënës),
- *e-elarning* krijon lidhje të reja mësmidhënës-nxënës (asnjë mësimdhënës) dhe

- *e-learning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (3 mësimdhënës).

Nëpërmjet analizës “Chi-Square Tests”, paraqiten lidhjet ndërmjet variablës (ndryshores) së varur “*e-learning*” dhe variablës së pavarur “*mosha*”. Nga të dhënat e paraqitura në tabelën 22 vërejmë se vlera statistikore është 38,877<sup>a</sup> dhe shkalla e lirisë (df) është 9, ndërsa  $p=0,000<0,05$ . Kjo analizë gjen një marrëdhënie statistikisht domethënëse ndërmjet variablave.

Analizat po ashtu tregojnë se raporti i mundësisë (Likelihood Ratio) është 31.993. Po ashtu analizojmë edhe  $p=0,000<0,05$ . Nga kjo përfundojmë se variablat “*e-learning*” dhe “*mosha*” janë të varura. Testi statistikor tregon lidhje kuptimplota ndërmjet variablave, d.m.th. variablat janë të varura dhe lidhja ndërmjet tyre është e justifikueshme.


**Tabela 22.** Lidhja ndërmejt “*e-learning*” dhe “*mosha*”

Chi-Square Tests			
	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	38,877 <sup>a</sup>	9	.000
Likelihood Ratio	31,993	9	.000
Linear-by-Linear Association	4,542	1	.033
N of Valid Cases	100		

- a. 11 celula (68.8%) i kanë vlerat e pritura më të vogla se 5. Numri më i vogël i pritshëm është 0,50.

Burimi: Autori, 2016

**Diag. 2.** Moshë e mësimdhënësve të intervistuar



Burimi: Autori, 2016

Në diagramin 2 është paraqitur grafiku me përqindje të moshës së mësimdhënësve.

### ***P1.3. Ndikimi i përvojës së punës së mësimdhënësve në mësimnxënien, e-learning***

Se sa ndikon përvoja e punës (variabël e pavarur) në mësimnxënien në distancë e-learning (variabël e varur), do të bëjmë krahasimin e tyre nëpërmjet programit për hulumtime shkencore dhe analiza të të dhënave SPSS Statistics versioni 22. Në fillim, ashtu siç shihet në tabelën (23), konkludojmë se mësimdhënësit e intervistuar për hulumtimin shkencor të mësimnxënies nga distanca nëpërmjet platformës e-learning, është konstatuar se përvoja e punës është shumë e rëndësishme dhe ndikuese. Përvoja e tyre e punës është ndarë në 4 (katër) grupe. Me përvojë pune deri në 10 vjet ishin 67 mësimdhënës, nga 11 deri 25 vjet përvojë pune u deklaruan 14 mësimdhënës, nga 26 deri 35 vjet përvojë ishin 11 mësimdhënës, ndërsa me përvojë pune mbi 35 vjet ishin 8 mësimdhënës. Kjo shihet në tabelën (23) dhe diagramin 3, ku shprehet edhe përqindja e mësimdhënësve.

**Tabela 23.** Përvoja e punës së mësimdhënësve

**Crosstab**

Count

		përvoja				Total
		Deri 10 vjet	11-25 vjet	26-35	Mbi 35 vjet	
e_learning	e-mësimi është inovacion	24	6	4	3	37
	Nuk ofron lajm të veçantë	27	1	2	1	31
	Lidhje të reja: mësues-nxënës	4	0	5	1	10
	qasje të reja	12	7	0	3	22
Total		67	14	11	8	100

Burimi, autori, 2016

Në tabelën 23 është paraqitur lidhshmëria ndërmjet variablës së varur “*e-learning*” dhe variablës së pavarur “*përvoja e punës*” së mësimdhënësve që morën pjesë në hulumtimin e të mësuarit nga distanca nëpërmjet e-learning. Në këtë pyetje të kërkimit përgjigje kanë dhënë gjithsej 100 mësimdhënës, prej të cilëve 67 mësimdhënës kanë përvojë pune deri në 10 vjet, ndërsa nga 11 deri në 35 vjet kanë marrë pjesë në këtë hulumtim 25 mësimdhënës, ndërsa 8 mësimdhënës rezultojnë se kanë pasur përvojë pune mbi 35 vjet. Po ashtu nga tabela 23 konkludojmë se mësimdhënësit me përvojë pune deri në 10 vjet vlerësojnë se:

- *e-learning* është inovacion (67 mësimdhënës),
- *e-learning* nuk ofron lajm të veçantë (14 mësimdhënës),
- *e-learning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (11 mësimdhënës) dhe
- *e-learning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (8 mësimdhënës).

Ndryshe shprehen mësimdhënësit e moshës mbi 60 vjeç me përvojë pune mbi 35 vjet, të cilët njëherësh janë në vitet e fundit të karrierës së tyre. Po nga tabela e njëjtë nxjerrim konkluzionet e tyre:

- *e-learning* është inovacion (3 mësimdhënës),
- *e-elarning* nuk ofron lajm të veçantë (1 mësimdhënës),
- *e-elarning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (1 mësimdhënës) dhe
- *e-elarning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (3 mësimdhënës).

Nëpërmjet analizës “Chi-Square Tests” paraqiten lidhjet ndërmjet variablës (ndryshores) së varur “*e-learning*” dhe variablës së pavarur “*përvoja e punës*”. Nga të dhënat e paraqitura në tabelën 24 vërejmë se vlera statistikore është 31.219<sup>a</sup> dhe shkalla e lirisë (df) është 9, ndërsa  $p=0,000<0,05$ . Kjo analizë gjen një marrëdhënie statistikisht domethënëse ndërmjet variablave.


**Tabela 24.** Lidhja ndërmjet “*e-learning*” dhe “*përvoja e punës*”

Chi-Square Tests			
	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	31,219 <sup>a</sup>	9	.000
Likelihood Ratio	28,649	9	.001
Linear-by-Linear Association	1,110	1	.292
N of Valid Cases	100		

a. 11 celula (68,8%) i kanë vlerat e pritura më të vogla se 5. Numri më i vogël i pritshëm është 0,80.

Analizat po ashtu tregojnë se raporti i mundësisë (Likelihood Ratio) është 28,649. Po ashtu analizojmë edhe  $p=0,001<0,05$ . Nga kjo përfundojmë se variablat “*e-learning*” dhe “*përvoja e punës*” janë të varura. Testi statistikor tregon lidhje kuptimplota ndërmjet variablave, d.m.th. variablat janë të varura dhe lidhja ndërmjet tyre është e justifikueshme.

**Diag. 3.** Përvoja e punës së mësimdhënësve



Burimi: Autori, 2016

#### ***P1.4. Përdorimi i kompjuterit dhe e-learning***

Përgjigjet në pyetjen rreth përdorimit të kompjuterit nga mësimdhënësit në shtëpi apo në shkollë janë prezantuar në tabelën 25 dhe diagramin 4. Nga të dhënat e prezantuara shihet se 86 mësimdhënës e përdorin kompjuterin në shtëpi apo në shkollë, ndërsa 14 mësimdhënës nuk e përdorin.

Gjatë përpilimit të pyetësorit që do t'u drejtohej mësimdhënësve, pa hamendje është arritur deri te vendimi për t'ua shtruar pyetjen atyre që do të marrin pjesë në plotësimin e pyetësorit: “E përdorni kompjuterin në shtëpi apo në shkollë?”. Me anë të kësaj pyetje sigurisht se do të gjendet ndikimi i përdorimit të kompjuterit për të rritur efektin e të mësuarit nga distanca. Kjo nuk ka dyshim kur kemi parasysh se pa përdorimin e kompjuterit, mësimdhënësi nuk do të mund t'i përgatisë njësitë mësimore që kanë të bëjnë me mësimdhënie nga distanca, e-learning.

Këtu për variabël të pavarur është vendosur: *përdorimi i PC*.



Nëpërmjet programit për gjetjen e statistikave SPSS me analizën Crosstab paraqitet lidhja ndërmjet variablës së varur “*e-learning*” dhe asaj të pavarur “*përdorimi i PC*”.

Nga tabela 25 shihet se 62 mësimdhënës janë deklaruar se nuk e përdorin fare kompjuterin, 14 mësimdhënës e përdorin rrallë, përderisa 24 mësimdhënës e përdorin shpesh.

Lidhshmëria ndërmjet variablave “*e-learning*” dhe “*përdorimi i PC*” me anë të kryqëzimit të këtyre tabelave “Crosstab” është paraqitur në tabelën 24 dhe komentohet, si në vijim:

**Tabela 25.** Lidhja ndërmjet variablave: “*e-learning*” dhe “*përdorimi i PC*”

**Crosstab**

Count

		përdorimi_i_PC			Total
		Nuk e përdor fare	Rrallë e përdor	E përdor shpesh	
e_learning	e-mësimi është inovacion	22	6	9	37
	Nuk ofron lajm të veçantë	26	1	4	31
	Lidhje të reja: mësues-nxënës	4	0	6	10
	qasje të reja	10	7	5	22
Total		62	14	24	100

Burimi: Autori, 2016

Mësimdhënësit, të cilët janë deklaruar se nuk e përdorin fare kompjuterin, e kanë këtë mendim lidhur me 4 (katër) opsionet e mësimit e-learning:

- *e-learning* është inovacion (22 mësimdhënës),
- *e-learning* nuk ofron lajm të veçantë (26 mësimdhënës),
- *e-learning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (4 mësimdhënës) dhe

- *e-learning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (10 mësimdhënës).

Përderisa mësimdhënësit, të cilët janë deklaruar se e përdorin kompjuterin shpesh, lidhur me mësimin e-learning janë shprehur kështu:

- *e-learning* është inovacion (9 mësimdhënës),
- *e-learning* nuk ofron lajm të veçantë (4 mësimdhënës),
- *e-learning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (6% mësimdhënës) dhe
- *e-learning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (5% mësimdhënës).

**Tabela 26.** “Chi-Square Tests “ - “*e-learning*” dhe “*përdorimi i PC*”

Chi-Square Tests			
	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	20,279 <sup>a</sup>	6	.002
Likelihood Ratio	20,205	6	.003
Linear-by-Linear Association	1,375	1	.241
N of Valid Cases	100		


a. 4 celula (33,3%) I kanë vlerat e pritura më të vogla se 5. Numri më i vogël i pritshëm është 1,40.

Burimi: Autori, 2016

Me anë të analizës “Chi-Square Tests” paraqitet lidhja ndërmjet variablës (ndryshore) së varur “*e-learning*” dhe variablës së pavarur “*përdorimi i PC*”. Nga të dhënat e paraqitura në tabelën 26 vërejmë se vlera statistikore është 20,279<sup>a</sup> dhe shkalla e lirisë (df) është 6, ndërsa  $p=0,002$ . Kjo vlerë e probabilitetit është më e vogël se 0,05, për çka konstatojmë se kjo analizë gjen një marrëdhënie statistikisht domethënëse ndërmjet variablave.

Analizat po ashtu tregojnë (tabela 26) se raporti i mundësisë (Likelihood Ratio) është 20,205. Po ashtu, analizojmë edhe  $p=0,003 < 0,05$ . Nga kjo përfundojmë se variablat “e-learning” dhe “përdorimi i PC” janë të varura. Testi statistikor tregon lidhje kuptimplota ndërmjet variablave, d.m.th. variablat janë të varura dhe lidhja ndërmjet tyre është sinjifikante.

**Diagrami 4.** Përdorimi i kompjuterit nga mësimdhënësit



Burimi: Autori, 2016

### ***P1.5. Qasja e mësimdhënësve në internet***

Nga 100 mësimdhënësit e përfshirë në hulumtim 96 % deklarohen se kanë qasje në internet ndërsa vetëm 4 % nuk kanë qasje në internet.

**Tabela 27.** Qasja e mësimdhënësve në internet

Count		Crosstab			Total
		qasja_internet			
		Po	Jo	Nuk ka përgjigje	
e-learning	e-mesimi është inovacion	29	6	2	37
	Nuk ofron lajm të veçantë	30	1	0	31
	Lidhje të reja: mësues-nxënës	6	0	4	10
	qasje të reja	15	7	0	22
Total		80	14	6	100

Në pyetjen drejtuar mësimdhënësve: “A keni qasje në internet?”, janë dhënë këto përgjigje:

- Po (kemi qasje në internet), kanë pohuar 80 mësimdhënës;
- Jo (nuk kemi qasje në internet), janë deklaruar 14 mësimdhënës dhe
- Nuk kanë dhënë përgjigje 6 mësimdhënës.

Ndërsa me anë të analizës së lidhshmërisë së varaiblave “*e-learning*” (variabël e varur) dhe “*qasja në internet*” (variabël e pavarur), e paraqitur në tabelën 27, konkludojmë se mësimdhënësit që e përdorin internetin kanë këto opinione për e-mësimin:

- *e-learning* është inovacion (29 mësimdhënës),
- *e-learning* nuk ofron lajm të veçantë (30 mësimdhënës);
- *e-learning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (6 mësimdhënës) dhe
- *e-learning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (15 mësimdhënës).

Përderisa mësimdhënësit, të cilët janë deklaruar se nuk e përdorin internetin, lidhur me mësimin e-learning janë shprehur kështu:

- *e-learning* është inovacion (6 mësimdhënës),
- *e-learning* nuk ofron lajm të veçantë (1 mësimdhënës),
- *e-learning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (0 mësimdhënës) dhe
- *e-learning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (7 mësimdhënës).

Në këtë pyetje (tabela 27), shihet se 6 mësimdhënës nuk janë deklaruar se kanë apo nuk kanë qasje në internet, por të njëjtit shprehen lidhur me e-mësimin, nëpërmjet pyetësorit:

- *e-learning* është inovacion (2 mësimdhënës),
- *e-elarning* nuk ofron lajm të veçantë (asnjë mësimdhënës),
- *e-elarning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (4 mësimdhënës) dhe
- *e-elarning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (asnjë mësimdhënës).

Lidhja e variablave “*e-learning*” dhe “*qasja në internet*” është paraqitur me anë të analizës “Chi-Square Tests”. Nga të dhënat e paraqitura në tabelën 28 vërejmë se vlera statistikore është 33,544<sup>a</sup> dhe shkalla e lirisë (df) është 6, ndërsa  $p=0,000 < 0,05$ . Kjo analizë shfaq një marrëdhënie statistikisht domethënëse ndërmjet variablave.

**Tabela 28.** Lidhja ndërmejt “*e-learning*” dhe “*qasja në internet*”

Chi-Square Tests			
	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	33,544 <sup>a</sup>	6	.000
Likelihood Ratio	27,067	6	.000
Linear-by-Linear Association	1,378	1	.240
N of Valid Cases	100		


a. 7 celula (58,3%) i kanë vlerat e pritura më të vogla se 5. Numri më i vogël i pritshëm është 0,60.

Burimi: Autori, 2016

Analizat po ashtu tregojnë se raporti i mundësisë (Likelihood Ratio) është 27,067. Gjithashtu analizojmë edhe  $p=0,000 < 0,05$ , ku përfundojmë se variablat “*e-learning*” dhe “*qasja në internet*” janë të varura. Testi statistikor tregon lidhje kuptimplota ndërmjet variablave, d.m.th. variablat janë të varura dhe lidhja ndërmjet tyre është e justifikueshme. Me anë të diagramit vijues paraqitet përqindja e qasjes në internet të mësimdhënësve. Siç vërehet nga diagrami 4,80% e mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim kanë qasje në

internet, 14% nuk kanë qasje në internet, derisa 6% e mësimdhënësve të intervistuar nuk kanë dhënë përgjigje lidhur me atë nëse kanë apo nuk kanë qasje në internet.

**Diagrami 5.** Qasja në internet



Burimi: Autori, 2016

#### ***Pl.6. Varshmëria e variablës “e-learning” nga variabla “përdorimi i e-mailit”***

Në këtë pyetje mësimdhënësit kanë pasur për detyrë të shprehen lidhur me kohëzgjatjen e përdorimit të postës elektronike, *email-it*. Ata kanë mund ta zgjedhin njëren nga tri opsionet e ofruara:

A (nuk e përdor fare),

B (rrallë e përdor, një herë në javë) ose

C (e përdor disa herë gjatë ditës).

Variabla e pavarur “përdorimi i e-mail-it” ndikon në variablen e varur “e-learning”. Për të paraqitur lidhshmërinë e tyre, nëpërmjet programit SPPSS Statistics versioni 22, shfaqet analiza *Crosstab*, si në tabelën 29.

**Tabela 29.** “e-learning” dhe “përdorimi i e-mail-it”

**Crosstab**

## Menaxhimi i institucioneve arsimore me mësimnxënie në distancë: e-learning

Count

		Sa e përdor e-mail-in			Total
		nuk e përdor	rrallë e përdor	e përdor disa herë brenda ditës	
e-learning	e-mësimi është inovacion	12	8	17	37
	Nuk ofron lajm të veçantë	6	13	12	31
	Lidhje të reja: mësues-nxënës	5	0	5	10
	qasje të reja	2	3	17	22
Total		25	24	51	100

Burimi: Autori, 2016

Nga tabela 29 shihet se 25 mësimdhënës janë deklaruar që nuk e përdorin postën elektronike, 24 mësimdhënës e kanë zgjedhur përgjigjen rrallë e përdor postën elektronike, ndërsa 51 mësimdhënës e përdorin disa herë brenda ditës postën elektronike. Po në këtë tabelë (29) është paraqitur analiza *Crosstab* për ta treguar lidhshmërinë ndërmjet variablave “*e-learning*” me “*e-mail*”.

Kështu konkludojmë se mësimdhënësit që nuk e përdorin postën elektronike kanë këto përgjigje rreth e-learning-ut:

- *e-learning* është inovacion (12 mësimdhënës),
- *e-learning* nuk ofron lajm të veçantë (6 mësimdhënës),
- *e-learning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (5 mësimdhënës) dhe
- *e-learning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (2 mësimdhënës).

Në këtë pyetje (tabela 29), shihet se nga 24 mësimdhënësit që rrallë e përdorin postën elektronike (mesatarisht një herë brenda javës) shprehen lidhur me e-mësimin, nëpërmjet pyetësorit:

- *e-learning* është inovacion (8 mësimdhënës),
- *e-learning* nuk ofron lajm të veçantë (13 mësimdhënës),

- *e-learning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (asnjë mësimdhënës) dhe
- *e-learning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (3 mësimdhënës).

Lidhja e variablave “*e-learning*” dhe “*e-mail*” është paraqitur me anë të analizës “Chi-Square Tests”. Nga të dhënat e paraqitura në tabelën 30 vërejmë se vlera statistikore është 17,650<sup>a</sup> dhe shkalla e lirisë (df) është 6, ndërsa  $p=0,007 < 0,05$ . Kjo analizë shfaq një marrëdhënie statistikisht domethënëse ndërmjet variablave “*e-learning*” dhe “*e-mail*”.

**Tabela 30.** Lidhja ndërmjet “*e-learning*” dhe “*e-mail*”

Chi-Square Tests			
	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	17,650 <sup>a</sup>	6	.007
Likelihood Ratio	19,273	6	.004
Linear-by-Linear Association	4,584	1	.032
N of Valid Cases	100		

a. 2 celula (16,7%) i kanë vlerat e pritura më të vogla se 5. Numri më i vogël i pritshëm është 2,40.

Burimi: Autori, 2016

Analizat po ashtu tregojnë se raporti i mundësisë (Likelihood Ratio) është 4,584. Gjithashtu analizojmë edhe  $p=0,032$ . Kjo vlerë e propabilitetit është më e vogël se 0,05, ku përfundojmë se variablat “*e-learning*” dhe “*e-maili*” janë të varura. Testi statistikor tregon lidhje kuptimplota ndërmjet variablave, d.m.th. variablat janë të varura dhe lidhja ndërmjet tyre është e justifikueshme.


Në diagramin 5 është paraqitur pjesëmarrja e mësimdhënësve në përgjigjen e pyetjes për përdorimin e postës elektronike. Nga ky grafikon shihet se:

- 25% e mësimdhënësve të intervistuar nuk e përdorin postën elektronike,



- 24% e mësimdhënësve të intervistuar rrallë e përdorin (mesatarisht një herë në javë) dhe
- 51% e mësimdhënësve të intervistuar e përdorin shumë shpesh (disa herë në javë).

**Diagrami 6.** Përdorimi i postës elektronike nga mësimdhënësit



Burimi: Autori, 2016

***P1.7. Komunikimi me nxënës nëpërmjet postës elektronike, variablat “e-learning” dhe “komunikimi”***

Komunikimi i mësimdhënësve nëpërmjet postës elektronike me nxënës është më se i domosdoshëm në mësimnxënien nga distanca nëpërmjet e-learning. Pa këtë komunikim nuk mund të ishte i plotfuqishëm realizimi i mësimimit elektronik. Kështu që për variabël të pavarur këtu është përcaktuar: “komunikimi”

Në këtë pyetje mësimdhënësit kanë qenë të kufizuar të japin përgjigje Po apo Jo:

- A) Po (komunikoj me nxënës me e-postë) 92 mësimdhënës,
- B) Jo (nuk komunikoj me nxënës me e-postë) 8 mësimdhënës.

**Tabela 31.** Komunikimi me nxënës nëpërmjet e-mail-it

**Crosstab**

Count		Kom_nx_e-mail		Total
		Po	Jo	
e-learning	e-mësimi është inovacion	30	7	37
	Nuk ofron lajm të veçantë	31	0	31
	Lidhje të reja: mësues-nxënës	9	1	10
	qasje të reja	22	0	22
Total		92	8	100

Burimi: Autori, 2016

Nga tabela 31 shihet se 92% e mësimdhënësve që e përdorin postën elektronike për të komunikuar me nxënës e kanë këtë qëndrim lidhur me mësimin elektronik, e-learning:

- *e-learning* është inovacion (30 mësimdhënës),
- *e-learning* nuk ofron lajm të veçantë (31 mësimdhënës),
- *e-learning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (9 mësimdhënës) dhe
- *e-learning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (22 mësimdhënës).

Ndërsa 8% e mësimdhënësve që nuk e përdorin postën elektronike për të komunikuar me nxënës kanë këtë qëndrim lidhur me mësimin elektronik, e-learning:

- *e-learning* është inovacion (7 mësimdhënës),
- *e-learning* nuk ofron lajm të veçantë (asnjë mësimdhënës),
- *e-learning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (1 mësimdhënës) dhe
- *e-learning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (asnjë mësimdhënës).

Pra, këtu shihet qartë se mësimdhënësit që nuk komunikojnë me nxënës nëpërmjet postës elektronike nuk e vlerësojnë shumë e-mësimin. Është karakteristikë që në dy opsionet: e-mësimi nuk ofron lajm të veçantë dhe e-mësimi krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie, asnjë mësimdhënësi nuk e vlerësojnë si të dobishëm mësimin në distancë.

Në tabelën 32 është paraqitur lidhja e variablave “*e-learning*” dhe “*komunikimi*” nëpërmjet analizës “Chi-Square Tests”. Nga të dhënat e paraqitura vërejmë se vlera statistikore është 10,657<sup>a</sup> dhe shkalla e lirisë (df) është 3, ndërsa  $p=0,014 < 0,05$ . Kjo analizë shfaq një marrëdhënie statistikisht domethënëse ndërmjet variablave “*e-learning*” dhe “*komunikimi*”.

**Tabela 32.** Lidhja ndërmjet “*e-learning*” dhe “*komunikimi*”

Chi-Square Tests			
	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	10,657 <sup>a</sup>	3	.014
Likelihood Ratio	13,359	3	.004
Linear-by-Linear Association	5,515	1	.019
N of Valid Cases	100		

a. 4 celula (50,0%) i kanë vlerat e pritura më të vogla se 5. Numri më i vogël i pritshëm është 0,80.

Burimi: Autori, 2016

Analizat po ashtu tregojnë (tabela 33) se raporti i mundësisë (Likelihood Ratio) është 13,359. Gjithashtu analizojmë edhe  $p=0,004$ . Kjo vlerë e probabilitetit është më e vogël se 0,05, ku përfundojmë se variablat “*e-learning*” dhe “*komunikimi*” janë të varura. Testi statistikor tregon lidhje kuptimplota ndërmjet variablave, d.m.th. variablat janë të varura dhe lidhja në mes tyre është e justifikueshme.

**Tabela 33.** “Chi Square” për “e-learning” dhe “komunikimi”


Chi-Square Tests			
	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	10,657 <sup>a</sup>	3	.014
Likelihood Ratio	13,359	3	.004
Linear-by-Linear Association	5,515	1	.019
N of Valid Cases	100		

a. 4 celula (50,0%) i kanë vlerat e pritura më të vogla se 5. Numri më i vogël i pritshëm është 0,80.

Burimi: Autori, 2016

Në diagramin (5) në mënyrë grafike paraqitet përqindja e mësimdhënësve që komunikojnë me nxënës. Siç lexohet, 92% e mësimdhënësve komunikojnë me nxënës, ndërsa 8% nuk e praktikojnë komunikimi me nxënës nëpërmjet postës elektronike.

**Diag. 7.** Komunikimi me nxënës nëpërmjet e-mail-it



Burimi: Autori, 2016

Njëri nga faktorët që ndikojnë në rritjen e efikasitetit të mësimnxënies elektronike, e-learning, është komunikimi me nxënës nëpërmjet postës elektronike.

***P1.8. A e përdorni internetin për ngritje profesionale?***

Për të arritur në përfundimin se sa ndikon ngritja profesionale si variabël e pavarur në e-learning (variabël e varur), mësimdhënësit nëpërmjet pyetësorëve janë pyetur: A e

përdorni internetin për ngritje profesionale? Përgjigjet e tyre janë dhënë në tabelën (34),

si në vijim:

**Tabela 34.** Lidhja ndërmjet “e-learnig” dhe “ngritje\_internet”

**Crosstab**

Count

		ngritje_internet			Total
		Po	Jo	Nuk ka përgjigje	
e_learning	e-mësimi është inovacion	22	6	9	37
	Nuk ofron lajm të veçantë	25	1	5	31
	Lidhje të reja: mësues-nxënës	4	0	6	10
	qasje të reja	7	7	8	22
Total		58	14	28	100

Burimi: Autori, 2016

Nga tabela 34 lexojmë se 58 mësimdhënës që janë deklaruar se e përdorin internetin për ngritje profesionale e kanë këtë opinion karshi mëimit e-learning:

- *e-learning* është inovacion (22 mësimdhënës);
- *e-elarning* nuk ofron lajm të veçantë (25 mësimdhënës);
- *e-elarning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (4 mësimdhënës) dhe
- *e-elarning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (7 mësimdhënës).

Ndërsa 14% e mësimdhënësve (tabela 34) që nuk e përdorin internetin për ngritje profesionale kanë këtë qëndrim lidhur me mësimin elektronik, e-learning:

- *e-learning* është inovacion (6 mësimdhënës);
- *e-elarning* nuk ofron lajm të veçantë (1 mësimdhënës);
- *e-elarning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (asnjë mësimdhënës) dhe

- *e-learning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (7 mësimdhënës).

Në këtë pyetje (tabela 34) është një numër prej 28 mësimdhënësve, të cilët nuk kanë dhënë përgjigje lidhur me përdorimin e internetit sa i përket ngritjes profesionale. Mirëpo, ata e kanë dhënë mendimin e tyre lidhur me e-learning:

- *e-learning* është inovacion (9 mësimdhënës),
- *e-learning* nuk ofron lajm të veçantë (5 mësimdhënës),
- *e-learning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (6 mësimdhënës) dhe
- *e-learning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (8 mësimdhënës).

Në tabelën (35) është paraqitur lidhja e variablave “*e-learning*” dhe “*ngritja\_internet*” me anë të analizës “Chi-Square Tests”. Nga të dhënat e paraqitura vërejmë se vlera statistikore është 20,948<sup>a</sup> dhe shkalla e lirisë (df) është 6, ndërsa  $p=0,002 < 0,05$ . Kjo analizë shfaq një marrëdhënie statistikisht domethënëse ndërmjet variablave “*e-learning*” dhe “*ngritja\_internet*”.

**Tabela 35.** Lidhja ndërmjet “*e-learning*” dhe “*ngritja\_internet*”

Chi-Square Tests			
	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	20,948 <sup>a</sup>	6	.002
Likelihood Ratio	21,796	6	.001
Linear-by-Linear Association	4,753	1	.029
N of Valid Cases	100		

a. 4 qeliza (33,3%) i kanë vlerat e pritura më të vogla se 5. Numri më l vogël i pritshëm është 1,40.

Burimi: Autori, 2016


Analizat po ashtu tregojnë (tabela 35) se raporti i mundësisë (Likelihood Ratio) është 21,796. Gjithashtu analizojmë edhe  $p=0,001$ . Meqë kjo vlerë e propabilitetit është më e

vogël se 0,05, përfundojmë se variablat “*e-learning*” dhe “*ngritja\_internet*” janë të varura. Testi statistikor tregon lidhje kuptimplota ndërmjet variablave, d.m.th. variablat janë të varura dhe lidhja ndërmjet tyre është sinjifikante.

Në diagramin 6 është paraqitur forma grafike nëse mësimdhënësit e përdorin internetin për ngritje profesionale. Nga ky grafikon vërejmë se:

- 58 mësimdhënës ose 58%, nga 100 të intervistuar e përdorin internetin për ngritje profesionale;
- 14 mësimdhënës ose 14%, gjithashtu nga 100 mësimdhënësit e intervistuar, deklarohen se nuk e përdorin internetin për ngritje profesionale dhe
- 28 mësimdhënës ose 28% të mësimdhënësve nuk kanë dhënë përgjigje nëse e përdorin apo jo internetin për ngritje profesionale.

**Diag. 8.** Përdorimi i internetit për ngritje profesionale



Burimi: Autori, 2016

### ***P1.9. Lidhja e variablës “e-learning” me “platforma online”***

Mësimi elektronik, përkatësisht e-mësimi (e-learning) i zgjedhur për këtë hulumtim, varet nga variabla “*platforma online*”. Mësimdhënësve u është drejtuar pyetja: *A keni përdorur ndonjë platformë online për mësim deri tani?* Në këtë pyetje (tabela 36) kanë qenë të

kufizuar që të përgjigjen vetëm me Po ose Jo. Nga përgjigjja në këtë pyetje ka pasur vazhdim algoritmik, në pyetjen e radhës. Pra, nëse mësimdhënësi është përgjigjur me Po, atëherë kalohet në pyetjen 10, përndryshe (me Jo), kalohet në pyetjen 11.

Përgjigjet të cilat kthehen nga pyetësorët (tabela 36) drejtuar mësimdhënësve, janë kështu:

- Nga 100 mësimdhënësit e intervistuar, 35 janë përgjigjur Po. Kjo do të thotë se ata kanë pohuar se e kanë përdorur ndonjë platformë online për mësim elektronik e-learning dhe
- 65 mësimdhënës kanë mohuar të kenë përdorur ndonjë platformë online për mësim elektronik, e-learning.

**Tabela 36.** Lidhmëria e “platformës online” dhe “e-learning”

**Crosstab**

Count

		platfomra_online		Total
		Po	Jo	
e_learning	e-mësimi është inovacion	10	27	37
	Nuk ofron lajm të veçantë	9	22	31
	Lidhje të reja: mësues-nxënës	1	9	10
	qasje të reja	15	7	22
Total		35	65	100

Burimi: Autori, 2016

Siç shihet nga tabela 36, 35 mësimdhënësit të cilët kanë dhënë përgjigje Po (kanë përdorur platformë online për mësim elektronik kanë këtë qëndrim lidhur me e-learning):

- *e-learning* është inovacion (10 mësimdhënës),
- *e-learning* nuk ofron lajm të veçantë (9 mësimdhënës),
- *e-learning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (1 mësimdhënës) dhe
- *e-learning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (15 mësimdhënës).



Ndërsa 65 mësimdhënësit (tabela 36), të cilët janë deklaruar me Jo (nuk kanë përdorur asnjë platformë online për mësim elektronik në distancë, e-learning, sa i përket kësaj platforme (e-learning) që studiohet në këtë hulumtim mbajnë këtë qëndrim:

- *e-learning* është inovacion (27 mësimdhënës),
- *e-learning* nuk ofron lajm të veçantë (22 mësimdhënës),
- *e-learning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (9 mësimdhënës) dhe
- *e-learning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (7 mësimdhënës).

Në tabelën 37 është paraqitur lidhja e variablave “*e-learning*” dhe “*platforma online*” nëpërmjet analizës “Chi-Square Tests”. Nga të dhënat e paraqitura vërejmë se vlera statistikore është 14,914<sup>a</sup> dhe shkalla e lirisë (df) është 3, ndërsa  $p=0,002 < 0,05$ . Kjo analizë shfaq një marrëdhënie statistikisht domethënëse ndërmjet variablave “*e-learning*” dhe “*platforma online*”.

**Tabela 37.** Lidhja ndërmjet “*e-learning*” dhe “*platforma online*”  
Chi-Square Tests

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	14,914 <sup>a</sup>	3	.002
Likelihood Ratio	14,934	3	.002
Linear-by-Linear Association	7,461	1	.006
N of Valid Cases	100		

a. 1 celulë (12,5%) e ka vlerën e pritur më të vogël se 5. Numri më i vogël i pritshëm është 3,50.


Burimi: Autori, 2016

Analizat po ashtu tregojnë se raporti i mundësisë (Likelihood Ratio) është 14,934 (tabela 37). Gjithashtu analizojmë edhe  $p=0,002$ . Meqë kjo vlerë e propabilitetit është më e vogël se 0,05, përfundojmë se variablat “*e-learning*” dhe “*platforma online*” janë të varura.

Testi statistikor tregon lidhje kuptimplota ndërmjet variablave, d.m.th. variablat janë të varura dhe lidhja ndërmjet tyre është e justifikueshme.

Me anë të diagramit 7 është paraqitur përqindja e përdorimit dhe jopërdorimit të platformës online. Në bazë të këtij diagrami përfundojmë se 35% e mësimdhënësve të intervistuar pohojnë se e kanë përdorur platformën online për të mësuar, ndërsa 65% të mësimdhënësve deklarohen se nuk kanë përdorur asnjë platformë online për të mësuar nga distanca nëpërmjet platformës elektronike për mësimnxënie apo mësimdhënie, të njohur si e-learning.

**Diag. 9.** Platforma online



Burimi: Autori, 2016

#### ***P1.10. Vlerësimi i platformës online nga 1 deri në 5***

Pyetja e dhjetë ndërlidhet me përgjigjen që jepet në pyetjen e nëntë. Pra, nëse mësimdhënësi është deklaruar me Po (ka përdorur ndonjë platformë online për mësim), atëherë në pyetjen e dhjetë pati mundësinë të deklarohet se si e vlerëson në një shkallë nga 1 (përdorim i vogël) deri në 5 (përdorim i lartë).

Siç paraqitet në tabelën 38, shihet se 35 mësimdhënës janë deklaruar me përgjigjen Po (kanë përdorur platformë online për mësim) dhe në tabelën 36 shihet se:

- Përdorim me vlerë 1 (nivel i ulët i vlerësimit) kanë dhënë 7 mësimdhënës apo 20%,
- Përdorim me vlerë 2 (nivel i mjaftueshëm) kanë dhënë 6 mësimdhënës apo 17,14%,
- Përdorim me vlerë 3 (nivel i mirë) kanë dhënë 14 mësimdhënës apo 40%,
- Përdorim me vlerë 4 (nivel shumë i mirë) ka dhënë 1 mësimdhënës apo 2,86% dhe
- Përdorim me vlerë 5 (nivel i shkëlqyeshëm) kanë dhënë 7 mësimdhënës apo 20%.

**Tabela 38.** Vlerësimi (1-5) për përdorimin e platformës online

	Si e vlerësoni përdorimin e platformës?					Gjithsej
Vlerësimi	1 (ulët)	2 (mjaft.)	3 (mirë)	4 (sh. mirë)	5 (shkëlq.)	
Mësimdh.	7	6	14	1	7	35
%	20,00	17,14	40,00	2,86	20,00	100

Burimi: Autori, 2016

Në tabelën 39 me anë të programit SPSS Statistics versioni 22 është paraqitur kryqëzimi ndërmjet variablave “*e-learning*” dhe “*platforma online*”. Nga kjo tabelë konkludojmë se 35 mësimdhënësit që e zgjodhën përgjigjen Po në pyetjen se: *A keni përdorur ndonjë platformë online për mësim deri tani?*, vlerësimin me notë nga 1 deri në 5 e kanë bërë kështu:

- Vlerësimi: (1) ulët, 7 mësimdhënës,
- Vlerësimi: (2) mjaft., 6 mësimdhënës,
- Vlerësimi: (3) mirë, 14 mësimdhënës,
- Vlerësimi: (4) sh. mirë, 1 mësimdhënës dhe
- Vlerësimi: (5) shkëlqyeshëm, 7 mësimdhënës.

**Tabela 39.** Vlerësimi i platformës nga 1 (nivel i ulët i vlerësimit) deri në 5 (nivel i lartë i vlerësimit)

**Crosstab**

Count

		vleresimi_1deri5					Total
		ulët	Mjaft.	mirë	sh. mirë	Shkëlqe.	
e_learning	e-mesimi eshte inovacion	4	3	2	0	0	9
	Nuk ofron lajm të veçantë	1	1	8	0	2	12
	Lidhje të reja: mësues-nxënës	0	2	0	0	3	5
	qasje të reja	2	0	4	1	2	9
Total		7	6	14	1	7	35

Burimi: Autori, 2016

Po ashtu nga tabela 39 paraqiten përgjigjet e 7 mësimdhënësve që vlerësimin për platformën online e japin me notë më të ulët 1 (një), kanë këtë opinion lidhur me e-learning:

- *e-learning* është inovacion (4 mësimdhënës),
- *e-elarning* nuk ofron lajm të veçantë (1 mësimdhënës),
- *e-elarning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (asnjë mësimdhënës) dhe
- *e-elarning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (2 mësimdhënës).

Po nga tabela 39 paraqiten përgjigjet e 7 mësimdhënësve, të cilët platformën online e kanë vlerësuar me notën më të lartë në pyetësor 5 (pesë), lidhur me e-learning shprehen:

- *e-learning* është inovacion (asnjë mësimdhënës);
- *e-elarning* nuk ofron lajm të veçantë (2 mësimdhënës);
- *e-elarning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (3 mësimdhënës) dhe

- *e-learning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (2 mësimdhënës).

Në tabelën 40 është paraqitur lidhja e variablave “*e-learning*” dhe “*vlerësimi*” nëpërmjet analizës “Chi-Square Tests”. Nga të dhënat e paraqitura vërejmë se vlera statistikore është 23,181<sup>a</sup> dhe shkalla e lirisë (df) është 12, ndërsa  $p=0,026 < 0,05$ . Kjo analizë shfaq një marrëdhënie statistikisht domethënëse ndërmjet variablave “*e-learning*” dhe “*vlerësimi*”.

**Tabela 40.** Lidhja ndërmjet “*e-learning*” dhe “*vlerësimi*”

Chi-Square Tests			
	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	23,181 <sup>a</sup>	12	.026
Likelihood Ratio	26,660	12	.009
Linear-by-Linear Association	4,438	1	.035
N of Valid Cases	35		

a. 20 celula (100,0%) i kanë vlerat e pritura më të vogla se 5. Numri më i vogël i pritshëm është 0,14.  
Burimi: Autori, 2016


Analizat po ashtu tregojnë se raporti i mundësisë (Likelihood Ratio) është 26,660. Gjithashtu analizojmë edhe  $p=0.009$ . Meqë kjo vlerë e propabilitetit është më e vogël se 0,05, përfundojmë se variablat “*e-learning*” dhe “*vlerësimi*” janë të varura. Testi statistikor tregon lidhje kuptimplota ndërmjet variablave, d.m.th. variablat janë të varura dhe lidhja ndërmjet tyre është sinjifikante.

Në diagramin 8 paraqitet vlerësimi i platformës online që e japin 35 mësimdhënësit që janë përgjigjur me Po në pyetjen: A keni përdorur ndonjë platformë online për mësim elektronik nga distanca, e-learning?. Diagrami shpreh vlerat në përqindje, si në vijim:

- Vlerësimi: (1) ulët, 7 mësimdhënës, përkatësisht 20,00%,

- Vlerësimi: (2) mjaft., – 6 mësimdhënës, përkatësisht 17,14%,
- Vlerësimi: (3) mirë, 14 mësimdhënës, përkatësisht 40,00%,
- Vlerësimi: (4) sh. mirë, 1 mësimdhënës, përkatësisht 2,86% dhe
- Vlerësimi: (5) shkëlq., 7 mësimdhënës, përkatësisht 20,00%.

Diagrami 10. Vlerësimi i platformës online nga 1 deri 5



Burimi: Autori, 2016

Nga pyetja 11 deri në pyetje 15, mësimdhënësi ka pasur 5 (pesë) alternativa prej të cilave ka mundur të zgjedhë një apo asnjë alternativë. Ato pyetje dukeshin si në tabelën vijuese:

**Tabela 41.** Përmbajtja e pyetjeve 11, 12, 13 ,14 dhe 15

Rretho shkronjën nën opsionin e dhënë	Aspak nuk pajtohem	Nuk pajtohem	Jam i pavendosur	Pajtohem	Plotësisht pajtohem
11. Konsideroj se jam mjaft i udhëzuar për mësim në distancë, e-learning.	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	<b>D</b>	<b>E</b>
12. Në të ardhmen interneti do t'i zëvendësojë librat.	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	<b>D</b>	<b>E</b>
13. Në të ardhmen e-mësimi & m-mësimi do të përdoret si kombinim i teknologjisë me metodat tradicionale të të nxënës -mësimi i kombinuar (blended learning).	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	<b>D</b>	<b>E</b>
14. Në të ardhmen e-mësimi & m-mësimi, plotësisht do të zëvendësojnë mësimin tradicional me klasë virtuale dhe teknika tjera.	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	<b>D</b>	<b>E</b>
15. Pengesa më e madhe për përdorimin e e-mësimi & m-mësimi është njohja e teknikave.	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	<b>D</b>	<b>E</b>

Burimi: Autori, 2016

Përgjigjet ishin, si në vijim:

**Pyetja 11.** *Konsideroj se jam mjaft i udhëzuar për mësim në distancë, e-learning.*


- A) Aspak nuk pajtohem, 8 mësimdhënës apo 8,70%,
- B) Nuk pajtohem, 10 mësimdhënës apo 10,87%,
- C) Jam i pavendosur, 24 mësimdhënës apo 26,09%,
- D) Pajtohem, 30 mësimdhënës apo 32,61%,
- E) Plotësisht pajtohem, 20 mësimdhënës apo 21,74%.

**Tabela 42.** Vetëvlerësimi për mësimin në distancë

A	B	C	D	E
8	10	24	30	20
8,70%	10,87%	26,09%	32,61%	21,74%

Burimi: Autori, 2016

**Diagrami 11.** Vetëvlerësimi për mësimin në distancë



Burimi: Autori, 2016

Në këtë pyetje janë 92 përgjigje, nga 100 mësimdhënës sa e kanë plotësuar pyetësin.

Kjo tregon se 8 mësimdhënës nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje.

**Pyetja 12.** Në të ardhmen interneti do t'i zëvendësojë librat.

- A) Aspak nuk pajtohem, 5 mësimdhënës apo 5,49%,
- B) Nuk pajtohem, 30 mësimdhënës apo 32,97%,
- C) Jam i pavendosur, 6 mësimdhënës apo 6,59%,
- D) Pajtohem, 40 mësimdhënës apo 43,96%,
- E) Plotësisht pajtohem, 10 mësimdhënës apo 10,99%.




**Tabela 43.** Interneti dhe libri

A	B	C	D	E
5	30	6	40	10
5,49	32,97	6,59	43,96	10,99

Burimi: Autori, 2016

**Diag. 12.** Interneti do t'i zëvendësojë librat



Burimi: Autori, 2016

Në këtë pyetje janë 91 përgjigje, nga 100 mësimdhënës sa e kanë plotësuar pyetësin.

Kjo tregon se 9 mësimdhënës nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje.

**Pyetja 13.** *Në të ardhmen e-mësimi & m-mësimi do të përdoret si kombinim i teknologjisë me metodat tradicionale të të nxëniet - mësim i kombinuar (blended learning).*


- A) Aspak nuk pajtohem, 5 mësimdhënës apo 5,56%,
- B) Nuk pajtohem, 10 mësimdhënës apo 11,11 %,
- C) Jam i pavendosur, 10 mësimdhënës apo 11,11%,
- D) Pajtohem, 50 mësimdhënës apo 55,56%,
- E) Plotësisht pajtohem, 15 mësimdhënës apo 16,67%.

**Tabela 44.** Përdorimi në të ardhmen i *e-mësim*it dhe *m-mësim*it

A	B	C	D	E
5	10	10	50	15
5,56 %	11,11 %	11,11%	55,56 %	16,67 %

Burimi: Autori, 2016

**Diag.13.** Përdorimi në të ardhmen i *e-mësim*it dhe *m-mësim*it



Burimi: Autori, 2016

Në këtë pyetje janë 90 përgjigje, nga 100 mësimdhënës sa e kanë plotësuar pyetësin. Kjo tregon se 10 mësimdhënës nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje, përkatësisht 10%.

**Pyetja 14.** Në të ardhmen *e-mësim*i & *m-mësim*i do ta zëvendësojë plotësisht mësimin tradicional me klasë virtuale dhe teknika tjera.

- A) Aspak nuk pajtohem, 5 mësimdhënës apo 5,26%,
- B) Nuk pajtohem, 10 mësimdhënës apo 11,05 %,
- C) Jam i pavendosur, 10 mësimdhënës apo 10,53 %,
- D) Pajtohem, 45 mësimdhënës apo 47,37 %,
  - E) Plotësisht pajtohem, 15 mësimdhënës apo 16,67 %


E) Plotësisht pajtohem, 15 mësimdhënës apo 15,79 %.

**Tabela 45.** Përdorimi në të ardhmen i e-mësimit dhe m-mësimit

A	B	C	D	E
5	20	10	45	15
5,26 %	21,05 %	10,53 %	47,37 %	15,79 %

Burimi: Autori, 2016

**Diag.14.** e-mësimi dhe m-mësimi do të zëvendësojnë mësimin tradicional



Burimi: Autori, 2016

Në këtë pyetje janë 95 përgjigje, nga 100 mësimdhënës sa e kanë plotësuar pyetësin.

Kjo tregon se 5 mësimdhënës nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje apo 5%.

**Pyetja 15.** Pengesa më e madhe për përdorimin e e-mësimit & m-mësimit është njohja e teknikave.

A) Aspak nuk pajtohem, 5 mësimdhënës apo 5,15%,

B) Nuk pajtohem, 10 mësimdhënës apo 10,31%,

C) Jam i pavendosur, 12 mësimdhënës apo 12,37%,

D) Pajtohem, 55 mësimdhënës apo 56,70%,


E) Plotësisht pajtohem, 15 mësimdhënës apo 15,46%.

**Tabela 46.** Njohja e teknikave

A	B	C	D	E
5	10	12	55	15
5,15 %	10,31 %	12,37 %	56,70 %	15,46 %

Burimi: Autori, 2016

**Diag. 15.** Njohja e teknikave



Burimi: Autori, 2016

Në këtë pyetje janë 97 përgjigje, nga 100 mësimdhënës sa e kanë plotësuar pyetësin.

Kjo tregon se 3 mësimdhënës nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje apo 3%.

*Pyetja 16. Cilat mjete teknologjike i përdorni për aftësim të mësimin në distancë?*

Në këtë pyetje mësimdhënësit kanë mundur të zgjedhin më shumë se një përgjigje apo edhe të mos e zgjedhin asnjë opsion të ofruar. Kështu që numri i përgjigjeve nuk do të thotë se përkon me numrin e pyetësorëve.

A) CD-ROM, DVD-ROM, Flash - e kanë zgjedhur gjithsej 25 mësimdhënës;

- B) Blog, wiki ose sistem burim tjetër të hapur - e kanë zgjedhur gjithsej 15 mësimdhënës;
- C) Forum, chat, fb rrjet tjetër social ose të ngjashme - e kanë zgjedhur gjithsej 30 mësimdhënës;
- D) Programe për krijimin e ueb-faqeve - e kanë zgjedhur gjithsej 15 mësimdhënës;
- E) Sistem video konferencash - e kanë zgjedhur gjithsej 12 mësimdhënës.

Në bazë të dhënave të paraqitura në tabelën 17 shihet se janë gjithsej 97 përgjigje. Kjo nuk nënkupton se vetëm 3 (tre) mësimdhënës nuk kanë dhënë përgjigje, ngase, siç e cekëm më lart, një intervistues ka mundur t'i japë disa përgjigje, e të tjerët kanë mundur të mos japin fare përgjigje.


**Tabela 47.** Mjetet teknologjike që përdoren për e-mësim

A	B	C	D	E
25	15	30	15	12
25,77 %	15,46 %	30,93 %	15,46 %	12,37 %

Burimi: Autori, 2016

Në diagramin 14 është paraqitur përmbajtja e tabelës 45.

**Diag.16.** Mjetet teknologjike që përdoren për e-mësim



Burimi: Autori, 2016

Në pyetjen 17 të pyetësorit P1: ***Çfarë konsideroni të jetë lajmi më i madh i e-mësimit karshi mënyrave tradicionale të të mësuarit?***, patën opsionet e dhëna për zgjedhje:

- *Nuk ofron lajm të veçantë,*
- *Mundëson zhvillimin e modeleve pedagogjike inovative,*
- *Krijon lidhje të reja komunikimi ndërmjet nxënësve dhe mësimitdhënës-nxënës,*
- *Jep qasje të reja të objekteve dhe njohurive të arsimit formal.*

Në këtë pyetje janë përgjigjur të gjithë mësimitdhënësit që kanë pranuar të jenë pjesëmarrës të këtij hulumtimi. Nga tabela 48 nxjerrim këto rezultate:

- 37 mësimitdhënës konsiderojnë se e-mësimi nuk ofron lajm të veçantë,
- 31 mësimitdhënës thonë se e-mësimi mundëson zhvillimin e modeleve pedagogjike inovative,
- 10 mësimitdhënës konstatuan gjatë hulumtimit se e-mësimi krijon lidhje të reja komunikimi ndërmjet nxënësve dhe mësimitdhënës- nxënës dhe

- 22 mësimdhënës konstatuan se e-mësimi jep n qasje të reja të objekteve dhe njohurive të arsimit formal.

**Tabela 48.** Pjesëmarrja dhe përgjigjet e mësimdhënësve lidhur me e-learning

		e_learning			
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	e-mësimi është inovacion	37	37,0	37,0	37,0
	Nuk ofron lajm të veçantë	31	31,0	31,0	68,0
	Lidhje të reja: mësuës-nxënës	10	10,0	10,0	78,0
	qasje të reja	22	22,0	22,0	100,0
	Total	100	100,0	100,0	

Burimi: Autori, 2016

Të gjitha këto të dhëna janë llogaritur nëpërmjet programit SPSS Statistics versioni 22.

**Tabela 49.** Statistika e variablës: e-learning

Statistics		
e_learning		
N	Valid	100
	Missing	0
Median		2,00
Mode		1
Std. Deviation		1,155
Variance		1,334

Burimi: Autori, 2016

Nga tabela 49 shihet se numri i pyetësorëve të vlefshëm (valid) ishte 100 dhe asnjë pyetësor nuk u gjet i dështuar (Missing). Mediana ishte 2,00, ndërsa Mode doli të ketë vlerën 2. Devijimi standard ka vlerën 1,155 dhe Varianca 1,334.

Nga pyetja 18 nxjerrim këto përfundime:

- Nuk kam njohuri të veçanta rreth kësaj platforme, por kisha pasur dëshirë që pak a shumë të jemi të informuar rreth kësaj platforme mësimore,

- Nuk kam pasur përvojë për këtë lloj mësimi deri më tani, mirëpo konsideroj se avancimi i teknikave do të jetë mjaft i dobishëm për realizimin e mësimin,
- Po, kam përvojë nga studimet master dhe gjithashtu pjesëmarrja edhe në ndonjë konferencë ku mundësohet online qasja/prania. Nga kjo e kam kursyer kohën, mjetet financiare dhe njohuritë e marra kanë qenë të përafërta me ato të drejtpërdrejta. Dhe mendoj që është mjaft praktike kur me një “klik” arrin të kesh qasje në organizime të ndryshme në të gjitha vendet e botës,
- Gjithashtu gjatë procesit mësimor ndonjëherë i kam angazhuar nxënësit edhe nëpërmjet postës elektronike dhe kam kërkuar të kërkojnë të dhëna të ndryshme lidhur me temat e zhvilluara dhe kjo ka qenë mjaft interesante dhe e re për nxënësit, kur e kanë kuptuar që komunikimi elektronik nuk përdoret vetëm për komunikim të thjeshtë dhe lojëra, por që vetë interneti është një burim i pashtershëm i njohurive të reja.
  - Ka afro tre vjet që jam i inkuadruar në platformën online almooc.com. Është një eksperiencë e jashtëzakonshme kjo mënyrë e re e qasjes shkencore të lëndës të cilën e ligjëroj, komunikimi interaktiv me studentët e regjistruar në këtë platformë dhe mënyra krejtësisht inovative e punës,
  - Ky koncept i ri është provuar të funksionojë si metodë e re e arsimimit të të rinjve dhe që padyshim ka sjellë risi në arsimim,
  - Po, kam përvojë 3-vjeçare në realizimin dhe shpërndarjen e videove në You Tube, si dhe një vit përvojë në [www.almooc.com](http://www.almooc.com),
  - Realizimi i mësimin në distancë mund të bëhet kur ta arrijmë një standard më të lartë. Tani për tani nuk mund ta realizojmë këtë platformë,
  - Në të ardhmen ndoshta mund të realizohet kjo metodë,
  - Kam pak njohuri, më tepër po dëgjoj se po aplikohet në vendet e zhvilluara,



- Unë nuk kam përvojë për këtë platformë, mirëpo një shok imi ka mbaruar master për IT në Universitetin e Zarës të Kroacisë, ku disa provime i ka përfunduar nga Prishtina. Është e nevojshme të fillojë edhe te ne.
- Nuk kam përvojë të tillë. S' di ç'të them. Ndoshta ia vlen.
- Këto metoda mund të jenë sfidë negative për nxënësit (studentët). Mësimi tradicional është i pazëvendësueshëm,
- Nuk kam përvojë në realizimin e mësimin në distancë. Kjo është teknikë e re dhe ende nuk përdoret te ne,
- Kam pasur rast ta ndjek një ligjëratë të gjuhës angleze nëpërmjet Skype. Është realizuar pa pengesë. Eksperiencë e mirë. Uroj të aplikohet edhe te ne,
- Kam përvojë dhe jam munduar ta realizoj me studentët e mi. Nuk ka treguar sukses. Kjo po më bën që të rifilloj. Sistemi arsimor duhet të pësojë ndryshime. Ende jemi larg,
- Mua më mungojnë njohuritë për këtë platformë. Do të ishte interesant të aftësohemi. Por nevojitet buxhet, kohë, mund dhe sakrificë,
- Gjatë studimeve kemi ndjekur disa video-konferenca. Përvojë e mirë. Kam menduar që të kemi edhe ne diçka të tillë.

#### **5.6. Sa janë të përgatitur nxënësit të mësojnë nga distanca?**

Hulumtimi shkencor për të mësuarit nga distanca fokusohet në gjetjet se sa janë të përgatitur nxënësit të mësojnë nga distanca. Se si e shohin ata këtë mënyrë dhe sa do t'u sjellë rezultate në këtë lloj të mësuarit. Edhe në këtë pyetësor variabël e varur është e-

learning. Variabël të pavarur janë: *përdorimi i PC, qasja në internet\_nx, posta elektronike\_nx, komunikimi e-mail\_nx, mësimi në distancë\_nx, platforma online\_nx dhe vlerësimi*. Pyetja e parë e pyetësorit P2 kishte për qëllim ta kuptojmë prej nga janë nxënësit që përfshihen në intervistë. Ky faktor nuk ndikon në mësimin elektronik. Për këtë vendbanimi nuk është marrë si variabël, prej së cilës do të varej e-learning. Konkluzioni për këtë është se interneti në komunën e Prishtinës është i shpërndarë gjithandej nëpërmjet kablllove apo edhe nëpërmjet antenave në formë të valëve, që njihet si wi-fi. Megjithatë nga vendbanimi mësohet se sa nxënës që jetojnë në fshat kanë mendim se e-learning sjell apo jo inovacion, krijon lidhje të reja komunikimi ndërmjet mësimdhënësve, jep qasje të reja etj.

Mësimi elektronik në distancë *e-learning*, si variabël e varur nuk varet nga mosha, përkatësisht klasa (mosha) e mësimdhënësve. Atë mund ta aplikojnë nxënësit e klasës IX, por edhe ata të klasës X, e kështu me radhë. Por, kryqëzimi i tabelave e-learning në një rën anë dhe tabelave - vendbanimi si dhe klasa, do të ndihmojnë në konkluzionet se si janë opinionet e tyre për mësimin elektronik, e-mësimi (e-learning).

Analizat janë bërë nëpërmjet programit SPSS Statistics versioni 22.

### ***P2.1. Vendbanimi i nxënësve***

Për ta kuptuar se sa janë të interesuar nxënësit të mësojnë nga distanca nëpërmjet platformës e-learning sjellim rezultatet e hulumtimit.

Janë intervistuar 200 nxënës nëpërmjet pyetësorit, i cili i pati gjithsej 18 pyetje.

Pyetja e parë do ta identifikojë vendbanimin e nxënësit.

Nga tabela 50, e cila rrjedh nga programi SPSS, paraqitet statistika e nxënësve që kanë marrë pjesë në hulumtimin për mësimin në distancë nëpërmjet e-learning, nëpërmjet

pyetësorit P2. Sipas kësaj tabele konkludojmë se 200 nxënës e kanë plotësuar pyetësorin. Programi për statistika nuk e ka identifikuar asnjë pyetësor jovalid (të pavlefshëm). Në këtë janë përjashtuar 14 pyetësorët, të cilët para se të futen në program janë identifikuar si të pavlefshëm, tabela 8 në Kapitullin: *Metodologjia*.

**Tabela 50.** Vendbanimi i nxënësve

Statistics		
vendbanimi		
N	Valid	200
	Missing	0

Burimi: Autori, 2016

Në bazë të analizës që është paraqitur në tabelën 51 me pyetësorin P2 rezulton se: 167 nxënësit e intervistuar apo 83,50% jetojnë në Prishtinë, 6% e tyre përkatësisht 12 nxënës jetojnë afër Prishtinës, përdherisa në fshat janë deklaruar se jetojnë 17 nxënës, nga 200 të përfshirë dhe 4 nxënës apo 2,00% jetojnë jashtë Prishtinës.


**Tabela 51.** Shpërndarja e nxënësve dhe përqindja

Prishtinë	Afër Prishtinës	Në fshat (komuna Prishtinë)	Jashtë Prishtinës
167	12	17	4
83,50 %	6,00 %	8,50 %	2,00 %

Burimi: Autori, 2016

Në diagramin 15 është paraqitur në formë grafike përqindja e nxënësve që gravitojnë në shkollën e tyre. Nga diagrami lexojmë se 86,50% e nxënësve janë nga Prishtina, në ato shkolla ku u zhvillua hulumtimi, ndërsa 2,00% dolën të jenë me vendbanim jashtë Prishtine.

**Diag. 17.** Vendbanimi i nxënësve



Burimi: Autori, 2016

### **P2.2. Klasa të cilën e vijojnë nxënësit**

Nxënësit e intervistuar ishin të klasave IX, XI dhe XII. Në tabelën 52 shihet shpërndarja e tyre nëpër klasë dhe përqindja.

- Nga klasa IX janë 16 nxënës me 8,00%,
- Nga klasa XI janë 68 nxënës me 34,00% dhe
- Nga klasa XII janë 101 nxënës me 50,50%.
- Nuk dhanë përgjigje në këtë pyetje 15 nxënës me 7,50%.

**Tabela 52.** Shpërndarja e nxënësve nëpër klasa

**Crosstab**

Count		Klasa				Total
		Klasa IX	Klasa XI	Klasa XII	Nuk ka përgjigje	
e_learning	e-mësimi është inovacion	7	28	35	4	74
	Nuk ofron lajm të veçantë	2	16	39	5	62
	Lidhje te reja: mësues-nxënës	0	10	10	0	20
	qasje të reja	7	14	17	6	44
Total		16	68	101	15	200

Burimi: Autori, 2016

Nga tabela 52 shihet se nxënësit e klasës IX e kanë këtë opinion për e-mësimin:

- *e-learning* është inovacion (7 nxënës),
- *e-elarning* nuk ofron lajm të veçantë (2 nxënës),
- *e-elarning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (asnjë nxënës) dhe
- *e-elarning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (7 nxënës).

Ndërsa nxënësit që nuk kanë dhënë përgjigje për vendbanimin e tyre, lidhur me e-learning kanë këtë opinion:

- *e-learning* është inovacion (4 nxënës);
- *e-elarning* nuk ofron lajm të veçantë (5 nxënës);
- *e-elarning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (asnjë nxënës) dhe
- *e-elarning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (6 nxënës).

### ***P2.3. Lidhja e variablës “e-learning” me “përdorimi i PC\_nx”***

Përgjigjet në pyetjen rreth përdorimit të kompjuterit nga nxënësit në shtëpi apo në shkollë janë prezantuar në tabelën 53 dhe diagramin 15. Nga të dhënat e prezantuara shihet se 175 nxënës e përdorin kompjuterin në shtëpi apo në shkollë, ndërsa 19 nxënës nuk e përdorin. Ndërsa 6 nxënës nuk janë deklaruar nëse e përdorin apo jo kompjuterin.

Gjatë përpilimit të pyetësorit që do t'u drejtohej nxënësve i identifikuar si P2 është parë e udhës që nxënësve t'u shtrohet pyetja: “E përdorni kompjuterin në shtëpi apo në shkollë?”. Me anë të kësaj pyetjeje gjatë analizës kuptohet ndikimi i përdorimit të kompjuterit për të rritur efektin e të mësuarit nga distanca. Kjo nuk ka dyshim kur e kemi parasysh se pa përdorimin e kompjuterit nxënësi nuk do të mund t'i përcjellë (mësoj) njësitë mësimore që kanë të bëjnë me mësimnxënie nga distanca, e-learning.

Këtu për variabël të pavarur është vendosur: *përdorimi i PC\_nx*.

Nëpërmjet të programit për gjetjen e statistikave SPSS me analizën Crosstab paraqitet lidhja ndërmjet variablës së varur: “*e-learning*” dhe asaj të pavarur: “*përdorimi i PC\_nx*”.

Nga tabela 53 shihet se 175 nxënës janë deklaruar se e përdorin kompjuterin, 19 nxënës nuk e përdorin, përderisa 6 nxënës nuk kanë pëlqyer të japin përgjigje në këtë pyetje.

**Tabela 53.** Lidhja ndërmjet variablave “*e-learning*” dhe “*përdorimi i PC\_nx*”

**Crosstab**

Count

		përdorimi_i_PC_nx			Total
		PO	JO	Nuk ka përgjigje	
e_learning	e-mësimi është inovacion	58	13	3	74
	Nuk ofron lajm të veçantë	59	3	0	62
	Lidhje të reja: mësues-nxënës	16	2	2	20
	qasje të reja	42	1	1	44
Total		175	19	6	200

Burimi: Autori, 2016

Lidhshmëria ndërmjet variablave “*e-learning*” dhe “*përdorimi i PC\_nx*” me anë të kryqëzimit të këtyre tabelave “Crosstab” është paraqitur në tabelën 51 dhe komentohet, si në vijim:

Nga 175 nxënësit të cilët janë deklaruar se e përdorin kompjuterin e kanë këtë mendim lidhur me 4 (katër) opsionet e mësimi e-learning:

- *e-learning* është inovacion (58 nxënës),
- *e-learning* nuk ofron lajm të veçantë (59 nxënës),
- *e-learning* krijon lidhje të reja mësues-nxënës (16 nxënës) dhe

- *e-learning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (42 nxënës).

Përderisa 19 nxënës të cilët janë deklaruar se nuk e përdorin kompjuterin, lidhur me mësimin e-learning janë shprehur kështu:

- *e-learning* është inovacion (13 nxënës),
- *e-learning* nuk ofron lajm të veçantë (3 nxënës),
- *e-learning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (2 nxënës) dhe
- *e-learning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (1 nxënës).

**Tabela 54.** “Chi-Square Tests” - “*e-learning*” dhe “*përdorimi i PC<sub>nx</sub>*”

Chi-Square Tests			
	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	15,957 <sup>a</sup>	6	.014
Likelihood Ratio	16,923	6	.010
Linear-by-Linear Association	2,969	1	.085
N of Valid Cases	200		

a. 6 celula (50,0%) i kanë vlerat e pritura më të vogla se 5. Numri më i vogël i pritshëm është 0,60.

Burimi: Autori, 2016

Me anë të analizës “Chi-Square Tests” paraqitet lidhja ndërmjet variablës (ndryshores) së varur “*e-learning*” dhe variablës së pavarur “*përdorimi i PC<sub>nx</sub>*”. Nga të dhënat e paraqitura në tabelën 54 vërejmë se vlera statistikore është 15,957<sup>a</sup> dhe shkalla e lirisë (df) është 6, ndërsa  $p=0,014$ . Kjo vlerë e probabiliteti është më e vogël se 0,05, për çka konstatojmë se kjo analizë gjen një marrëdhënie statistikisht domethënëse ndërmjet variablave.


Analizat po ashtu tregojnë (tabela 54) se raporti i mundësisë (Likelihood Ratio) është 16,923, po ashtu analizojmë edhe  $p=0,010 < 0,05$ . Nga kjo përfundojmë se variablat “*e-*

*learning*” dhe “*përdorimi i PC\_nx*” janë të varura. Testi statistikor tregon lidhje kuptimplota ndërmjet variablave, d.m.th. variablat janë të varura dhe lidhja ndërmjet tyre është sinjifikante.

Me anë të diagramit 16 paraqitet përdorimi i kompjuterit nga nxënësit.

Në bazë të këtij diagrami, 87% e nxënësve, nga 200 sa ishin intervistuar, pohojnë se e përdorin kompjuterin, 10% janë deklaruar se nuk e përdorin, ndërsa 3% nuk kanë dhënë përgjigje nëse e përdorin apo nuk e përdorin kompjuterin në shkollë ose shtëpi.

**Diag. 18.** Përdorimi i PC nga nxënësit



Burimi: Autori, 2016

Në bazë të kësaj analize përfundojmë se rritja e numrit të nxënësve që nuk e përdorin kompjuterin do ta ulë efektivitetin e përdorimit të platformës elektronike e-learning. Prandaj, variabla e varur “*e-learning*” varet nga rritja e numrit të nxënësve që e përdorin kompjuterin.

#### ***P2.4. Ndërlidhja e “e-learning” me “qasja në internet\_nx”***

Nga 200 nxënësit e përfshirë në hulumtim, 179 deklarohen se kanë qasje në internet, ndërsa 21 nxënës nuk kanë qasje në internet.

**Tabela 55.** Qasja e nxënësve në internet



**Crosstab**

Count		qasja_internet		Total
		Po	Jo	
e_learning	e-mësimi është inovacion	60	14	74
	Nuk ofron lajm të veçantë	59	3	62
	Lidhje të reja: mësues-nxënës	18	2	20
	qasje të reja	42	2	44
Total		179	21	200

Në pyetjen drejtuar nxënësve: “A keni qasje në internet?”, janë dhënë këto përgjigje:

- Po (kemi qasje në internet), kanë deklaruar 179 nxënës;
- Jo (nuk kemi qasje në internet), kanë deklaruar 21 nxënës.

Ndërsa nëpërmjet analizës së lidhshmërisë së varaiblave “*e-learning*” (variabël e varur) dhe “*qasja në internet\_nx*” (variabël e pavarur), e paraqitur në tabelën 55, konkludojmë se nxënësit që e përdorin internetin i kanë këto opinione për e-mësimin:

- *e-learning* është inovacion (60 nxënës),
- *e-learning* nuk ofron lajm të veçantë (59 nxënës),
- *e-learning* krijon lidhje të reja mësues-nxënës (18 nxënës) dhe
- *e-learning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (42 nxënës).

Përderisa nxënësit të cilët janë deklaruar se nuk e përdorin internetin, lidhur me mësimin e-learning janë shprehur kështu:

- *e-learning* është inovacion (14 nxënës),
- *e-learning* nuk ofron lajm të veçantë (3 nxënës),
- *e-learning* krijon lidhje të reja mësues-nxënës (2 nxënës) dhe

- *e-learning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (2 nxënës).

Lidhja e variablave “*e-learning*” dhe “*qasja në internet\_nx*” është paraqitur nëpërmjet analizës “Chi-Square Tests”. Nga të dhënat e paraqitura në tabelën 56 vërejmë se vlera statistikore është 9,361<sup>a</sup> dhe shkalla e lirisë (df) është 3, ndërsa  $p=0,025 < 0,05$ . Kjo analizë shfaq një marrëdhënie statistikisht domethënëse ndërmjet variablave.

**Tabela 56.** Lidhja ndërmjet “*e-learning*” dhe “*qasja në internet\_nx*”

Chi-Square Tests			
	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	9,361 <sup>a</sup>	3	.025
Likelihood Ratio	9,287	3	.026
Linear-by-Linear Association	5,364	1	.021
N of Valid Cases	200		


a. 2 celula (25,0%) i kanë vlerat e pritura më të vogla se 5. Numri më i vogël i pritshëm është 2,10.

Burimi: Autori, 2016

Analizat (tabela 56) po ashtu tregojnë se raporti i mundësisë (Likelihood Ratio) është 9.287. Gjithashtu analizojmë edhe  $p=0,026 < 0,05$ , ku përfundojmë se variablat “*e-learning*” dhe “*qasja në internet\_nx*” janë të varura. Testi statistikor tregon lidhje kuptimplota ndërmjet variablave, d.m.th. variablat janë të varura dhe lidhja ndërmjet tyre është e justifikueshme.

Me anë të diagramit vijues (17), paraqitet përqindja e qasjes e nxënësve në internet. Siç vërehet nga diagrami 89% e mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim kanë qasje në internet, ndërsa 11% e tyre nuk kanë qasje në internet.

**Diag. 19.** Qasje e nxënësve në internet



Burimi: Autori, 2016

### P2.5. Lidhja ndërmjet variablës “e-learning” dhe “përdorimi i e-mailit\_nx”

Në këtë pyetje nxënësit kanë pasur për detyrë të shprehen lidhur me kohëzgjatjen e përdorimit të postës elektronike: *email-it*. Ata kanë mundur të zgjedhin njëren nga dy opsionet e ofruara:

A (e përdor),

B (rrallë e përdor).

Variabla e pavarur: “përdorimi i e-mail\_nx” ndikon në variabilën e varur “e-learning”.

Për ta paraqitur lidhshmërinë e tyre, nëpërmjet programit SPPSS Statistics versioni 22, shfaqet analiza *Crosstab*, si në tabelën (57).

**Tabela 57.** “e-learning” dhe “përdorimi i email\_nx”

**Crosstab**

Count

		Email_nx		Total
		e përdor	rrallë e përdor	
e_learning	e-mësimi është inovacion	61	13	74
	Nuk ofron lajm të veçantë	59	3	62
	Lidhje të reja: mësues-nxënës	18	2	20
	qasje të reja	43	1	44
Total		181	19	200

Burimi: Autori, 2016

Nga tabela 57 shihet se 181 nxënës janë deklaruar që e përdorin postën elektronike, ndërsa 19 nxënës kanë zgjedhur përgjigjen: rrallë e përdor postën elektronike. Po në këtë tabelë (57) është paraqitur analiza *Crosstab* për ta treguar lidhshmërinë ndërmjet variablave “*e-learning*” me “*e-mail\_nx*”.

Kështu konkludojmë se nxënësit që e përdorin postën elektronike kanë këto përgjigje rreth e-learning-ut:

- *e-learning* është inovacion (61 nxënës),
- *e-elarning* nuk ofron lajm të veçantë (59 nxënës),
- *e-elarning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (18 nxënës) dhe
- *e-elarning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (43 nxënës).

Në këtë pyetje (tabela 57) shihet se nga 181 nxënësit që rrallë e përdorin postën elektronike lidhur me e-mësimin shprehen nëpërmjet pyetësorit:

- *e-learning* është inovacion (13 nxënës),
- *e-elarning* nuk ofron lajm të veçantë (3 nxënës),
- *e-elarning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (2 nxënës) dhe
- *e-elarning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (1 nxënës).

Lidhjen e variablave “*e-learning*” dhe “*e-mail*” është paraqitur me anë të analizës “Chi-Square Tests”. Nga të dhënat e paraqitura në tabelën 58 vërejmë se vlera statistikore është 9,848<sup>a</sup> dhe shkalla e lirisë (df) është 3, ndërsa  $p=0,020 < 0,05$ . Kjo analizë shfaq një marrëdhënie statistikisht domethënëse ndërmjet variablave “*e-learning*” dhe “*e-mail*”.

**Tabela 58.** Lidhja ndërmjet “*e-learning*” dhe “*e-mail\_nx*”

Chi-Square Tests			
	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	9,848 <sup>a</sup>	3	.020
Likelihood Ratio	10,224	3	.017
Linear-by-Linear Association	6,551	1	.010
N of Valid Cases	200		

a. 2 celula (25,0%) i kanë vlerat e pritura më të vogla se 5. Numri më i vogël i pritshëm është 1,90.


Burimi: Autori, 2016

Analizat po ashtu tregojnë se raporti i mundësisë (Likelihood Ratio) është 10,224. Gjithashtu analizojmë edhe  $p=0,017$ . Kjo vlerë e probabilitetit është më e vogël se 0,05, me çka përfundojmë se variablat “*e-learning*” dhe “*e-maili\_nx*” janë të varura. Testi statistikor tregon lidhje kuptimplota ndërmjet variablave, d.m.th. variablat janë të varura dhe lidhja ndërmjet tyre është e justifikueshme.

Në diagramin 18 është paraqitur pjesëmarrja e nxënësve në përgjigjen e pyetjes për përdorimin e postës elektronike. Nga ky grafikon shihet se:

- 89% e nxënësve të intervistuar e përdorin postën elektronike;
- 11% e nxënësve të intervistuar rrallë e përdorin postën elektronike (e-mail-in)

**Diagrami 20.** Përdorimi i postës elektronike nga nxënësit



Burimi: Autori, 2016

**P2.6. Komunikimi me mësimdhënës nëpërmjet postës elektronike, variablat: “e-learning” dhe “komunikimi me e-mail\_nx”**

Komunikimi i nxënësve nëpërmjet postës elektronike me mësimdhënës është më se i domosdoshëm në mësimnxënien nga distanca nëpërmjet e-learning. Pa këtë komunikim nuk mund të ishte i plotfuqishëm realizimi i mësimit elektronik (e-learning). Kështu që për variabël të pavarur këtu është përcaktuar “komunikimi me e-mail\_nx”.

Në këtë pyetje nxënësit kanë qenë të kufizuar të japin përgjigje Po apo Jo:

- A) Po (komunikoj me nxënës me e-postë) 179 nxënës,
- B) Jo (nuk komunikoj me nxënës me e-postë) 21 nxënës.

**Tabela 59.** Komunikimi i nxënësve me mësimdhënës nëpërmjet e-mail-it

**Crosstab**

Count

		Kom_email_nx		Total
		Po	Jo	
e_learning	e-mësimi është inovacion	60	14	74
	Nuk ofron lajm të veçantë	59	3	62
	Lidhje të reja: mësues-nxënës	18	2	20
	qasje të reja	42	2	44
Total		179	21	200

Burimi: Autori, 2016

Nga tabela 59 shihet se 179 nxënës ose 89,50% e tyre që e përdorin postën elektronike për të komunikuar me mësimdhënës, kanë këtë qëndrim lidhur me mësimin elektronik: e-learning:

- *e-learning* është inovacion (60 nxënës),
- *e-learning* nuk ofron lajm të veçantë (59 nxënës),
- *e-learning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (18 nxënës) dhe

- *e-learning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (42 nxënës).

Ndërsa 21 nxënës apo 10,50% e tyre që nuk e përdorin postën elektronike për të komunikuar me mësimdhënës, kanë këtë qëndrim lidhur me mësimin elektronik, e-learning:

- *e-learning* është inovacion (14 nxënës),
- *e-learning* nuk ofron lajm të veçantë (3 nxënës),
- *e-learning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (2 nxënës) dhe
- *e-learning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (2 nxënës).

Pra, këtu shihet qartë se nxënësit që nuk komunikojnë me mësimdhënës nëpërmjet postës elektronike nuk e vlerësojnë shumë e-mësimin (e-learning). Nxënësit që nuk e praktikojnë përdorimin e postës elektronike për të komunikuar me të tjerët e vlerësojnë pak rëndësinë e mësimin elektronik, e-learning. Rritja e numrit të nxënësve që do ta përdornin postën elektronike për komunikim do ta rriste edhe interesimin e tyre për mësim elektronik (e-learning) dhe anasjelltas. Ndërkaq rritja e numrit të nxënësve që nuk e përdorin postën elektronike për komunikim me mësimdhënësit e tyre do ta zvogëlojë interesimin e nxënësve për përdorimin e kësaj platforme.

Në tabelën 60 është paraqitur lidhja e variablave “*e-learning*” dhe “*komunikimi me e-mail\_nx*” nëpërmjet analizës “Chi-Square Tests”. Nga të dhënat e paraqitura vërejmë se vlera statistikore është 9,361<sup>a</sup> dhe shkalla e lirisë (df) është 3, ndërsa  $p=0,025 < 0,05$ . Kjo analizë shfaq një marrëdhënie statistikisht domethënëse ndërmjet variablave “*e-learning*” dhe “*komunikimi me e-mail\_nx*”.

**Tabela 60.** Lidhja ndërmjet “*e-learning*” dhe “*komunikimi me e-mail\_nx*”

Chi-Square Tests


	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	9,361 <sup>a</sup>	3	.025
Likelihood Ratio	9,287	3	.026
Linear-by-Linear Association	5,364	1	.021
N of Valid Cases	200		

a. 2 celula (25,0%) i kanë vlerat e pritura më të vogla se 5. Numri më i vogël i pritshëm është 2,10.

Burimi: Autori, 2016

Analizat po ashtu tregojnë se raporti i mundësisë (Likelihood Ratio) është 9,287. Gjithashtu analizojmë edhe  $p=0,026$ . Kjo vlerë e probabilitetit është më e vogël se 0,05, me çka përfundojmë se variablat “*e-learning*” dhe “*komunikimi me e-mail\_nx*” janë të varura. Testi statistikor tregon lidhje kuptimplota ndërmjet variablave, d.m.th. variablat janë të varura dhe lidhja ndërmjet është e justifikueshme.

Diag. 21. Komunikimi me nxënës nëpërmjet e-mail-it



Burimi: Autori, 2016

Një nga faktorët që ndikojnë në rritjen e efikasitetit të mësimnxënies elektronike e-learning është komunikimi me nxënës nëpërmjet postës elektronike.



**P2.7. Varshmëria e e-learning nga përdorimi i internetit për mësim në distancë**

Për paraqitjen ndërlidhjes së të mësuarit e-learning është mjaft e rëndësishme të dimë nga nxënësit nëse e përdorin internetin për të mësuar diçka nga distanca. Ky raport ndërmjet “e-learning” dhe “mësimi në distancë\_nx” paraqitet në tabelën 61 me anë të analizës Crosstab, nëpërmjet programit SPSS Statistics versioni 22.

**Tabela 61.** Përdorimi i internetit për mësim nga distanca

**Crosstab**

Count

		mësimi_distancë_nx			Total
		Jo nuk e përdor	rrallë e përdor	shpesh e përdor	
e_learning	e-mësimi është inovacion	57	14	3	74
	Nuk ofron lajm të veçantë	59	3	0	62
	Lidhje të reja: mësues-nxënës	16	2	2	20
	qasje të reja	41	2	1	44
<b>Total</b>		<b>173</b>	<b>21</b>	<b>6</b>	<b>200</b>

Burimi: Autori, 2016

Në këtë pyetje nxënësit patën tri opsione, në të cilat përgjigjen, si në vijim:

- A) Jo (nuk e përdorim internetin për ngritje profesionale) deklarohen 173 nxënës, përkatësisht 86,50%,
- B) Rrallë (e përdorim internetin për ngritje profesionale) deklarohen 21 nxënës, përkatësisht 10,50%,
- C) Shpesh (e përdorim internetin për ngritje profesionale) deklarohen 28 nxënës, përkatësisht 14,00%.

Nga tabela 61 lexojmë se vetëm 6 nxënës janë deklaruar se e përdorin internetin për mësim nga distanca. Këta nxënës e kanë dhënë opinionin e tyre për e-learning, si më poshtë:

- *e-learning* është inovacion (3 nxënës);
- *e-learning* nuk ofron lajm të veçantë (asnjë nxënës);
- *e-learning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (2 nxënës) dhe
- *e-learning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (1 nxënës).

Ndërsa 86,50% e nxënësve që nuk e përdorin internetin për mësim nga distanca kanë këtë qëndrim lidhur me mësimin elektronik: e-learning:

- *e-learning* është inovacion (57 nxënës),
- *e-learning* nuk ofron lajm të veçantë (59 nxënës),
- *e-learning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (16 nxënës) dhe
- *e-learning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (41 nxënës).

Në këtë pyetje është një numër prej 21 nxënësve, të cilët rrallë e përdorin internetin për të mësuar nga distanca, ndërsa për platformën e-learning kanë këtë opinion:

- *e-learning* është inovacion (14 nxënës),
- *e-learning* nuk ofron lajm të veçantë (3 nxënës),
- *e-learning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (2 nxënës) dhe
- *e-learning*, krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (2 nxënës).

Në tabelën 62 është paraqitur lidhja e variablave “*e-learning*” dhe “*mësimi në distancë\_nx*” nëpërmjet analizës “Chi-Square Tests”. Nga të dhënat e paraqitura vërejmë se vlera statistikore është 15,487<sup>a</sup> dhe shkalla e lirisë (df) është 6, ndërsa  $p=0,017 < 0,05$ .

Kjo analizë shfaq një marrëdhënie statistikisht domethënëse ndërmjet variablave “*e-learning*” dhe “*mësimi në distancë\_nx*”.

**Tabela 62.** Lidhja ndërmjet “*e-learning*” dhe “*mësimi në distancë\_nx*”

Chi-Square Tests			
	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	15,487 <sup>a</sup>	6	.017
Likelihood Ratio	16,000	6	.014
Linear-by-Linear Association	2,567	1	.109
N of Valid Cases	200		

a. 6 celula (50,0%) i kanë vlerat e pritura më të vogla se 5. Numri më i vogël i pritshëm është 0,60.


Burimi: Autori, 2016

Analizat po ashtu tregojnë se raporti i mundësisë (Likelihood Ratio) është 16,000. Gjithashtu analizojmë edhe  $p=0,014$ , meqë kjo vlerë e probabilitetit është më e vogël se 0,05, me çka përfundojmë se variablat “*e-learning*” dhe “*mësimi në distancë\_nx*” janë të varura. Testi statistikor tregon lidhje kuptimplota ndërmjet variablave, d.m.th. variablat janë të varura dhe lidhja ndërmjet është sinjifikante.

Në diagramin 20 është paraqitur forma grafike se a përdorin internetin nxënësit për të mësuar nga distanca. Nga ky grafikon vërejmë se:

- 173 nxënës ose 86%, nga 200 nxënësit e intervistuar, nuk e përdorin internetin për mësim nga distanca,
- 21 nxënës ose 11%, gjithashtu nga 200 nxënësit e intervistuar, deklarohen se rrallë e përdorin internetin për të mësuar nga distanca dhe
- Janë vetëm 6 nxënës ose 3%, të cilët janë deklaruar se e përdorin internetin për të mësuar nga distanca.

**Diag. 22.** Përdorimi i internetit për mësim nga distanca



Burimi: Autori, 2016

### ***P2.8. Lidhja e variablës “e-learning” me “platforma online\_nx”***

Mësimi elektronik, përkatësisht e-mësimi (e-learning) i zgjedhur për këtë hulumtim varet edhe nga variabla “platforma online\_nx”. Nxënësve u është bërë pyetja: *A keni përdorur ndonjë platformë online për mësim deri tani?*. Në këtë pyetje (tabela 60) kanë qenë të kufizuar që të përgjigjen vetëm me Po ose Jo. Nëse nxënësi ka dhënë përgjigje Po në këtë pyetje, atëherë ka vazhduar në pyetjen 11, përndryshe ka kaluar në pyetjen 12 (Dika, 2007).

Përgjigjet të cilat kthehen nga pyetësorët (tabela 63) drejtuar nxënësve, janë kështu:

- Nga 200 nxënësit e intervistuar, 70 janë përgjigjur Po. Kjo do të thotë se ata kanë pohuar se e kanë përdorur ndonjë platformë online për mësim elektronik e-learning dhe
- 128 nxënës kanë mohuar të kenë përdorur ndonjë platformë online për mësim në distancë.

- Siç vërehet një nxënës nuk është deklaruar në këtë pyetje.

**Tabela 63.** Lidhshmëria e “*e-learning*” dhe “*platforma online\_nx*”

**Crosstab**

Count

		platformë_online_nx		Total
		Po	Jo	
e_learning	e-mësimi është inovacion	18	55	73
	Nuk ofron lajm të veçantë	24	38	62
	Lidhje të reja: mësues-nxënës	10	10	20
	qasje të reja	19	25	44
Total		71	128	199

Burimi: Autori, 2016

Siç shihet nga tabela 63, nga gjithsej 71 nxënës të cilët kanë dhënë përgjigje Po (kanë përdorur platformë online për mësim elektronik, kanë këtë qëndrim lidhur me e-learning:

- *e-learning* është inovacion (18 nxënës),
- *e-learning* nuk ofron lajm të veçantë (24 nxënës),
- *e-learning* krijon lidhje të reja mësues-nxënës (10 nxënës) dhe
- *e-learning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësues-nxënës (19 nxënës).

Ndërsa 128 nxënësit të cilët janë deklaruar me Jo (nuk kanë përdorur asnjë platformë online për mësim elektronik në distancë e-learning sa i përket kësaj platforme (e-learning) që studiohet në këtë hulumtim kanë këtë qëndrim:

- *e-learning* është inovacion (55 nxënës);
- *e-learning* nuk ofron lajm të veçantë (38 nxënës);
- *e-learning* krijon lidhje të reja mësues-nxënës (10 nxënës) dhe
- *e-learning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësues-nxënës (25 nxënës).

Në tabelën 64 është paraqitur lidhja e variablave “*e-learning*” dhe “*platforma online\_nx*” nëpërmjet analizës “Chi-Square Tests”. Nga të dhënat e paraqitura vërejmë se vlera

statistikore është 6,979<sup>a</sup> dhe shkalla e lirisë (df) është 3, ndërsa  $p=0,073$ . Vlera e  $p$ -së nuk është më e vogël se 0,05,  $p=0,73 > 0,05$ , që do të thotë se variablat nuk shfaqin një marrëdhënie statistikisht domethënëse ndërmjet variablave “*e-learning*” dhe “*platforma online*”. Ky raport ndërmjet përdorimit të platformës online të nxënësve për të mësuar nga distanca është në kundërshtim me platformën që hulumtohet. Përfundimisht këto variabla nuk janë sinjifikante ndërmjet tyre.

**Tabela 64.** Lidhja ndërmjet “*e-learning*” dhe “*platforma online*”

Chi-Square Tests			
	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	6,979 <sup>a</sup>	3	.073
Likelihood Ratio	7,104	3	.069
Linear-by-Linear Association	5,059	1	.025
N of Valid Cases	199		

a. 0 celula (0,0%) i kanë vlerat e pritura më të vogla se 5. Numri më i vogël i pritshëm është 7,14.


Burimi: Autori, 2016

Analizat po ashtu tregojnë se raporti i mundësisë (Likelihood Ratio) është 7,104. Gjithashtu analizojmë edhe  $p=0,069$ . Meqë kjo vlerë e propabilitetit është më e madhe se 0,05, përfundojmë se variablat “*e-learning*” dhe “*platforma online*” nuk janë të varura. Testi statistikor nuk tregon lidhje kuptimplota ndërmjet variablave, d.m.th. variablat nuk janë të varura dhe lidhja ndërmjet tyre është josinjifikante.

Me anë të diagramit 21 është paraqitur përqindja e përdorimit dhe jopërdorimit të platformës online. Në bazë të këtij diagrami përfundojmë se 36% e nxënësve të intervistuar pohojnë se e kanë përdorur platformën online për të mësuar, ndërsa 64% e nxënësve deklarohen se nuk kanë përdorur asnjë platformë online për të mësuar nga

distanca nëpërmjet platformës elektronike për mësimnxënie apo mësimdhënie, të njohur si e-learning.

**Diag 23.** Platforma online



Numri i vogël i nxënësve që janë duke e përdorur ndonjë platformë online për mësim nga distanca është tregues se me këtë platformë duhet të fillohet me zhvillimin e saj nëpër institucionet arsimore në Kosovë.

**P2.9. Vlerësimi i platformës online nga 1 deri në 5**

Pyetja 10 (e dhjetë) ndërlihet me përgjigjen që jepet në pyetjen 9 (e nëntë). Pra, nëse nxënësi është deklaruar me Po (ka përdorur ndonjë platformë online për mësim), atëherë në pyetjen dhjetë pati mundësinë të deklarohet se si e vlerëson në një shkallë nga 1 (përdorim i vogël) deri në 5 (përdorim i lartë), tabela 65.

**Tabela 65.** Vlerësimi i platformës online

Vlerësimi	Si e vlerësoni përdorimin e platformës?					Gjithsej
	1 (ulët)	2 (mjaft.)	3 (mirë)	4 (sh.mirë)	5 (shkëlq.)	
Nxënës	14	12	28	2	15	71
%	19,72	16,91	39,43	2,82	21,12	100

Burimi: Autori, 2016

Sipas tabelës 65, shihet se 71 nxënës janë deklaruar me përgjigjen Po (kanë përdorur platformë online për mësim) dhe në tabelën 66 shihet se 71 nxënësit e deklaruar se përdorin platforma online për të mësuar nëpërmjet internetit, e-learning-un e vlerësojnë:

- Përdorim me vlerë 1 (nivel i ulët i vlerësimit) kanë dhënë 14 nxënës apo 19,72%,
- Përdorim me vlerë 2 (nivel i mjaftueshëm) kanë dhënë 12 nxënës apo 16,91%,
- Përdorim me vlerë 3 (nivel i mirë) kanë dhënë 28 nxënës apo 39,43%,
- Përdorim me vlerë 4 (nivel shumë i mirë) kanë dhënë 2 nxënës apo 2,82% dhe
- Përdorim me vlerë 5 (nivel i shkëlqyeshëm) kanë dhënë 15 nxënës apo 21,12%.

**Tabela 66.** Vlerësimi (1-5) për përdorimin e platformës online

**Crosstab**

Count

		Vlerësimi_1deri5					Total
		Ulët	Mjaft.	Mirë	Sh. mirë	Shkëlq.	
e_learning	e-mësimi është inovacion	8	6	4	0	0	18
	Nuk ofron lajm të veçantë	2	2	16	0	4	24
	Lidhje të reja: mësues-nxënës	0	4	0	0	6	10
	qasje të reja	4	0	8	2	5	19
Total		14	12	28	2	15	71

Burimi: Autori, 2016

Nga tabela 66 paraqiten përgjigjet e 15 nxënësve që vlerësimin për platformës online e japin me notë më të lartë 5 (pesë), kanë këtë opinion lidhur me e-learning:

- *e-learning* është inovacion (asnjë nxënës),
- *e-learning* nuk ofron lajm të veçantë (4 nxënës);
- *e-learning* krijon lidhje të reja mësues-nxënës (6 nxënës) dhe
- *e-learning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe mësimdhënie (5 nxënës).



Po nga tabela 66 paraqiten përgjigjet e 28 nxënësve (që është numri më i madh nga 71 përgjigjet Po, nga pyetja 9 (nëntë), të cilët platformën online e kanë vlerësuar me notën 3 (mirë), lidhur me e-learning shprehen:

- *e-learning* është inovacion (4 nxënës),
- *e-learning* nuk ofron lajm të veçantë (16 nxënës),
- *e-learning* krijon lidhje të reja mësimdhënës-nxënës (asnjë nxënës) dhe
- *e-learning* krijon qasje të reja për mësimnxënie dhe nxënës (8 nxënës).

Në tabelën 67 është paraqitur lidhja e variablave “*e-learning*” dhe “*vlerësimi\_nx*” nëpërmjet analizës “Chi-Square Tests”. Nga të dhënat e paraqitura vërejmë se vlera statistikore është 46,174<sup>a</sup> dhe shkalla e lirisë (df) është 12, ndërsa p=0,000. Vlera e p-së është më e vogël se 0,05, p=0,00<0,05, që do të thotë se variablat shfaqin një marrëdhënie statistikisht domethënëse ndërmjet variablave “*e-learning*” dhe “*platforma online*”. Ky raport ndërmjet variablave është i varur, prandaj variablat janë sinjifikante.

**Tabela 67.** Lidhja ndërmjet “*e-learning*” dhe “*vlerësimi\_nx*”

Chi-Square Tests			
	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	46,174 <sup>a</sup>	12	.000
Likelihood Ratio	53,652	12	.000
Linear-by-Linear Association	10,167	1	.001
N of Valid Cases	71		

a. 16 celula (80,0%) i kanë vlerat e pritura më të vogla se 5. Numri më i vogël i pritshëm është 0,28.

Burimi: Autori, 2016


Analizat (tabela 67) po ashtu tregojnë se raporti i mundësisë (Likelihood Ratio) është 53,652. Gjithashtu analizojmë edhe p=0,000. Meqë kjo vlerë e propabilitetit është më e vogël se 0,05, përfundojmë se variablat “*e-learning*” dhe “*vlerësimi*” janë plotësisht të

varura. Testi statistikor tregon lidhje kuptimplota ndërmjet variablave, d.m.th. variablat janë të varura dhe lidhja ndërmjet tyre është ekstrem sinjifikante.

Në diagramin 22 paraqitet vlerësimi i platformës online që e japin 71 nxënësit për përgjigje Po, në pyetjen: *A keni përdorur ndonjë platformë online për mësim elektronik nga distanca: e-learning?*. Diagrami shpreh vlerat në përqindje, si në vijim:

- Vlerësimi 1 (ulët), 14 nxënës, përkatësisht 19,72%,
- Vlerësimi 2 (mjaft), 12 nxënës, përkatësisht 16,91%,
- Vlerësimi 3 (mirë), 28 nxënës, përkatësisht 39,43%,
- Vlerësimi 4 (sh. mirë), 2 nxënës, përkatësisht 2,82% dhe
- Vlerësimi 5 (shkëlqë), 15 nxënës, përkatësisht 21,12%.

**Diag 24.** Vlerësimi i platformës online nga 1 deri 5



Burimi: Autori, 2016

Rezultatet e mblodhura nga pyetësorët për pyetjet 11 deri 15 janë përmbledhur në tabelën 68.

**Tabela 68.** Vetëvlerësim për mësimin nga distanca

Menaxhimi i institucioneve arsimore me mësimnxënie në distancë: e-learning

Rretho shkronjën nën opsionin e dhënë	Aspak nuk pajtohem	Nuk pajtohem	Jam i pavendosur	Pajtohem	Plotësisht pajtohem
11. Konsideroj se jam mjaft i udhëzuar për mësim në distancë e-learning.	<b>A</b> 4 nxënës 2,06%	<b>B</b> 26 nxënës 13,40 %	<b>C</b> 83 nxënës 42,78%	<b>D</b> 77 nxënës 39,69%	<b>E</b> 4 nxënës 2,06%
12. Në të ardhmen interneti do t'i zëvendësojë librat.	<b>A</b> 19 nxënës 8,86%	<b>B</b> 33 nxënës 15,21 %	<b>C</b> 32 nxënës 14,75%	<b>D</b> 91 nxënës 41,94%	<b>E</b> 42 nxënës 19,35%
13. Në të ardhmen e-mësimi & m-mësimi do të përdoret si kombinim i teknologjisë me metodat tradicionale të të nxënit - mësimi i kombinuar (blended learning).	<b>A</b> 5 nxënës 2,65%	<b>B</b> 20 nxënës 10,58 %	<b>C</b> 57 nxënës 30,16%	<b>D</b> 85 nxënës 44,97%	<b>E</b> 22 nxënës 11,64%
14. Në të ardhmen e-mësimi & m-mësimi plotësisht do ta zëvendësojë mësimin tradicional me klasë virtuale dhe teknika tjera.	<b>A</b> 12 nxënës 6,19%	<b>B</b> 28 nxënës 14,43 %	<b>C</b> 65 nxënës 33,51%	<b>D</b> 68 nxënës 35,05%	<b>E</b> 21 nxënës 10,82%
15. Pengesa më e madhe për përdorimin e e-mësimit & m-mësimit është njohja e teknikave.	<b>A</b> 15 nxënës 7,69%	<b>B</b> 28 nxënës 14,36 %	<b>C</b> 51 nxënës 26,15%	<b>D</b> 79 nxënës 40,51%	<b>E</b> 22 nxënës 11,28%

Pyetjet vijuese kishin të bënin me mjetet teknologjike që i përdorin për aftësim të mësimin në distancë, si dhe lidhshmërinë e mësimin tradicional me e-learning. Në tabelën 68 dhe diagramin 23 lexojmë këto të dhëna:


- A) CD-ROM, DVD-ROM, Flash e kanë zgjedhur gjithsej 8 nxënës,
- B) Blog, wiki ose sistem burim tjetër të hapur, e kanë zgjedhur gjithsej 83 nxënës,
- C) Forum, chat, fb rrjet tjetër social ose të ngjashme, e kanë zgjedhur gjithsej 103 nxënës,
- D) Programe për krijimin e ueb-faqeve, e kanë zgjedhur gjithsej 13 nxënës,
- E) Sistem video-konferencash, e kanë zgjedhur gjithsej 10 nxënës.

Në bazë të të dhënave të paraqitura në tabelën 28 shihet se gjithsej janë mbledhur 217 përgjigje. Kjo nuk nënkupton se disa nxënës kanë zgjedhur më shumë se një alternativë, si mjete teknologjike, të cilat i përdorin për të mësuar nëpërmjet internetit.

**Tabela 69.** Mjetet teknologjike që përdoren për e-mësim

A	B	C	D	E
8	83	103	13	10
3,69 %	38,25 %	47,47 %	5,99 %	4,61 %

**Diag. 25.** Përqindja e mjeteve teknologjike



### 5.7. Sa janë të përgatitur prindërit për t'i ndihmuar fëmijët e tyre të studiojnë me mësim nga distanca?

Të gjithë aktorët e shoqërisë tonë janë të prirë që të përdorin gjithçka që del e re në treg me bindjen se ajo është më e mira. Por, a ka treguar gjithmonë sukses ky konkludim? Sigurisht se e reja kërkon që t'u nënshtrohet testeve vlerësuese para se ajo të jetë e garantuar se është më adekuate. Edhe metodat e reja në mësimnxënie trumbetohen apo nënkuptohen si më të mirat për vetë faktin se janë më të reja. Por, një konkludim i tillë

mund të jetë vetëm një hipotezë e ngrehur mbi parimin se e reja është më e mira. Për një thënie të tillë mund të thuhet se është një paragjykim me diskriminim pozitiv. Por, se është duke u përdorur të mësuarit nga distanca (e-learning) në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe pasuar nga m-mësimi (m-learning), është fakt i vërtetuar. Të nxëniet nga distanca (e-learning) po hap shtigje të reja, duke lehtësuar në masë të madhe gjithçka. Pos faktorëve të tjerë lehtësues në këtë drejtim, faktori kohë po ashtu është i përmbushur, sepse këto metoda të fundit e kanë eliminuar “humbjen e kohës” për vajtje-ardhje në shkollë.

Me m-mësim tani është mundësuar që nxënësi në çdo kohë mund t’i marrë leksionet e tij nga mësimdhënësi i lëndës dhe t’i përpunojë ato, e të përgjigjet në pjesën e dhënë për nxënësin.

Po si mendon prindi për një gjë të tillë?

Në pyetjen nëse kanë qasje në internet fëmijët e tyre, ata janë përgjigjur kështu:

**Tabela 70.** Qasja në internet

Po	Jo
97	3
97%	3%

**Diag. 26.** Qasja në internet



Tabela 70 dhe diagrami 24 tregojnë për përgjigjet e prindërve sa i përket qasjes në internet që e kanë fëmijët e tyre.

Prindërit duhej të përgjigjeshin në pyetjen:

- Sa gjatë e përdorin fëmijët tuaj internetin për të mësuar?


Në këtë pyetje kanë pasur tri opsione, që janë paraqitur në tabelën 71 dhe diagramin 25:

- A) Nuk e përdorin fare, përgjigjen 5 prind apo 5%,
- B) Rrallë e përdorin, një herë në javë, përgjigjen 26 prind apo 26% dhe
- C) E përdorin disa herë gjatë ditës, përgjigjen 69 prind apo 69%.

**Tabela 71.** Përdorimi i internetit

Nuk e përdorin fare	Rrallë e përdorin, një herë në javë	E përdorin disa herë gjatë ditës
5	26	69
5%	26%	69%

**Diag. 27.** Përdorimi i internetit



Një pyetje tjetër që u është parashtruar prindërve: *A e përdorin fëmijët tuaj internetin për të komunikuar me të tjerët?*

Në këtë pyetje, prindërit patën dy alternativa: Po ose Jo. Në tabelën 72 dhe diagramin 26 e shohim se ata janë përgjigjur kështu:


A) Po (fëmijët e përdorin internetin për ngritje profesionale), kanë dhënë përgjigje 95 prindër apo 95% dhe

B) Jo (fëmijët nuk e përdorin internetin për ngritje profesionale), kanë dhënë përgjigje 5 prindër apo 5%.

**Tabela 72.** Komunikimi i fëmijëve

Po	Jo
95	5
95,00 %	5,00 %

**Diag. 28.** Përdorimi i internetit për komunikim ndërmjet fëmijëve



Në pyetjen 8, prindërit janë pyetur nëse fëmijët e tyre e përdorin internetin për ngritje profesionale.

Kanë pasur të zgjedhin njërin nga tri opsionet e ofruara A, B ose C. Nga diagrami 27 dhe tabela 73 përfundojmë se:

A) Jo (nuk e përdorin internetin për ngritje profesionale), janë përgjigjur 10 prindër,


B) Rrallë (e përdorin internetin për ngritje profesionale), janë përgjigjur 25 prindër dhe

C) Shpesh (e përdorin internetin për ngritje profesionale), janë përgjigjur 65 prindër.

**Tabela 73.** Përdorimi i internetit për ngritje profesionale

Jo	Rrallë	Shpesh
10	25	65
10,00 %	25,00 %	65,00 %

**Diag. 29.** Përdorimi i internetit për ngritje profesionale



Pyetja 10 ishte: *A keni njohuri për mësimin në distancë?*

Në këtë pyetje opsionet për përgjigje ishin Po ose Jo.

Përgjigjet e tyre ishin:

Po (kam njohuri për mësimin në distancë), 30 prindër dhe

Jo (nuk kam njohuri për mësimin në distancë), 70 prindër.


Këto rezultatet janë paraqitur në tabelën 71 dhe diagramin 28.

**Tabela 74.** Njohuritë për mësimin në distancë



Po	Jo
30	70
30,00 %	70,00 %

**Diag. 30.** Njohuritë për mësimin në distancë



Pyetja 10 (e dhjetë) ndërlidhet me përgjigjen që jepet në pyetjen e nëntë. Pra, nëse prindërit janë deklaruar me Po (kanë përdorur ndonjë platformë online për mësim), atëherë në pyetjen 10 (e dhjetë) e patën mundësinë të deklarohen se si e vlerësojnë në një shkallë nga 1 (përdorim i vogël) deri në 5 (përdorim i lartë).

Siç u paraqit në tabelën 75 dhe diagramin 29, shihet se 30 prindër janë deklaruar me përgjigjen Po (kanë përdorur platformë online për mësim) dhe në tabelën 75 shihet se:


- Përdorim me vlerë 1 (nivel i ulët i vlerësimit) kanë dhënë 2 prindër apo 6,67%,
- Përdorim me vlerë 2 (nivel i mjaftueshëm) kanë dhënë 3 prindër apo 10%,
- Përdorim me vlerë 3 (nivel i mirë) kanë dhënë 7 prindër apo 23,33 %,
- Përdorim me vlerë 4 (nivel shumë i mirë) kanë dhënë 12 prindër apo 40% dhe
- Përdorim me vlerë 5 (nivel i shkëlqyeshëm) kanë dhënë 6 prindër apo 20%.

**Tabela 75.** Vlerësimi i platformës nga 1 (nivel i ulët i vlerësimit) deri në 5 (nivel i lartë i vlerësimit)

Si e vlerësoni përdorimin e platformës?				
1 (ulët)	2 (mjaft.)	3 (mirë)	4 (sh. mirë)	5 (shkëlq.)
2	3	7	12	6
6,67%	10,00%	23,33%	40,00%	20,00%

Burimi: Autori, 2016

**Diag. 31.** Vlerësimi i platformës nga 1 (nivel i ulët i vlerësimit) deri në 5 (nivel i lartë i vlerësimit)



Burimi: Autori, 2016

Në pyetjet nga 11 deri 15, prindërit përgjigjen si në tabelën 76.

**Tabela 76.** Vetëvlerësimi i prindërve për njohuritë e mësimit nga distanca

Rretho shkronjën nën opsionin e dhënë	Aspak nuk pajtohem	Nuk pajtohem	Jam i pavendosur	Pajtohem	Plotësisht pajtohem
11. Konsideroj se jam mjaft i udhëzuar për mësim në distancë, e-learning.	<b>A</b> 6 prindër 6%	<b>B</b> 14 prindër 14 %	<b>C</b> 42 prindër 42%	<b>D</b> 27 prindër 27%	<b>E</b> 11 prindër 11%

## Menaxhimi i institucioneve arsimore me mësimnxënie në distancë: e-learning

12. Në të ardhmen interneti do t'i zëvendësojë librat.	<b>A</b> 5 prindër 5%	<b>B</b> 12 prindër 12 %	<b>C</b> 13 prindër 13%	<b>D</b> 49 prindër 49%	<b>E</b> 21 prindër 21%
13. Në të ardhmen e-mësimi & m-mësimi do të përdoret si kombinim i teknologjisë me metodat tradicionale të të nxënit - mësimi i kombinuar (blended learning).	<b>A</b> 3 prindër 3%	<b>B</b> 6 prindër 6 %	<b>C</b> 31 prindër 31%	<b>D</b> 48 prindër 48%	<b>E</b> 12 prindër 12%
14. Në të ardhmen e-mësimi & m-mësimi plotësisht do ta zëvendësojë mësimin tradicional me klasë virtuale dhe teknika tjera.	<b>A</b> 6 prindër 6%	<b>B</b> 12 prindër 12 %	<b>C</b> 32 prindër 32%	<b>D</b> 39 prindër 39%	<b>E</b> 11 prindër 11%
15. Pengesa më e madhe për përdorimin e e-mësimit & m-mësimit është njohja e teknikave.	<b>A</b> 8 prindër 8%	<b>B</b> 15 prindër 15 %	<b>C</b> 24 prindër 24%	<b>D</b> 41 prindër 41%	<b>E</b> 12 prindër 12%

### 5.8. Sa janë të përgatitur menaxherët e arsimit për zbatimin e platformës së mësimin nga distanca?

Kuadrot arsimore më tepër arrijnë të marrin njohuri për të mësuarit nga distanca nga interneti sesa që u ofrohet ndonjë trajnim bazik për këtë platformë. Edhe pse nevoja për këtë mënyrë të të nxënit është shumë me rëndësi, në veçanti kur dihet se Kosova ende nuk është e pranuar nga një numër i madh i shteteve, që ndikon në lëvizjen e lirë të të rinjve për të studiuar në vendet e treta. Ato pak quadro arsimore që kanë arritur të aftësohen për këtë platformë tashmë janë të angazhuar në ndonjë platformë e-learning. Mbetet të bëhet punë intensive në këtë drejtim. Në anën tjetër kërkohet përkushtim i vazhdueshëm i ministrisë përkatëse dhe drejtorive komunale të arsimit.

Nëse paraqiten faktet se menaxherët e arsimit (në DKA, shkolla (drejtorët, zv.drejtorët etj.) i mbajnë ato pozita falë dëgjueshmërisë dhe lojalitetit ndaj subjektit të tyre politik,

vështirë se ata mund të jenë adekuatë për të bërë ndryshime dhe reforma në arsim. Ata në paraqitjet e tyre trumbetojnë se janë në gatishmëri të plotë për të filluar zbatimin e e-mësimit dhe m-mësimit. Ndërkaq realiteti është krejt ndryshe nga prononcimet e tyre. Nëpërmjet pyetësorëve, intervistave, vizitave dhe konsultimeve do të kemi pasqyrë reale në fund të hulumtimit shkencor.

### **5.9. Ku duhet të ndërhyhet në menaxhimin aktual?**

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës kemi shumë punëtorë të punësuar në të gjitha nivelet e politikëbërjes, në Ministrinë e Arsimit etj. Shumë prej tyre, së paku deri tani, kanë treguar se janë të gatshëm të japin mbështetje profesionale për metodat e reja të mësimdhënies nga distanca nëpërmjet teknologjive të reja elektronike (e-learning). Strukturat relevante menaxheriale të arsimit në nivel qendror dhe lokal nuk janë të përgatitura për të marrë mbi supet e veta që të bëjnë reforma të thella në arsim. Kjo për faktin se:

- Staf i udhëheqës nuk është i përgatitur profesionalisht të implementojnë,
- Drejtorët e shkollave nuk janë të zgjedhur në bazë të meritave dhe përgatitjeve profesionale e shkathtësive të kërkuara për menaxhim të mësimdhënies me metoda të reja.
- Mësimdhënësit nuk kanë ndjekur programe të veçanta për fushën e mësimdhënies nga distanca.
- Prindërit nuk janë të gatshëm të financojnë në pajisje të teknologjive të reja që fëmijët e tyre t'i ndjekin mësimet nga distanca nëpërmjet platformës e-learning.

### **5.10. Analizë dhe përfundime nga intervistat e menaxherëve të institucioneve arsimore në Kosovë**

Në kuadër të hulumtimit ka qenë edhe një intervistë e drejtuar menaxherëve institucionalë, si: drejtorë të shkollave, ndihmës drejtorë, kandidatë për drejtorë, drejtorëve të arsimit në nivel komunash dhe menaxherë tjerë nëpër institucione arsimore. Përmbajtja e kësaj interviste është dhënë në aneks të këtij punimi, si Intervista 1 (për menaxherë). Në këtë intervistë kanë marrë pjesë rreth 50 persona, të cilëve u janë shtruar gjithsej 6 pyetje. Në vijim do të sjellim disa komente të tyre, që i kanë bërë gjatë përgjigjeve që i kanë dhënë në formë të shkruar.

Në pyetjen e parë: *Sa janë të përgatitur menaxherët e arsimit për zbatimin e platformës së mësimin nga distanca?*, veçojmë:

- Me aq sa unë kam njohuri, menaxherët e arsimit janë shumë pak të përgatitur për këtë fushë.
- Menaxherët nuk janë të përgatitur sa duhet, por besoj që për një kohë jo shumë të gjatë do të përgatiten.
- Sipas mendimit tim shumë pak, të mos them fare.
- Janë pjesërisht të përgatitur, pasi jo të gjithë e njohin punën me kompjuter.
- Nuk kam ide.
- Sipas njohurive të mia, ekziston një numër i vogël i këtij lloji të menaxherëve të arsimit, të cilët janë profesionalisht të përgatitur për të ligjëruar për nxënësit apo studentët e tyre, duke përdorur metoda të avancuara, siç është ajo e platformave online.

Në pyetjen e dytë: *Ku duhet të ndërhyhet në menaxhimin aktual?, veçojmë disa përgjigje të menaxherëve apo pretendentëve për menaxherë arsimorë.*

- Ndërhyrja duhet të bëhet në mbajtjen e trajnimeve të vazhdueshme për këtë fushë të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Kjo e forcon edhe më shumë nevojën e mësimin “gjatë gjithë jetës”.
- Qasja në internet, aprovimi i bazës ligjore dhe përmbushja e kushteve materiale.
- Fillimisht duhet të ekzistojnë platforma të tilla. Sipas njohurive të mia, platforma të tilla ka shumë pak në numër dhe ato ekzistuese janë biznese private. Pra, nevoja është të ketë platforma të tilla, të cilat do të ofrohen nga institucionet shtetërore, më saktësisht nga Ministria e Arsimit apo drejtoritë e arsimit në nivel komunal (DKA). Mandej, duhet të përgatiten edhe mësimdhënësit me trajnime adekuate për t’u aftësuar si të përdoren ato dhe po ashtu të trajnohen si duhet t’i përcjellin njohuritë e tyre te studentët apo te nxënësit.
- Duhet të ndërhyhet te mënyra e shpërndarjes së parasë publike. Të bëhet decentralizimi i shkollave, me ç’rast do t’u kthehej buxheti dhe ato t’i bëjnë politikat e tyre për mënyrën e investimeve dhe ndryshimeve në realizimin e planprogramit mësimor të miratuar nga MASHT-i.
- Për realizimin e kësaj platforme, shumë nga intervistuesit mendojnë se duhet të ndahet buxhet shtesë në nivel republikan. Këtë e arsyetojnë me bindjen e tyre se për realizimin e një platforme të tillë nevojitet një buxhet i caktuar.

Pyetjes së tretë: *Sa janë të përgatitur nxënësit të mësojnë nga distanca?, të intervistuarit i janë përgjigjur në këtë mënyrë:*

- Është i vogël numri i nxënësve në Kosovë që mësojnë nga distanca.

- Në bazë të rrethanave, konkludoj se nxënësit me dëshirë do të mësonin nga distanca, meqë ata edhe ashtu kohën më të gjatë e kalojnë pranë kompjuterit të konektuar në internet. Së paku do të kishin dobi me këtë platformë.
- Meqë nxënësit janë avancuar në teknologji, mendoj se në një shkallë janë të përgatitur për këtë mënyrë të të nxënimit.
- Jam skeptik në rezultatin që do të arrihej nga kjo metodologji e të nxënimit, ngase në bazë të përvojës, kam vërejtur se nxënësit janë të prirë më tepër që të kopjojnë sesa të pajisen me dije.
- Meqë i kam mbaruar studimet jashtë Kosovës dhe tani punoj në një institucion arsimor në Prishtinë, Duke iu referuar trendëve evropianë dhe botërorë, mendoj se një numër i konsiderueshëm i nxënësve/studentëve janë të interesuar t'i ndjekin apo vijojnë studimet në distancë. Posaçërisht ata atë cilët janë me punë aktive dhe dëshirojnë njëkohësisht të punojnë dhe t'i vazhdojnë studimet.

Se sa janë të përgatitur prindërit për t'i lejuar fëmijët e tyre që të studiojnë me këtë platformë, veçojmë disa opinione të menaxherëve, që mbase edhe disa nga ata mund të jenë njëkohësisht edhe prindër që ballafaqohen me sfidën e arsimit.

- Prindërit do të hezitojnë ta marrin këtë përgjegjësi. Ata sigurisht do të ndihen të frikësuar nëse fëmijët e tyre do të përfshihen me këtë platformë, ngase mund edhe të humbin motivin për mësim e ta braktisin në tërësi shkollën.
- Këtu mungon besueshmëria pasi brezi i prindërve për moshën e tyre (nuk kanë qenë të informuar me këtë platformë) mund të jenë skeptikë se kjo metodë mund të jetë funksionale.

- Edhe prindërit duhet të informohen më hollësisht për të mirat dhe të këqijat që i ka kjo metodë e të nxënësve. Sigurisht se nevojitet kohë dhe mënyrë për t'u bindur edhe ata se kjo është në dobi të tyre dhe të fëmijëve.
- Te ne kjo është një temë jo shumë e popullarizuar. Prindërit janë pak më të rezervuar në këtë drejtim. Arsyeja kryesore është pasi nuk kanë eksperiencë dhe njohuri se sa kualitative është kjo platformë e të nxënësve.

Pyetja e pestë me radhë ishte: *Sa është e përshtatshme dhe e përgatitur infrastruktura shkollore në Kosovë për këtë model të ri të mësimin? Veçuar disa nga përgjigjet që i morëm:*

- Në shkollën ku unë punoj, infrastruktura është e përgatitur, meqë objekti shkollor është ndërtuar para 5-6 vjetësh. Është ndërtuar me standarde të reja, por shkollës i mungojnë pajisjet teknologjike të nevojshme për këtë mënyrë të mësimin. Po ashtu edhe kuadri arsimor duhet të ndjekë trajnime të thella, ngase në kohën e studimeve të tyre ka munguar teknologjia adekuate. Ia vlen të investohet në këtë drejtim meqë nxënësit edhe ashtu kanë shumë interesim për lëndët fizikë, matematikë dhe TIK.
- Disa nga të intervistuarit konkludojnë se ende jemi larg me përgatitjet e infrastrukturës shkollore, kadrovike dhe menaxheriale.

Skepticizmin në institucionet e shtetit e shprehin edhe menaxherët kur japin përgjigje për këtë pyetje. Kështu përmbledhëm mendimin e disave:

- Momentalisht, në institucionet tona arsimore nuk është e gatshme infrastruktura. Ka disa zëra/lajme që Ministria e Arsimit është duke punuar në digjitalizimin e shkollave të mesme dhe atyre të arsimit të lartë. Ec e beso!



Në pyetjen e fundit: *A e ka integritetin e nevojshëm shoqëria kosovare për ta pranuar këtë metodë mësimi?*, për të cilën veçuar disa përgjigje:

- Pjesërisht po vërehet lëvizje në atë drejtim.
- Duhet t'i ndjekim hapat që i bëjnë vendet e zhvilluara evropiane. Ne duhet të jemi ndjekës së tyre, me qëllim që përvojat e tyre t'i sjellim në Kosovë.
- Mendoj se jo, por shoqëria kosovare duhet ta ketë parasysh faktorin crucial, që rininë ta ketë brenda shtetit të vet, atëherë duhet medoemos të bëjë investime në këtë fushë.
- Çdo fillim është i vështirë, por duhet pa hezitim të ngutemi dhe të arrijmë në hap me kohën. Gjeneratat e reja nuk guxojnë të mbeten peng i së kaluarës sonë të errët në fushën e teknologjive dhe shkencave natyrore. Megjithatë, suksesi nuk do të mungojë.

#### **5.11. Analizë dhe përfundime nga intervistat e komunitetit (njohës të arsimit) në Kosovë**

Nga intervistat me komunitetet shkëputëm përmbledhje të përgjithshme për pyetjet e parashtruara.

*1. Si e shihni mësimin në distancë: luks, nevojë, gjest human apo diçka tjetër?*

Përgjigje:

- a) Mësimi në distancë çdo ditë e më shumë është duke u bërë nevojë, në mënyrë që edhe nxënësit tanë të jenë në trend me zhvillimet ndërkombëtare.
- b) Më shumë si nevojë.

- c) Mësim në distancë është nevojë dhe një mundësi e mirë për nxënësit të mësojnë në kohën që atyre u konvenon.
  - d) Mësimi në distancë, sidomos për një kategori të caktuar qytetarësh, është tani nevojë permanente për të ecur në rrafshin profesional dhe kulturor.
2. *Ku duhet të ndërhyhet në menaxhimin aktual?*

Përgjigje:

- a) Mësimdhënësit, para së gjithash, duhet të jenë të aftësuar për t'i stimuluar nxënësit që ta përdorin edhe mësimin në distancë të kombinuar edhe me materialet tjera mësimore.
  - b) Nuk e di, as që e kam idenë.
  - c) Në sigurimin e infrastrukturës, bazës ligjore, si dhe vetëdijesimi më i madh.
3. *Sa është e përgatitur shoqëria jonë kosovare për mësim në distancë (e-learning)?*

Përgjigje:

- a) Pavarësisht penetrimit të madh të internetit, në Kosovë ende nuk ka një kulturë të përdorimit të internetit për nevoja e arsye edukative. Prandaj, shoqëria jonë duhet të vetëdijesohet më shumë për rëndësinë dhe dobinë e internetit në funksion të edukimit.
- b) Nuk është e përgatitur sa duhet.
- c) Brezi i ri mëton të jetë më i përgatitur nga gjenerata jonë. Arsye sigurisht është se tani të rinjtë çdo ditë përballen me teknologji të reja dhe sigurisht se domosdoshmërisht pajisen me njohuri të reja që kanë të bëjnë edhe me këtë metodë të të nxënit.

4. *Sa janë të përgatitur prindërit për t'i lejuar fëmijët e tyre të studiojnë mësimin nga distanca?*

Përgjigje:

- a) Gjithçka e mirë që mund t'u ofrohet fëmijëve për nevoja të arsimit e edukimit mendoj se pranohet mirë nga prindërit.
  - b) Një fushatë informuese me lehtësi mund t'i sqarojë të gjitha efektet pozitive të të nxënies nga distanca. Natyrisht se edhe anët negative do të nxirren nga vetë prindërit, të cilët pastaj janë të fundit ata që do të vendosnin.
  - c) Prindërit mund të ngrenë me plotë të drejtë edhe dilemën se fëmijët nga ky lloj i të mësuarit mund lehtë ta braktisin shkollën. Do t'u bie motivi shpejt dhe interesimi i tyre nuk do të jetë si në fillim. Nuk do të kisha marrë guximin ta implementoja në plotësi, pa kombinim me mësimin tradicional.
5. *Si do të veproje sikur të ishit personi kyç për fillimin e procesit mësimor kombinuar (blended learning)?*

Përgjigje:

- a) Fillimisht mendoj që duhet të rikonceptohen tekstet shkollore ekzistuese dhe të përgatiten tekste elektronike, interaktive e atraktive. Mandej kjo do të mund të kombinohej mirë edhe me materialet mësimore online.
- b) Mësimi i kombinuar është me përparësi të veçantë. Kombinimi i metodave të reja me ato tradicionalet sigurisht se do ta sillte një freski të gjenerata e re, e cila siç duket se e ka ulur motivin për mësim.
- c) Një kombinim i tillë do të duhej të testohej, e pastaj me një analizë të thelluar me njohës të arsimit do të merrej vendimi përfundimtar.

6. A keni ndjekur ndonjë mësim, kurs apo program të plotë të mësimin e-learning?

*Nëse po, përshkruani përparësitë dhe mangësitë për e-mësim?*

Përgjigje:

- a) Jo.
- b) Kam pasur rast të përcjellë disa leksione të gjuhës së huaj. Jo edhe aq shumë.
- c) Po. Motivi vështirë se mbahet. Të duket se ke mbetur i vetmuar. Shumë shpejt e sheh veten si në “izolim”. Po arrite deri në fund, është ndjenjë e veçantë. Ia vlen të investohet në këtë drejtim.

#### **5.12. Sa e mbështet infrastruktura shkollare në Kosovë mësimin elektronik, e-mësimin?**

Shumë institucione arsimore, në veçanti ato private, punojnë me një hap të nxituar për t’i sjellë të gjitha metodologjitë e reja të të nxënimit. Të mësuarit nga distanca kërkon edhe infrastrukturë adekuate, e cila njëkohësisht ka kosto të lartë, që nuk është edhe e lehtë për kompletim. Ndërsa të nxënimit në distancë paraqet edhe një biznes (Ksenija Klasić, 2003:22), i cili duhet të jetë i decentralizuar dhe jashtë sistemit partiak. Pjesëmarrësit e këtyre shkollave mund të jenë njëkohësisht të gjithë ata që jetojnë në Kosovë, por edhe jashtë saj. Kështu që këto institucione, qofshin publike, private apo edhe publiko-private duhet të jenë plotësisht të pavarura. Pavarësia e tyre (decentralizimi) sjell rezultate, ngase menaxhmenti udhëheqës (Robbins, 2012:166) pa dyshim se këtu mban edhe barrën kryesore, e cila siguron një mbarëvajtje të suksesshme.

Shifrat e investimeve në infrastrukturën arsimore në Kosovë kapin shuma të mëdha. Por, sa janë përshtatur ato për t’i përmbushur kriteret e nevojshme për këtë model të ri të të

nxënit është një pyetje që në vete përmban përgjigje mohore. Tejet larg standardeve është infrastruktura shkollore në Kosovë. Numri i madh i nxënësve në një klasë ka çuar në vendimmarrjen e prindërve për t'i regjistruar fëmijët e tyre në institucione private, në të cilat kostoja e studimit është e madhe për xhepin e tyre. Edhe kuadri arsimor është tejet larg përmbushjes së standardeve përgatitore për ta implementuar këtë model të ri të të nxënit, i cili duhet të jetë ndihmesë e të nxënit tradicional. Në shumë shkolla kemi ende mungesë karrigesh, e tabelat janë po ato të cilat ishin të shumë viteve më parë. Në anën tjetër, kur merret parasysh se sot në shumë vende të rajonit dhe më gjerë, në klasat e tyre (Smart, 2016) moderne përdoren smart board (tabela të mençura) mund të paramendohet se aty veç kemi implementim të e-mësimit dhe m-mësimit. Në klasa të tilla nxënësit ndahen në grupe të vogla dhe marrin pozitat e tyre përreth tabelës së mençur, nga e cila marrin informata të reja, të cilat atyre ua plasojnë mësuesi karizmatik. Po ashtu, në ato tabela shfaqen edhe laboratorë virtualë të shkencave ekzakte, ku nxënësve u është “servuar” një grumbull punimesh nga eksperimentet e përgatitura më parë. Sigurisht se kuadrot e tilla arsimore janë mirë të trajnuara për këtë model të të nxënit. Llogaritjet matematikore, barazimet e reaksioneve kimike, apo gjetja e vendeve të ndryshme në hartat gjeografike do të ishin përmbushje e kërkesave të nxënësve për një mësimnxënie ndryshe (Edukimi, 2016).

Kjo do të ishte ajo që më së paku do të duhej t'u ofrohej fëmijëve kosovarë nëpër klasat e shkollave kosovare.

### **5.13. A është e përgatitur shoqëria kosovare për ta pranuar këtë metodë mësimi?**

Integriteti tashmë është bërë standard, krahas të cilit vlerësohen individët, institucionet, madje edhe shtetet (UNDP, 2015). Shumica e të punësuarve në Kosovë janë në sektorin

shtetëror, ndaj edhe rreziku për shmangie është më i madh. Shoqëria kosovare, e orientuar kah Evropa, përpiqet që t'i aplikojë të gjitha ligjet dhe rregullat tjera ekzistuese të BE-së. Por, edhe një orvatje e tillë për një gjithëpërfshirje dhe gjithështrirje të të mësuarit nga distanca nëpërmjet internetit e-learning, rrezikon uljen e sukseseve individuale dhe institucionale.

Metoda e të mësuarit nga distanca është vazhdimësi e të mësuarit tradicional. Kështu vlerësojnë shumë ekspertë të arsimit nga vendet e zhvilluara. Por sa ka arritur Kosova, si një nga vendet e sapodala nga lufta të integrohet si shoqëri për ta pranuar këtë model mësimi, është çështje tabu.

Ndonëse strategjitë e arsimit kanë hapur mundësinë e një kalimi sa më parë në modelet e reja të të nxënimit, shoqëria kosovare ende është larg realitetit.

#### **5.14. A është mësimi i kombinuar ose i përzier (blended learning) ndryshe nga mësimi në distancë (distance learning)?**

Metodat e reja të të mësuarit i kanë sjellë në lajthitje edhe vetë studiuesit e fushë së arsimit. Me kujdes duhet t'i interpretojmë të gjitha metodat e të nxënimit, gjithnjë duke pasur parasysh që mos t'u humbë efekti metodave tradicionaleve të të nxënimit (Viktoria, 2012). Në këtë kontest nuk është qëllimi që të hidhen metodat e vjetra si të pavlera e të merren metoda të reja si adekuate, të qëlluara dhe të garantuara. Vetë mësimi në distancë ofron një formë të mësimi të kombinuar. Nëse kthehemi në perspektivë, konstatojmë se tradicionalisht arsimit në distancë është mbajtur kryesisht për studentët, të cilët kanë qenë gjeografikisht të izoluar për t'i ndjekur studimet. Asokohe mësimi në distancë është realizuar nëpërmjet valëve të radiove e të televizioneve (Ligjerata, 2016), por tani një gjë

e tillë po realizohet në mënyrë dukshëm më përfshirëse nëpërmjet teknologjive të reja nëpërmjet internetit, i njohur si e-mësimi (e-learning) dhe m-mësimi (m-learning) (Fiz, 2016). Falë kësaj mundësie, tani nxënësit, e sidomos studentët mund ta zgjedhin lirshëm mënyrën e studimit. Tani vijuesit e leksioneve dhe shkollave të ndryshme përdorin studimet e kombinuara, por mjaft shumë i aplikojnë metodat e të nxënimit nëpërmjet internetit, që njihet ndryshe si e-learning. Zakonisht e ndjekin pjesëmarrësit të cilët kanë pak kohë për studime, ngase ata punojnë, apo jetojnë në largësi të madhe nga institucioni, i cili e ofron programin e nevojshëm për studiuesit. Kjo mënyrë e të nxënimit e ul dukshëm koston e shpenzimeve.

Një epërsi e rëndësishme e të mësuarit nga distanca është edhe për atë grup studiuesish, të cilët mund të jenë të privuar nga e drejta e lëvizjes së lirë, që për pasojë mund të jenë nga shumë faktorë, si: zonat e thella në të cilën jetojnë, pengesat në ecje për shkak të ndonjë lëndimi apo kufizimi më të gjatë në ecje, konfliktet e ndryshme familjare, vuajtja e dënimit me burg për shkak të prishjes së rendit dhe të qetësisë, e shumë faktorë të tjerë. Në këto dhe raste të tjera të ngjashme, mësimi në distancë (e-learning) është zgjedhje e qëlluar.

#### **5.15. Çelësi i suksesit në arsim, e-mësimi (e-learning)**

Para se të fillohet me implementimin e një qendre arsimore me mësimnxënie në distancë, natyrisht se duhet të ndërmerren edhe disa hapa krucialë, që llogariten si çelës i suksesit, që sipas (Corry, 2007:63) janë qasjet teknologjike, pajisje adekuate, shkathtësi të larta, komunikim online dhe motivim. Me anë të këtyre tipareve, që sigurisht se çdo menaxher karizmatik i ka parasysh këto dhe shumë strategji të tjera duke e bërë e-mësimin si

garantues i ngritjes së suksesit në një shkollë moderne, e cilësuar si “shkollë pa mure dhe pa kufij”.

Sigurisht se parësore për ta filluar punën në një shkollë virtuale është sigurimi i teknologjive të reja, të cilat duhet t’i përkrahin softuerët e rinj dhe të gjitha programet tjera përcjellëse për emetim të audio e video-sekuencave, të cilat marrin edhe hapësirë të konsiderueshme në hard-disqe. Pajisjet duhet të jenë të përshtatshme dhe t’i përkrahin lidhjet me internet për të qenë efçiente në dërgimin dhe pranimin e materialeve, duke pasur parasysh se pranimi dhe dërgimi i materialeve bëhet nëpërmjet internetit. Ai duhet gjithsesi të jetë i sigurt në qëndrueshmëri, që do të thotë se duhet të sigurohet provideri i përshtatshëm për furnizim me internet. Furnizimi duhet të jetë i dedikuar (dedication), e kurrsesi share (i disponueshëm). Për rrugëtim pa barriera duhet të punojë një ekip i përkryer në këtë fushë shumë të rëndësishme, në mesin e tyre duhet të jenë edhe persona me shkathtësi të veçanta, të cilët lundrojnë nëpër internet për t’i gjetur në çdo kohë gjërat më joshëse dhe më atraktive për funksionalizim të mësimin në distancë nëpërmjet e-mësimin (e-learning). Motivimi i pakontestueshëm është një faktor, i cili dosido është pjesë e planit për sukses të një qendre të re arsimore me mësim në distancë, e-learning.



## **KAPITULLI VI PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME**

Ky kapitull përmbledh diskutimet e hulumtimit, të cilat janë realizuar nëpërmjet pyetësorëve dhe intervistave. Nga analizat e realizuara në kapitullin paraprak, nëpërmjet programit kompjuterik SPSS versioni 22, janë nxjerrë konkluzionet dhe rekomandimet, të cilat përfshihen në këtë kapitull. Rekomandimet u drejtohen institucioneve arsimore, të cilat drejtpërdrejt përfshihen në përpilimin e planprogrameve dhe politikave për ndryshime, ndërhyrje dhe mbikëqyrje të të gjitha punëve që bëhen nëpër shkolla publike dhe private. Rekomandimet u dedikohen edhe prindërve, mësimdhënësve, njohësve të arsimit dhe të gjithë të tjerëve që janë të lidhur direkt apo indirekt me mbarëvajtjen e arsimit. Të gjitha këto bëhen me qëllim që nxënësit të fitojnë njohuri të reja dhe të arrijnë në realizimin e hulumtimeve të reja në fushën e tyre të zgjedhur për studim.

### **6.1. Diskutime**

Në vijim trajtohen diskutimet e çështjeve dhe rezultateve të dala nga hulumtimi. Diskutimet nxirren nga pyetjet dhe përgjigjet si rezultat i realizimit të pyetësorëve dhe të intervistave. Varësia e variablës e-learning nga variablat e pavarura shprehet nëpërmjet përfundimeve të faktorëve që ndikojnë në rritjen e rezultateve të suksesit të nxënësve në mësimnxënie, si dhe mësimdhënies nga mësuesit e lëndëve përkatëse.

Pjesë e diskutimeve janë edhe kufizimet në të cilat ka hasur studimi, besueshmëria e hulumtimit, shkalla e pjesëmarrjes në hulumtim, sinjifikanca, vlefshmëria statistikore, përqindja e pjesëmarrjes së respondentëve për të arritur në mbrojtjen apo hedhjen poshtë

të hipotezës lidhur me të nxënit nga distanca nëpërmjet e-learning karshi mësimin tradicional.

*6.1.1. Diskutim lidhur me faktorët që ndikojnë në ngritjen e cilësisë në mësimnxënie nëpërmjet e-learning*

Përcaktimi i faktorëve që ndikojnë në ngritjen e cilësisë së mësimnxënies nuk është edhe aq i lehtë. Të mësuarit nuk fillon dhe nuk mbaron gjatë një ore mësimore. Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ka ndikuar që të paraqiten kërkesa të reja dhe ndërhyrje të shpejta në metodologjitë e të nxënit. Nëpërmjet rishikimit të literaturës janë paraqitur faktorët, të cilët kanë ndikuar në vende tjera për të nxënit nga distanca nëpërmjet e-learning.

Mësimnxënia gjithnjë ka qenë dhe si e tillë po vazhdon të mbetet në të mësuarit në Kosovë. Sfidë e studimit ishte gjetja e faktorëve, të cilët ndikojnë në e-mësim. Prandaj, e-mësimi që në fillim të këtij hulumtimi bëhet variabël e varur. Varshmëria e saj lidhet me variabla të ndryshme të cilat njihen si të pavarura: *mosha, përvoja e punës e mësimdhënësve, përdorimi i PC, qasja në internet, e-mail, komunikimi, interneti për ngritje profesionale, platforma online dhe vlerësimi.*

Në hulumtim morën pjesë mësimdhënës dhe nxënës, në të cilin disa variabla të pavarura janë të njëjta, prandaj ato janë indeksuar me  $\_nx$  (variablat e pavarura të nxënësve). Mbi bazën e variablave përpilohen tri lloje pyetësorësh, të cilët janë për mësimdhënës, nxënës dhe prindër. Po ashtu, janë edhe dy lloje të intervistave drejtuar menaxherëve institucionalë dhe njohësve të arsimit. Pas mbledhjes së pyetësorëve dhe intervistave bëhet verifikimi i tyre dhe pastaj analiza e besueshmërisë, e cila shprehet me koeficientin Alfa i Cronbach-ut, vlera e së cilës sillet nga  $\alpha=0,60-0,70$  (Myers, 2003). Nga tabela 19,

që gjendet në kapitullin e pestë të këtij hulumtimi, lexohet vlera e koeficientit të besueshmërisë Cronbach's Alpha,  $\alpha=0,646$ , për të gjitha variablat e pavarura dhe të varura të këtij hulumtimi. Prandaj, të gjitha variablat e përdorura janë të besueshme dhe të mjaftueshme për analizën e të dhënave. Lidhja ndërmjet variablave është vërtetuar nëpërmjet metodës statistikore Chi Scuar dhe vlerës së saj të rëndësisë (domethënies). Nëse plotësohet kushti ( $p<0,05$ ), atëherë konkludohet se ndërmjet dy variablave ekziston ndryshim sinjifikant.

Cili ishte opinionioni i mësimdhënësve për e-mësimin?

Në këtë hulumtim, në të cilin morën pjesë 100 mësimdhënës, për mësimin në distancë (e-learning) kishin këtë opinion: se e-learning është inovacion përgjigjen 37 mësimdhënës, e-learning nuk ofron lajm të veçantë kanë deklaruar 31 mësimdhënës, 10 mësimdhënës mendojnë se krijohen lidhje të reja: mësues-nxënës dhe e-learning, dhe shfaq qasje të reja kanë thënë 22 mësimdhënës.

#### *6.1.2. Diskutimi i varshmërisë së e-learning nga mosha dhe nga përvoja e mësimdhënësve*

Në bazë të analizës së nxjerrë nga pyetësorët e mësimdhënësve që patën të bënin me moshën e mësimdhënësve dhe përvojën e tyre të shprehur në vite, del se variabla e varur e-learning në mënyrë sinifikante është e varur nga mosha e mësimdhënësve dhe përvoja e tyre e punës. Kjo është shprehur nëpërmjet të vlerës së sinjifikantës, që në literaturë shprehet me treguesin (indeksin)  $p<0,05$ . Të gjitha vlerat nën 0,05, ose shprehur në përqindje që janë nën 5%, janë të justifikueshme, gjë që tregon se janë të varura ndërmjet

vete. Siç është treguar në kapitullin Analiza e pyetësorëve, shihet se 75% e mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim ishin të moshës së re (deri 35 vjeçe), nga 36-45 vjeçe ishin 14%, 49-60 vjeçe, 6% dhe me moshë mbi 60 vjeçe ishin 5% e mësimdhënësve pjesëmarrës në këtë hulumtim. Rritja e numrit të mësimdhënësve me moshë të shtyrë në procesin e mësimdhënies nga distanca nëpërmjet platformës e-learning, ndikon direkt në uljen e suksesit të kësaj platforme.

Gjithashtu, edhe përvoja e punës së mësimdhënësve në fakt lidhet me moshën. Nëse një mësimdhënës i përfshirë në këtë hulumtim ka përvojë të gjatë të punës, domosdoshmërisht ai ka edhe moshë më të madhe. Përjashtimet në këtë karakteristikë mund të vlejnjë për të ardhmen, kur mund të kemi mësimdhënës që nuk kanë arritur të punësohen me përfundimin e studimeve, gjë kjo shumë e kuptueshme për faktin se mësimdhënësit të cilët nuk kanë qenë pjesë e subjekteve politike nuk kanë arritur të punësohen, kështu që mosha e tyre nuk lidhet me përvojën e punës.

Nga analiza e këtij hulumtimi del se varshmëria e variablës e-learning lidhet me përvojën e punës, e këto dy variabla janë sinjifikante, meqë vlera e p-së është shumë më e vogël se kufiri 0,05 ( $p < 0,05$ ).

*6.1.3. Diskutimi i varshmërisë së variablës e-learning nga variablat tjera të pavarura: përdorimi i PC, qasja në internet, e-mail, komunikimi, interneti për ngritje profesionale, platforma online dhe vlerësimi*

Nga gjetjet në terren është vërtetuar se variabla e varur e-learning varet nga variablat e pavarura: përdorimi i PC, qasja në internet, e-mail, komunikimi, interneti për ngritje

*profesionale, platforma online dhe vlerësimi.* Me anë të analizës statistikore në të gjitha rastet vërehet se vlera e probabilitetit (p) del të jetë më e vogël se 0,05, me ç’gjë konkludohet se ndërmjet variablës së varur dhe variablave të pavarura ekziston varshmëria, që do të thotë se ndërmjet tyre ka sinjifikancë të theksuar. Paraqitja tabelare shihet në tabelën 77.

**Tabela 77.** Pearson Chi-Square dhe Likelihood Ratio për variablën e varur dhe variablat e pavarura të mësimdhënësve

Variabla e varur	Variabla e pavarur	Pearson Chi-Square			Likelihood Ratio		
		Value	df	p<0.05 (sinifikanca)	Value	df	p<0.05 (sinjifikanca)
<i>e-learning</i>	<i>Mosha</i>	38,877 <sup>a</sup>	9	.000	31,993	9	.000
	<i>përvoja</i>	31,219 <sup>a</sup>	9	.000	28,649	9	.001
	<i>përdor. PC</i>	20,279 <sup>a</sup>	6	.002	20,205	6	.003
	<i>qasja intern.</i>	33,544 <sup>a</sup>	6	.000	27,067	6	.000
	<i>e-mail</i>	17,650 <sup>a</sup>	6	.007	19,273	6	.004
	<i>komunikimi</i>	10,657 <sup>a</sup>	3	.014	13,359	3	.004
	<i>int.për ngr.</i>	20,948 <sup>a</sup>	6	.002	21,796	6	.001
	<i>plat. online</i>	14,914 <sup>a</sup>	3	.002	14,934	3	.002
	<i>vlerësimi</i>	23,181 <sup>a</sup>	12	.026	26,660	12	.009

#### 6.1.4. Varshmëria e variablës e-learning nga variablat e pavarura të nxënësve

Mësimnxënja tradicionale dhe ajo në distancë nëpërmjet platformës e-learning zhvillohet te nxënësit, përkatësisht te studentët. Në këtë studim është bërë studimi për të nxënësit nga

distanca nëpërmjet platformës e-learning. Kjo platformë zë fillimet e para të interesimit për të filluar në Republikën e Kosovës. Studimi pati për qëllim të nxjerrë në pah se sa është e përgatitur shoqëria kosovare për të zënë nëpërmjet kësaj platforme. Nxënësit kanë qenë një nga faktorët kyç në këtë platformë. Pyetësor i veçantë është përgatitur për ta, përmbajtja e të cilit paraqitet në fund të këtij hulumtimi si Pyetësori P2. Variabla e varur e këtij studimi është e-learning. Variablat e pavarura janë të ngjashme me ato të mësimdhënësve, dallimin e tyre e gjeni te variabla e pavarur\_nx: *përdorimi i PC, qasja në internet\_nx, posta elektronike\_nx, komunikimi e-mail\_nx, mësimi në distancë\_nx, platforma online\_nx dhe vlerësimi.*

Nëpërmjet analizës statistikore vërehet se vlera e probabilitetit (p) del të jetë më e vogël se 0,05, për çka konkludohet se ndërmjet variablës së varur dhe variablave të pavarura ekziston varshmëri, që do të thotë se ndërmjet tyre ka sinjifikancë të theksuar. Paraqitja tabelare shihet në tabelën 78.

**Tabela 78.** Pearson Chi-Square dhe Likelihood Ratio për variablën e varur dhe variablat e pavarura të nxënësve

Variabla e varur	Variabla e pavarur	Pearson Chi-Square			Likelihood Ratio		
		Value	df	p<0,05 (sinjifikanca)	Value	df	p<0,05 (sinjifikanca)
<i>e-learning</i>	<i>përdor. PC</i>	15,957 <sup>a</sup>	6	.014	16,923	6	.010
	<i>qasja intern.</i>	9,361 <sup>a</sup>	3	.025	9,287	3	.026
	<i>e-mail</i>	9,848 <sup>a</sup>	3	.020	10,224	3	.017

Menaxhimi i institucioneve arsimore me mësimnxënie në distancë: e-learning

	<i>komunikimi</i>	9,361 <sup>a</sup>	3	.025	9,287	3	.026
	<i>int.për ngr.</i>	15,487 <sup>a</sup>	6	.017	16,000	6	.014
	<i>plat. online</i>	6,979 <sup>a</sup>	3	.073	7,104	3	.069
	<i>vlerësimi</i>	46,174 <sup>a</sup>	12	.000	53,652	12	.000

Në tabelën 78 është paraqitur varshmëria e variablës së varur e-learning nga variablat e pavarura. Siç shihet, e-learning varet nga ajo se sa e përdorin kompjuterin nxënësit, ngase mësimi nëpërmjet kësaj platforme lidhet direkt me përdorimin e kompjuterit. Natyrisht se me zhvillimin e hovshëm të TIK-ut nuk janë më të kufizuar vetëm kompjuterët desktop PC (Personal Computer), por tashmë janë në përdorim llaptopët, tabletët, si dhe një varg pajisjesh smart (të mençura), të cilat konjektohen me internetin nëpërmjet rrjetit pa kablo wi-fi. Të gjitha këto dhe pajisjet tjera në përdorim nënkuptojnë variablën e pavarur, *përdorimi i PC*. Sinjifikanca e ka vlerën më të vogël se 0,05 dhe siç është konstatuar edhe te analiza e pyetësorëve, vlen pohimi se variablat e-learning dhe përdorimi i PC janë të varura ndërmjet vete, për çka thuhet se ato janë sinjifikante ( $p < 0,05$ ).

Varshmëria e suksesit të të nxënit nga distanca nëpërmjet platformës e-learning është edhe me qasjen në internet. Vetvetiu është e nënkuptueshme se këto dy variabla janë skajshmërisht të varura ndërmjet vete, ngase të nxënit e-learning është e pamundur të realizohet pa qasje në internet. Të nxënit nëpërmjet e-learning mund të bëhet edhe nëse qasja është offline, me kusht që më parë janë shkarkuar mësimet dhe tani ato mund të përcillen nga hard disku. Kjo qasje është e kufizuar, ngase nuk mund të komentohet, diskutohet, kthehen përgjigje apo pyetje të çfarëdoshme kolegëve, përkatësisht

mësimdhënësve. Nga tabela 78 shihet se vlera e sinjifikancës është  $p < 0,05$ , për çka me të drejtë është konkluduar se këto variabla janë sinjifikante.

Nxënësit janë pyetur po ashtu nëse e përdorin internetin për ngritje profesionale. Qëllimi me këtë ka qenë të dimë se sa nxënësit kanë përvojë në platforma digjitale të të nxënit nga distanca. Me analizën nëpërmjet programit SPSS, nga tabela (78) shihet se ekziston lidhje sinjifikante ndërmjet variablës e-learning dhe përdorimit të internetit për ngritje profesionale, ku  $p < 0,05$ .

Ekziston varshmëri ndërmjet variablës së varur e-learning dhe platformës online. Nxënësit të cilët kanë përdorur platformë online, të cilat kanë të bëjnë me të nxënit nga distanca, kanë deklaruar edhe vlerësimin e atyre platformave që ata i kanë përdorur. Kështu që varshmëria ndërmjet variablës e-learning dhe variablave të pavarura: platforma online dhe vlerësimi i platformave online, është sinjifikante, meqë  $p < 0,05$ .

#### *6.1.5. Diskutime lidhur me intervistën me menaxherë*

Sistemi arsimor në Kosovë është në integrim të vazhdueshëm. Gjatë këtyre viteve të pasluftës janë bërë ndërhyrje të shpeshta, të cilat nuk kanë qenë vazhdimësi e një platforme paraprake. Kjo ka ndikuar që të radhitet si shtet në pozitë skajshmërisht të fundit në shumë vlerësime që bëhen nga organizata kredibile ndërkombëtare të arsimit. Edhe vetë akreditimi i institucioneve arsimore bëhet pas vlerësimit të jashtëm që i bëhet programit të caktuar. Në të gjitha institucionet arsimore qeveritare apo lokale ka një numër të konsiderueshëm menaxherësh, të cilët janë të angazhuar për mbarëvajtjen dhe reformat në arsim. Njëra nga pyetjet drejtuar disa menaxherëve për ta dhënë opinionin e



tyre sa janë të përgatitur menaxherët institucionalë për të nxënit nga distanca, shumë nga ta si arsye e theksojnë faktin se shoqëria kosovare nuk është ende e përgatitur për udhëheqje të kësaj platforme, se disa ende nuk dinë ta përdorin kompjuterin, se nuk janë kushtet tjera të përshtatshme, si dhe se mungon infrastruktura adekuate, e cila do të mundësonte një mësimnxënie kualitative nëpërmjet kësaj platforme.

Ndërhyrjet e nevojshme që duhet të bëhen në sistemin arsimor, menaxherët përmendin shumë pista: trajnime të vazhdueshme, nga organizata kredibile, buxhet më të lartë për shkollat që do të fillonin këtë lloj mësimnxënie, rritje e motivit të mësimdhënësve (duke ua rritur të ardhurat dhe benifite të tjera), mosndërhyrje të politikës në fushën e arsimit, analizë e hollësishme për ngritje të suksesit të nxënësve, marrje e përgjegjësisë së kreut udhëheqës në rast të dështimit të kësaj platforme, bashkëbisedimi me prindër se sa ata janë të gatshëm me eksperimentime të vazhdueshme ndaj fëmijëve të tyre, përgatitja e infrastrukturës, e cila është në nivelin më të ulët të mundshëm për këtë lloj të të nxënit.

#### *6.1.6. Diskutime lidhur me intervistën me njohës të arsimit*

Aktorë tjerë me rëndësi të veçantë të të nxënit janë njohësit e arsimit. Profesionit i tyre ka të bëjë me këtë fushë, prandaj edhe mendimet e tyre ngjallin diskutime, të cilat janë të rëndësisë së veçantë për dhënien e dritës jeshile të të nxënit nëpërmjet platformës e-learning. Opinione të tyre i kanë shprehur nëpërmjet intervistës së tyre, që është dhënë në shtojcën e këtij punimi si Intervista 2 (për komunitet).

Të nxënit nga distanca nëpërmjet platformës online e-learning zgjon një interesim të jashtëzakonshëm për njohësit e kësaj fushe. Thuaja të gjithë e shohin si të nevojshme këtë mënyrë të të nxënit, ngase shumë kushte janë plotësuar që edhe ne si shoqëri të jemi në hap me kohën. Nuk e shohin si të pamundur që nxënësit ta akceptojnë këtë platformë. Më

shumë si e pamundur shihet përgatitja institucionale, infrastruktura, mësimdhënësit, menaxherët, ndërhyrjet politike, mospërkrahja nga shoqëria civile, e shumë faktorë të tjerë.

Analistët e fushës së arsimit mendojnë se ndërhyrjet të cilat janë të nevojshme të bëhen janë:

- trajnimet adekuate dhe të vazhdueshme për mësimdhënësit, të cilët do të përgatiteshin në mënyrën më të mirë për këtë platformë mësimdhënieje,
- përgatitjet e infrastrukturës adekuate, e cila i plotëson kriteret e të nxënësve elektronik e-learning,
- orari fleksibil për nxënësit që ata të mësojnë kur atyre u konvenon dhe jo kur e kanë orarin e caktuar që për ta mund të jetë si diçka e imponueshme,
- baza ligjore, e cila do ta rregullojë njehsimin e atyre diplomave në mënyrë të menjëhershme nga institucionet shtetërore me të drejtë vazhdimi të studimeve edhe jashtë vendit,
- fushatë informuese për prindërit që të binden se ky lloj i të nxënësve është përdorur në vendet e rajonit dhe të BE-së,
- fillimi me mësim të kombinuar për të arritur deri te pavarësimi i plotë i kësaj platforme,
- rritja e motivit të të gjithë faktorëve kyçë të kësaj platforme.

Diskutimet, studimet, analizat, konkluzionet, nevojat dhe kërkesat për të nxënësve nga distanca nëpërmjet e-learning nuk janë domosdoshmërisht faktorë vendimtarë, të cilët do t'i çonin institucionet arsimore publike apo jopublike deri te vendimmarrja për transformim të tyre në këtë lloj të të nxënësve. Kjo kërkon kohë dhe përgatitje adekuate

profesionale për të qenë të gatshëm me implementimin e të nxënies nga distanca nëpërmjet e-learning.

Vendimet e shpejta dhe pa u cekur përgjegjësia në rast të dështimit të një sistemi të ri arsimor ka sjellë deri te dështimet e shumta që janë bërë në ndërhyrjet e shumta gjatë këtyre viteve.

Derisa politika të qëndrojnë mbi kokën e menaxherëve të arsimit në të gjitha nivelet, duke shkuar edhe deri në institucionin më të lartë - Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, kjo ka sjellë deri te dështimet e vazhdueshme dhe mosdhënien e llogarisë të askujt dhe ndaj askujt.

Shoqëria kosovare është stërngopur me dështime në arsim, ndërsa arsimi është shtylla themelore e një shoqërie njerëzore. Pavarësimi i tij do të jetë pikë zero e fillimit të përparimit të platformës së mësimnxënies së mirëfilltë në Republikën e Kosovës.

## **6.2. Përfundime**

Shoqëria kosovare e ka si top-prioritet korrjen e suksesit në fushën e arsimit. Për këtë, edhe qeveritë të cilat vijnë e shkojnë e kanë gojën plot me premtime se në çdo kohë janë të përkushtuara për t'i gjetur projektet më të mira të cilat do të korrin sukses në mësimdhënie dhe mësimnxënie në institucionet arsimore. Rezultatet e përpjekjeve të tilla janë dështimet në të gjitha sferat e kësaj fushe. Raporti i fundit nga rezultati i PISA-s ka thënë gjithçka për arsimin tonë kosovar. Sistem i dështuar dhe pa marrje të përgjegjësisë nga askush, si dhe pa penalizim të asnjë sektori, flet për gjendjen e katandisur mbi të cilën qëndron politika e dështuar kosovare, veçmas në fushën më të ndjeshme - atë të arsimit. Arsimi kosovar është skajshmërisht i politizuar. Nuk ka drejtor shkolle që mund të

zgjidhet nëpërmjet konkursit publik pa kaluar në filtrat më të shpeshtë të politikës udhëheqëse mbi atë institucion. Nuk mund të zgjidhet asnjë menaxher apo kohëve të fundit qoftë edhe ndonjë koordinator shkolle, i cili nuk i është nënshtruar politikës ditore të subjektit që qëndron në krye të atij rrethi. Mjerimi vazhdon edhe në zgjedhjen e kuadrove arsimore, për të shkuar deri te pranimi i studentëve të rinj, të cilët zgjedhin për studim mësimdhënien. Për këtë, politikëbërja kosovare duhet ta dëgjojë zërin e njohësve të arsimit për ta ndërtuar një strategji të re, e cila do të fillojë me mësimnxënie të reja, të cilat në vendet e BE-së, në SHBA etj., është treguar e suksesshme dhe lehtë e aplikueshme. Ky studim e ka pasur pikërisht qëllimin që t'i nxjerrë në fund konkluzionet dhe rekomandimet, të cilat do të jenë ndihmesë për qeveritarët e sotëm dhe ata të cilët pasojnë. Të mësuarit nga distanca e-elarning do të mund të implementohet edhe në institucionet e Kosovës sikur të bëhej ndërhyrja e nevojshme dhe adekuate në të gjitha pikat kyçe të arsimit. Në vijim janë paraqitur konkluzionet të cilat janë rezultat i analizës së këtij hulumtimi.

- i) *Kosova e ka një kuadër ligjor të pamjaftueshëm për rregullimin e të mësuarit në distancë*

Për të filluar me implementimin e të mësuarit nga distanca nëpërmjet platformës e-learning, Kosova nuk ka kuadër të mjaftueshëm për ta implementuar atë. Për këtë duhet të bëhen ndërhyrjet adekuate në këtë fushë. Të sillen kuadrot e reja nga vendet në të cilat kanë shkuar të rinjtë shqiptarë për të studiuar. Ata mund të kthehen me përkrahje të rezervë, duke ua plotësuar kushtet dhe kërkesat që rezultojnë t'i kenë në vendet ku ata ndodhen tani. Po ashtu, sistemi ynë arsimor të fillojë sa më parë me përzgjedhjen e studentëve të rinj, të cilët i përmbushin kriteret për të dalë në të ardhmen kuadro të

përgatitura në mënyrën më të mirë të kërkuar për implementimin e të nxënimit nëpërmjet platformës digjitale, e-learning.

- ii) *Platforma e-learning në shkollat e Kosovës është e pazhvilluar në masën e duhur*

Nëse shfletojmë platforma online në internet lehtë mund të përfundojmë se çka duhet të ketë një institucion arsimor kosovar për t'i plotësuar kriteret e të qenët shkollë që përmbush standardet për platformën e-learning. Kjo e ka koston e vet të investimit, të cilin mund ta mbulojë shteti. Për këtë është domosdoshmëri që shkollat e kësaj fushe të jenë të zhvilluara në masën e kërkuar për realizimin e të nxënimit të suksesshëm për brezat e rinj. Investimi në këtë fushë do ta rrisë zhvillimin e ekonomisë së vendit, ngritjen e kuadrove të reja dhe zbulimet e aplikimet e metodologjive të reja, të cilat me hov të madh zhvillohen në fushën e TIK-ut.

- iii) *Pritshmëria për të mësuarit në distancë nuk është realizuar deri më tani*

Të mësuarit në distancë në Kosovë nuk haset për të parën herë në këtë studim. Këtë term e gjejmë edhe në Ligjin për akreditim të institucioneve arsimore. Po ashtu, edhe MASHT, DKA, si dhe në institucione tjera të pothuajse të gjitha ministrive të Qeverisë së Kosovës në politikat e veta ditore dhe për konsum ditor kanë të ngërthyer, por rrjedhimisht deri tani ato kanë dështuara për ta realizuar këtë platformë të të nxënimit, të cilën paraprakisht e gjejmë të suksesshme në vendet me demokraci të zhvilluar dhe aty ku synohet ngritja e rezultateve të të nxënimit. Këto pritshmëri, të cilat janë premtime permanente, deri më tani

nuk janë realizuar në Kosovë. Mospërbushja e tyre do të duhej të pasonte me llogaridhënie para nxënësve, të cilët janë ardhmëria e shtetit.

*iv) Të mësuarit në distancë është i kufizuar në nivelet e arsimit parauniversitar*

Të mësuarit në distancë nuk duhet dhe nuk mund të ketë kufizime. Ai mund të aplikohet në të gjitha nivelet e arsimit. Kushtet që duhet të plotësohen janë pothuajse të njëjta për të gjitha nivelet. Ato duhet të kenë trajtim të veçantë në përmbushjen e kriterëve dhe standardeve, si të vendeve të zhvilluara, që i kanë prioritet reformat në arsim. Në Kosovë, të mësuarit në distancë ka kufizime të cilat reflektojnë direkt në realizimin e të nxënit nga distanca, edhe në arsimin parauniversitar. Dihet se arsimi parauniversitar është obligativ në Kosovë. Së paku në këtë nivel investimet qeveritare do të duhej t'i përmbushnin kriteret e parapara për realizimin e të nxënit nga distanca, nëpërmjet TIK-ut, me platformën e-learning. Ndërhyrja e menjëhershme nga Qeveria do të duhej të ishte në plotësimin e kushteve të cilat parashihen për realizimin e të nxënit nëpërmjet teknologjive të reja. Ky kriter është obligativ dhe duhet të plotësohet sa më parë.

*v) Kosova ka burime njerëzore dhe kapacitete institucionale të pamjaftueshme për rregullimin e të mësuarit në distancë*

Të mësuarit në distancë është mjaft i komplikuar. Për realizimin e kësaj platforme është e nevojshme të plotësohen një varg kushtesh dhe kriteresh. Ato nuk janë domosdoshmërisht të lidhura me investimet materiale. Secili vend, përfshirë Kosovën, duhet të ketë burime të mjaftueshme njerëzore dhe kapacitete institucionale për

rregullimin e të mësuarit në distancë, të njohur si e-learning. Përmbushja e kriterit më të rëndësishëm, që është faktori njeri, nuk është fare e lehtë të plotësohet. Duke u bazuar në faktin se Kosova ka kaluar nëpër labirinte të vështira, duke mbijetuar gjithnjë nga krahurat e pushtesve, ajo e ka trashëguar një ekip të mbijetesës dhe tani është tejet vështirë për t'i plotësuar kërkesat dhe nevojat e të nxënës nga distanca. Në anën tjetër, pikërisht për shkak të vështirësive të cekura, shumë familje gjatë viteve të '90-ta patën marrë rrugën e mërgimit. Fëmijët e tyre sot janë bërë kuadro, të cilat janë të kërkuara për të gjitha vendet e Perëndimit. Kuadrot e tilla duhet të përkrahen për t'i kthyer në vendlindje, me çka do të plotësohej kriteri i burimeve njerëzore për plotësimin e kapaciteteve institucionale të nevojshme për e-learning.

*vi) Politizimi i sistemit arsimor, pengesë për eficientësinë e të mësuarit në distancë*

Sistemi arsimor i të gjitha niveleve është “i ngulfatur” nga politika ditore e partive politike, të cilat janë në pushtetin qendror apo lokal. Ky politizim ndikon direkt në eficientësinë e të mësuarit në distancë. Kuadrot e zgjedhura apo të emëruara në këto institucione nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për realizimin e të nxënës nëpërmjet teknologjive të reja.

## **7.2. Rekomandime**

Ky punim doktoresh është njëri ndër hulumtimet e para që ka të bëjë me të mësuarit në distancë nëpërmjet mësimit elektronik (e-learning). Për realizimin e mirëfilltë të të nxënës në distancë nëpërmjet platformës e-learning nuk janë të mjaftueshme vetëm rekomandimet që dalin nga ky hulumtim, por do ta riaktualizojë sadopak nevojën që e ka Kosova në përmbushjen e misionit për të arritur që nxënës kosovarë ta kenë

mundësinë e të mësuarit edhe nëpërmjet platoformës e-learning. Sidomos pavarësimi i institucioneve arsimore nga politika është një pikëkthesë për krijimin e kushteve të parapara për mësim elektronik.

Për t'i rikujtuar të gjithë ata që janë të emëruar dhe ata që po e pengojnë këtë platformë numërohen disa rekomandime, si në vijim:

- i) Sistemi arsimor kosovar ka nevojë ta plotësojë kuadrin ligjor për ta rritur eficiencën e të mësuarit në distancë. Kjo do të arrihej duke i ekuivalentuar ligjet e BE-së me ato të Republikës së Kosovës, si dhe me sjelljen e përvojave nga vendet e zhvilluara në sistemin ligjor kosovar do të shtohet efektiviteti i të nxënimit me metoda të reja;
- ii) Sistemi arsimor kosovar ka nevojë për përgatitjen e burimeve njerëzore dhe për forcimin e kriterëve të punësimit të mësimdhënësve për ta rritur eficiencën e të mësuarit në distancë. Kjo do të arrihet duke i decentralizuar ato, për të mundësuar që punësimet të bëhen jo me preferenca politike, por sipas meritave profesionale dhe intervistave nga një panel i pavarur intervistues;
- iii) Sistemi arsimor kosovar ka nevojë për zhvillimin e kapaciteteve institucionale dhe menaxhuese për ta rritur eficiencën e të mësuarit në distancë, në drejtoritë komunale të arsimit (DKA), divizionet e arsimit dhe aftësimin profesional (DAAP), në kuadër të MASHT, në AAAP dhe ARR, në Institutin Pedagogjik (IP), në Sektorin për Arsim dhe Aftësim Profesional (SAAP), që funksionon në kuadër të MPMS, në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve (AKK) etj.;
- iv) Të mësuarit në distancë mund të aplikohet edhe në sistemin e arsimit të lartë. Të mësuarit në distancë do të duhej të zhvillohej edhe në sistemin e arsimit të lartë në Kosovë. Studimet e sotme mund të jenë jashtëzakonisht të lehta po që se



studentëve u ofrohen platforma online të të nxënit nëpërmjet e-learning. Pajisjet të cilat janë të nevojshme për t'i pranuar mësimet nëpërmjet e-learning, të njohura si SMART-pajisje nuk kanë kosto të lartë, për çka studentët do të mund të furnizoheshin me to. Ajo që duhet të bëhet nga investimet kapitale qeveritare është plotësimi i infrastrukturës së nevojshme në sistemin e arsimit të lartë. Realizimi i këtyre kriterëve do të siguronte një garanci për mësim të suksesshëm dhe efikas për gjeneratat e reja, të cilat janë e tashmja dhe e ardhmja e vendit;

- v) Për nxitjen e realizimit të të mësuarit në distancë eficient, si edhe për modernizimin e mësimdhënies në nivelet parauniversitare duhet të aplikohet një paketë masash kalimtare, e cila duhet të përfshijë:

- *Mësimdhënësit mbi moshën 60 vjeçe të shkojnë në pension të parakohshëm*

Lirimi i mësimdhënësve nga detyra, të cilën e mbajnë mbi supë të veta, do të hapte rrugë për inkuadrim të kuadrove të reja, që të fillohet me implementimin e mësimdhënies nga distanca. Ky përfundim është rrjedhojë e realizimit të intervistave dhe pyetësorëve të këtij hulumtimi. Variabla e varur e këtij hulumtimi, e-learning, pati varshmëri nga mosha e mësimdhënësve dhe përvoja e tyre e punës. Me rritjen e numrit të mësimdhënësve të moshës mbi 60 vjeçe direkt do të ulej sinjifikanca e të mësuarit, e-learning. Në anën tjetër, sikur rritej numri i mësimdhënësve deri në moshën deri 35 vjeçe, rriste edhe variablën e-learning. Për plotësimin e këtij faktori është e domosdoshme të merret parasysh mosdëmtimi i gjeneratës së artë të mësimdhënësve të moshës mbi 60 vjeçe. Kjo do të bëhej në marrjen e pagës së plotë deri në moshën 65 vjeçe, atëherë kur edhe është koha e

pensionimit të tyre. Kjo do të arrihej me një marrëveshje të vullnetshme për secilin mësimdhënës. Në të kundërtën, do të ishte shkelje e të drejtave të njeriut.

○ *Mësimdhënësit mbi moshën 55 vjeçe të kenë ndihmës-mësimdhënës*

Për realizimin e të nxënimit në distancë nëpërmjet e-learning, mësimdhënësit të cilët e kanë mbushur moshën 55 vjeçe do të duhej të kenë ndihmës-mësimdhënës. Kjo do të ndihmonte që përvoja e mësimdhënësit të karrierës të bartej te mësimdhënësi i ri dhe po ashtu ndihmës-mësimdhënësi ta ndihmonte mësimdhënësin në realizimin e planprogramit mësimor të reformuar në mësim elektronik, e-learning. Rregullimi i të ardhurave mujore do të realizohej me anë të një ligji që lehtë mund të miratohej pa i shkelur të drejtat ligjore të mësimdhënësit. Kjo nuk do ta dëmtonte buxhetin qeveritar, ndërsa do ta rriste efikasitetin e të mësuarit te brezat e rinj.

○ *Mësimdhënësit mbi moshën 50 vjeçe të jenë mësimdhënës vullnetarë*

Aprovimi i një udhëzimi administrativ (UA) të veçantë, që ka të bëjë me punën vullnetare, mundëson implementimin e këtij rekomandimi. Me lidhjen e kontratës për punë vullnetare, institucioni arsimor nuk merr përsipër obligime financiare për mësimdhënësit vullnetarë. Por, në anën tjetër, mësimdhënësi vullnetar do të pranohet pasi të kalojë në një intervistë me konkurs të veçantë dhe me kundërkandidatë. Mësimdhënësi vullnetar pranohet me qëllim të realizimit të punëve dhe detyrave të parapara për realizimin e mësimin në distancë, e-learning. Për realizimin e kësaj platforme mësimdhënësi dhe

mësimdhënësi vullnetar do të ndihmohej nga koordinatori i shkollës, paraprakisht i përzgjedhur në mënyrën më profesionale.

- *Mësimdhënësit deri në moshën 50 vjeçe të përfshihen në aftësim profesional që ka të bëjë me ndryshimet rrënjësore në metodat e mësimdhënies nëpërmjet teknologjive të reja dhe të përfshihen në mësimin gjatë gjithë jetës*

Organizata profesionale, e akredituar nga një organ i pavarur ndërkombëtar, do ta hartojë programin afatgjatë për përgatitjen e kuadrove arsimore aktuale të moshës së cekur, për implementimin e mësimin në distancë, e-learning. Kjo organizatë (e mund të jenë edhe në numër më të madh) duhet t'i pranojë përgjegjësitë e veta për përmbushjen e kritereve dhe suksesin që do ta kenë mësimdhënësit e certifikuar për platformën e-learning. Kontrolli i vazhdueshëm nga përgjegjësit shtetërorë të arsimit do të garantojë që implementimi i kësaj reforme në arsim të sjellë rezultatet e para pas gjeneratës së parë, e cila e përfundon ciklin e vet arsimor. Implementimi i saj mund të fillojë si pilot projekt në disa shkolla të Prishtinës e më gjerë.

- *Të akreditohen programe specifike për mësimdhënësit, të cilëve u japin kredi me të cilat e rriten pagat*

Implementimi i suksesshëm i kësaj platforme duhet të ndikojë domosdoshmërisht në rritjen e pagës së mësimdhënësit, i cili përfundon trajnime profesionale të mësimdhënies në distancë. Kjo do t'i motivojë mësimdhënësit për punë edhe më të përkushtuar dhe

arritjen e suksesit të mirëfilltë të nxënësve. Programet e akredituara garantojnë që mësimdhënësi të jetë ngritur në mënyrë sa më profesionale për mësimdhënie në distancë. Kjo tregohet me rezultatet e pyetësorëve, të cilët kanë përfshirë variablat e pavarura: *përdorimi i PC, qasja në internet, e-mail, komunikimi, interneti për ngritje profesionale, platforma online dhe vlerësimi*. Për realizimin e këtij rekomandimi, përgjegjës do të ishte Agjencia Kosovare e Akreditimit (AKA).

*vi) Nxitja e të mësuarit në distancë shtron nevojën e rritjes së burimeve financiare për sistemin arsimor në Kosovë*

Sistemi arsimor që do të fillojë me implementimin e platformës së nxënies në distancë, e-learning, kërkohet të ketë buxhet të veçantë financiar, me ç'gjë në mënyrë të pavarur do të bënte investimet në pikat kyçe. Dhënia e përgjegjësisë direkte bie në menaxherin e shkollës dhe koordinatorin, të cilët e përcjellin në mënyrë të vazhdueshme implementimin e të nxënit në distancë, e-learning. Qeveria është kompetente për ndarjen e burimeve financiare si garanci për nxitjen e të mësuarit në distancë.

*vii) Nxitja e të mësuarit në distancë e shtron nevojën e krijimit të infrastrukturës adekuate në shkolla dhe digjitalizimin e teksteve shkollore, lekturave shkollore, si dhe materialeve tjera përcjellëse*

Për implementimin e suksesshëm të mësimdhënies dhe nxënies në distancë, e-learning, është e nevojshme që institucioni arsimor parauniversitar apo universitar të bëjë

ndërhyrjet e nevojshme për krijimin e infrastrukturës adekuate që mundëson realizimin pa pengesa të kësaj platforme. Ky është aset shtetëror, investimi mbi të cilin garanton sukses gjeneratave të reja për ekuivalentim të njohurive të zëna të nxënësve (studentëve) si në vendet e zhvilluara.

Implementimi i platformës e-learning kërkon domosdoshmërisht që tekstet shkollore, lekturat adekuate dhe materiali tjetër përcjellës të atij profili të jenë të digjitalizuara në mënyrë që nxënësit (studentët) kudo dhe kurdo ta kenë librin në formë elektronike (e-libri), si dhe bibliotekën elektronike (e-bibliotekën), të cilat janë përshkruar në kapitullin e dytë në këtë disertacion.

*viii) Nxitja e të mësuarit në distancë shtron nevojën e themelimit të një institucioni të pavarur arsimor që përgatit mësimnxënie nga distanca (distance learning), nëpërmjet e-mësimit (e-learning) dhe m-mësimit (m-learning)*

*ix) Nxitja e të mësuarit në distancë sugjeron rritjen e pagave si një iniciativë e domosdoshme*

*x) Nxitja e të mësuarit në distancë kërkon edhe përshtatjen e kuadrit rregullator, kodin e sjelljes për nxënësin, mësimdhënësin, prindin, komunitetin, si dhe çdo person tjetër të tretë që lidhet me edukimin dhe arsimimin e gjeneratave të reja*

Për implementimin e suksesshëm të të nxënësve në distancë, e-learning kalon nëpër shkallë të cilat nuk janë lehtë të implementueshme. Investimet në këtë fushë kërkojnë bartje dhe kalim të përgjegjësive të nxënësit, mësimdhënësit, prindërit dhe të gjithë personat tjerë,

të cilët kanë lidhshmëri direkte apo indirekte në mbarëvajtjen e kësaj platforme, e cila si rezultat duhet ta ketë suksesin e nxënies së mirëfilltë. Për këtë duhet të formulohen edhe rregullore të veçanta, të cilat parashohin kodin e mirësjelljes, përgjegjësinë, bartjen e pasojave në rast të mospërbushjes së kërkesave dhe kriterëve, të cilat i kërkon medoemos ky lloj i të nxëniet. Në fakt, kjo platformë ka të bëjë edhe me edukimin dhe jo vetëm me arsimimin e të rinjve. Jodomsdoshmërisht platforma përdoret si e pavarur. Ajo rekomandohet që të jetë e kombinuar me mësimin tradicional, në mënyrë që të ruhet motivi i nxënësve dhe mësimdhënësve. Të gjitha këto duhet të parashihen në mënyrë të detajuar me rregullore të veçanta, të cilat miratohen nga organet e posaçme të akredituara, të cilat njëherësh janë edhe përgjegjëset kryesore për sukses të gjeneratave të reja.

*xi) Nxitja e të mësuarit në distancë në sistemin universitar kërkon forcimin e kriterëve për pranimin e studentëve në kolegje dhe në universitete*

Institucionet arsimore nuk mund të jenë gjithnjë bartëse të përgjegjësive për trajnime dhe aftësi profesionale të mësimdhënësve aktualë. Gjeneratat e reja, të cilat do të zgjedhin për studim fakultetet për mësimdhënie, duhet t'u nënshtrohen kriterëve të veçanta për pranim në fakultetet e tilla. Komisioni për pranime të tilla duhet të jetë plotësisht i pavarur dhe i papenguar nga kushdo qoftë për pranim të studentëve që vërtet i plotësojnë kushtet, e jo i përmbushin kriteret tjera si deri më tani. Komisionet e tilla do të mbajnë përgjegjësi kombëtare në rast të devijimeve të cilësdo natyrë që ndikon direkt apo indirekt në pranimin e këtyre studentëve. Vendet eventuale boshe do të plotësohen nga gjeneratat e

## Menaxhimi i institucioneve arsimore me mësimnxënie në distancë: e-learning

---

ardhshme, të cilat bëjnë strategjinë afatgjatë për kërkesat që i ka tregu kosovar në fushën e arsimit dhe edukimit, në përgjithësi, e të mësimin në distancë, e-learning, në veçanti.

## Burimet dhe bibliografia

Literatura: libra, artikuj shkencorë dhe materiale tjera

Agjencia, 2016 Marrë nga: <http://aaaparr.rks-gov.net>, parë më 05. 5. 2016

AKA, 2016, Marrë nga: (<http://www.akreditimi-ks.org/docs/NewsPublications/ENQA%20grants%20KAA%20full%20membershi p.pdf> parë më 05. 5. 2016)

Aleksic Zvonko, Corel Draw12, 2005, Çaqak, Serbi

Almooc, 2016, Marrë nga: [www.almooc.com](http://www.almooc.com) parë më, 09. 4. 2016

Anderson W.Lorin, Mësimdhënia e të mësuarit, 2013, Selanik, Greqi

Ang. 2016, Marrë nga: (<http://anglisht.almooc.com/v2/> parë më, 29. 4. 2016

BEP, (2015), “Ndikimi i të nxëniet nga shtëpia në ngritjen e rezultateve në mësim”  
Marrë nga [http://bep-ks.org/wp-content/uploads/2016/03/HV\\_Ndikimi-i-t%C3%AB-nx%C3%ABnit-nga-sht%C3%ABpia-n%C3%AB-ngritjen-e-rezultateve-n%C3%AB-m%C3%ABsim.pdf](http://bep-ks.org/wp-content/uploads/2016/03/HV_Ndikimi-i-t%C3%AB-nx%C3%ABnit-nga-sht%C3%ABpia-n%C3%AB-ngritjen-e-rezultateve-n%C3%AB-m%C3%ABsim.pdf) (parë më, 15.5.2016)

Beqiri Ramadan, Detyra të zgjidhura nga fizika, 2007, Prishtinë, Kosovë

Beqiri Ramadan, Marrë nga: [http://www.skaponline.com/Articles/31/Images/31-07-2015/311202\\_e-conference\\_Proceeding\\_20-09-16.pdf](http://www.skaponline.com/Articles/31/Images/31-07-2015/311202_e-conference_Proceeding_20-09-16.pdf) parë më 10. 8. 2016, 397-406

Beqiri Ramadan, Menaxhimi i planifikimit në mësimdhënie, mësimnxënie dhe vlerësim nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në institucionet e arsimit në Kosovë, (Mikrotezë), 2010, Prishtinë, Kosovë

Beqiri Ramadan, Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit 1, 2008, Prishtinë, Kosovë

Blackboard 2016, Marrë nga: <http://uki.blackboard.com> (parë më 26. 4. 2016)



Burns Mary, Distance Education for Teacher Training: Modes, Models, and Methods, 2011, Washington, SHBA

Cedefop, Marrë nga: <http://www.cedefop.europa.eu/en> , (parë më 14.6. 2016

Celebiq Gorana, Obrada teksta – Microsoft Word 2010, 2012, Zagreb, Kroaci

Corry Michael, e-Learning Strategy, 2007, Santa Rosa, Kanada, SHBA

Cox Joyce, Brzi tecaj za Microsoft Office 2000, 1999, Lublanë, Slloveni

Craft A. Continuing Professional Development: A Practical Guide for Teachers and Schools, 2000, Londër, Britani e Madhe

Dauti Bardhyl, Mikroekonomia me kalkulim, 2008, Tetovë, Maqedoni

Dervisholli Haxhere, Trajnimi i mësimdhënësve për programin e ECDL-it, 2013, Prishtinë, Kosovë

Dika Agni, Algoritmet, 2007, Prishtinë, Kosovë

Dika Agni, Informatika 9, 2003, Prishtinë, Kosovë

Dika Agni, Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit 10, 2004, Prishtinë, Kosovë

DistanceLearning, 2016), Marrë nga:

(<http://www.godistancelearning.com/history-of-distance-learning.html> (parë më, 22. 4. 2016)

Ecdl-Kosova, 2016 Marrë nga: <http://ecd1-kosova.org/category/individe-kompani/#> (parë më, 28. 4. 2016)

Edupoint, 2016. Marrë nga: <http://www.edupoint.com/> (parë më 22. 3. 2016)

Education, 2016, Marrë nga <http://education.smarttech.com/en> (parë më, 30 prill 2016)

Edukimi, 2016, Marrë nga: <http://www.edukimi.net/> (parë më, 22. 4. 2016)

elearningIndustry, 2016 Marrë nga: <http://elearningindustry.com/the-history-of-distance-learning-infographic> (parë më, 15. 5. 2016)

Encarta, Marrë nga: <https://www.britannica.com/topic/Encarta> (parë më, 23. 4. 2016).

Epignosis LLC, E-learning concepts, trends, applications, 2014, Kalifornia, SHBA

Epoka, 2016 Marrë nga:  
[http://www.epoka.edu.al/new/mat/self\\_evaluation\\_report\\_.pdf](http://www.epoka.edu.al/new/mat/self_evaluation_report_.pdf) (parë më 4. 5. 2016)

European Schoolnet, (2016) – The gateway to education in Europe Marrë nga:  
<http://www.eun.org/home> (parë më, 09.4. 2016)

Fiz, 2016, Marrë nga: <http://fizike.almooc.com/v2/> parë më, 28. 3. 2016

Fochler, S, Karagiannis D., Kotauczek J., Nemetz M., eduWeaver – A courseware tool , University of Vienna, Faculty of Computer Science, Department of Knowledge and Business Engineering, Brünner Vienna, Austri, 2006. Marrë nga:  
[http://edubite.dke.univie.ac.at/downloads/eduWeaver-a\\_courseware\\_tool.pdf](http://edubite.dke.univie.ac.at/downloads/eduWeaver-a_courseware_tool.pdf)  
(parë më 11. 3. 2016)

Gaebel, Michael, E-learning in european higher education institutions, 2014, Bruksel, Belgjikë

Gerbault Jeannine, “TIC et diffusion du français: des aspects sociaux, affectifs et cognitifs aux politiques linguistiques”, L’harmattian, 2002, Paris, Francë

GIZ, Komunikimi, Marrëdhëniet dhe Menaxhimi, 2012, Prishtinë, Kosovë

Globalization, 2016, Marrë nga:  
(<http://www.globalization101.org/uploads/File/Culture/cultall.pdf> (parë më, 21.8.2016),

Glušac Dragana, Elektronsko ucenje, 2012, Zrenjanin, Serbi

Gojkov Grozdanka, Kvalitativna istraživačka paradigma u pedagogiji, 2007, Vrsac, Serbi, 131- 137

Perry Greg, Microsoft Office 2003, 2004, Cacak, Serbi

Gollob Rolf, Edukimi për demokraci, Belgjikë

Gutenberg, 2016, Marrë nga: (<http://www.gutenberg.org/> (parë më 06 maj 2016).

Gjeçovi Shtjefën, 1993, Kanuni i Leke Dukagjinit, Shkoder, Shqipëri,

Hall Nathan, Marrë nga: [https://www.tru.ca/\\_shared/assets/Nathan\\_Hall\\_-\\_The\\_Landscapes\\_of\\_Technology\\_in\\_Language\\_Education\\_Theory\\_Knowledge\\_and\\_Practice26974.pdf](https://www.tru.ca/_shared/assets/Nathan_Hall_-_The_Landscapes_of_Technology_in_Language_Education_Theory_Knowledge_and_Practice26974.pdf) (parë më 15. 5. 2016)

Hamelton, R. K., & Patsula, L. (1999). Increasing the validity of adapted test: Myths to be avoid and guidelines for improving test adaption practice. Marrë nga: [www.testpublishers.org](http://www.testpublishers.org) (parë më 15. 8. 2016)

Hermods, 2016

<https://books.google.com/books?id=UF2uBAAQBAJ&pg=PT30&lpg=PT30&dq=Hans+Hermods+1890&source=bl&ots=dbNtLWsbJm&sig=NIIyoPcql6ynEz6NhuENV2BWFKY&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEwj9g7z46KXMAhUBESwKHbFnAyAQ6AEIHDA#v=onepage&q=Hans%20Hermods%201890&f=false> (parë më, 23. 4. 2016)

Hodge Elizabeth (2006), Marrë nga: [http://itdl.org/journal/dec\\_06/Dec\\_06.pdf](http://itdl.org/journal/dec_06/Dec_06.pdf) (parë më 15. 5. 2016)

Holcombe Rebecca, Guidelines for Home Study in Vermont, Barre, Vermont, SHBA

Horton William, Illustrating computer documentation, 2001, Boulder, Kolorado

Iml, History, Marrë nga:

(<http://iml.jou.ufl.edu/projects/spring01/declair/history.html> (parë më, 04. 4. 2016)

Iversity, 2016, Marrë nga: <https://iversity.org/blog/the-birth-of-distance-learning/> (parë më, 10. 8. 2016)

Jakupi Ali, Metodologjia e punës shkencore kërkimore, Prishtinë, Kosovë

Kasimati Mimoza, Sjellje organizative, 2010, Tiranë, Shqipëri

Kasumi Bekim, Doracak për ECDL, 2005, Prishtinë, Kosovë

Kelmendi Shyqri, Bazat e informatikës, 2010, Mitrovicë, Kosovë

Kimi, 2013 Marrë nga: <http://kimia.almooc.com/v2/> (parë më, 23. 3. 2016)

Klasic Ksenija, Uvod u uredsko poslovanje, 2004, Zagreb, Kroaci

Knoblauch, J, Učenje ne mora biti mučenje, 2001, Zagreb, Kroaci

Kodim, 2016 Marrë nga: <http://almooc.com/kodim/> (parë më, 24. 3. 2016)

Kuleto Valentin, e-learning, e-učenje, 2013, Beograd, Serbi

Learndirect, 2016, Marrë nga: <http://www.learndirect.com/store/office-computing/ecdl> (parë më 19. 8. 2016)

Ligjerata, 2016 Marrë nga: <https://www.youtube.com/watch?v=MNfKPTThYTBU> (parë më, 21. 8. 2016),

Ligji ALK, 2016, <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/2-ligji-per-arsimin-e-larte.pdf> parë më 05. 5. 2016

Ligji Kroat, 2016)

([https://www.pravo.unizg.hr/download/repository/Nacrt\\_prijedloga\\_zakona\\_o\\_vi\\_sokom\\_obrazovanju.pdf](https://www.pravo.unizg.hr/download/repository/Nacrt_prijedloga_zakona_o_vi_sokom_obrazovanju.pdf)) parë më 01. 5. 2016

LMS, 2016, Marrë nga: <http://lms.southcentralpartnership.org/lmsusermanual.pdf> (parë më 15. 5. 2016)

Llaci Shyqyri, Qeverisja e korporatave, 2012, Tiranë, Shqipëri

Maksimović, J, Researcher-practitioner's role in action research, (The Andragogic Perspectives), nr. 2, 2012, Lublanë, Slloveni

Maliqi Rashit, Ushtrime interaktive dhe laboratorike nga Fizika, 2002, Prishtinë, Kosovë

Mandić, Danimir., Didaktičko-informatičke inovacije u obrazovanju, 2003, Beograd, Serbi

Marjanović Radovan, Geodezija za rudare i geologe, 2008, Zagreb Kroaci

Markja Albana, Mësimdhënia dhe të nxëniet në edukimin joformal, 2006, Tiranë, Shqipëri

Mat, 2016 Marrë nga: <http://matematike.almooc.com/v2/> (parë më, 29.4.2016)

Mattheews Bob, Metodot e hulumtimit, 2012, Tiranë, Shqipëri

Mattheis Carmen, Shkolla e mirë, Zhvillimi i Kapaciteteve në Udhëheqjen Arsimore 2012, Prishtinë, Kosovë

Maturski.org, 2016, WebCT alat za e-učenje. Marrë nga:

<http://www.seminarski-diplomski.co.rs/INTERNET-WEB/WebCTalatZaE-ucenje.html> (parë më, 21 gusht 2016)

McQuiggan Scott, Mobile learning, 2015, Cary, Karolina Veriore

Michael W. Allen, Designing Successful e-Learning, 2007, San Francisko, Kaliforni

Miller Herman -Company, 2011, fq. 5-6

Musai Bardhyl, Metodologji e mesimdhënies, Tiranë, Shqipëri

Myers, J.H., Mullet, G.M. (2003). Managerial Applications of Multivariate Analysis in Marketing. American Marketing Association.

Nektari, 2015, Marrë nga: <http://nektari.almooc.com> (parë më, 24. 6. 2015)

Neto Pedro, The e-Learning Café project of the University of Porto, 2013, Porto, Portugali

Oblinger G. Diana, Learning Spaces, 2006, Washington, SHBA

Olson Jennifer, An Analysis of e-Learning Impacts & Best Practices in Developing Countries, 2011, Michigan

Osman Mohamed (2010), Marrë nga: [http://www.ifets.info/journals/13\\_3/3.pdf](http://www.ifets.info/journals/13_3/3.pdf) (parë më 15. 5. 2016)

Osmani Nexhmie, 2000 Reformat ne arsimin e Kosovës 2000-2010. Marrë nga: <http://www.germ-a.com/?p=1921> parë më, 05. 8. 2016)

Pallant, J., SPSS Priručnik za preživljavanje – postupni vodič kroz analizu podataka pomoću SPSS-a za Windows, 2009, Mikro knjiga, Beograd, SRB

Parliament, 2016, Marrë nga: (<http://www.parliament.uk/about/living-heritage/transformingsociety/livinglearning/school/overview/1870educationact/>) parë më, 04. 8. 2016

Perry Greg, Microsoft Office 2003, 2004, Çaqak, Serbi

Pešić. M. Pedagogija u akciji, 2004, Beograd, Serbi

Pink H. Daniel, The New Social Learning, 2010, San Francisco

Pitman Isaac, Modern Course, Marrë nga: [http://sokkidouraku.com/t28/pitman\\_cs.pdf](http://sokkidouraku.com/t28/pitman_cs.pdf) (parë më 07. 5. 2016), 3-7

Pitmans Isaac, Shorthand instructor, 1919, New York, Marrë nga: <http://booksnow1.scholarsportal.info/ebooks/oca4/46/isaacpitmansshor00pitm/isaacpitmansshor00pitm.pdf> (parë më 07. 5. 2016)

Pogledaj, 2016, Marrë nga: <http://pogledaj.to/arhitektura/skola-bez-zidova-buducnost-obrazovanja/> parë më, 30. 4. 2016

Prensky Marc, EDUCAUSE Learning Initiative, 2006, San Diego, Kanada

PTK, 2016, Marrë nga: (<http://www.postakosoves.com/?page=1,91> (parë më 15. 5. 2016)

Published by the Ultranet and Digital Learning Branch Department of Education and Early Childhood Development, 2012, Melbourne

QK, 2016, Strategjia e qeverisjes elektronike 2009-2015 Marrë nga: ([http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA\\_E\\_QEVERISJES\\_ELEKTRONIKE\\_2009\\_2015.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_E_QEVERISJES_ELEKTRONIKE_2009_2015.pdf) (parë më, 22. 4. 2016)

Quivy Raymond, Manuel de recherche en sciences sociales, Paris, Francë, 1995

Rgvision, 2016, Marrë nga: <http://rgvisionmagazine.com/2013/08/evolving-classrooms-for-21st-century-learning/> (parë më, 30. 4. 2016)

Robbins P.Stephen, Bazat e menaxhimiti, 2012, Tiranë, Shqipëri

Rodek Stjepan, Kompjuter i suvremena nastavna tehnologija, 1986, Zagreb, Kroaci

Rotim Ivana, Kako poducavati, 2014, Split, Kroaci

Rumble Grevilre, The management of distance learning systems, 2002, Paris, Francë

Saliba Gina, Fundamentals of Blended Learning, 2013, Published by the Ultranet and Digital Learning Branch Department of Education and Early Childhood Development, 2012, Melbourne, Australi

Skenderi S. Besnik, SPSS, 2016, Prishtinë, Kosovë

Skenderi Skender, Interneti, 2000, Prishtinë, Kosovë

Skenderi Skender, Microsoft Excel 2000, 2000, Prishtinë, Kosovë

Skenderi Skender, Microsoft word 2000, 2000, Prishtinë, Kosovë

Smart, 2016 <http://education.smarttech.com/en/products/smart-table>

Staker Heather, Classifying K-12 Blended Learning, 2012, Marrë nga:

<http://www.christenseninstitute.org/wp-content/uploads/2013/04/Classifying-K-12-blended-learning.pdf> (parë më 28. 10. 2016)

Stenhouse Lorence, Introduction to Curriculum Research and Development, 1975  
Londër, Britani e Madhe

Stoll L, Mijenjajmo naše škole. 2000, Zagreb, Kosovë

Students' Union, 2016 Marrë nga: <https://www.qmsu.org/learningcafe/> (parë më, 30. 4.2016)

Sheron T, Boettcher V, Distance Learning: The Shift to Interactivity, 1997, SHBA

TeamViewer, 2016, Marrë nga:

([https://www.teamviewer.com/download/teamviewer\\_manual.pdf](https://www.teamviewer.com/download/teamviewer_manual.pdf) (parë më 03. 5. 2016)

TIK, 2016, Marrë nga: <http://tik.almooc.com/v2/> (parë më, 23. 3. 2016)

Torres Jozenia (2010), Nga "Student demographics and success in online learning environments" Emporia, Vol. 46, fq.5

Torres Michael, Theodore Roosevelt: A Teacher's Guide, 2009, Texas, SHBA

Trejs Brajan, Zlatna pravila za uspjeh, Marrë nga:

[http://all4hope.weebly.com/uploads/5/9/7/5/5975947/zlatna\\_pravila\\_1.pdf](http://all4hope.weebly.com/uploads/5/9/7/5/5975947/zlatna_pravila_1.pdf) , (parë më 20. 8. 2016)

Forster Thomas, 2016) (<http://explorepahistory.com/hmarker.php?markerId=1-A-37B>) (parë më 23. 4. 2016)

UNDP, 2015 <http://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/SAEK/manual-layout-Shqip.pdf>

UNESCO, Education Strategy 2014-2021, 2014, Paris, Francë, 33-34



UP, 2016. Marrë nga: <http://www.uni-pr.edu/Universiteti/Historiku.aspx> (parë më, 05. 8. 2016).

Vangjeli Gjergji, Edukimi për shoqërinë 1, 2010, Tiranë, Shqipëri

Viktoria, 2012, Marrë nga:

<http://www.education.vic.gov.au/Documents/about/research/blendedlearning.pdf>  
(parë më 10.8.2016)

Vukiq Radmila, Aplikativni softver, 2012, Beograd, Serbi

Walden University (2016) Marrë nga:

(<http://www.distancelearningportal.com/universities/10396/walden-university.html>) (parë më, 07. 5. 2016)

Warner D. Nancy, Excel 200-Kao od sale, 2000, Çaqak, Serbi

WebCt, Marrë nga: (<http://www.mdc.edu/ctd/webct/whatis.htm>) (parë më, 21. 8. 2016)

Wikipedia, 2016, Marrë nga: [www.wikipedia.org](http://www.wikipedia.org) (parë më, 23. 4. 2016)

WikipediaShqip, 2016, Marrë nga:

([https://sq.wikipedia.org/wiki/Radio\\_Televizioni\\_Shqiptar](https://sq.wikipedia.org/wiki/Radio_Televizioni_Shqiptar)) (parë më 15. 5. 2016).

Winter Helen, Pasuria e kombeve-Adam Smith, 2006, Tiranë, Shqipëri

Yamane Taro, (1967), "Elementary Sampling Theory", New Jersey: Prentice-Hall, Inc, Englewood Cliffs.

Zajmi Ilire, Pamjet televizive dhe realiteti, Prishtinë, Kosovë

Zhuro Dunja, mësimi në distancë nëpërmjet video konferencës në relacionin: shf."Majstora Radovana Trogir-pro Veli Drvenik, 2004, Trogir, Kroaci

**UEB-LITERATURA:**

<http://www.efrontlearning.net/>, (parë më 15. 5. 2016)

<http://www.testpublishers.org/>, (parë më 19. 5. 2016)

<http://www.it-akademija.com/>, (parë më 21. 5. 2016)

<http://eucenje.efst.hr/teritoriji-e-ucenja/>, (parë më 12. 6. 2016)

<https://webgate.ec.europa.eu>, (parë më 15. 5. 2016)

<http://ec.europa.eu/>, (parë më 18. 4. 2016)

[http://ec.europa.eu/dgs/scic/working-with-interpreters/index\\_hr.htm](http://ec.europa.eu/dgs/scic/working-with-interpreters/index_hr.htm), (parë më 25. 5. 2016)

<http://www.eden-online.org/>, (parë më 25. 6. 2016)

<http://mysite.du.edu/~kkeairns/de/Text/Lessons/Lesson1.pdf>, (parë më 15. 5. 2016)

<http://lms.southcentralpartnership.org/>, (parë më 9. 4. 2016)

<http://www.nottingham.ac.uk/index.aspx>, (parë më 10. 4. 2016)

<http://www.eurobrussels.com/education>, (parë më 15. 2. 2016)

<http://www.kcl.ac.uk/index.aspx>, (parë më 15. 1. 2016)

<http://www.britannica.com/>, (parë më 7. 1. 2016)

<http://ec.europa.eu/> (parë më 12. 3. 2016)

<http://almooc.com/>, (parë më 7. 5. 2016)

<http://thinkofit.com/webconf/index.htm>, (parë më 1. 5. 2016)

<http://www.deac.org/>, (parë më 14. 6. 2016)

<http://www.deac.org/Seeking-Accreditation/Online-Training-Center.aspx>, (parë më 14. 6. 2016)

<http://www.efrontlearning.net/tour>, (parë më 15. 4. 2016)

<https://www.avaya-learning.com/lms/#/>, (parë më 15. 4. 2016)

<http://elearningindustry.com/the-history-of-distance-learning-infographic>, (parë më 10. 5. 2016)

<http://www.cdlponline.org/index.cfm?fuseaction=whatis&pg=3>, (parë më 10. 5. 2016)

<http://fshn.eriglangani.al/2016-2017/sisteme-interneti>, (parë më 4. 8. 2016)

<https://www.distance-learning-centre.co.uk/products/168/ecdl-online-course.htm>, (parë më 10. 8. 2016)

<http://www.distancelearningportal.com/universities/10396/walden-university.html>, (parë më 7. 5. 2016)

[https://sq.wikipedia.org/wiki/Wikipedia\\_shqip](https://sq.wikipedia.org/wiki/Wikipedia_shqip), (parë më 23. 4. 2016)

<https://www.britannica.com/topic/Encarta>, (parë më 23. 4. 2016)

<http://www.computer-dictionary-online.org/?q=Free%20Online%20Dictionary%20of%20Computing>, (parë më 25. 3. 2016)

<http://www.edupoint.com/> (parë më 22. 3. 2016)

<http://www.computer-dictionary-online.org/?q=Free%20Online%20Dictionary%20of%20Computing>, (parë më 25. 3. 2016)

<http://uki.blackboard.com/>, (parë më 26. 4. 2016).

<http://www.seminarski-diplomski.co.rs/INTERNET-WEB/WebCTalatZaE-ucenje.html>,  
(parë më 22. 4. 2016)

<http://www.claroline.net/>, (parë më 23. 4. 2016)

<https://moodle.org/>, (parë më 6. 5. 2016)

<http://education.smarttech.com/en>, (parë më 30. 4. 2016)

([https://www.google.com/search?q=Smart+tabela&source=Inms&tbm=isch&sa=X&ved=0ahUKEwjasKK02NLOAhXGtRQKHRGWAbOQ\\_AUICigD&biw=1366&bih=610#tbm=isch&q=smart+table&imgcr=FmQHBrkC4-sSM%3A](https://www.google.com/search?q=Smart+tabela&source=Inms&tbm=isch&sa=X&ved=0ahUKEwjasKK02NLOAhXGtRQKHRGWAbOQ_AUICigD&biw=1366&bih=610#tbm=isch&q=smart+table&imgcr=FmQHBrkC4-sSM%3A)), (parë më 21. 8. 2016)

[https://www.teamviewer.com/download/teamviewer\\_manual.pdf](https://www.teamviewer.com/download/teamviewer_manual.pdf), (parë më 3. 5. 2016)

[https://www.teamviewer.com/download/teamviewer\\_manual.pdf](https://www.teamviewer.com/download/teamviewer_manual.pdf), (parë më 3. 5. 2016)

<http://www.talentlms.com/elearning/elearning-101-jan2014-v1.1.pdf>, (parë më 14. 5. 2016)

<http://eruditiollc.com/2015/05/why-elearning-is-your-best-choice/>, (parë më 4. 8. 2016)

<http://iml.jou.ufl.edu/projects/spring01/declair/history.html> (parë më 15. 5. 2016)

<http://elearningindustry.com/the-history-of-distance-learning-infographic>, (parë më 15. 5. 2016)

<http://www.godistancelearning.com/history-of-distance-learning.html>, (parë më 22. 4. 2016)

<https://iversity.org/blog/the-birth-of-distance-learning/>, (parë më 4. 8. 2016)

[https://sq.wikipedia.org/wiki/Radio\\_Televizioni\\_Shqiptar](https://sq.wikipedia.org/wiki/Radio_Televizioni_Shqiptar), (parë më 15. 5. 2016)

[file:///C:/Users/bel/Desktop/PHD/PUNIMI/TEMA/LIGJET%20E%20ARSIMIT/Nacrt\\_prijedloga\\_zakona\\_o\\_visokom\\_obrazovanju.pdf](file:///C:/Users/bel/Desktop/PHD/PUNIMI/TEMA/LIGJET%20E%20ARSIMIT/Nacrt_prijedloga_zakona_o_visokom_obrazovanju.pdf) (parë më 1. 5. 2016).

<http://www.wired.com/2012/07/50th-anniversary-telstar-1/>, (parë më 5. 8. 2016)

<http://elearningindustry.com/the-history-of-distance-learning-infographic>, (parë më 22. 4. 2016)

<http://explorepahistory.com/hmarker.php?markerId=1-A-37B>, (parë më 23. 4. 2016)

<https://books.google.com/books?id=UF2uBAAAQBAJ&pg=PT30&lpg=PT30&dq=Hans+Hermods+1890&source=bl&ots=dbNtLWsbJm&sig=NIIyoPcql6ynEz6NhuENV2BWFKY&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEwj9g7z46KXMAhUBESwKHbFnAyAQ6AEIHDAA#v=onepage&q=Hans%20Hermods%201890&f=false>, (parë më 23. 4. 2016)

<http://www.postakosoves.com/?page=1,91>, (parë më 15. 5. 2016)

<http://unesdoc.unesco.org/images/0023/002312/231288e.pdf>, (parë më 30. 4. 2016)

<http://rgvisionmagazine.com/2013/08/evolving-classrooms-for-21st-century-learning/>,  
(parë më 30. 4. 2016)

<https://www.qmsu.org/learningcafe/>, (parë më 30. 4. 2016)

<http://pogledaj.to/arhitektura/skola-bez-zidova-buducnost-obrazovanja/>, (parë më 30. 4. 2016)

<http://www.germ-a.com/?p=1921> (parë më 5. 8. 2016)

<http://www.uni-pr.edu/Universiteti/Historiku.aspx>, (parë më 5. 8. 2016)

<http://www.talentlms.com/elearning/elearning-101-jan2014-v1.1.pdf>, (parë më 15. 5. 2016)

[http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA\\_E\\_QEVERISJES\\_ELEKTRONIKE\\_2009\\_2015.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_E_QEVERISJES_ELEKTRONIKE_2009_2015.pdf), (parë më 22. 4. 2016)

[http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA\\_E\\_QEVERISJES\\_ELEKTRONIKE\\_2009\\_2015.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_E_QEVERISJES_ELEKTRONIKE_2009_2015.pdf), (parë më 22. 4. 2016)

[www.google.com](http://www.google.com), (parë më 10. 8. 2016)

[www.almooc.com](http://www.almooc.com), (parë më 9. 4. 2016).

<http://anglisht.almooc.com/v2/>, (parë më 29. 4. 2016)

<http://www.akreditimi-ks.org/new/index.php/sq/>, (parë më 9. 5. 2016)

<http://almooc.com/kodim/>, (parë më 24. 3. 2016)

<http://matematike.almooc.com/v2/>, (parë më 29. 4. 2016)

<http://fizike.almooc.com/v2/>, (parë më 28. 3. 2016)

<http://kimia.almooc.com/v2/>, (parë më 23. 3. 2016)

<http://tik.almooc.com/v2/>, (parë më 23. 3. 2016)

<http://www.globalization101.org/uploads/File/Culture/cultall.pdf>, (parë më 21. 8. 2016)

<https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/2-ligji-per-arsimin-e-larte.pdf>, (parë më 5. 5. 2016):

<http://www.learndirect.com/store/office-computing/ecdl>, (parë më 19. 8. 2016)

## SHTOJCA

### Pyetësi P1.

Pyetësi për mësimdhënës

I/e nderuar koleg/e

Jam duke e kryer një hulumtim lidhur me mësimin nga distanca, e-learning. Ju jeni zgjedhur në mënyrë të rastësishme që të jeni pjesë e këtij hulumtimi. Të dhënat tuaja janë konfidenciale dhe përgjigjet në pyetjet në vijim nuk vlerësohen gabimisht apo saktë. Ju thjesht e jepni opinionin tuaj, i cili pa dyshim se do të më ndihmojë për nxjerrjen e konkluzioneve që kanë të bëjnë me mësimin nga distanca. Paraprakisht ju falënderoj!

1. Ku jetoni: (Rretho shkronjën nën opsionin e ofruar)	Prishtinë	Afër Prishtinës	Në fshat (komuna Prishtinë)	Jashtë Prishtinës
	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	<b>D</b>
2. Sa vjeç jeni?:				
3. Sa vjet keni përvojë pune në arsim?				
4. E përdorni kompjuterin në shtëpi apo shkollë?	<b>Po</b>		<b>Jo</b>	
5. Keni qasje në internet?	<b>Po</b>		<b>Jo</b>	
6. Sa gjatë e përdorni postën elektronike? (rrethoni shkronjën nën opsionin e dhënë)	Nuk e përdor fare	Rrallë e përdor, një herë në javë	E përdor disa herë gjatë ditës	
	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	
7. A e përdorni e-postën për të komunikuar me nxënës?	<b>Po</b>		<b>Jo</b>	
8. A e përdorni internetin për ngritje profesionale? (rrethoni shkronjën nën opsionin e dhënë)	Jo	Rrallë	Shpesh	
	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	
9. A keni përdorur ndonjë platformë online për mësim deri tani?	<b>Po</b>		<b>Jo</b>	



Menaxhimi i institucioneve arsimore me mësimnxënie në distancë: e-learning

10. <b>nëse Po</b> , si do ta vlerësoni?( <i>rretho numrin</i> )	<div style="border: 1px solid black; width: 100%; height: 20px; margin-bottom: 5px;"></div> Përdorim <b>1 2 3 4 5</b> Përdorim i vogël i lartë
--	---

Rretho shkronjën nën opsionin e dhënë	Aspak nuk pajtohem	Nuk pajtohem	Jam i pavendosur	Pajtohem	Plotësisht pajtohem
11. Konsideroj se jam mjaft i udhëzuar për mësim në distancë, e-learning.	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	<b>D</b>	<b>E</b>
12. Në të ardhmen interneti do t'i zëvendësojë librat.	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	<b>D</b>	<b>E</b>
13. Në të ardhmen e-mësimi & m-mësimi do të përdoret si kombinim i teknologjisë me metodat tradicionale të të nxënit - mësim i kombinuar (blended learning).	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	<b>D</b>	<b>E</b>
14. Në të ardhmen e-mësimi & m-mësimi plotësisht do ta zëvendësojë mësimin tradicional me klasë virtuale dhe teknika tjera.	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	<b>D</b>	<b>E</b>
15. Pengesa më e madhe për përdorimin e e-mësimit & m-mësimit është mosnjohja e teknikave.	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	<b>D</b>	<b>E</b>

16. Cilat mjete teknologjike i përdorni për aftësim të mësimit në distancë?( <i>rretho shkronjën nën mjetin teknologjik, mund të rrethoni disa apo asnjë, varësisht nga përdorimi</i> ).	CD-ROM, DVD-ROM, Flash	Blog, wiki ose sistem burim tjetër të hapur	Forum, chat, fb rrjet tjetër social ose të ngjashme	Programe për krijimin e ueb-faqeve	Sistem video-konferencash
	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	<b>D</b>	<b>E</b>

Menaxhimi i institucioneve arsimore me mësimnxënie në distancë: e-learning

<p>17. Çfarë konsideroni të jetë lajmi më i madh i e-mësimit karshi mënyrave tradicionale të të mësuarit? Përgjigjet i rangoni sipas çelësit vijues:  <i>1 – Pajtohem plotësisht,</i>  <i>2 – Pak pajtohem,</i>  <i>3 – Pjesërisht pajtohem,</i>  <i>4 – Nuk pajtohem</i></p>	<p>Nuk ofron lajm të veçantë</p>	<p>Mundëson zhvillimin e modeleve pedagogjike inovative</p>	<p>Krijon lidhje të reja komunikimi ndërmjet nxënësve dhe mësimdhënës-nxënës</p>	<p>Jep qasje të reja të objekteve dhe njohurive të arsimit formal</p>
<p>18. A keni përvojë në realizimin e mësimit në distancë ose njohuri për këtë platformë!          (Përshkruajeni me fjalë).</p>				

Ju faleminderit për kontributin Tuaj!

Pyetësi P2.

Pyetësi për nxënës

I/e nderuar nxënës/e

Jam duke e kryer një hulumtim lidhur me mësimin nga distanca, e-learning. Ju jeni zgjedhur në mënyrë të rastësishme që të jeni pjesë e këtij hulumtimi. Të dhënat tuaja janë konfidenciale dhe përgjigjet në pyetjet në vijim nuk vlerësohen gabimisht apo saktë. Ju thjesht e jepni opinionin tuaj, i cili pa dyshim se do të më ndihmojë për nxjerrjen e konkluzioneve që kanë të bëjnë me mësimin nga distanca. Paraprakisht ju falënderoj!

1. Ku jetoni: (Rretho shkronjën nën opsionin e ofruar)	Prishtinë	Afër Prishtinës	Në fshat (komuna Prishtinë)	Jashtë Prishtinës
	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	<b>D</b>
2. Sa vjeç jeni?:				
4. E përdorni kompjuterin në shtëpi apo shkollë?		<b>Po</b>	<b>Jo</b>	
5. Keni qasje në internet?		<b>Po</b>	<b>Jo</b>	
6. Sa gjatë e përdorni postën elektronike? (rrethoni shkronjën nën opsionin e dhënë)	Nuk e përdor fare	Rrallë e përdor, një herë në javë	E përdor disa herë gjatë ditës	
	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	
7. A e përdorni e-postën për të komunikuar me profesor?		<b>Po</b>	<b>Jo</b>	
8. A e përdorni internetin për mësim nga distanca? (rrethoni shkronjën nën opsionin e dhënë)	Jo	Rrallë	Shpesh	
	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	
9. A keni përdorur ndonjë platformë online për mësim deri tani?		Po	Jo	
10. nëse <b>Po</b> , si do ta vlerësoni?(rretho numrin)	_____ Përdorim 1 2 3 4 5 Përdorim i vogël i lartë			

Rretho shkronjën nën opsionin e dhënë	Aspak nuk pajtohem	Nuk pajtohem	Jam i pavendosur	Pajtohem	Plotësisht pajtohem
11. Konsideroj se jam mjaft i udhëzuar për mësim në distancë e-mësim (e-learning), m-mësim (m-learning).	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	<b>D</b>	<b>E</b>
12. Në të ardhmen interneti do të zëvendësoj librat.	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	<b>D</b>	<b>E</b>
13. Në të ardhmen e-mësimi & m-mësimi do të përdoret si kombinim i teknologjisë me metodat tradicionale të të nxënit - mësim i kombinuar (blended learning).	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	<b>D</b>	<b>E</b>
14. Në të ardhmen e-mësimi & m-mësimi, plotësisht do të zëvendësojë mësimin tradicional me klasë virtuale dhe teknika tjera.	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	<b>D</b>	<b>E</b>
15. Pengesa më e madhe për përdorimin e e-mësimit & m-mësimit është mosnjohja e teknikave.	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	<b>D</b>	<b>E</b>

16. Cilat mjete teknologjike i përdorni për aftësim të mësimin në distancë? <i>(rretho shkronjën nën mjetin teknologjik, mund të rrethoni disa apo asnjë, varësisht nga përdorimi).</i>	CD-ROM, DVD-ROM	Blog, wiki ose sistem burim tjetër të hapur	Forum, chat, rrjet social ose të ngjashme	Programe për krijimin e ueb-faqeve	Sistem video-konferencash
	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	<b>D</b>	<b>E</b>
17. Çfarë konsideroni të jetë lajmi më i madh i e-mësimin karshi mënyrave tradicionale të të mësuarit? Përgjigjet i rangoni sipas çelësit vijues: <i>1 – Pajtohem plotësisht, 2 – Pak pajtohem, 3 – Pjesërisht pajtohem, 4 – Nuk pajtohem)</i>	Nuk ofron lajm të veçantë	Mundëson zhvillimin e modeleve pedagogjike inovative	Krijon lidhje të reja komunikimi ndërmjet nxënësve dhe mësimdhënës-nxënës	Jep qasje të reja të objekteve dhe njohurive të arsimit formal	

18. A keni njohuri në mësimin nga distanca ose njohuri për këtë platformë! (Përshkruajeni me fjalë).

Ju faleminderit për kontributin Tuaj!

**Pyetësi P3.**

Pyetësi për prindër

I/e nderuar prind

Jam duke e kryer një hulumtim lidhur me mësimin nga distanca, e-learning. Ju jeni zgjedhur në mënyrë të rastësishme që të jeni pjesë e këtij hulumtimi. Të dhënat tuaja janë konfidenciale dhe përgjigjet në pyetjet në vijim nuk vlerësohen gabim apo saktë. Ju thjeshtë jepni opinionin e juaj, i cili padyshim se do të më ndihmoj për nxjerrjen e konkluzioneve që kanë të bëjnë me mësimin nga distanca. Paraprakisht ju falënderoj!

1. Ku jetoni: (Rretho shkronjën nën opsionin e ofruar)	Prishtinë	Afër Prishtinës	Në fshat (komuna Prishtinë)	Jashtë Prishtinës
	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	<b>D</b>
2. Sa vjeç jeni?				
3. Shkollimi juaj:				
4. Sa fëmijë keni në shkollë (nxënës, studentë)?				
5. Kanë qasje në internet fëmijët e juaj?	<b>Po</b>		<b>Jo</b>	
6. Sa gjatë e përdorin fëmijët e juaj internetin për të mësuar? (rrethoni shkronjën nën opsionin e dhënë)	Nuk e përdor fare	Rrallë e përdor, një herë në javë	E përdor disa herë gjatë ditës	
	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	
7. A e përdorin fëmijët e juaj internetin për të komunikuar me të tjerët?	<b>Po</b>		<b>Jo</b>	
8. A e përdorni internetin për ngritje profesionale? (rrethoni shkronjën nën opsionin e dhënë)	Jo	Rrallë	Shpesh	
	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	
9. A keni njohuri për mësimin në distancë?	<b>Po</b>		<b>Jo</b>	
10. <b>nëse Po</b> , si do ta vlerësoni?(rretho numrin)	_____ Përdorim <b>1 2 3 4 5</b> Përdorim i vogël i lartë			

**Menaxhimi i institucioneve arsimore me mësimnxënie në distancë: e-learning**

Rretho shkronjën nën opsionin e dhënë	Aspak nuk pajtohem	Nuk pajtohem	Jam i pavendosur	Pajtohem	Plotësisht pajtohem
11. Konsideroj se jam mjaft i udhëzuar për mësim në distancë e-learning.	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	<b>D</b>	<b>E</b>
12. Në të ardhmen interneti do të zëvendësoj librat.	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	<b>D</b>	<b>E</b>
13. Në të ardhmen e-mësimi & m-mësimi do të përdoret si kombinim i teknologjisë me metodat tradicionale të të nxënit - mësim i kombinuar (blended learning).	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	<b>D</b>	<b>E</b>
14. Në të ardhmen e-mësimi & m-mësimi, plotësisht do të zëvendësojë mësimin tradicional me klasë virtuale dhe teknika tjera.	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	<b>D</b>	<b>E</b>
15. Pengesa më e madhe për përdorimin e e-mësimit & m-mësimit është mosnjohja e teknikave.	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	<b>D</b>	<b>E</b>
16. Si e vlerëson mësimin në distancë (e-learning) <b>(Përshkruaje me fjalë)</b> .					

Ju faleminderit për kontributin Tuaj!

**Intervistë 1.** (për menaxhment)

I/e nderuar

Tani jam duke e bërë një hulumtim për të nxënit nga distanca, e-learning. Po ju drejtohem me disa pyetje për të marrë opinionin tuaj për çështjet e ngritura. Me përgjigjet tuaja do të ndihmoni shumë që hulumtimi im të jetë sa më i kompletuar. Privatësia juaj është e mbrojtur dhe askund nuk do të përmenden të dhënat tuaja. Paraprakisht ju falënderoj për kohën që e keni ndarë në përmbushjen e obligimit tonë për gjeneratat e reja.

- 7. Sa janë të përgatitur menaxherët e arsimit për zbatimin e platformës së mësimin nga distanca?*
- 8. Ku duhet të ndërhyhet në menaxhimin aktual?*
- 9. Sa janë të përgatitur nxënësit që të mësojnë nga distanca?*
- 10. Sa janë të përgatitur prindërit për t'i lejuar fëmijët e tyre që të studiojnë-mësojnë nga distanca?*
- 11. Sa është e përshtatshme dhe e përgatitur infrastruktura shkollore në Kosovë për këtë model të ri të mësimin?*
- 12. A e ka integritetin e nevojshëm shoqëria kosovare për ta pranuar këtë metodë mësimi?*



**Intervistë 2.** (për komunitet)

I/e nderuar

Tani jam duke e bërë një hulumtim për të nxënit nga distanca, e-learning. Po ju drejtohem me disa pyetje për të marrë opinionin tuaj për çështjet e ngritura. Me përgjigjet tuaja do të ndihmoni shumë që hulumtimi im të jetë sa më i kompletuar. Privatësia juaj është e mbrojtur dhe askund nuk do të përmenden të dhënat tuaja. Paraprakisht ju falënderoj për kohën që e keni ndarë në përmbushjen e obligimit tonë për gjeneratat e reja.

1. *Si e shihni mësimin në distancë: luks, nevojë, akt human apo diçka tjetër?*
2. *Ku duhet të ndërhyhet në menaxhimin aktual?*
3. *Sa është e përgatitur shoqëria jonë kosovare për mësim në distancë, e-learning?*
4. *Sa janë të përgatitur prindërit për t'i lejuar fëmijët e tyre që të studiojnë-mësojnë nga distanca?*
5. *Si do të veproje sikur të ishit personi kyç për fillimin e procesit mësim i kombinuar (blended learning)?*
6. *A keni ndjekur ndonjë mësim, kurs apo program të plotë të mësimin e-learning. Nëse po, përshkruajini përparësitë dhe mangësitë për e-mësim.*